

# INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT



## PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE DREJTUAR AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE GJATË VITIT 2015

Prishtinë, 2016



## **PËRMBAJTJA**

PARATHËNIE.....	6
<b>PRISHTINË, MË 16 JANAR 2015.....</b>	<b>7</b>
ANKESA NR: 542/2013.....	7
Lënda: Rekomandim lidhur me ankesat për pezullimin e kërkesave për realizimin e të drejtave që burojnë nga Ligji për Statusin e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre Ligjin Nr. 04/L-054.....	7
<b>PRISHTINË, MË 29 JANAR 2015.....</b>	<b>22</b>
ANKESA NR. 221/2013.....	22
Çështja:    Zvarritjet procedurale nga gjykata në vendosjen e lëndës C.nr.899/2012, që ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.....	22
<b>PRISHTINË, MË 18 SHKURT 2015.....</b>	<b>36</b>
RASTI NR. 518/2014.....	36
Çështjen e regjistrimit të studentëve të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” për vitin akademik 2014/2015.....	36
<b>PRISHTINË, MË 19 SHKURT 2015.....</b>	<b>102</b>
ANKESA NR. 369/2014.....	102
Çështja: Rekomandim, përkitazi me zvarritjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së z. S. K., z. Rr. M, dhe z. A. H., të datës 17 mars 2014, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të mosbashkëpunimit të MPMS me Avokatin e Popullit.....	102
<b>PRISHTINË, MË 23 SHKURT 2015.....</b>	<b>113</b>
ANKESA NR. 302/2012.....	113
Çështja:    Zvarritja procedurale nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në vendosjen e lëndës SR-11-0315/C-III-12-1993, që ka të bëjë me dorëzimin e patundshmërisë nga KBI “Progres” në Prizren.....	113
<b>PRISHTINË, MË 12 MARS 2015.....</b>	<b>124</b>
ANKESA NR:125/2013.....	124

*PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE DREJTUAR AUTORITETEVE  
PËRGJEGJËSE GJATË VITIT 2015*

---

Lënda: Rekomandime lidhur me ankesat për moszbatimin e vendimeve përfundimtare të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore të Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore, në Komunën e Mitrovicës së veriut.....	124
<b>PRISHTINË, MË 6 MAJ 2015.....</b>	<b>141</b>
ANKESA NR.435/2013.....	141
Lënda: Rekomandim në lidhje me ankesën për moszekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI 187/13, të datës 16 prill 2014.....	141
<b>PRISHTINË, MË 7 MAJ 2015.....</b>	<b>153</b>
RASTI NR. 251/2012.....	153
Lënda: Rekomandime për lirim të hapësirës publike në rrugën ndarëse në mes të objekteve të banimit dhe Parkut Arkeologjik të Kosovës, në rrugën “Ilir Konushëfci”, p.n., në pjesën e mbrojtur të Komunës së Prishtinës.....	153
<b>PRISHTINË, MË 13 MAJ 2015.....</b>	<b>164</b>
ANKESA NR: 602/2014.....	164
Lënda: Rekomandim lidhur me ankesën e z. S. R., për shkak të mosrealizimit të së drejtës në arsim, sipas <i>Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Nr.04/L-149</i> .....	164
<b>PRISHTINË, MË 29 MAJ 2015.....</b>	<b>176</b>
RASTI NR. 498/2014.....	176
Lënda: Ngritja e “Parkut të Paqes”, “Sheshit Car Lazar”, “Sheshit “UÇK” dhe “Sheshit Adem Jashari”, në komunën e Mitrovicës së Veriut.....	176
<b>PRISHTINË, MË 22 SHTATOR 2015.....</b>	<b>213</b>
ANKESA NR. 337/2014.....	213
Çështja: Zvarritjet procedurale nga gjykata në vendosjen e lëndës C.nr.702/03, që ka të bëjë me vërtetimin dhe dorëzimin e pronësisë.....	213
<b>PRISHTINË, MË 16 TETOR 2015.....</b>	<b>223</b>
RASTI NR. 517/2015.....	223
Procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme.....	223
<b>PRISHTINË, MË 23 TETOR 2015.....</b>	<b>248</b>
ANKESA NR. 201/2015.....	248
Lënda: Rekomandime lidhur me zbatimin e nenit 8, paragrafit 2 të Ligjit Nr.04/L-054, për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.....	248

*PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE DREJTUAR AUTORITETEVE  
PËRGJEGJËSE GJATË VITIT 2015*

---

<b>PRISHTINË, MË 30 TETOR 2015.....</b>	<b>255</b>
ANKESA NR. 23/2014.....	255
Lënda: Mosemërimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit .....	255
<b>PRISHTINË, MË 3 NËNTOR 2015.....</b>	<b>265</b>
ANKESA NR: 89/2015.....	265
lidhur me të drejtën në jetë.....	265
<b>PRISHTINË, MË 6 NËNTOR 2015.....</b>	<b>286</b>
ANKESA NR. 66/2015.....	286
lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë.....	286
<b>PRISHTINË, MË 6 NËNTOR 2015.....</b>	<b>299</b>
ANKESA NR. 305/2015.....	299
Lidhur me mos ekzekutimin e vendimit të plotfuqishëm në rastin E.nr.193/2008, të datës 18 mars 2008, nga Gjykata Themelore në Prishtinë.....	299
<b>PRISHTINË, MË 24 NËNTOR 2015.....</b>	<b>308</b>
ANKESA NR. 124/2015.....	308
Lënda: Rekomandim lidhur me moszbatimin e vendimit të Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës nr.09/442, të datës 15 prill 2015, sipas të cilit ishte anuluar vendimi i kryetarit të Komunës së Parteshit nr.54/15, i datës 10 shkurt 2015, që ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.....	308
<b>PRISHTINË, MË 25 NËNTOR 2015.....</b>	<b>318</b>
ANKESA NR. 290/2015.....	318
Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM).....	318
Komisioni i ankesave për shtetësi (KASH).....	318
<b>PRISHTINË, MË 16 DHJETOR 2015.....</b>	<b>333</b>
REKOMANDIM.....	333
Strategjitë për mbrojtjen e drejtave dhe lirive të njeriut të hartuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë / ZKM.....	333



## **PARATHËNIE**

Në këtë përmbledhje janë përfshirë të gjitha raportet me rekomandime të cilat Avokati i Popullit i ka publikuar gjatë vitit 2015, e që pasqyrojnë situatën e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend për periudhën janar - dhjetor 2015.

Qëllimi është që nëpërmjet kësaj përmbledhjeje të raporteve me rekomandime, të publikuara gjatë vitit 2015, të gjithë qytetarëve, grupeve të interesit dhe autoriteteve publike t'u ofrohet qasje më e lehtë në punën njëvjeçare të Institucionit të Avokatit të Popullit..

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka për qëllim t'u ofrojë ndihmë përfaqësuesve të popullit si dhe profesionistëve ligjorë në institucionet e Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe lokal të vendit, në kryerjen e detyrave përkatëse lidhur me rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Rekomandimet e përmbledhura janë mbështetur në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Standardet Ndërkombëtare të zbatueshme në sistemin tonë juridik. Prandaj, shpresojmë që ky material t'ju shërbejë, jo vetëm për referim në punën e tyre, por edhe për njohje më relevante dhe më praktike me të drejtat e njeriut.

Duke konsideruar se Avokati i Popullit, si institucion kombëtar për të drejtat e njeriut, po krijon pozitë të qëndrueshme në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, besojmë fuqishëm në rivendosjen e të drejtave të individëve, të cilët kanë përjetuar shkelje të të drejtave të njeriut, dhe në përmirësimin e punës së administratës dhe autoriteteve përgjegjëse për shkeljet e shkaktuara.

Avokati i Popullit mbetet me shpresë që kjo përmbledhje t'ju shërbejë të gjithëve e sidomos studiuesve në fushat e të drejtave të njeriut, me synim të krijimit të vetëdijes sa më e lartë për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në shoqërinë tonë.

Prishtinë, më 16 janar 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa. nr: 542/2013**

**H. B.**

**A. nr: 4/2014**

**S. C.**

**A. nr: 85/2014**

**Xh. A.**

**kundër**

**Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)**

Për: Z. Nenad Rashiq, ministër i Ministrisë së Punës dhe  
Mirëqenies Sociale

Lënda: Rekomandim lidhur me ankesat për pezullimin e  
kërkesave për realizimin e të drejtave që burojnë nga  
Ligji për Statusin e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës,  
Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të  
Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre Ligjin  
Nr. 04/L-054

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16



## **Qëllimi i raportit**

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (më tutje: MPMS), përkatësisht ministrit të MPMS-së z. Nenad Rashiq për vendimin 171, të lëshuar më 9.6.2011 (më tutje: *vendimi*), lidhur me rekomandimet për veprime që duhet ndërmarrë Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimat Civile (më tutje: DFDIL) dhe që të rekomandohet shfuqizimi i tij.

## **Kompetenca e Avokatit të Popullit**

2. Bazuar në nenin 16, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195, Avokati i Popullit është i autorizuar:

*“të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*

## **Përshkrimi i çështjes**

3. Ky raport është bazuar në tri ankesa të ndara, të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), nga znj. H. B., znj. S. C. dhe nga z. Xh. A. Ankesat janë paraqitur kundër DFDIL-it të MPMS-së, lidhur me kërkesat për njohjen e statusit dhe realizimin e të drejtave që burojnë nga Ligji Për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktima Civile dhe Familjet e Tyre për vlerat e luftës.

## **Përmbledhja e fakteve**

4. Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon IAP, mund të përmbledhen si në vijim:

***Rasti i znj. H. B.***

5. Më 28 tetor 2013, znj. H. B. ka paraqitur ankesë në IAP kundër MPMS-së për mospranimin e dokumentacionit, lidhur me kërkesën për realizimin e të drejtës në pension për viktimë civile të luftës për vajzën e saj gjashtëmuajshe K. B. Sipas pohimeve të ankueses, vajza e saj ka ndërruar jetë më 16 prill 1999, gjatë luftës në Kosovë, ditën kur ajo se bashku me bashkëshortin e saj dhe një grup fshatarësh po dëboheshin me dhunë nga fshati Koliq.
6. Më 10 dhjetor 2013, ankuesja ka informuar IAP-në që ajo ishte takuar me drejtorin e DFDIL-it për të dorëzuar kërkesën për realizimin e të drejtës në pension, mirëpo drejtori i DFDIL-it nuk i ka pranuar dokumentet, me arsyetimin se qeveria e Kosovës e ka ndaluar regjistrimin e rasteve të reja.

***Rasti i znj. S.C.***

7. Në mënyrë që të realizojë të drejtat që burojnë nga Ligji për Vlerat e Luftës, znj. S. C. pohuar se disa herë ka provuar të paraqesë kërkesë në DFDIL të MPMS-së për njohje të statusit dhe për të drejtat e përcaktuara me ligj, si familjare e bashkëshortit dhe të birit të saj, viktimë civile të luftës, të cilët janë konsideruar të zhdukur deri në vitin 2002, respektivisht vitin 2003, kur ata janë gjetur dhe janë rivarrosur. DFDIL ka refuzuar të pranojë kërkesën
8. Në shkurt të vitit 2013, znj. S. C., pas shumë përpjekjesh të dështuara, ka arritur të paraqesë kërkesë në DFDIL (kërkesa nr.05-10/2592) për njohje të statusit të viktimave civile të luftës. Mirëpo, kërkesa e znj. S. C. është refuzuar nga DFDIL, me vendimin e datës 18 tetor 2013, me arsyetimin se *“të gjitha kërkesat që janë pranuar pas datës 31 maj 2011 nuk do të shqyrtohen deri në nxjerrjen e një vendimi të ri politik.”*
9. Më 28 tetor 2013, znj. S. C. ka ushtruar ankesë kundër vendimit të DFDIL-it të datës 18 tetor 2013, në sektorin e ankesave të DFDIL-it. Si përgjigje ndaj ankesës, ajo ka pranuar një njofim të datës 19

nëntor 2013, nga menaxheri i Sektorit të ankesave në DFDIL. Në këtë përgjigje të DFDIL thuhet se ankesa kundër vendimit të shkallës së parë nuk mund të shqyrtohet, sepse me *vendimin* i cili është ende në fuqi, rekomandohet që:

*“numri i aplikuesve për pensione dhe beneficione, sipas Ligjit për vlerat e luftës të përmbyllet me gjendjen e datës 31 maj 2011; Të mos pranohet asnjë kërkesë e re për realizimin e pensioneve të parapara me Ligjin për vlerat e luftës, si dhe të mos pranohet asnjë kërkesë për njohjen e asnjë të drejte deri në nxjerrën e një vendimi të ri politik na ana e ministrit të MPMS-së.”*

10. Më 9 janar 2014, nga ana e IAP është kontaktuar drejtori i DFDIL-it në MPMS, lidhur me çështjen e ngritur nga znj. S. C. Sipas drejtorit, DFDIL-i është duke e bërë verifikimin e të gjitha rasteve dhe posa të përfundojë kjo fazë, ministri i MPMS-së do të nxjerrë një vendim për pranimin e aplikacioneve të reja për pensione dhe beneficione, sipas Ligjit për Vlerat e Luftës që i takojnë kësaj kategorie.
11. Më 29 janar 2014, IAP e ka kërkuar me shkrim nga Zyra për Informim e MPMS-së një kopje të *vendimit*.
12. Më 30 janar 2014, Zyra për Informim e MPMS-së i ka dërguar IAP-së kopjen e *vendimit*, sipas kërkesës së IAP-së.
13. Më 6 shkurt 2014, përfaqësuesit e IAP-së janë takuar me drejtorin e DFDIL-it të MPMS-së për të marrë informata shtesë lidhur me *vendimin*. Drejtori i DFDIL-it ka vërtetuar se *vendimi* është ende në fuqi dhe që nuk ka ndonjë ndryshim sa i përket pranimin të kërkesave të reja. Ai më tutje pohoi se janë gjithsej 13.500 përfitues nga skema e paraparë me Ligjin për Vlerat e Luftës dhe, sipas disa vlerësimeve, janë edhe së paku 1000 paraqitës potencialë të kërkesave, të cilat si të tilla nuk mund të pranohen për shkak se në fuqi është *vendimi*.

14. Më 28 shkurt 2014, është zhvilluar një takim midis përfaqësuesve të IAP-së dhe Zyrës Ligjore të MPMS-së. Përfaqësuesja e Zyrës Ligjore të MPMS-së ka mohuar që *vendimi* të ketë ndonjë ndikim në të drejtat e kategorisë së viktimave civile të luftës. Mirëpo, zyrtarët e IAP-së i paraqitën atyre njoftimin, i cili i është dërguar ankueses ku thuhet se kërkesa e saj nuk mund të shqyrtohet për shkak se në fuqi është *vendimi*, i cili si i tillë pamundëson rregullimin e statusit dhe realizimin e të drejtave të përcaktuara me Ligjin për Vlerat e Luftës.

**Rasti i z. Xh. A.**

15. Më 28 shkurt 2014, z. Xh. A. ka paraqitur ankesë në IAP, në emër të të afërmes së tij znj. F. K. Z. Ai ka pohuar se znj. F. K. ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në MPMS, për njohjen e statusit dhe realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligj, në emër të bashkëshortit të saj të ndjerë, i cili është viktimë civile e luftës në Kosovë. Z. Ademi, më tutje, ka pohuar se kërkesa është dorëzuar në MPMS në vitin 2011 dhe që prej asaj kohe ai vazhdimisht është interesuar për rastin, por pa ndonjë rezultat dhe pa ndonjë përgjigje konkrete.

16. Më 24 mars 2014, IAP ka kontaktuar z. A. për t'u informuar nëse ai ose znj. F. K. kanë marrë ndonjë njoftim me shkrim nga ana e MPMS-së, lidhur me kërkesën për realizimin e të drejtave. Ai pohoi se asnjëherë nuk ka marrë letër apo njoftim me shkrim nga MPMS-ja. Ai më tutje pohoi se gjatë bisedave me zyrtarët e MPMS-së ka marrë informata se çështja ka të bëjë me një vendim të ministrit për mospranim të kërkesave.

**Baza ligjore**

17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 31 përcakton se:  
*“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*

18. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 24 po ashtu përcakton se: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*
19. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj (KEDNJ), në nenin 6 përcakton se:
- “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tija të natyrës civile [...]”*
20. Sipas nenit 14 të KEDNJ:
- “Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.”*

### **Analiza ligjore**

21. Avokati i Popullit vëren se ministri i MPMS-së ka nxjerrë vendimin më 9 qershor 2011, siç thuhet pas takimit me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), me të cilat kërkon nga DFDIL që numri i paraqitësve të kërkesave për njohjen e statusit sipas Ligjit për Vlerat e Luftës të përmyllet me gjendjen e datës 31 maj 2011 dhe deri në nxjerrjen e *“një vendimi të ri politik”* nga Ministri i MPMS-së, të mos pranohet asnjë kërkesë e re për njohjen dhe realizimin e asnjë të drejte të përcaktuar me Ligjin për Vlerat e Luftës.
22. Në kohën kur është nxjerrë vendimi, në fuqi ka qenë Ligji nr.02/L-02 *Për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës*, i datës 23 shkurt 2006. Ndërsa, më 8

dhjetor 2011, Kuvendi ka miratuar Ligjin Nr. 04/L-054 *Për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktima Civile dhe Familjet e Tyre*, i cili aktualisht është në fuqi dhe i cili shfuqizon rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligjin nr.02/L-02. Megjithatë, vendimi ka vazhduar të mbetet në fuqi, duke pamundësuar kështu paraqitjen e kërkesave për realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligj.

23. Në funksion të analizës ligjore të ankesave të parashtruara në IAP dhe veprimeve të DFDIL-it të MPMS-së, Avokati i Popullit konsideron se duhet të bëhet krahasimi i Ligjit Nr. 04/L-054 me Ligjin Nr. 02/L-02, përkatësisht dispozitave të cilat përcaktojnë të drejtat e paraqitësve të kërkesave.

24. Sa i përket të drejtës së ankuesve që të paraqesin kërkesa për realizimin e të drejtave si familjarë të viktimave civile, Avokati i Popullit vëren se Ligji nr.02/L-02 e përkufizon këtë kategori përfituesish me nenin 2, pika 6:

*“Viktimë civile e luftës, konsiderohet personi i cili ka vdekur nga pasojat e luftës në Kosovë, prej 27.02.1998 deri më 20.06.1999, si dhe personat që konsiderohen të zhdukur gjatë kësaj periudhe kohore [...]”.*

25. Ligji Nr. 04/L-054 me nenin 3, pika 1.10 përkufizon se:

*“Viktimë civile e Luftës - personi i cili është i vrarë apo plagosur, nga forcat e armikut brenda periudhës 27.02.1998 deri me 20.06.1999 [...]”.*

ndërsa me nenin 3, pika 1.14

*“Person civil i zhdukur – personin vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjaret e tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999.”*

26. Kur është fjala për **viktimat civile të luftës** edhe Ligji Nr.02/L-02 edhe Ligjin Nr. 04/L-054 e përkufizojnë njëjtë këtë kategori. Ligji Nr.02/L-02 i trajton viktimat civile dhe personat e zhdukur me një nen të vetëm si një kategori, përderisa Ligji Nr. 04/L-054 i trajton me dy nene të veçanta, si dy kategori të ndryshme. Sidoqoftë, ankesat e paraqitura në IAP kanë të bëjnë me kategorinë e viktimave civile.<sup>1</sup>
27. Njohja e statusit të viktimës civile të luftës sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr.02/L-02:
- “Konstatohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile) në mbështetje të dokumentacionit që e lëshon organi kompetent i komunës në përputhje me procedurat administrative, në bazë të kërkesës së anëtarit të familjes.”*
28. Ndërsa neni 15, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-054 përcakton se:
- “Statusi i viktimës civile dhe invalidit të luftës, konstatohet nga organi përgjegjës i Komunës përkatëse, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me aktin nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.”*
29. E drejta për të paraqitur kërkesa për njohjen e statusit dhe për realizimin e të drejtave garantohet dhe nuk kufizohet me asnjërin nga të dy ligjet.
30. Avokati i Popullit vëren se, arsyetimi që u është dhënë ankuesve me rastin e refuzimit të kërkesave të tyre, bazohet në *vendimin* dhe jo në ndonjë fakt tjetër. Në vendimin e DFDIL-it, të datës 18 tetor 2013, me të cilën refuzohet kërkesa e znj. Suzana Caca, thuhet se:

---

<sup>1</sup> Familjarët e ankueses znj. C. janë konsideruar të zhdukur deri në vitet 2002/2003, kur ata janë gjetur dhe janë rivarrosur, prandaj ata konsiderohen viktimat civile të luftës.

*“Pas shqyrtimit të kërkesës si dhe shkresave në lëndë, u vërtetua se kërkesa nuk është e bazuar, sepse duke u bazuar në rekomandimet për veprime që duhet ndërmarrë nga Ministri i MPMS-së, të gjitha kërkesat që janë pranuar pas datës 31.05.2011 nuk do të shqyrtohen deri në nxjerrjen e një vendimi të ri politik.”*

31. Për më shumë, në njoftimin që znj. C. e ka pranuar, si përgjigje, lidhur me ankesën që ajo e ka ushtruar kundër vendimit të datës 18 tetor 2013, si vendim i shkallës së parë, thuhet se ankesa e saj nuk mund të shqyrtohet sepse *vendimi është ende në fuqi.*
32. Avokati i Popullit vëren se, pezullimi i pranimit të kërkesave, zvarrit realizimin e të drejtave, pasi që Ligji Nr.02/L-02 me nenin 16.6 ndër të tjera thotë se:

*“Pensioni familjar, pensioni personal invalidor, pensioni familjar invalidor, si dhe shtesat për përkujdesje dhe ndihmë personit tjetër, realizohet nga dita e parë e muajit që pason, nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës. [...]”*

33. Ndërsa Ligji Nr. 04/L-054 me nenin 18 përcakton se:

*“Të drejtat në pensione të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji se dhe shtesat për përkujdesje dhe ndihmë personit tjetër, realizohen nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet dhe kriteret për realizimin e këtyre të drejtave.”*

34. Avokati i Popullit është vënë në dijeni se ministri i MPMS-së, ka nxjerrë një vendim tjetër, Vendimin Nr.10, të datës 21 janar 2013, për *“shfuqizimin e pjesshëm” të Vendimit.* Shfuqizimi i vendimit vlen vetëm për familjet e të zhdukurve, të cilat kanë filluar të parashtrajnë kërkesat nga data 15 janar 2013 dhe për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës së UÇK-së dhe veteranëve të luftës, të cilët mund të aplikojnë për realizimin e të drejtave të tyre pas përfundimit të procesit të verifikimit të statusit të tyre. Mirëpo, *vendimi vazhdon të vlejë për kategorinë e viktimave civile.*



### **Konstatimi i Avokatit të Popullit**

35. Gjatë veprimeve të ndërmarra për të hetuar rastet e sipërpërmendura, Avokati i Popullit ka vërejtur dhe ka ardhur në përfundim se, paraqitësve të kërkesave për njohjen e statusit të viktimave civile nuk u është lëshuar ndonjë vendim individual për refuzimin e kërkesave ose ndonjë arsyetim me shkrim lidhur me mospranimin e kërkesave, përveç në rastin e znj. S. C., e cila e ka marrë një vendim për refuzimin e kërkesës së saj.
36. Për më shumë, ankesa e znj. C. kundër vendimit të shkallës së parë nuk është shqyrtuar fare për shkak të *vendimit*. Ndërsa, paraqitësit e tjerë të kërkesave janë njoftuar gojarisht dhe nëpërmes formave jozyrtare se *vendimi* e pamundëson pranimin e kërkesave të reja.
37. Avokati i Popullit konsideron se këto veprime të MPMS-së përbëjnë shkelje të parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe parimit të ligjshmërisë.
38. Parimi i ligjshmërisë garanton se të gjitha aktet dhe veprimet e ndërmarra nga organet shtetërore dhe institucionet që ushtrojnë autoritet publik duhet të jenë në pajtim me ligjin.
39. *Vendimi* i nxjerrë nga ministri i MPMS jo vetëm që nuk është në pajtim me ligjin, por vendoset mbi ligjin, duke e penguar në mënyrë diskriminuese paraqitjen e kërkesave për realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligj.
40. Avokati i Popullit, duke u bazuar në dispozitat e të dy ligjeve konstaton se ministrit të MPMS-së nuk i delegohet ndonjë kompetencë për nxjerrjen e ndonjë vendimi, me të cilin do të pezullohej apo pengohej zbatimi i ligjit. Asnjë anëtar i Qeverisë, në këtë rast as ministrit të MPMS, nuk i delegohet e drejta e kufizimit të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të parapara me ligj dhe me Kushtetutë. Çdo kufizim i tillë mund të bëhet vetëm me ligj duke u bazuar në Nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. *Vendimi* apo çfarëdo akti

tjetër normativ i një anëtarit të Qeverisë së Kosovës dhe i ndonjë autoriteti tjetër publik në Republikën e Kosovës, nuk është i vlefshëm nëse nuk është i bazuar në ligj dhe nuk është ligj.

41. Duhet vërejtur se, asnjëri nga ligjet në fjalë nuk përcakton ndonjë afat apo kufizim kohor sa i përket paraqitjes së kërkesave për njohjen dhe realizimin e ndonjë të drejte. Për më shumë, neni 93, pika (4) e Kushtetutës përcakton se Qeveria, pjesë përbërëse e të cilës janë ministrat, ka kompetencë të merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve. *Vendimi* i ministrit të MPMS-së në këtë rast nuk ka të bëjë me zbatimin e ligjit, por ka të bëjë me pengimin e zbatimit të ligjit.
42. Avokati i Popullit konsideron se *vendimi* politik i ministrit të MPMS-së vë në dyshim parimin e sigurisë juridike dhe se krijohet përshtypje e një paqëndrueshmërie juridike. *Vendimi* është lëshuar gjatë kohës sa ka qenë në fuqi Ligji Nr.02/L-02 dhe në ndërkohë Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 04/L-054 i cili ka shfuqizuar ligjin paraprak.
43. Avokati i Popullit konsideron se për paraqitësit e kërkesave të cilët kanë tentuar të paraqesin kërkesa pas nxjerrës së *vendimit* deri në miratimin e Ligjin Nr. 04/L-054 do të duhej të vlenin dispozitat e Ligjit Nr.02/L-02. Me këtë nuk do të thotë se Ligjin Nr. 04/L-054 garanton më pak apo më shumë të drejta se ligji paraprak, por për shkak se me këtë garantohej sundimi i ligjit dhe mbrohet shteti i së drejtës.
44. Në teorinë e së drejtës ekziston rregulli se legjislacioni nuk është i paracaktuar që të veprojë me efekte prapavepruese, ose në një mënyrë të tillë sa të ndërhyjë në të drejtat dhe liritë ekzistuese. Kjo duhet kuptuar në atë mënyrë që, për çdo fakt, ngjarje ose marrëdhënie, do të zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën që ka lindur apo krijuar fakti ose marrëdhënia juridike konkrete.
45. Avokati i Popullit, më tutje konsideron se veprimet që i ka ndër marrë DFDIL, të kushtëzuara nga *vendimi*, pamundësojnë

identifikimin e paraqitësve të kërkesave dhe përcaktimin e kohës së paraqitjes së kërkesave për arsye se DFDIL nuk ka lëshuar vendime individuale për mospranimin ose refuzimin e kërkesave. Për këtë arsye mund të mungojnë shënimet lidhur me numrin e paraqitësve të kërkesave dhe kohën kur ata kanë provuar të paraqesin kërkesat.

46. Në anën tjetër DFDIL dhe MPMS asnjëherë dhe në asnjë formë nuk kanë publikuar *vendimin*, i cili është trajtuar si një dokument i brendshëm dhe të cilin MPMS dhe DFDIL janë duke e zbatuar nga data 31.5.2011.
47. Mospublikimi i *vendimit* dhe mos nxjerrja e mosdhënia e vendimeve individuale për paraqitësit e kërkesave, i ka vënë në lajthitje si paraqitësit e kërkesave, ashtu edhe palët e interesuara të cilat do të mund të kërkonin shfuqizimin e vendimit, nëpërmes procedurave administrative apo gjyqësore.
48. Avokati i Popullit konstaton se veprimet e MPMS-së, përkatësisht *Vendimi* i MPMS-së, ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, përkatësisht nenin 31 të Kushtetutës i cili përcakton se “*Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*”
49. Po ashtu, veprimet e MPMS paraqesin edhe shkelje të 6 të KEDNJ-së, i cili përcakton se:  
*“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tija të natyrës civile [...]”.*
50. Avokati i Popullit me të drejtë i referohet nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak se lidhur me kërkesat e qytetarëve nuk vendos në këtë rast gjykata, por është DFDIL, organ ky që ushtron rolin e gjykatës kur

vendoset për të drejtat dhe detyrimet e paraqitësve të kërkesave. Një qëndrim të tillë e ka pranuar edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), që secili organ i themeluar me ligj, që vendos për ndonjë të drejtë të individëve mund të konsiderohet si gjykatë.<sup>2</sup>

51. Avokati i Popullit konsideron se nxjerrja e *vendimit*, me të cilin pezullohet procesi i paraqitjes së kërkesave për njohjen e statusit dhe realizimin e të drejtave më 31 maj 2011, dëshmon se gjatë procedurës së pranimit të kërkesave nuk është garantuar mbrojtje e barabartë për secilin dhe se mbetja në fuqi i një vendimi të tillë për një kohë aq të gjatë zvarrit procedurën dhe dëmton interesat e paraqitësve të kërkesave.

52. Avokati i Popullit gjithashtu konstaton se me veprimet e MPMS-së është cenuar neni 24 i Kushtetutës i cili përcakton se:

*“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”* ndërsa neni 14 i KEDNJ-së përcakton se: *“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim [...]”*.

53. *Vendimi* mohon të drejtën e njohur me ligj për parashtrimin e kërkesave pas datës 31 maj 2011, duke dalluar kështu paraqitësit e kërkesave të cilët kanë aplikuar para dhe pas kësaj date. Personat të cilët kanë paraqitur kërkesa para datës 31 maj 2011, do të realizojnë të drejtat e tyre nga dita e paraqitjes së kërkesave, ndërsa realizimi i të drejtave të personave që nuk kanë pasur mundësi të paraqesin kërkesa para datës 31 maj 2011, do të varet nga *vendimi* dhe, për aq kohë sa ky *vendim* të mbetet në fuqi. Rrjedhimisht, MPMS-ja me këtë *vendim* bën diskriminim, sepse jo të gjithë personat në situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë të barabartë, sikur

---

<sup>2</sup> Shih Aktgjykimin *CASE OF IMMOBILIARE SAFFI v. ITALY* (Application no. 22774/93), të datës 8.07.1999.

që është e përcaktuar me ligj.

54. Shfuqizimi i pjesshëm i *vendimit* (shih pikën 34 të këtij Raporti), jo vetëm që e dëshmon, por e thellon edhe më shumë diskriminimin që iu bëhet paraqitësve të kërkesave. Kjo, për shkak se fillimisht trajtimi i pabarabartë është bazuar me një datë të caktuar dhe i ka ndarë paraqitësit e kërkesave para dhe pas hyrjes në fuqi të *vendimit*, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për persona të zhdukur, viktimë civile, veteranë të luftës etj. Ndërsa, vendimi për shfuqizimin e pjesshëm të *vendimit* bëhet në mënyrë selektive, në bazë të kategorisë dhe vazhdon të mbetet në fuqi për kategorinë e viktimave civile të luftës.
55. Avokati i Popullit konsideron se *vendimi* pengon zbatimin e Ligjit për Vlerat e Luftës, është kundërligjor dhe kundër-kushtetues, për shkak se me të pezullohet procesi i paraqitjes së kërkesave për realizimin e të drejtave të përcaktuara me këtë ligj. Për më shumë, *vendimi* ka karakter diskriminues dhe cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare.
56. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”. Sipas kuptimit të nenit 16, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit “*(..) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...)*”, si dhe “*të rekomandojë[...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*” (neni 16, paragrafi 1.6).

Prandaj, Avokati i popullit rekomandon që:

- 1. Ministri i MPMS të ndërmerr masa të menjëhershme për shfuqizimin dhe anulimin e vendimit Nr. 171, të datës 9 qershor 2011.*
- 2. Të nxirret një vendim i ri nga ministri i MPMS, me të cilin do të riparoheshin dëmet e shkaktuara nga pasojat juridike të Vendimit Nr. 17, i datës 9 qershor 2011, në atë mënyrë që njohja e statusit dhe realizimi i të drejtave të zbatohet nga nga data 31 maj 2011.*
- 3. Ky rekomandim t'u përcillet të gjitha njësive në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të MPMS, për zbatimin e ligjeve në fuqi dhe mundësimin e realizimit të së drejtës së garantuar me Kushtetutë dhe ligj të të gjithë qytetarëve, si dhe mundësimin e shfrytëzimit të mjeteve juridike efektive, pa asnjë dallim.*

Në pajtim me nenin 132 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më **7 gusht 2014**.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Kopje: Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Z. Hashim Thaçi, Kryeministër i Republikës së Kosovës,  
Z. Eshref Shabani, Sekretar i Përgjithshëm, MPMS,  
Z. Bajram Pajaziti, drejtor, Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave civile.

Prishtinë, më 29 janar 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIM**

**Ankesa nr. 221/2013**

**A. B.**

**kundër**

**Gjykatës Themelore në Prizren**

**Çështja:** Zvarritjet procedurale nga gjykata në vendosjen e lëndës C.nr.899/2012, që ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës

**Palë përgjegjëse:** Gjykata Themelore në Prizren  
Z. Ymer Hoxha, kryetar

**Baza ligjore:** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 15 paragrafi 6

## Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës Themelore në Prizren, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr.899/2012, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. A. B. (në tekstin e mëtejme *Ankuesi*) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për të vendosur lidhur me çështjen e kthimit të ankuesit në punë.

## Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i posedon IAP, të paraqitura nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë mund të përmbledhen si në vijim:

3. Rasti i *ankuesit* ka filluar të procedohet në gjykata nga 9 dhjetor 2003 dhe deri më sot ende nuk është vendosur. Pra, *ankuesi* për 12 vite është në pritje të vendimit, lënda e të cilit sillet në gjykata pa u vendosur përfundimisht me vendim meritore. Gjykata e shkallës së dytë vendimet e gjykatës së shkallës së parë për tri herë me radhë ia ka kthyer në rigjykim, e po ashtu edhe Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së tretë, dy herë radhazi ia ka prishur vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.
4. Më 20 qershor 2002, ankuesi kishte lidhur kontratë pune me Raiffeisen Bank (në tekstin e mëtejme *e paditura*) për të kryer detyrën e arkëtarit. Ndërsa, më 10 tetor 2003, *ankuesi* njoftohet me shkrim se i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Më 28 tetor 2003, ai ankohet kundër ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në Raiffeisen Bank, mirëpo asnjëherë nuk merr përgjigje me shkrim.



5. Më 9 dhjetor 2003, *ankuesi* parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren, për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale për periudhën e largimit nga puna.
6. Më 1 korrik 2004, Gjykata Komunale në Prizren, lidhur me çështjen e ankuesit nxjerr aktgjykimin C.nr.769/03, me të cilin miratohet kërkesëpadija e ankuesit, për kthim në vendin e punës.
7. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.769/2003 të datës 1 korrik 2004, *e paditura* ushtron ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e cila me aktvendim Ac.nr.361/2004 të datës 9 dhjetor 2004, e hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme dhe e vërteton aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.769/2003, të datës 1 korrik 2004.
8. Më 24 mars 2005, Gjykata Supreme e Kosovës e pranon revizionin e të paditurës, me aktvendim Rev.nr.51/2005 të datës 24 mars 2005, e prish aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.361/2004, të datës 9 dhjetor 2004, dhe lëndën ia kthen së njëjtës në rivendosje.
9. Më 10 gusht 2005, Gjykata e Qarkut në Prizren e prish aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.769/03 të datës 1 korrik 2004 dhe lënda i kthehet Gjykatës së Shkallës së parë për rivendosje.
10. Më 26 tetor 2006, për të dytën herë Gjykata Komunale në Prizren vendos me aktgjykim C.nr.681/2005, të datës 26 tetor 2006, në favor të ankuesit.
11. Më 19 janar 2007, Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin Ac.nr.523/2006 të datës 19 janar 2007, e refuzon si të pabazë ankesën e të paditurës dhe për të dytën (2) herë vendos në favor të ankuesit, vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.681/05, i datës 26 tetor 2006.

12. Më 28 shkurt 2007, *e paditura* ushtron revizion në Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.523/2006, të datës 19 janar 2007, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
13. Më 31 mars 2007, edhe përfaqësuesja e ankuesit, ushtron kundër përgjigje ndaj revizionit të të paditurës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta hedh poshtë revizionin dhe të vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr.523/2006.
14. Më 10 korrik 2008, Gjykata Supreme e Kosovës pranon revizionin e të paditurës, me aktvendim Rev.nr.99/2007 të datës 10 korrik 2008, prish aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.523/2006 të datës 19 janar 2007, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.881/2005, të datës 26 tetor 2006 dhe lëndën e kthen në shkallë të parë për rigjykim.
15. Më 24 shtator 2010, Gjykata Komunale në Prizren, me aktgjykim C.nr.697/2008 të datës 24 shtator 2010, për të tretën (3) herë vendos në favor të ankuesit, duke e obliguar të paditurën që ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës dhe t'i kompensojë të ardhurat personale.
16. Më 10 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktvendim Ac.nr.666/2010 të datës 10 shtator 2012, aprovon ankesën e të paditurës, prishë aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.697/2008 të datës 24 shtator 2010 dhe lënda për të tretën (3) herë i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
17. Më 4 prill 2013, *ankuesi* paraqet ankesën e tij në IAP, lidhur me zvarritjen e procedurës për shqyrtimin e lëndës së tij, nga Gjykata e Themelore në Prizren.

18. Më 23 prill 2013, Këshilltari Ligjor i IAP e këshilloi ankuesin që t'i parashtrojë urgjencë Gjykatës Themelore në Prizren, për shpejtimin e procedurës në shqyrtimin e lëndës.
19. Më 25 prill 2013, *ankuesi* njoftoi se ka bërë urgjencë në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me shqyrtimin e lëndës së tij.
20. Më 2 gusht 2013, *ankuesi* njoftoi se lënda e tij i është caktuar gjyqtarit A. B.
21. Më 21 gusht 2013, Avokati i Popullit i dërgoi një letër Gjykatës Themelore në Prizren, në të cilën kërkoi informata për veprimet e ndërmarra ose ato që planifikonte të ndërmernte që rasti i ankuesit të shqyrtohej brenda një afati të arsyeshëm bazuar në ligj.
22. Më 2 shtator 2013, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, ku u njoftua se *“Lënda pasi është anuluar nga gjykata e shkallës së dytë, ka marrë numër të ri C.nr.899/2012, por pas bisedës me gjyqtarin e çështjes, na është premtuar se e njëjta do të shqyrtohet, kah fundi i muajit shtator, apo fillimi i tetorit 2013”*.
23. Më 18 shtator 2013, *ankuesi* u takua me zëvendësin e Avokatit të Popullit, në ditën e hapur me qytetarë në Prizren, ku paraqiti ankesat e tij, lidhur me zvarritjet gjyqësore.
24. Më 24 shtator 2013, *ankuesi* u takua me Avokatin e Popullit në ditën e hapur me qytetarët në Prishtinë, ku paraqiti shqetësimet e tija dhe kërkesën që përfaqësuesi i IAP-së t'i monitorojë seancat gjyqësore.
25. Më 23 dhjetor 2013, përfaqësuesi i IAP-së monitoroi seancën, ku gjyqtari i çështjes u dha kohë të mjaftueshme palëve për të arritur një marrëveshje mes tyre, për të cilën palët u pajtuan. Gjyqtari i çështjes seancën e radhës e caktoi për 6 janar 2014.

26. Më 9 janar 2014, *ankuesi* njoftoi se palët nuk kanë arritur marrëveshje dhe se për këtë e kanë njoftuar gjyqtarin e çështjes për procedim të mëtejme të rastit.
27. Më 21 maj 2014, *ankuesi* u takua me zëvendës Avokatin e Popullit në ditën e hapur me qytetarët e Prizrenit, paraqiti shqetësimet se edhe pas deponimit në gjykatë të shumës prej 150 eurosh, lidhur me pagimin e ekspertit financiar dhe për vonesa në caktimin e ekspertit financiar nga gjykata.
28. Më 9 korrik 2014, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me gjyqtarin e lëndës, i cili e njoftoi atë se eksperti është caktuar dhe se për rastin do të vendoset shpejt.
29. Më 20 nëntor 2014, *ankuesi* u takua me zëvendësin e Avokatit të Popullit, dhe ngriti shqetësimin e tij lidhur me atë se edhe pas 12 viteve për rastin e tij nuk ka një vendim meritore, ai kërkoi që përfaqësuesi i IAP të bisedojë me gjyqtarin.
30. Më 8 dhjetor 2014, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me gjyqtarin e çështjes, i cili deklaroi se për rastin do të vendosë brenda disa ditësh, para përfundimit të vitit 2014.

### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës**

31. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 31 përcakton: *“Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
32. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejt me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Prandaj, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ, garanton që: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm.”*

33. Ndërsa neni 13 i KEDNJ përcakton: “Çdo njeri, të cilit i janë shkëlur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për **mjetet ligjore efektive** për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtare, pavarësisht se shkëlja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”
34. Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, në nenin 1. përcakton “rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.”
35. Sipas nenit 10, paragrafi 1 të po këtij ligji “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet **pa zvarritje** dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”
36. Neni 12 i këtij ligji obligon gjykatën që “Procedura e shkallës së parë, si rregull, përbëhet prej dy seancave: a) seancës përgatitore; b) seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.”
37. Paragrafi 3 i nenit 190 i këtij ligji përcakton se si duhet të veprojnë gjykata e shkallës së dytë, pas anulimit për herë të dytë (2) të aktgjykimit të shkallës së parë:
- “Gjykata e shkallës së dytë do të caktojë shqyrtimin e drejtpërdrejt të çështjes edhe po që se aktgjykimi i shkallës së parë anulohet dy herë dhe kur në seancën e kolegjit vlerëson se aktgjykimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkëljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë.”
38. Neni 420, paragrafi 2 i LPK përcakton mënyrën e caktimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes: “Seanca kryesore do të mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditë

*nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore*”. Ndërsa në paragrafin 4 po të nenit 420 thuhet: *“Po që se gjykata çmon se shqyrtimi kryesor do të zgjatë më tepër se një ditë, seanca do të konvokohet për aq ditë më radhë sa është e domosdoshme që shqyrtimi të bëhet në vazhdimësi.”*

39. *Po sipas këtij ligji, neni 293,” Gjykata mund ta dënojë me gjobë deri në 1000 euro ekspertin që pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk e dorëzon brenda afatit të caktuar konstatimin dhe mendimin e vet, apo që pa arsye nuk vjen në seancë edhe pse është thirrur rregullisht.”*
40. *Gjithashtu tek rastet kur palët nuk merren vesh për caktimin e ekspertit, neni 357, paragrafi 3 thotë se “Po që se palët nuk merren vesh për personin që do të bëjë ekspertizën si dhe për objektin dhe vëllimin e tij, vendimin për këtë do ta jap gjykata.”*
41. *Ndërsa neni 441, paragrafi 1, shprehimisht përcakton se: “Sanca për shqyrtimin kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pa caktuar”. Dhe paragrafi 2 i po të njëjtit përcakton po ashtu se: “Sanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, [...]”*
42. *Neni 442 përcakton “Po që se seanca e filluar nuk mund të përfundojë brenda një dite, gjyqtari do ta përcaktojë vazhdimin e seancës për ditën e ardhshme të punës (vazhdimi i seancës).”*
43. *Ndërsa në pjesën e tretë, kur flet për Procedurat e Posaçme Kontestimore, Kreu XXVI, në nenin 475, lidhur me Procedurat në kontestet nga marrëdhënia e punës, ky ligj precizon: “Në konteste nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.”*

## Konstatimet e Avokatit të Popullit

44. Nisur nga analiza e informatave, dëshmime dhe fakteve që posedon, Avokati i Popullit konstaton se **ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor**, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura; se **ka pasur shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike**, duke dështuar gjyqësori (tri nivelet gjyqësore) në vendosjen e lëndës së *ankuesit* nga marrëdhënia e punës, për më shumë se 11 vite, procedurat e së cilës janë iniciuar që nga viti 2003, dhe ende nuk janë vendosur përfundimisht deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti (janar 2015); se zvarritje të tepruara të procedurave gjyqësore dhe pa një vendim përfundimtar të formës së prerë, janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ dhe nenin 10.1 të LPK.
45. Që në fillim, Avokati i Popullit ua përkujton se çështjet nga marrëdhënia e punës dhe ushtrimit të profesionit konsiderohen të jenë të drejta civile, për qëllime të nenit 6 të KEDNJ, i cili për këtë arsye është i aplikueshëm në procedurat e rastit në fjalë.
46. Avokati i Popullit përkujton që, e drejta precedente e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka vërtetuar që në rastet ku përfshihet përcaktimi i të drejtës civile, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Girolomi kundër Italisë*, më 19 shkurt 1991 dhe aktgjykimin *Boddaert kundër Belgjikës*, më 12 tetor 1995). Për rastin në fjalë, procedura gjyqësore ishte filluar në Gjykatën Komunale në Prizren, më 9 dhjetor 2003 dhe vazhdon ende në vitin 2015.
47. Po ashtu, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 (1) i KEDNJ nuk parashkruan ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës. Ai përcaktim varet nga rrethanat e

- veçanta të rastit, veçanërisht nga ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve të përfshira, si dhe prej asaj se çfarë është në interes për ankuesin.
48. Mirëpo, sipas GJEDNJ-së, është e domosdoshme të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i procedurave me qëllim të përcaktimit të arsyes për zgjatje të procedurës. Kjo do të thotë që, vonesat e caktuara lidhur me një pjesë të procedurave mund të mos përbëjnë shkelje nëse zgjatja e tërësishme e procedurës nuk ka qenë e tepruar. Nga provat dhe dëshmitë e prezantuara, Avokati i Popullit nuk gjen arsye për zvarritje të procedurës, ngase në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një proces të ndërlikuar.
49. Avokati i Popullit vëren se për rastin në fjalë, periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej 9 dhjetorit 2003, data kur *ankuesi* paraqiti padinë e tij në Gjykatën Komunale në Prizren. Pasi ende nuk është marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin, lënda tani gjendet për rigjykim në Gjykatën Themelore në Prizren. Data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim, konsiderohet data e publikimit të këtij raporti. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se procedurat kanë zgjatur mbi 11 (njëmbëdhjetë) vite.
50. Lidhur me sjelljen e autoriteteve gjyqësore, Avokati i Popullit vëren se, që nga muaji dhjetor i vitit 2003 e deri në vitin 2012, Gjykata Komunale në Prizren, kishte nxjerrë tri (3) aktgjykime në favor të ankuesit: aktgjykimin C.nr.769/03, aktgjykimin C.nr.681/05 dhe aktgjykimin C.nr.697/08, por që më vonë të atakuar me ankesë, Gjykata e Qarkut në Prizren tri herë i kishte prishur vendimet gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykata Supreme e Kosovës dy herë i kishte prishur vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe asaj të dytë, duke i kthyer në rigjykim: *“Me arsyetimin se aktgjykimet e atakuara kanë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, njeherit edhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, e si pasoj edhe e drejta*



*materiale është zbatuar gabimisht*". Kjo vendimmarrje e gjykatave/gjyqtarëve paraqet një dështim të tyre në vendosjen përfundimtare të rastit, në dëm të ankuesit dhe paraqet dështim për mbrojtje gjyqësore të drejtave të njeriut të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

51. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se është keqpërdorim i pushtetit dhe papërgjegjësi e gjyqtarit të çështjes, duke mos e siguruar raportin e ekspertit financiar që nga marsi 2014, e deri në publikimin e këtij raporti, pra, nga 6 marsi 2014, gjykata nuk ka mbajtur më asnjë seancë, me arsyetimin se është duke pritur raportin e ekspertit financiar dhe ky veprim i gjykatës është në kundërshtim me nenet 293, 357 edhe 441 të LPK, të cilat caktojnë afatet ligjore për mbajtjen e seancave gjyqësore në afate të caktuara ligjore dhe jo zvarritje deri në pafundësi, si dhe të detyrimit të gjyqtarit për caktimin e ekspertit financiar. Avokati i Popullit ka gjetur se mossa sigurimi për mbi dhjetë (10) muaj nga gjykata i ekspertit financiar, ka për pasojë që ende të mos të ketë një vendim meritor nga Gjykata Themelore në Prizren.
52. Lidhur me fushën e zbatueshmërisë së nenit 13 të KEDNJ-së, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ, në disa raste shprehimisht e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, përbëjnë një kërcënim serioz për sundimin e ligjit të vendit. Kufizimet e theksuara në nenin 13 të KEDNJ, GJEDNJ i komenton kështu: *“Për sa i përket dështimit të supozuar për të siguruar seancë brenda një afati të arsyeshëm, nuk mund të shquhet asnjë kualifikim i tillë në fushën e nenit 13. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të paraparë me konventë, më shumë favorizon mbajtjen në minimum të kufizimeve të nënkuptuara me nenin 13.”*
53. Neni 13 i KEDNJ-së, duke theksuar në mënyrë të veçantë dhe shprehimisht obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojtë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë

- për një individ që ai apo ajo gëzon këto të drejta në mënyrë efektive. Kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave, sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Meqenëse rasti i z. B. ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i KEDNJ-së është i zbatueshëm.
54. Avokati i Popullit përkujton se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet, pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme. Nga informatat në dispozicion nuk mund të konstatohet se ankuesi, me veprimet/mosveprimet e tij, ka kontribuar në çfarëdo zvarritje të procedurës, ndërsa ka indikacione se (mos)veprimet apo veprimi i kundërligjshëm i tri niveleve të gjyqësorit, i kanë kontribuar shkeljeve të drejtave për mbrojtje gjyqësore, në dëm të ankuesit, të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
55. Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk i është vënë në dispozicion ankuesit, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës, me parashikimin apo shpresën për ta arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar. **Kjo mënyrë e veprimit të gjykatës dëshmon për mohimin e drejtësisë dhe ligjshmërisë nga vetë gjykata.**
56. Avokati i Popullit konstaton që ka pasur **shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm**, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura dhe se ka pasur **shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike** ndaj vendimeve gjyqësore, duke u trajtuar rasti i tij nga ana e gjykatave/gjyqësorit në një rreth të vendimeve të pafundme.

57. Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, dhe nenin 15, paragrafi 6 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “*Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit*”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës, **Rekomandon**

#### **Gjykatën Themelore në Prizren**

- 1. Të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin dhe vendosjen meritore, pa vonesë të mëtutjeshme, të lëndës gjyqësore të z. A. B., lënda C.nr.899/2012.*
- 2. Të garantojë shqyrtimin e rasteve për të gjitha palët brenda një afati të arsyeshëm kohor, në pajtim edhe me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.*

#### **Zyrën e Prokurorit Disiplinor**

- 1. Të merren masa ndaj mosveprimeve/keqpërdorimeve eventuale të gjyqtarëve përkatës, në të tri nivelet e gjyqësorit, të cilat kanë trajtuar rastin e z. B., për zvarritjen e paarsyeshme të procedurës gjyqësore, në rastin e A. B.*

#### **Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

- 1. Që gjyqësori të zbatojë nenin 190, paragrafi 3, të Ligjit për Procedurën Kontestimore që, pas anulimit për herë të dytë të aktgjyqimeve të gjykatave të shkallës së parë, të mos i rikthejë çështjet në rigjykim, por të vendosen në mënyrë meritore.*

Në pajtim me nenin 132 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Gjykata Themelore në Prizren, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se më **2 mars 2015**.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Kopje: - Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kryesues z. Enver Peci.

- Gjykatës Supreme të Kosovës, kryetar z. Fejzullah Hasani.
- Gjykata e Apelit të Kosovës, kryetar z. Sali Mekaj.
- Zyra e Prokurorit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, drejtor z. Zef Prendrecaj.

Prishtinë, më 18 shkurt 2015

*Ex officio*

**Rasti Nr. 518/2014**

**RAPORT**

**I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

në lidhje me

Çështjen e regjistrimit të studentëve të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” për vitin akademik 2014/2015

**Drejtuar:**

**Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu, Rektor i Universitetit të Prishtinës  
“Hasan Prishtina”**

## **QËLLIMI I RAPORTIT**

Ky raport ka tri qëllime kryesore: (1) të vlerësojë ligjshmërinë e të gjitha veprimeve (dhe mosveprimeve) të Universitetit të Prishtinës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me regjistrimin e kandidatëve nga kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së në vitin akademik 2014/2015; (2) të vlerësojë kushtetutshmërinë e përparësisë në regjistrim për kandidatët e këtyre kategorive dhe; (3) t'u japë rekomandime Universitetit të Prishtinës, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të këtyre vlerësimeve.

## **BAZA LIGJORE**

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.” Gjithashtu, Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:

- “të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (pika 2);
- “të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (pika 3);
- “të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut” (pika 4);
- “t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet

dhe raportet e veta” (pika 5);

- “të rekomandojë . . . ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi” (pika 6);
- “të përgati[s]ë raporte . . . mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës” (pika 7);
- “të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit të Kuvendit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (pika 8).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet publike përgjegjëse, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

## **PËRMBLEDHJA E FAKTEVE**

### **A. Miratimi i ligjeve që rregullojnë të drejtën për përparësi në regjistrim në institucione arsimore për kandidatët e kategorive të dala nga lufta**

Ligji i parë që ka përcaktuar të drejta të veçanta për kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së, ka qenë Ligji Nr. 02/L-2 për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës (në tekstin e mëtejshëm: “*Ligji i 2006*”). Një ndër të drejtat e veçanta që e përcaktoi *Ligji i 2006* ishte e drejta për përparësi në regjistrim në institucione arsimore:

*“Përparësia e regjistrimit në institucione arsimore është e drejtë të cilën e realizojnë personat që janë anëtarë të familjeve të dëshmorëve të rënë të UÇK-së, invalidët [e UÇK-së], veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-së, anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së dhe invalidët civilë, me kusht që të*

*kalojnë prapun e poenëve në provimet pranuese*” (neni 5, par. 2, pika 14).<sup>3</sup>

Siç vërehet në tekstin e cituar, *Ligji i 2006* përkufizon në dy dimensione të drejtën për përparësi në regjistrim. Në dimensionin e parë, përcaktohet se cilët janë *përfituesit e së drejtës*: “anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, invalidët e UÇK-së, veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-së, anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së dhe invalidët civilë.” Në dimensionin e dytë, përcaktohet se cili është *kushti i përfitimit*: anëtarët e kategorive të përcaktuara gëzojnë përparësi vetëm nëse kalojnë prapun minimal të pikëve në provimet pranuese.

Mirëpo, në vitin 2011 dhe 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi dy ligje të reja për të rregulluar çështjen e përparësisë në regjistrim. Këto ishin Ligji 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre (në tekstin e mëtejshëm: “*Ligji i 2011*”), dhe Ligji Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “*Ligji i 2014*”). Qëllimet e *Ligjeve të 2011* dhe *2014* përcaktohen në nenin 1 të secilit ligj dhe janë afërsisht njësoj. Në *Ligjin e 2011* përcaktohet se: “Qëllimi i nxjerrjes [së] këtij ligji është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit”, ndërsa në *Ligjin e 2014* përcaktohet se “Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në beneficione të Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të cilët, me

---

<sup>3</sup> Termi “anëtarë të familjes”, siç përdoret në këtë ligj, sikur edhe në këtë raport, nënkupton anëtarë të familjes së ngushtë: “bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), thjeshtri, thjeshtira, prindërit, njerku, njerka, si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesore” (*id.*, neni 2, par. 11).



sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës”. Gjithashtu, të dy ligjet i arsyetojnë beneficionet e veçanta, duke përfshirë të drejtën për përparësi në regjistrim, me “kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së” (*Ligji i 2011*, neni 4, dhe *Ligji i 2014*, neni 15). *Ligji i 2011* dhe *Ligji i 2014* janë ende në fuqi.

Këto ligje rezultuan me disa ndryshime të rëndësishme në përkufizimin e së drejtës për përparësi në regjistrim. Sa u përket *përfituesve të së drejtës*, kemi parë që kategoritë të cilave u ishte dhënë kjo e drejtë sipas *Ligjit të 2006* ishin: “anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, invalidët e UÇK-së, veteranët e UÇK-së, anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së dhe invalidët civilë.” Prej kësaj liste, *Ligji i 2011* dhe *Ligji i 2014*, lexuar bashkërisht, hoqën kategorinë e invalidëve civilë dhe shtuan dy kategori të tjera: “anëtarët e familjeve të invalidëve të UÇK-së dhe anëtarët e familjeve të të zhdukurve të UÇK-së.” (shih *Ligjin e 2011*, nenin 6, par. 7).<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> Dy vërejtje: (1) Përcaktimi i anëtarëve të familjeve të invalidëve të UÇK-së si kategori përfituese nuk mund të quhet përcaktim krejt i ri, sepse edhe në *Ligjin e 2006*, ata mund të përfshihen në kategorinë “veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-së”, familjet e të cilëve gëzonin përparësi në regjistrim. (2) Ka edhe një ndryshim të vogël midis *Ligjit të 2006* dhe *Ligjit të 2014*. Sipas *Ligjit të 2006*, përfitojnë “veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-së”, një kategori që përkufizohet si në vijim: “Veteran dhe pjesëtar i UÇK-së, është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar nga komandat (shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, brenda periudhës 30.12.1991 deri më 20.06 1999” (*Ligji i 2006*, neni 2, par. 5). Ndërsa, sipas *Ligjit të 2014*, përfitojnë “veteranët luftëtarë”, një kategori që përkufizohet si në vijim: “Veteran luftëtar[] i UÇK –së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës (*Ligji i 2014*, neni 3, par. 1, pika. 3.2, theks i shtuar). Siç është e dukshme nga frazat e theksuara të tekstit,

Sa u përket *kushteve të përfitimit*, *Ligji i 2006* kishte përcaktuar që anëtarët e kategorive përfituese do të gëzonin përparësi në regjistrim “me kusht që të kalojnë pragun e poenëve në provimet pranuese” (*Ligji i 2006*, neni 5, par. 2, pika 14). Ndërsa në *Ligjin e 2011* dhe *Ligjin e 2014*, kjo pjesë është fshirë dhe, në vend të saj, përcaktohet se kategoritë përfituese do të gëzonin “përparësinë në regjistrim dhe pranim në institucione arsimore publike në kushte të barabarta me të tjerët” (*Ligji i 2011*, neni 8, par. 1, pika 3, theks i shtuar; shih gjithashtu *id.*, neni 9, par. 1, pika 9, dhe *Ligjin e 2014*, neni 30). Një pasqyrë e të gjitha ndryshimeve relevante midis *Ligjit të 2006* dhe *Ligjeve të 2011* dhe *2014* paraqitet në Tabelën 1, poshtë.

---

përkufizimi i “veteran luftëtar” në *Ligjin e 2014* është pak më i ngushtë se përkufizimi i “veteran dhe pjesëtar i UÇK-së” në *Ligjin e 2006*. Megjithatë, janë mjaft afër njëri-tjetrit dhe prandaj mund t’u referohemi të dy kategorive me të njëjtin emër: “veteranët”. Gjithashtu, ia vlen për të përmendur se *Ligji i 2014* përkufizon nënkategori të tjera të veteranëve përveç “veteranëve luftëtarë”, por në këtë raport, termi “veteran” do të nënkuptohet përkatësisht si “veteran luftëtar”, sipas përkufizimit të këtij termi.

**Tabela 1: Pasqyrë e ndryshimeve midis Ligjit të 2006 dhe Ligjeve të 2011 dhe 2014 në përkufizimin e së drejtës për përparësi në regjistrim të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së**

	<b>Ligji i 2006</b>	<b>Ligjet e 2011 dhe 2014</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kategoritë që gëzojnë të drejtën për përparësi në regjistrim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së</li> <li>• invalidët e UÇK-së</li> <li>• veteranët e UÇK-së</li> <li>• anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së</li> <li>• invalidët civilë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së</li> <li>• invalidët e UÇK-së</li> <li>• anëtarët e familjeve të invalidëve të UÇK-së</li> <li>• veteranët e UÇK-së</li> <li>• anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së</li> <li>• anëtarët e familjeve të zhdukurve të UÇK-së</li> </ul>
<b>Kushtet në të cilat kategorive u jepet përparësi</b>	Me kusht të kalimit të pragut të pikëve në provimet pranuese	Në kushte të barabarta me të tjerët

**B. Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit midis Universitetit të Prishtinës dhe shoqatave të kategorive të dala nga lufta, dhe praktika e mëhershme e zbatimit të tij, për regjistrimin e kandidatëve të këtyre kategorive**

Në shtator të vitit 2009, tri vite pas hyrjes në fuqi të *Ligjit të 2006*, ish-rektori i Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Mujë Rugova, nënshkroi një “Memorandum Bashkëpunimi” (në tekstin e mëtejshëm: “*Memorandumi*”), në emër të Universitetit të Prishtinës, me tri shoqata të kategorive të dala nga lufta: Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së. Ky *Memorandum* u lidh “[m]e qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë”, për të ofruar ndihma për kategoritë e përfaqësuara nga shoqatat: “familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës dhe fëmijët e invalidëve e veteranëve të luftës” (*Memorandumi*, hyrja dhe pika 1). Sipas *Memorandumit*, Universiteti i Prishtinës “merr për obligim” të ndihmojë këto kategori në pesë fusha të caktuara, njëra prej të cilave është “në regjistrimin si student[ë] të rregulltë dhe me korrespondencë” (*id.*, pika 2), një obligim të cilin, megjithatë, *Ligji i 2006* e kishte përcaktuar mjaft qartë tri vite më parë. *Memorandumi* përcakton gjithashtu një detyrim reciprok për tri shoqatat nënshkruese, sipas të cilit ato do të “obligohen për dërgimin e listave të studentëve . . . që do të përfitojnë nga ndihmesat e UP-së” (*id.*, pika 3). Megjithatë, sa u përket “procedura[ve] [të] ofrimit të ndihmës reciproke”, *Memorandumi* i lë këto të papërcaktuara, duke parashikuar që palët nënshkruese do t’i përcaktonin “[m]e vendime të veçanta” (*id.*, pika 4).

Praktika e zbatimit të *Memorandumit*, që nga nënshkrimi i tij në vitin 2009, deri në vitin akademik 2013/2014, ka ndjekur dy hapa. Fillimisht, “aplikantët hyjnë në teste pranuese”, dhe pastaj, “[p]ërkundër që nuk tregojnë rezultate të mira emrat e tyre dërgohen në rektorat për

regjistrim në fakultetet ku i janë nënshtruar testeve”.<sup>5</sup> Për shembull, në vitin akademik 2013/2014, tri shoqatat nënshkruese dorëzuan “një listë me 649 emra . . . , numër ky i cili është dërguar vetëm në afatin e dytë”, pasi që nuk kishin përmbushur kriteret e përcaktuara në konkursin e afatit të parë.<sup>6</sup> Një pasqyrë e kësaj praktike të mëhershme paraqitet në Tabelën 2, poshtë.

**C. Qasja e re e Universitetit të Prishtinës për regjistrimin e kandidatëve të kategorive të dala nga lufta për vitin akademik 2014/2015 dhe ndalja e praktikës së mëhershme të zbatimit të *Memorandumit***

Në vitin akademik 2014/2015, Universiteti i Prishtinës vendosi të ndalë praktikën e mëhershme të zbatimit të *Memorandumit*. Më 30 maj 2014, Senati i Universitetit të Prishtinës shpalli konkursin e afatit të parë “për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore-bachelor në vitin akademik 2014/2015”. Paragrafi i tretë i shpalljes përcakton tri kategori që do të trajtoheshin në mënyrë të veçantë prej kandidatëve të tjerë: “(1) familje e ngushtë e dëshmorit (fëmijë ose bashkëshort/e);

---

<sup>5</sup> M. Krasniqi, “UP-ja Regjistron Qindra Studentë Jashtë Kritereve”, *Gazeta Jeta në Kosovë*, 25 nëntor 2013, në <http://gazetajnk.com/?cid=1.979.7086>.

<sup>6</sup> *Id.* Praktika e pranimit të kandidatëve jashtë kritereve nuk ishte e re në vitin 2009: “Këtë veprim për pranimin e studentëve që nuk arrijnë të tregojnë rezultate të mira në teste, universiteti më i madh publik në Kosovë e ka bërë që nga pas luft[ës] . . . . Zbatimi i një memorandumit të tillë ishte ndërprerë vetëm gjatë periudhës 2007–2009. Por, praktika është vënë sërish në jetë, me t’u bërë rektor Mujë Rugova në korrik të 2009-ës” (*id.*). E vetmja ndërprerje në këtë praktikë ndodhi gjatë udhëheqjes së ish-rektorit Enver Hasani, i cili pohoi në atë kohë që “[k]ërkesa për të regjistruar në atë mënyrë studentët është kundër çdo ligji dhe kundër çdo etike” (*id.*, duke cituar deklaratën e ish-rektorit Hasani për gazetën *Koha Ditore* më 10 korrik 2007).

(2) veteran/e i/e luftës; (3) invalid/e i/e luftës”.<sup>7</sup> Sipas kriterëve të caktuara në shpalljen e konkursit, kandidatët e

**Tabela 2: Pasqyrë e praktikës së zbatimit të Memorandumit nga viti akademik 2009/2010 deri në vitin akademik 2013/2014**

<b>Kategoritë që gëzojnë të drejtën për përparësi në regjistrim</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së</li><li>• invalidët e UÇK-së</li><li>• fëmijët e invalidëve të UÇK-së</li><li>• veteranët e UÇK-së</li><li>• fëmijët e veteranëve të UÇK-së</li></ul>
<b>Kushtet në të cilat kategorive u jepet përparësi</b>	Me kusht të nënshtimit (por jo edhe të kalimit) të provimeve pranuese

këtyre kategorive fillimisht duhet të arrijnë pragun minimal të kalueshmërisë në provimet pranuese. Pragu minimal për vitin akademik 2014/2015 ishte “30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues”. Ata të cilët e arrijnë këtë prag “do t’i nënshtrohen konkurrencës brenda një kuote të përcaktuar nga Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me MASHT-in dhe shoqatat përkatëse”.

Duke e ndjekur praktikën e viteve të mëhershme të përshkruar më sipër, tri shoqatat nënshtroren të Memorandumit, në fund të gushtit 2014, një muaj pas shpalljes së rezultateve të afatit të parë, dërguan tek Rektori i Universitetit të Prishtinës listat e kandidatëve që kishin aplikuar për regjistrim në Universitetin e Prishtinës. Sipas shoqatave, kandidatët në këto lista bënë pjesë në kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së dhe, për rrjedhojë, kishin të drejtë për t’u regjistruar, edhe pa përbushur kriteret e shpallura. Në tri listat e dërguara, të cilat Avokati i Popullit i

---

<sup>7</sup> Faktikisht, përkufizimi i përdorur këtu për frazën “familje e ngushtë” është pak më i ngushtë sesa përkufizimi i përdorur në ligj. Shih *supra*, fn. 1.

ka siguruar nga Rektorati i Universitetit të Prishtinës, paraqiten gjithsej 848 emra.<sup>8</sup>

Më 26 shtator 2014, Senati i Universitetit të Prishtinës shpalli konkursin plotësues për pranimin e studentëve në afatin e dytë. Në tekstin e kësaj shpalljeje vërehen dy ndryshime nga kriteret e konkursit të afatit të parë. Së pari, sipas kriterëve të afatit të dytë, vetëm njëra prej tri kategorive të privileguara në konkursin e parë (anëtarët e familjeve të dëshmorëve), do të gëzonin përparësi në regjistrim. Së dyti, në vend që t'u jepej kandidatëve të kësaj kategorie përparësi përmes konkurrencës brenda një kuote të veçantë, për konkursin e dytë përcaktohet që ata “do të kenë një bonus prej 5 pikësh në pikët e përgjithshme me rastin e aplikimit”. Por, “[k]andidatët . . . që nuk arrijnë të kalojnë pragun minimal prej 30% të provimit pranues . . . do të konsiderohen të refuzuar”, bashkë me “ata të cilët edhe përkundër bonusit prej 5 pikësh nuk arrijnë të kualifikohen në listën e kandidatëve të pranuar”.

Pastaj, më 16 tetor 2014, Senati i Universitetit të Prishtinës vendosi të ndryshonte edhe kriteret e konkursit në afatin e parë. Sipas këtij vendimi, kandidatët e tri kategorive të përmendura në shpalljen e konkursit të parë nuk do t'i nënshtroheshin më konkurrencës brenda një kuote të veçantë, ashtu siç ishte planifikuar. Në vend të kësaj, Senati vendosi të pranonte *të gjithë* kandidatët që kishin aplikuar në afatin e parë “të cilët i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve . . . e të cilët e kanë kaluar pragun prej 30% të pikëve nga provimi pranues në afatin e parë të konkursit” (pika I), pa pasur nevojë t'i nënshtrohen konkurrencës së mëtejshme. Por, përveç kandidatëve që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve, dy kategorive të tjera që do të duhej të përfitonin sipas kriterëve të shpallura për afatin e parë (veteranëve të

---

<sup>8</sup> Për dallim, në letrën e rektorit Zejnullahu të datës 9 janar 2015, llogaritet që shoqatat kanë kërkuar “regjistrimin e më shumë se 1,050 kandidatëve”.

luftës dhe invalidëve të luftës), në fund nuk u dha asnjë përparësi, as brenda një kuote të veçantë, as në ndonjë mënyrë tjetër. Prandaj, ndryshe nga praktika e mëhershme, kërkesat e dërguara nga tri shoqatat nënshkruese të *Memorandumit* janë zbatuar vetëm pjesërisht për vitin akademik 2014/2015, dhe vetëm për një kategori të dalë nga lufta. Një pasqyrë e të gjitha ndryshimeve midis tri vendimeve të Senatit të Universitetit të Prishtinës, në konkursin e vitit akademik 2014/2015, paraqitet në Tabelën 3, poshtë.

**D. Vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për regjistrimin e kandidatëve të kategorive të dala nga lufta, në linjë me praktikën e mëhershme të zbatimit të *Memorandumit*, dhe moszbatimi i këtij vendimi nga ana e Universitetit të Prishtinës**

Më 13 nëntor 2014, ministri i atëhershëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja, vendosi të ndërhynte në procesin e regjistrimit të studentëve, duke nxjerrë Vendimin nr. 178/01B “Për regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina në vitin akademik 2014/2015” (në tekstin e mëtejshëm: “*Vendimi i MASHT-it*”). Ky vendim urdhëroi një rikthim në praktikën e mëhershme të zbatimit të *Memorandumit*. Në linjë me këtë praktikë, *Vendimi i MASHT-it* kërkoi që “[t]ë regjistrohen fëmijët e kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së, sipas Memorandumit të Bashkëpunimit”,<sup>9</sup> por “vetëm ata kandidatë të cilët i janë nënshtruar provimeve pranuese sipas afateve zyrtare të shpallura nëpërmjet konkurseve për vitin akademik

---

<sup>9</sup> Megjithatë, ka një ndryshim të vogël midis kategorive përfutuese të përcaktuara në *Memorandum* dhe ato që përmenden në *Vendimin e MASHT-it*. *Vendimi i MASHT-it* flet vetëm për “fëmijët e kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së”, kurse *Memorandumi* përfshin jo vetëm fëmijët e kategorive, por edhe vetë invalidët dhe veteranët e luftës, si dhe anëtarët e tjerë të familjes së ngushtë të dëshmorëve. (Shih *supra*, Tabelën 2).



2014/2015” (par. 1–2), pa marrë parasysh nëse arritën të kalonin ose jo prapun minimal. Për më tepër, vendimi përcakton se: “Në pamundësi

**Tabela 3: Pasqyrë e kriterëve të përcaktuara nga Senati i Universitetit të Prishtinës sa i përket së drejtës për përparësi në regjistrim të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së për vitin akademik 2014/2015**

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konkursi i parë</li> <li>• <i>Vendimi i Senatit i datës 30 maj 2014</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konkursi i dytë</li> <li>• <i>Vendimi i Senatit i datës 26 shtator 2014</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimi i kriterëve të Konkursit të parë</li> <li>• <i>Vendimi i Senatit i datës 17 tetor 2014</i></li> </ul>
Kategoritë që gëzojnë të drejtën për përparësi në regjistrim	<ul style="list-style-type: none"> <li>• anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së</li> <li>• invalidët e UÇK-së</li> <li>• veteranët e UÇK-së</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së</li> </ul>
Kushtet në të cilat kategorive u jepet përparësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kalimi i pragut minimal në provimet pranuese</li> <li>• Sukses në konkurrencë brenda një kuote të veçantë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kalimi i pragut minimal në provimet pranuese</li> <li>• Sukses në konkurrencë me kandidatët e tjerë, me një bonus prej 5 pikësh</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kalimi i pragut minimal në provimet pranuese</li> </ul>

eventuale që të regjistrohen në programe ku kanë aplikuar, të regjistrohen në programe të përafërta” (par. 3).

Universiteti i Prishtinës vendosi të mos e zbatonte *Vendimin e MASHT-it*. Në një letër drejtuar ish-ministrit Buja, fill pas nxjerrjes së vendimit, rektori i Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu (në tekstin e mëtejshëm: *Rektori*), shpreh mospajtimin e tij me praktikën e mëhershme të zbatimit të *Memorandumit*. Sipas interpretimit të *Rektorit*, kjo praktikë nuk kishte qenë e detyruar nga përmbajtja e vetë *Memorandumit*: “Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Universitetit të Prishtinës dhe Shoqatave të dala nga lufta . . . parasheh lehtësime për regjistrimin e kandidatëve që u përkasin kategorive të lartpërmendura, por nuk përcakton kritere, procedura, apo kuota që do të aplikohen për këto raste”. Në të njëjtën letër, *Rektori* citon disa arsye “pse nuk mund të marr[ë] përgjegjësi për rritjen e numrit të studentëve sipas kërkesës [së ish-ministrit Buja]”. Një ndër arsyet e cituara nga *Rektori* ishte që “[r]ritja eventuale e numrit të studentëve do ta rëndonte procesin mësimor i cili po zhvillohet në mungesë të infrastrukturës hapësinore e laboratorike” dhe “do të ndërhynte në fillimin e vitit shkollor e si pasojë do ta dëmtonte cilësinë në procesin mësimor”.

**E. Dërgimi dhe ridërgimi i kërkesës së Avokatit të Popullit për masë të përkohshme dhe pezullimin e menjëhershëm të *Vendimit të MASHT-it*, dhe mospërgjigjia ndaj kësaj kërkesë nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës**

Më 2 dhjetor 2014, Avokati i Popullit vendosi të kërkojë masë të përkohshme dhe pezullimin e menjëhershëm të *Vendimit të MASHT-it*, deri në përfundimin e hetimeve nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit ia drejtoi këtë kërkesë ish-ministrit Buja, si dhe ish-kryeministrit, z. Hashim Thaçi. Baza ligjore e kërkesës së Avokatit të Popullit ishte neni 16, par. 5, i Ligjit Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, i cili përcakton se: “Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të

rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.” Duke vlerësuar seriozisht brengën dhe pohimet e *Rektorit* rreth pasojave të mundshme negative që do të mund të rezultonin nga zbatimi i *Vendimit të MASHT-it*, Avokati i Popullit konstatoi që, “këto pohime të Rektorit paraqesin dëshmi të mjaftueshme që ‘ekzekutimi i [këtij] vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme’ për studentët aktualë të Universitetit të Prishtinës”, dhe prandaj, kriteri ligjor për kërkesën për masë të përkohshme “është përmbushur qartazi në rastin konkret”. Megjithatë, Avokati i Popullit theksoi se rekomandimi për masë të përkohshme “nuk paragjykon në asnjë mënyrë meritat e çështjes ose rezultatet e . . . hetimeve”.

Në ndërkohë, më 9 dhjetor 2014, Kuvendi votoi Qeverinë e re të Republikës së Kosovës, me z. Isa Mustafa në krye të saj dhe z. Arsim Bajrami si ministri i ri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Më 10 dhjetor, ish-ministri Buja i dorëzoi detyrën ministrit të ri Bajrami, kurse më 12 dhjetor, ish-kryeministri Thaçi i dorëzoi detyrën kryeministrit të ri Mustafa.<sup>10</sup> Meqenëse Avokati i Popullit nuk mori asnjë përgjigje prej ish-ministrit Buja dhe ish-kryeministrit Thaçi, para se ata të dorëzonin detyrat tek pasardhësit e tyre, Avokati i Popullit, më 15 dhjetor 2014, iu drejtua kryeministrit Mustafa dhe ministrit Bajrami me kërkesa përsëritëse për masë të përkohshme dhe pezullimin e menjëhershëm të *Vendimit të MASHT-it*. Në të dyja letrat, Avokati i Popullit shprehu mirënjohjen e tij për fjalimin inaugurues të kryeministrit Mustafa me rastin e nominimit të tij, në të cilin ai theksoi se “Qeveria do t’i vendosë të drejtat e njeriut

---

<sup>10</sup> Shih “Buja i dorëzon detyrën Arsim Bajramit”, *Zëri*, 10 dhjetor 2014: <http://zeri.info/aktuale/10486/buja-i-dorezon-detyren-arsim-bajramit/>. Shih po ashtu “Sot, Thaçi i dorëzon detyrën Mustafës”, *Telegrafi*, 12 dhjetor 2014: <http://www.telegrafi.com/lajme/sot-thaci-i-dorezon-detyren-mustafes-2-55109.html>.

lart në axhendën e saj politike” dhe “do të sigurojë që rekomandimet e Ombudspersonit të adresohen në mënyrë adekuate”.

Megjithatë, deri më sot, Avokati i Popullit nuk ka marrë asnjë përgjigje prej ministrit Bajrami dhe kryeministrit Mustafa, sa i përket rekomandimit të tij për masë të përkohshme për këtë çështje. Në vend që t’i kthente Avokatit të Popullit përgjigje të drejtpërdrejtë, ministri Bajrami, në mbledhjen e pestë të Qeverisë, më 29 dhjetor 2014, “ka theksuar se do të mbështes[ë] palët, Universitetin e Prishtinës ‘Hasan Prishtina’ dhe shoqatat e dala nga lufta, që të arrijnë një zgjedhje të pranueshme për situatën e krijuar”, por njëkohësisht “ka theksuar mbështetjen për autonomin[ë] institucionale të Universitetit të Prishtinës . . . , duke shtuar se qeveria dhe ministria nuk mund të jenë adresa për zgjidhjen e këtij problemi”.<sup>11</sup> Gjithashtu, ministri Bajrami ka nxjerrë edhe deklarata të tjera, më 6 janar 2015 në faqen e tij të rrjetit social “Facebook”, si dhe më 16 janar në emisionin “Argument Plus” në RTK, duke ritheksuar besimin e tij në autonominë e Universitetit të Prishtinës.

Këto komunikata sugjerojnë se, ministri Bajrami dhe kryeministri Mustafa nuk kanë ndërmend të detyrojnë Universitetin e Prishtinës që ta zbatojë *Vendimin e MASHT-it*, megjithëse Avokati i Popullit nuk ka marrë asnjë informatë që e konfirmon këtë, dhe nuk ka marrë asnjë informatë që ata e kanë pezulluar, revokuar ose shfuqizuar këtë vendim.

**F. Komunikimet e mëtejshme midis Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Universitetit të Prishtinës dhe shoqatave të kategorive të dala nga lufta, dhe shkëputja e Memorandumit nga ana e Universitetit të Prishtinës**

---

<sup>11</sup> “Qeveria zhvilloi mbledhjen e 5-të, të rregullt”, përmbledhje e publikuar në uebfaqen e kryeministrit më 29 dhjetor 2014, në <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,4607>.

Gjatë javëve në vijim, pas deklaratës së ministrit Bajrami në mbledhjen e Qeverisë, u zhvillua një sërë komunikimesh midis ministrit Bajrami, zyrtarëve të Universitetit të Prishtinës dhe tri shoqatave nënshkruese. Më 5 janar 2015, *Rektori* i drejtoi ministrit Bajrami një letër rreth situatës së krijuar lidhur me kategoritë e dala nga lufta. Në këtë letër, *Rektori* shprehu mendimin e tij që *Memorandumi* midis Universitetit të Prishtinës dhe tri shoqatave nënshkruese “është një dokument mirëkuptimi me të cilin Universiteti ka shprehur vullnetin e mirë që t’u ndihmojë kategorive të dala nga lufta për regjistrim në Universitet”. Mirëpo, “[n]jë dokument mirëkuptimi, sipas praktikës dhe parimeve juridike, nuk mund të paraqesë referencë ligjore që obligon palët”. Për më tepër, *Rektori* përsërit mendimin e shprehur në letrën e tij të mëparshme, që i kishte drejtuar ish-ministrit Buja, se “[m]emorandumi nuk përcakton asnjë modalitet të konkretizimit të këtij vullneti të mirë”, ndërsa ligjet në fuqi “parashohin përparësi për regjistrimin e . . . kategorive [përkatëse] në institucione arsimore publike, por në kushte të barabarta” (theks në origjinal).

Sa i përket konkursit të afatit të parë, *Rektori* pranon që “edhe pse ishte paraparë përcaktimi i një kuote për kandidatët që u takojnë kategorive të luftës dhe kanë arritur pragun minimal të kalueshmërisë, kjo kuotë është anashkaluar”. Justifikimi i këtij anashkalimi ishte që “kërkesa e vetme e shoqatave ka qenë të pranohen të gjithë kandidatët që ndodhen në lista, pa marrë parasysh nëse kanë arritur pragun minimal të kalueshmërisë ose jo”. Pastaj, letra e *Rektorit* rithekson se në vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës të datës 16 tetor 2014, është vendosur “të pranohen të gjithë kandidatët nga familjet e dëshmorëve që kanë arritur pragun minimal të kalueshmërisë, gjithsej 79 studentë”, kurse për konkursin plotësues, është vendosur “që t’u jepen nga 5 pikë bonus të gjithë kandidatëve nga familjet e dëshmorëve dhe 50 kandidatë janë regjistruar duke shfrytëzuar këtë privilegj”. Megjithatë, lidhur me këta kandidatë, *Rektori* ngre një shqetësim, që sipas një mostre të vogël prej 19 nga 79 studentë të pranuar në konkursin e parë,

“6 prej tyre deklarojnë se e kanë njërin prind të vrarë gjatë luftës, ndërsa 13 deklarojnë se i kanë të dy prindërit gjallë”.

Përveç 129 kandidatëve të pranuar në bazë të anëtarësisë së tyre (të pretenduar) në familje të dëshmorëve, *Rektori* pohon se “Universiteti i Prishtinës nuk mund të bëjë regjistrimin e studentëve jashtë kriterëve të konkursit dhe në kundërshtim me vendimet e organeve të tij”. Gjithsesi, sipas *Rektorit*, Universiteti i Prishtinës mbetet i gatshëm për të ofruar një program “për përkrahjen e kandidatëve që i takojnë kategorive të luftës . . . , duke i përfshirë edhe kandidatët të cilët nuk kanë arritur të regjistrohen këtë vit në Universitetin e Prishtinës”.

Së fundi, *Rektori* e njofton ministrin Bajrami se, “për të shmangur të gjitha keqkuptimet dhe keqinterpretimet në të ardhmen,” Universiteti i Prishtinës kishte vendosur të shkëpuste, në mënyrë të njëanshme, *Memorandumin*, “duke besuar se kjo fushë tanimë është rregulluar në masë të mjaftueshme me ligjet e Republikës së Kosovës dhe do të vazhdojë të rregullohet në të ardhmen me akte nënligjore përkatëse.”

Më 6 janar 2015, ministri Bajrami i ktheu përgjigje *Rektorit*, duke iu drejtuar njëkohësisht dhe Kryesueses së Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, Dr. sc. Shefkije Islamaj. Megjithëse ministri thekson se “Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për respektimin e parimit të autonomisë akademike të Univeritetit të Prishtinës”, letra e ministrit Bajrami përfshin edhe disa kërkesa dhe rekomandime.

Së pari, ministri Bajrami i referohet vendimit të *Rektorit* për ndërprerjen e *Memorandumit* me shoqatat nënshkruese, dhe u kërkon *Rektorit* dhe kryesueses Ismajli “që njoftimin për këtë vendim të ju përcjell[in] zyrtarisht shoqatave përkatëse”.

Pastaj, ministri Bajrami shpreh shqetësimin e tij për vendimin e Universitetit të Prishtinës për anashkalimin e konkurrencës brenda kuotës së veçantë, e cila ishte përcaktuar në konkursin e afatit të parë për “kandidatët e kategorive të familjes së ngushtë të (1) dëshmorit, (2) veteranëve dhe (3) invalidëve të luftës” (Letra e ministrit Bajrami), që

arritën të kalonin pragun minimal të kalueshmërisë. Sipas ministrit Bajrami, “[k]onkursi i shpallur dhe kriteret e përcaktuara në të, janë miratuar nga Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me 30 maj 2014 dhe si të tilla sipas parimeve dhe dispozitave juridike, paraqesin referencë ligjore që obligon palët”. Bazuar në vendimin e Senatit prej kësaj mbledhjeje, ministri Bajrami e kritikon pranimin eventual të kandidatëve që i takojnë familjes së dëshmorëve pa nënshtrimin e konkurrencës së mëtejshme që Senati e kishte miratuar. Ministri Bajrami kritikon gjithashtu mosorganizimin e konkurrencës brenda një kuote të veçantë për “kandidatët nga familjet e ngushta të veteranëve dhe invalidëve të luftës” që kishin kaluar pragun minimal. Sipas ministrit Bajrami, “Universiteti i Prishtinës duhet gjithmonë të bëjë regjistrimin e studentëve sipas kushteve dhe kriterëve akademike të përcaktuara me konkurset e shpallura për pranimin e studentëve, sipas vendimeve të organeve të tij.” Sipas Ministrit, kjo do të thotë se Universiteti i Prishtinës ishte i detyruar të zbatojë kriteret e shpallura më 30 maj 2014.

Për më tepër, ministri Bajrami vëren se “kemi shumë kandidat[ë] nga këto kategori që kanë vijuar studimet tash e disa muaj nëpër njësi akademike, duke mos e gëzuar statusin juridik të studentit të regjistruar”. Ministri Bajrami u lutet rektorit Zejnullahu dhe kryesueses Ismajli që t’u japin këtyre kandidatëve një përgjigje përfundimtare lidhur me statusin e tyre.

Së fundi, sa i përket verifikimit të statusit të kandidatëve në listat e shoqatave, ministri Bajrami shpreh mendimin që kjo vështirësi mund të kapërcehet dhe u rekomandon *Rektorit* dhe Kryesueses Ismajli që “administrata juaj në bashkëpunim me Zyrën për çështjet e kategorive të dala nga lufta e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, të bëjnë verifikimin e gjithë dokumentacionit dhe vërtetësisë së të dhënave të kandidatëve të paraqitur”.

Disa ditë më vonë, më 9 janar 2015, *Rektori* u drejtoi një letër udhëheqësve të tri shoqatave nënshkruese të *Memorandumit*: z. Smajl

Elezaj, kryetar (u.d.) i Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK; z. Xhavit Jashari, kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK; dhe z. Fadil Shurdhaj, kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Luftës. Kjo letër i njofton zyrtarisht shoqatat për tërheqjen e Universitetit të Prishtinës nga *Memorandumi*, dhe i përsërit arsyet për tërheqjen që i kishte shprehur ministrit Bajrami në letrën e 5 janarit. Në justifikim të shkëputjes së Memorandumit, *Rektori* pretendon se çështja e përparësisë në regjistrim “tanimë është rregulluar në masë të mjaftueshme me ligjet e Kosovës,” dhe që një arsye tjetër për shkëputjen ishin “keqkuptimet në interpretimin e karakterit të [*Memorandumit*] dhe të obligimeve të palëve që dalin nga ky dokument”. Përveç kësaj, *Rektori* e përsërit pretendimin e tij se *Memorandumi* “është një dokument mirëkuptimi me të cilin Universiteti ka shprehur vullnetin e mirë” dhe “nuk paraqet obligim ligjor për palët nënshkruese”.

Duke iu referuar praktikës së mëhershme të zbatimit të *Memorandumit*, *Rektori* pohon se kërkesat e shoqatave “për regjistrimin e të paktën 1,050 kandidatëve . . . bazohen në një praktikë 4-vjeçare, e jo në përmbajtjen ose në karakterin obligues të *Memorandumit*”. Ai rithekson vendimin e Universitetit që “nuk do të marrë obligim që në të ardhmen të regjistrojë studentë sipas këtij dokumenti”. Megjithatë, *Rektori* i njofton udhëheqësit e shoqatave se Universiteti i Prishtinës është duke zhvilluar një “program të veçantë për përkrahjen e kandidatëve që u takojnë kategorive të luftës”, i cili “nënkupton ofrimin e ndihmës për përgatitjen e kandidatëve për provimin shtetëror të maturës dhe provimin pranues, si dhe këshillimin akademik gjatë studimeve”. Sipas *Rektorit*, “Universiteti i Prishtinës mbetet i përkushtuar . . . t’i zbatojë të gjitha obligimet ndaj kategorive të luftës që dalin nga legjislacioni i Kosovës”, duke përfshirë “dhëni[en] e përparësisë me rastin e regjistrimit në kushte të barabarta”.

Këto premtime, me sa duket, nuk ishin të mjaftueshme për Organizatën e Veteranëve të Luftës, kryesia e së cilës, më 13 janar 2015, vendosi të padisë *Rektorin*. Në një komunikatë për mediat, kjo shoqatë shpjegoi se



padia do të ngritet “për mosrespektim të Memorandumit, gjatë kohës sa ai ishte në fuqi. Prishja e njëanshme e Memorandumit nga Rektori, vlen për vitin e ardhshëm akademik, e asesi për vitin akademik 2014/2015, kur Memorandumi ishte në fuqi”. Për më tepër, komunikata e shoqatës pretendon se “[n]e si Organizatë, kemi kryer të gjitha obligimet sipas Memorandumit, proces mjaft i vështirë dhe delikat, njëkohësisht organet kompetente ftohen që të kontrollojnë e verifikojnë listën tonë, për saktësinë e të cilës ne japim përgjegjësi të plotë”.

### **ANALIZA JURIDIKE**

Analiza juridike e Avokatit të Popullit ndahet në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë paraqet një vlerësim të ligjshmërisë së të gjitha veprimeve (dhe mosveprimeve) të autoriteteve të dy institucioneve shtetërore të përfshira në këtë rast: Universiteti i Prishtinës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky vlerësim do të shoqërohet me rekomandime për autoritetet e të dyja këtyre institucioneve, për harmonizimin e praktikave të tyre me ligjet në fuqi. Pjesa e dytë e analizës, ofron një vlerësim të kushtetutshmërisë së *Ligjeve të 2011 dhe 2014*, përkatësisht të pjesëve që parashohin përparësi në regjistrim për kategoritë e dala nga lufta. Ky vlerësim do të shoqërohet me rekomandime për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me qëllimin e harmonizimit të ligjeve me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut.<sup>12</sup>

Këto dy pjesë të analizës juridike, si dhe rekomandimet me të cilat shoqërohen, janë relativisht të pavarura prej njëra-tjetrës. Mospërputhja

---

<sup>12</sup> Në këtë rast, Avokati i Popullit nuk ka mundësi të kërkojë prej Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shfuqizim, të plotë ose të pjesshëm, të *Ligjeve të 2011 dhe 2014*, sepse ka kaluar afati gjashtëmuor nga hyrja në fuqi e këtyre ligjeve, pas të cilit Avokati i Popullit nuk ka të drejtë ligjore t’i referojë si çështje përpara Gjykatës. Shih Ligjin Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 29 dhe 30.

e ligjeve në fuqi me Kushtetutën nuk do të lironte në asnjë mënyrë Universitetin e Prishtinës apo Qeverinë e Republikës së Kosovës prej detyrimit të tyre për t'i zbatuar këto ligje në mënyrë të plotë. Për aq kohë që një ligj është në fuqi, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës—madje të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës—e kanë për detyrë ta respektojnë, derisa i njëjti të ndryshohet ose shfuqizohet nga institucionet kompetente. Për këtë arsye, rekomandimet e Avokatit të Popullit, për zbatimin e plotë të ligjeve në fuqi, nuk varen nga rezultatet e vlerësimit të kushtetutshmërisë së këtyre ligjeve.

## **I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS DHE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS LIDHUR ME PËRPARËSINË NË REGJISTRIM PËR KANDIDATËT E KATEGORIVE TË DALA NGA LUFTA NË VITIN AKADEMIK 2014/2015**

### **A. Vlerësimi i ligjshmërisë së veprimeve të Universitetit të Prishtinës**

Vlerësimi i ligjshmërisë së veprimeve të Universitetit të Prishtinës mund të ndahet në dy pjesë. Së pari, duhet të vlerësohet ligjshmëria e tri vendimeve të Senatit të Universitetit të Prishtinës, lidhur me konkurset për pranimin e studentëve në vitin akademik 2014/2015. Së dyti, duhet të vlerësohet ligjshmëria e zbatimit të *Memorandimit* nga ana e Universitetit të Prishtinës, si dhe tërheqja e njëanshme nga ky *Memorandum*. Një tjetër veprim (ose më saktë, mosveprim) i Universitetit të Prishtinës, moszbatimi i *Vendimit të MASHT-it*, do të duhet të vlerësohet gjithashtu, por kjo do të jetë e mundur vetëm pasi të vlerësojmë nëse ish-ministri Buja kishte të drejtë ose jo ta nxjerrë vendimin e tij në radhë të parë (shih *infra*, §I.B.1).

#### **1. Vendimet e Senatit të Universitetit të Prishtinës**

Vendimet e Senatit, të datave 30 maj 2014, 26 shtator 2014 dhe 16 tetor 2014, përcaktojnë, përkatësisht: kriteret e konkursit në afatin e parë, kriteret e konkursit në afatin e dytë dhe ndryshimet e kriterëve të

konkursit në afatin e parë (shih Tabelën 2, *supra*). Këto vendime duhet të vlerësohen nga dy aspekte, në linjë me dy dimensionet e së drejtës për përparësi në regjistrim të përcaktuara në ligj (shih Tabelën 1, *supra*). Së pari, duhet sqaruar nëse tri vendimet u japin përparësi të gjitha kategorive të duhura sipas *Ligjeve të 2011 dhe 2014*. Së dyti, duhet sqaruar nëse tri vendimet japin përparësi në “kushte të barabarta me të tjerët”, ashtu siç përcaktohet në këto ligje.

Sa i përket dimensionit të parë, *Ligjet e 2011 dhe 2014* përcaktojnë gjashtë kategori të dala nga lufta, të cilëve duhet t’u jepet përparësi:

- (1) anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së
- (2) invalidët e UÇK-së
- (3) anëtarët e familjeve të invalidëve të UÇK-së
- (4) veteranët e UÇK-së
- (5) anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së
- (6) anëtarët e familjeve të të zhdukurve të UÇK-së

Vendimi për shpalljen e konkursit në afatin e parë përcakton vetëm kategoritë (1), (2) dhe (4) me përparësi në regjistrim, duke lënë mënjanë kategoritë (3), (5) dhe (6).<sup>13</sup> Vendimi për shpalljen e konkursit në afatin të dytë dhe vendimi për ndryshimin retroaktiv të kriterëve të konkursit të afatit të parë, e shkurtojnë këtë listë edhe më shumë, duke përcaktuar vetëm kategorinë (1), anëtarë të familjeve të dëshmorëve, si kategori që përfiton. Pesë kategorive të tjera, nuk u japin asnjë përparësi në regjistrim. Në këtë mënyrë, qasja e Universitetit të Prishtinës ndaj kategorive të dala nga lufta, për vitin akademik 2014/2015, paraqet një dallim në trajtimin e anëtarëve të familjeve të dëshmorëve, kundrejt pesë kategorive të tjera.

---

<sup>13</sup> Është e mundshme që kategoria (6) konsiderohen si të përfshirë në kategorinë (1), por kjo nuk është e qartë nga vendimi.

Ky dallim nuk është në përputhje me *Ligjet e 2011 dhe 2014*. Sipas këtyre ligjeve, gjashtë kategoritë e listuara kanë të njëjtën të drejtë për të përfitur nga përparësia në regjistrim. Kjo është mjaft e qartë nga fakti se, këto ligje përdorin (ose citojnë) të njëjtat fjalë në përcaktimin e së drejtës për përparësi për të gjitha gjashtë kategoritë. Shih *Ligjin e 2011*, neni 8, pika 1.3 (“Anëtarët e ngushtë të familjes së dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së . . . realizojnë . . . përparësinë në regjistrim dhe pranim në institucione arsimore publike në kushte të barabarta me të tjerët” (theks i shtuar)); *id.*, neni 9, par. 1, pika 1.9 (“Invalidët e UÇK-së . . . realizojnë . . . përparësinë për regjistrim dhe pranim në institucione arsimore publike në kushte të barabarta me të tjerët” (theks i shtuar)); *id.*, neni 9, par. 2 (“Të drejtat dhe beneficionet e përcaktuara në paragrafin 1[,] nën-paragraf[i] . . . 1.9 . . . të këtij neni i realizojnë edhe anëtarët e familjes së ngushtë të invalidëve të UÇK-së”); *Ligjin e 2014*, neni 30 (“Përparësia e pranimit në institucionet arsimore publike, në kushte të barabarta, është e drejtë të cilën e realizojnë veteranët luftëtarë dhe anëtarët e ngushtë të familjes së tyre” (theks i shtuar)). Siç është e dukshme nga pjesët e theksuara të tekstit, gjashtë kategorive u jepet e njëjta e drejtë për përparësi në regjistrim sipas ligjit. Prandaj, privilegjimi i anëtarëve të familjeve të dëshmorëve, kundrejt pesë kategorive të tjera, nuk ka asnjë bazë ligjore. **Në këtë aspekt, Avokati i Popullit konsideron se qasja e Universitetit të Prishtinës ndaj kategorive të dala nga lufta, për vitin akademik 2014/2015, ka qenë e kundërligjshme.**

Sa i përket dimensionit të dytë—nëse përparësia në regjistrim është dhënë “në kushte të barabarta me të tjerët”—duhet së pari të sqarojmë se çfarë kuptimi duhet t’i japim kësaj fraze. Ka tri interpretime të mundshme. Sipas interpretimit të parë, “kushte të barabarta” do të thotë “kushte *pjesërisht* të barabarta”: në mënyrë që anëtarët e kategorive të dala nga lufta të përfitojnë nga përparësia në regjistrim, është e mjaftueshme që ata të kenë kualifikime të njëjta me kandidatë të tjerë, por vetëm sipas *disa* prej kriterëve të përcaktuara për pranim. Sipas interpretimit të dytë, “kushte të barabarta” do të thotë “kushte *plotësisht*

të barabarta”: kandidatët që u takojnë kategorive të dala nga lufta duhet të kenë kualifikime të njëjta me kandidatë të tjerë, sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara për pranim, para se t’u jepet përparësi kundrejt tyre. Kjo do të thotë se përparësia mund të jepet vetëm në raste ku dy ose më shumë kandidatë fitojnë të njëjtin numër pikësh gjithsej, dhe disa prej tyre u takojnë kategorive të dala nga lufta. Sipas interpretimit të tretë, të dy këto interpretime janë të gabuara, sepse *Ligjet e 2011* dhe *2014* e lënë të papërcaktuar nëse kandidatët e kategorive të dala nga lufta mund të përfitojnë në kushte *pjesërisht* të barabarta me të tjerët, ose vetëm në kushte *plotësisht* të barabarta. Sipas interpretimit të tretë, ligjet e lënë në diskrecionin e Universitetit të Prishtinës për të përcaktuar se cilat kushte këta kandidatë duhet t’i kenë të barabarta me të tjerët, në mënyrë që të përfitojnë nga përparësia në regjistrim.<sup>14</sup>

Një shembull konkret mund të bëjë edhe më të qartë dallimin midis këtyre tri interpretimeve. Le të supozojmë që një kandidat hipotetik është fëmija i një veterani të luftës dhe është diplomuar nga shkolla e mesme, por nuk ka kaluar provimin pranues të Universitetit të Prishtinës, madje as nuk ka hyrë në provim fare. A duhet t’i jepet këtij kandidatit përparësi kundrejt të gjithë kandidatëve të tjerë që, njëlloj si ai, janë diplomuar nga shkolla e mesme? Sipas interpretimit të parë, ky kandidat është në “kushte të barabarta me të tjerët”, sepse në të paktën një aspekt—aspekti i diplomimit nga shkolla e mesme—ai ka kualifikime të njëjta me kandidatët e tjerë që nuk i takojnë ndonjë

---

<sup>14</sup> Kur flitet në këtë pjesë të raportit për “diskrecion”, nënkuptohet *diskrecioni substancial*, i cili ka të bëjë me pyetjen, a ka kufij ligjorë mbi lirinë e institucioneve arsimore për të përcaktuar kriteret për regjistrimin e studentëve, sa i përket substancës së atyre kriterëve? Ky koncept nuk duhet të ngatërrohet me konceptin e *diskrecionit procedural*, i cili ka të bëjë me pyetjen, a ka të drejtë ndonjë institucion tjetër, si p.sh. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për të ndërhyrë në caktimin e kriterëve për regjistrimin e studentëve? Çështja e diskrecionit procedural do të trajtohet *infra*, në pjesën I-B-1 të këtij raporti.

kategorie të veçantë, dhe prandaj, sipas ligjit, ai ka të drejtë të regjistrohet në Universitetin e Prishtinës përpara të tjerëve.

Sipas interpretimit të dytë, kandidati në fjalë nuk do të gëzonte përparësi në regjistrim. Megjithëse kandidati është i barabartë me të tjerët nga të paktën një aspekt, nuk është i barabartë me ta në *të gjitha* aspektet: për shembull, nuk ka marrë të njëjtin vlerësim në provimin pranues që kanë marrë kandidatë të tjerë, përderisa nuk e ka dhënë fare provimin pranues. Sipas interpretimit të dytë, pra, kandidati në fjalë nuk do të gëzonte përparësi në regjistrim kundrejt kandidatëve të tjerë, sepse nuk ka arritur të njëjtin numër pikësh gjithsej sa kanë arritur kandidatët e tjerë, dhe prandaj nuk ekzistojnë kushte *plotësisht* të barabarta midis tyre.

Sipas interpretimit të tretë, ligji nuk përcakton nëse kandidati në fjalë ka të drejtë ose jo për përparësi në regjistrim. Përkundrazi, kjo është një çështje që lihet në diskrecionin e Universitetit të Prishtinës. Nëse Universiteti vendos se, në mënyrë që të përfitohet nga përparësia në regjistrim, është e mjaftueshme që kandidatët prej kategorive të dala nga lufta të jenë të barabarta vetëm në aspektin e diplomimit nga shkolla e mesme, atëherë kandidati në fjalë do të kishte të drejtë për të gëzuar këtë përparësi. Por nëse Universiteti i Prishtinës vendos se është e nevojshme që të ekzistojnë edhe kushte të tjera të barabarta me kandidatët e tjerë në mënyrë që të jepet përparësia, atëherë fakti që kandidati në fjalë është diplomuar nga shkolla e mesme nuk do të mjaftonte, më vete, për gëzimin e kësaj përparësie.

Nga këto tri interpretime të mundshme, interpretimin e parë mund ta eliminojmë, sepse na çon në rezultate absurde. Edhe kandidati më i dobët dhe jo i kualifikuar mund të jetë i barabartë, nga një ose dy aspekte, me kandidatët më të fortë. Për Fakultetin e Mjekësisë, për shembull, përcaktohet në shpalljen e konkursit në afatin e parë që: “Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të matures . . . [n]umri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë: Suksesi në shkollën e mesme deri në 20

pikë; dhe [s]uksesi në provim pranues deri në 80 pikë”. Kandidati hipotetik që kemi diskutuar më sipër, do të kishte mundësi të arrijë maksimalisht 20 pikë, sepse kemi supozuar se ai nuk ka hyrë fare në provimin pranues. Nëse imagjinojmë një kandidat tjetër me të njëjtin numër pikësh të fituara në bazë të suksesit në shkollën e mesme, por që i është nënshtruar provimit pranues dhe ka marrë notën maksimale (80 pikë) në këtë provim, atëherë këta dy kandidatë do të ishin “në kushte të barabarta” sipas interpretimit të parë, përderisa në një aspekt (aspekti i suksesit në shkollën e mesme), ata kanë kualifikime të njëjta. Për rrjedhojë, sipas interpretimit të parë, kandidati që nuk ka hyrë në provim fare, në rast se i takon njëres prej kategorive të dala nga lufta, do të gëzonte përparësi kundrejt kandidatit tjetër në Fakultetin e Mjekësisë, edhe pse ky kandidat tjetër ka avantazh prej 80 pikësh ndaj tij, nga 100 pikë gjithsej të mundshme. Ky do të ishte një rezultat qartazi absurd. “Ligjet duhet të interpretohen për të shmangur rezultate absurde” (E. Elhauge, *Statutory Default Rules: How to Interpret Unclear Legislation* (2008), f. 144). Prandaj, në këtë rast, jemi të detyruar që të mos e kuptojmë frazën “kushte të barabarta me të tjerët” sipas interpretimit të parë.

Gjithashtu, interpretimin e tretë mund ta eliminojmë si të papranueshëm. Sipas këtij interpretimi, *Ligjet e 2011 dhe 2014* e lënë në diskrecionin e Universitetit të Prishtinës për të përcaktuar se cilat kushte duhet të jenë “të barabarta me të tjerët”, në mënyrë që një kandidat nga kategoritë e dala nga lufta të gëzojë përparësi në regjistrim. As ky interpretim nuk mund të pranohet, sepse e shëndrron frazën “kushte të barabarta me të tjerët” në fjalë të tepërta. Nëse Kuvendi kishte ndërmend t’i linte të papërcaktuara kushtet në të cilat kandidatët mund të përfitojnë nga e drejta për përparësi në regjistrim, dhe t’i linte Universitetit të Prishtinës të drejtën për t’i përcaktuar këto kushte, atëherë nuk do të kishte pasur nevojë të përcaktojë se përparësia mund të jepet vetëm “në kushte të barabarta me të tjerët”. Do të kishte mjaftuar që të përcaktohet thjesht se, kategoritë do të gëzonin “përparësinë për regjistrim dhe pranim në institucione arsimore

publike”, pa përmendur ndonjë kusht specifik, ose të paktën të përcaktohet se kategoritë në fjalë do ta gëzonin përparësinë “në kushte të përcaktuara nga Universiteti i Prishtinës me vendime të veçanta”. Sido që të jetë, formulimi “kushte të barabarta me të tjerët” do të ishte i tepërt dhe i papërshtatshëm nëse e lexojmë sipas interpretimit të tretë. “[Ç]do nen dhe çdo fjalë në ligj përfshihet për një arsye” (T.A. Dorsey, *Statutory Interpretation and Construction* (2010), §3.34, f. 85). Prandaj, jemi të detyruar të shmangim interpretimin e tretë të frazës “kushte të barabarta”, sepse kjo frazë nuk do të kishte arsye për t’u përfshirë në tekstin e ligjeve.

I vetmi interpretim që mbetet si i vlefshëm është interpretimi i dytë, sipas të cilit kandidatët që u takojnë kategorive të dala nga lufta do të gëzonin përparësi në regjistrim vetëm në kushte *plotësisht* të barabarta me të tjerët, pra: nuk mjafton që të ekzistojnë kushte vetëm pjesërisht të barabarta midis kandidatëve, dhe nuk është në diskrecionin e Universitetit të Prishtinës, që të përcaktojë se cilat kushte duhet të jenë të barabarta mes kandidatëve, në mënyrë që të jepet përparësia. Sipas *Ligjeve të 2011* dhe *2014*, për kandidatët e kategorive të dala nga lufta, vlejnë të njëjtat kritere si për kandidatët e tjerë. Vetëm në raste ku dy ose më shumë kandidatë kanë të njëjtin numër pikësh gjithsej, atëherë mund të gëzojë përparësi kandidati që i takon një kategorie të dalë nga lufta.

Edhe dy vërejtje të mëtejshme lidhur me frazën në diskutim: Së pari, duhet theksuar se, interpretimi i frazës “në kushte të barabarta me të tjerët”, prapëseprapë i lë Universitetit të Prishtinës diskrecionin e plotë për të përcaktuar kriteret e *përgjithshme* për pranim. E vetmja kërkesë e *Ligjeve të 2011* dhe *2014* është që, këto kritere të përgjithshme, çfarëdo që të jenë, të zbatohen për të gjithë kandidatët pa dallim, duke përfshirë kandidatët e kategorive të dala nga lufta. Dhe, vetëm më pastaj, në raste të pikëve të barabarta, mund t’u jepet përparësi kandidatëve të kategorive të dala nga lufta.

Së dyti, me sqarimin e frazës “kushte të barabarta me të tjerët”, mund të



kuptohet më saktë tranzicioni nga *Ligji i 2006* në *Ligjet e 2011* dhe *2014*. Siç u pa më sipër, *Ligji i 2006* përcaktonte se, kategoritë e dala nga lufta do të gëzonin përparësi në regjistrim “me kusht që të kalojnë pragun e poenëve në provimet pranuese” (*id.*, neni 5, par. 2, pika 14). Sipas kësaj dispozite, kandidatët e kategorive të përcaktuara në këtë ligj do të gëzonin përparësi me kalimin e pragut minimal, edhe nëse nuk arrijnë të të njëjtin numër pikësh sa kandidatët e tjerë. Por, në *Ligjet e 2011* dhe *2014*, Kuvendi ka vendosur të imponojë kushte më rigoroze për realizimin e së drejtës për përparësi në regjistrim. Me hyrjen në fuqi të *Ligjeve të 2011* dhe *2014*, nuk mjafton më që kandidatët prej kategorive të dala nga lufta thjesht të kalojnë pragun minimal në provimet pranuese. Sipas këtyre ligjeve, ata duhet jo vetëm të kalojnë pragun minimal por edhe të fitojnë të njëjtin numër pikësh sa kandidatë të tjerë, në mënyrë që t’u jepet përparësia kundrejt tyre.

Me këto sqarime, mund të vlerësojmë ligjshmërinë e tri vendimeve të Senatit të Universitetit të Prishtinës, sa u përket kushteve që secili vendim i përcakton për përfitimin nga e drejta për përparësi. Vendimi i Senatit i datës 30 maj 2014 përcaktoi kriteret për konkursin e afatit të parë dhe vendosi dy kushte: (1) kalimi i pragut minimal në provimet pranuese dhe (2) suksesi në konkurrencë brenda një kuote të veçantë për tri kategoritë e përcaktuara (anëtarët e familjeve të dëshmorëve të luftës, veteranët e luftës dhe invalidët e luftës). Vendimi i Senatit i datës 26 shtator 2014 përcaktoi kriteret për konkursin e afatit të dytë, dhe vendosi gjithashtu dy kushte: (3) kalimi i pragut minimal në provimet pranuese dhe (4) suksesi në konkurrencë me të gjithë kandidatët e tjerë (jo brenda një kuote të veçantë), me një bonus prej 5 pikësh në konkursin e përgjithshëm. Vendimi i Senatit i datës 16 tetor 2014 ndryshoi kriteret e konkursit të parë dhe i bëri edhe më të lehta kushtet për përfitim për njërën kategori, anëtarët e familjeve të dëshmorëve, të cilët, sipas kriterëve të reja, vetëm (5) duhej të kishin kaluar pragun minimal në mënyrë që të pranohen, pa pasur nevojë fare t’i nënshtrohen konkurrencës së mëtejshme.

Avokati i Popullit vëren se të tri vendimet e Senatit janë në përputhje,

të paktën me *Ligjin e 2006*, i cili përcaktonte që kandidatët nga kategoritë e dala nga lufta mund të gëzojnë përparësi vetëm nëse arrijnë të kalojnë provimet pranuese. Siç evidentohen nga kriteret (1), (3) dhe (5) më lart, të tri vendimet përfshijnë këtë kusht. Megjithatë, asnjëri prej tri vendimeve nuk është në përputhje me ligjet aktualisht në fuqi, *Ligjet e 2011* dhe *2014*, sepse japin përparësi pa kërkuar barazi të plotë në pikët e fituara gjithsej. Të tri vendimet, në një mënyrë ose tjetër, përcaktojnë kriterë më të lehta për pranim, të paktën për disa prej kategorive, kundrejt kriterëve për kandidatët e tjerë në përgjithësi. Përcaktimi i kriterëve të veçanta—organizimi i një kuote të veçantë sipas vendimit të parë, dhënia e pesë pikëve bonus sipas vendimit të dytë, dhe pranimi i të gjithë kandidatëve të një kategorie vetëm me kalimin e pragut minimal, sipas vendimit të tretë—ka lejuar regjistrimin e disa kandidatëve përpara kandidatëve të tjerë megjithëse këta kandidatë të tjerë kishin fituar më shumë pikë gjithsej. Kjo do të thotë se përpërsia është dhënë në kushte jo plotësisht të barabarta. Prandaj, **tri vendimet e Senatit Avokati i Popullit i cilëson të kundërligjshme, sepse japin më shumë përparësi sesa lejohet sipas Ligjeve të 2011 dhe 2014.**

Një tjetër problem ligjor me zbatimin e vendimeve të Senatit, është ngritur nga vetë *Rektori*, në letrën e tij të datës 5 janar 2015. Në këtë letër, siç kemi parë më sipër, *Rektori* njofton se, sipas një mostre të vogël prej 19 kandidatëve të pranuar si anëtarë të familjeve të dëshmorëve, 13 deklaruan se i kanë të dy prindërit gjallë. Avokati i Popullit i cilëson këto të dhëna si jashtëzakonisht shqetësuese, sepse përbëjnë dëshmi se në listat e dërguara nga shoqatat, ka mundësi që janë përfshirë kandidatë në bazë të informacioneve të falsifikuara. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vëren se, sipas Rregullores së Universitetit të Prishtinës për procedurën disiplinore, “shkelje e rëndë disiplinore konsiderohen [mes të tjerash] falsifikimi [dhe] dhënia e shënimeve jo të sakta organeve të Universitetit, me qëllim të përvetësimit të [të] drejtave të caktuara të studentëve” (Rregullorja e Universitetit të Prishtinës për procedurën disiplinore, neni 16, par. 2).

Prandaj, studentët që kanë përfituar nga statusi i pretenduar si anëtarë të familjeve të dëshmorëve, pa pasur në të vërtetë këtë status, mund t'i nënshtrohen “marrj[es] [së] masave disiplinore” nga komisioni disiplinor, sipas nenit 18 të Rregullores.

Mbetet vetëm një aspekt i fundit që duhet ta vlerësojmë lidhur me vendimet e Senatit, dhe posaçërisht me vendimin e tij të tretë. Ky vendim, siç kemi vërejtur, ndryshoi kriteret e përcaktuara për konkursin e afatit të parë. Ky vendim ka qenë objekt i kritikës së ministrit Bajrami, i cili, në letrën e tij të datës 6 janar 2015, shpreh shqetësimin e tij për anashkalimin e konkurrencës brenda një kuote të veçantë për “kandidatët e kategorive të familjes së ngushtë të (1) dëshmorit, (2) veteranëve dhe (3) invalidëve të luftës”. Thelbi i shqetësimit të ministrit Bajrami ishte që “[k]onkursi i shpallur dhe kriteret e përcaktuara në të, janë miratuar nga Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2014 dhe, si të tilla, sipas parimeve dhe dispozitave juridike, paraqesin referencë ligjore që obligon palët”. Bazuar në këtë vendim, ministri Bajrami kritikon, së pari, pranimin e kandidatëve që i takojnë familjes së dëshmorëve, pa iu nënshtroar konkurrencës brenda kuotës së veçantë, dhe së dyti, mosdhënien e mundësisë për konkurrencën brenda kuotës së veçantë për “kandidatët nga familjet e ngushta të veteranëve dhe invalidëve të luftës”. Sipas ministrit Bajrami, “Universiteti i Prishtinës duhet gjithmonë të bëjë regjistrimin e studentëve sipas kushteve dhe kriterëve akademike të përcaktuara me konkurset e shpallura për pranimin e studentëve, sipas vendimeve të organeve të tij”. Prandaj, sipas tij, moszbatimi i kriterëve të konkursit të afatit të parë ka qenë i kundërligjshëm.

Para se të vlerësojmë ligjshmërinë e ndryshimit të kriterëve, duhet të vërejmë një gabim faktik në kritikën e paraqitur nga ministri Bajrami. Ministri pretendon se shpallja e konkursit të afatit të parë ka parashikuar përparësi për “kandidatët e kategorive të familjes së ngushtë të (1) dëshmorit, (2) veteranëve dhe (3) invalidëve të luftës”. Kjo nuk është e saktë. Në konkursin e parë, nuk ishte parashikuar përparësia për “*familje[n] [e] ngushtë të . . . veteranëve dhe . . .*

invalidëve të luftës” (theks i shtuar). Në vend të kësaj, ishte parashikuar përparësi vetëm për familjet e dëshmorëve, si dhe për vetë veteranët dhe invalidët e luftës, por jo edhe për familjet e këtyre dy kategorive të fundit. Kategoritë përfituese, sipas shpalljes së konkursit, ishin: “(1) familje e ngushtë e dëshmorit (fëmijë ose bashkëshort/e); (2) veteran/e i/e luftës; (3) invalid/e i/e luftës”. Prandaj, edhe po të marrim si të mirëqenë argumentin e ministrit Bajrami, që kriteret e shpallura për konkursin në afatin e parë duhen zbatuar si “referencë ligjore që obligon palët”, kjo nuk do të na çonte drejt konkluzionit se kandidatët prej familjeve të ngushta të veteranëve dhe invalidëve të luftës duhet të gëzojnë përparësinë. Sipas shpalljes së konkursit në afatin e parë, këtë përparësi e gëzojnë vetëm veteranët dhe invalidët vetë, si individë të veçantë.

Tani mund të vlerësojmë nëse ndryshimi i kriterëve të konkursit të afatit të parë ka qenë në kundërshtim me obligimet ligjore të Universitetit të Prishtinës, ashtu siç pretendon ministri Bajrami. Kemi parë që *Rektori*, në letrën e tij të datës 5 janar 2015, është përpjekur ta justifikojë këtë ndryshim, duke pohuar se “kërkesa e vetme e shoqatave ka qenë të pranohen të gjithë kandidatët që ndodhen në lista, pa marrë parasysh nëse kanë arritur pragun minimal të kalueshmërisë ose jo”.

Këtë justifikim të *Rektorit* Avokati i Popullit e cilëson jobindës. Fakti që shoqatat kanë kërkuar që të gjithë kandidatët në listat e tyre të pranohen pa kaluar pragun minimal, nuk e ka bërë të pamundur që Universiteti i Prishtinës të pranojë kandidatët nga lista në mënyrë selektive, sipas kriterëve të veta. Kjo evidentohet nga qasja e Universitetit ndaj kandidatëve që u takojnë familjeve të dëshmorëve. Fakti që shoqatat kishin kërkuar që të gjithë kandidatët në listë që i takojnë kësaj kategorie të pranohen pa kaluar pragun minimal, nuk e ka penguar Senatin e Universitetit të vendosë që, për konkursin e afatit të parë, “të pranohen të gjithë kandidatët nga familjet e dëshmorëve që kanë arritur pragun minimal të kalueshmërisë” (Letra e *Rektorit*, e datës 5 janar 2015) dhe t’i refuzojnë ata që nuk kanë kaluar. Gjithashtu, kërkesa e shoqatave për pranimin e të gjithë kandidatëve në listë nuk e

ka penguar Universitetin që, në konkursin plotësues, t'u japë një bonus pesë pikësh të gjithë kandidatëve nga familjet e dëshmorëve, në vend që t'i pranojnë të gjithë. Prandaj, çfarëdo që të ishin kërkesat e shoqatave, Universiteti i Prishtinës kishte mundësi të organizojë një konkurs për kategoritë e përcaktuara brenda një kuote të veçantë, ashtu siç ishte parashikuar, dhe fakti që shoqatat kishin kërkuar diçka më shumë, nuk mund të arsyetojë mosorganizimin e kësaj kuote.

Por, megjithëse justifikimi i *Rektori* nuk është bindës, Avokati e Popullit megjithatë e konsideron kritikën e ministrit Bajrami si të dështuar. Nga njëra anë, është e vërtetë që konkurset e shpallura dhe kriteret e përcaktuara nga Senati i Universitetit të Prishtinës, në përgjithësi, “paraqesin referencë ligjore”. Këtë e bën mjaft të qartë vetë Statuti i Universitetit të Prishtinës, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës: “Rregullat për shpalljen e konkursit dhe kriteret për regjistrim nxirren nga Senati” (Statuti i Universitetit të Prishtinës, neni 106). Prandaj, ministri Bajrami ka të drejtë që kriteret e përcaktuara, me datë 30 maj 2014, për konkursin e afatit të parë paraqesin referencë ligjore, përderisa janë nxjerrë me vendim të Senatit. Por kjo nuk e siguron konkluzionin që Universiteti i Prishtinës e ka për detyrë t'i zbatojë këto kritere. Arsyeja është që, njësoj si kriteret e nxjerra me datë 30 maj 2014, ndryshimet e këtyre kritereve më 16 tetor 2014, gjithashtu janë bërë me vendim të Senatit. Edhe këto ndryshime, pra, “paraqesin referencë ligjore”. Ndryshimi i kritereve të konkursit të afatit të parë, me një datë të mëvonshme, mund t'i duket ministrit Bajrami i padrejtë, dhe sipas parimeve të përgjithshme të mirëadministrimit dhe parashikueshmërisë së veprimeve institucionale, nuk është e pëlqyeshme që kriteret e një konkursi publik të ndryshohen pas shpalljes së tyre. Por, përderisa ndryshimi në këtë rast është miratuar nga Senati, ai “paraqe[t] referencë ligjore” sipas logjikës së vetë ministrit Bajrami.

Duhet theksuar që e drejta e Senatit për të ndryshuar kriteret për pranimin e studentëve në mënyrë retroaktive, nuk është pa kufi. Për shembull, pasi të regjistrohet zyrtarisht një student, Universiteti nuk

mund të ndryshojë kriteret në bazë të të cilave ai është pranuar, dhe ta përjashtojë për mospërmbushjen e kriterëve të reja. Siç kemi parë më sipër, një student i regjistruar i Universitetit të Prishtinës mund të përjashtohet vetëm në bazë të shkeljeve disiplinore të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit për procedurën disiplinore. Por, ministri nuk citon asnjë dispozitë ligjore që ndalon Senatin për të bërë ndryshime retroaktive të kriterëve për pranim, në rastet kur miratimi i kriterëve të reja vjen në kohën *përpara* se të regjistrohen studentët në bazë të kriterëve të vjetra, dhe Avokati i Popullit nuk është në dijeni për ndonjë dispozitë të tillë.

A mund të argumentohet se në vendimin e datës 16 tetor 2014 Senati ka ndryshuar vetëm pjesërisht kriteret e shpallura më 30 maj? Sipas këtij argumenti, në tekstin e vendimit të 16 tetorit, në pikën e parë përcaktohet se, kandidatët nga familjet e dëshmorëve do të regjistroheshin vetëm me kusht të kalimit të pragut minimal, por megjithatë, nuk anulohet shprehimisht organizimi i kuotës së veçantë. Në bazë të kësaj, a mund të argumentohet se, përcaktimi i kësaj kuote në vendimin e 30 majit mbetet i pandryshuar, edhe pas vendimit të 16 tetorit?

Ky argument nuk mund të dalë i suksesshëm. Anulimi i kuotës së veçantë nënkuptohet nga vetë fakti që *të gjithë* kandidatët me statusin e anëtarit të familjes së dëshmorit, sipas vendimit të 16 tetorit, do të pranoheshin pa pasur nevojë për konkurrencë të tillë. Fakti që Senati e kishte për qëllim për të anuluar plotësisht organizimin e kuotës konfirmohet edhe nga letra e *Rektorit*, dërguar ish-ministrit Buja pas nxjerrjes së *Vendimit të MASHT-it*, në të cilën *Rektori* njofton se, përveç pranimit të të gjithë anëtarëve të familjeve të dëshmorëve që kishin kaluar pragun minimal, “Senati i UP-së në mbledhjen e vet të datës 16.10.2014 nuk ka vendos[ur] për rritjen e mëtutjeshme të numrit të studentëve . . . të kategorive [të] tjera sipas kërkesës së Shoqatave të dala nga lufta”. Kjo nënkupton se kategoritë e tjera, përveç anëtarëve të familjeve të dëshmorëve, nuk do të gëzonin asnjë përparësi, as nëpërmjet konkurrencës brenda një kuote të veçantë, as në ndonjë

mënyrë tjetër. Gjithsesi, nëse mbetja në fuqi ose jo e organizimit të kuotës së veçantë është akoma e paqartë për ministrin Bajrami, ai mund t'i kërkojë sqarim Senatit të Universitetit sa i përket përmbajtjes së vendimit të 16 tetorit. Por ajo që është më e rëndësishme të theksohet këtu është se, **në parim, ndryshimi nga ana e Senatit i kritereve për regjistrim, edhe pas zhvillimit të konkursit, nuk përbën shkelje ligjore.**

Megjithatë, duhet theksuar gjithashtu se dështimi i kritikës së ministrit Bajrami nuk do të thotë se tri vendimet e Senatit janë plotësisht të rregullta ligjërisht. Kemi vërejtur më sipër që këto vendime janë të kundërligjshme në dy aspekte: përderisa (1) nuk përfshijnë të gjitha kategoritë që kanë të drejtë ligjore për përparësi në regjistrim, dhe (2) ua japin kandidatëve këtë përparësi në kushte jo plotësisht të barabarta me të tjerët. Dështimi i kritikës së ministrit Bajrami do të thotë vetëm se, përkundër pretendimit të tij, ndryshimi i kritereve të konkursit të afatit të parë nuk paraqet një shkelje të mëtejshme të obligimeve ligjore të Universitetit të Prishtinës, pavarësisht nga shkeljet e tjera që kemi vërejtur më parë.

## **2. Zbatimi i Memorandumit dhe tërheqja e njëanshme prej tij**

Përveç tri vendimeve të Senatit të Universitetit të Prishtinës, duhet të vlerësojmë gjithashtu nëse Universiteti i Prishtinës ka respektuar siç duhej obligimet e tij ligjore lidhur me *Memorandumin*.

Është e nevojshme fillimisht që të kuptojmë më saktë statusin ligjor të *Memorandumit*, të paktën deri në shkëputjen e tij nga ana e Universitetit. Mbi këtë çështje janë shprehur mendime të ndryshme, madje edhe kundërthënëse. Nga njëra anë, në letrën e tij të 5 janarit, *Rektori* pretendon se *Memorandumi* “është një dokument mirëkuptimi me të cilin Universiteti ka shprehur vullnetin e mirë që t’u ndihmojë kategorive të dala nga lufta për regjistrim në Universitet”, dhe “[n]jë dokument mirëkuptimi, sipas praktikës dhe parimeve juridike, nuk mund të paraqesë referencë ligjore që obligon palët”. Nga ana tjetër, Organizata e Veteranëve të Luftës, një ndër shoqatat nënshkruese të

*Memorandumit*, më 13 janar 2015 deklaroi se do të ngrinte një padi kundër *Rektorit*, “për mosrespektim të *Memorandumit*, gjatë kohës sa ai ishte në fuqi”, e cila nënkupton që, për mendimin e kësaj shoqate, *Memorandumi* nuk ishte thjesht një dokument mirëkuptimi, por një kontratë që obligonte palët.

Në mënyrë që të vlerësojmë nëse ky *Memorandum* paraqet obligime ligjore për palët nënshkruese, duhet t’u përgjigjemi tri pyetjeve. Pyetja e parë është, a ishte *qëllimi* i palëve të lidhin një kontratë të mirëfilltë, ose thjesht një “dokument mirëkuptimi”, pa obligim? Lidhur me këtë pyetje, nuk ka rëndësi që dokumenti në diskutim ka titullin “memorandum” dhe jo “kontratë”, sepse “[I]dhja e kontratës nuk i nënshtrohet asnjë forme” (Ligji Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 51, par. 1).<sup>15</sup> Përkundrazi, mjafton që të ekzistojë mes palëve “[v]ullneti për ta lidhur kontratën”, i cili mund të shprehet në forma të ndryshme, duke përfshirë “me fjalë, me shenja të rëndomta ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij” (*id.*, neni 18). Në tekstin e *Memorandumit*, vullneti i tillë është i dukshëm. *Memorandumi* përcakton qartë se “Universiteti i Prishtinës merr për obligim për të ndihmuar kategoritë e lartcekura [të dala nga lufta]” (pika 2, theks i shtuar), që “OVL të UÇK-së, SHIL të UÇK-së dhe SHFD të UÇK-së, obligohen për dërgimin e listave të studentëve, të kategorive të lartcekura, që do të përfitojnë nga ndihmesat e UP-së” (*id.*, pika 3, theks i shtuar) dhe që “[m]emorandumi hyn në fuqi dhe i obligon palët që nga dita e nënshkrimit (*id.*, pika 5, theks i shtuar). Përsëritja e vazhdueshme e formave të fjalës “obligim”

---

<sup>15</sup> Ka përjashtime kur ligji përcakton që kontratat e lidhura duhet t’i përshtaten një forme specifike (shih *id.*, nenin 51). Për shembull, “[k]ontrata në bazë të së cilës transferohet titulli i paluajtshmërisë ose përmes së cilës krijohet një e drejtë tjetër subjektive për paluajtshmërinë duhet të lidhet në formën e shkruar” (*id.*, nenin 52). Për kontrata të lidhura midis institucioneve arsimore dhe palëve të treta, nuk parashikohet ndonjë formë specifike.



tregon qartë se palët nënshkruese kishin “vullnet[] për ta lidhur kontratën”.

Pyetja e dytë është: a mundet një kontratë e tillë të paraqesë obligime ligjore për Universitetin e Prishtinës si person juridik, edhe pas ikjes së rektorit që kishte nënshkruar kontratën, Prof. Dr. Mujë Rugova? Sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, “[l]idhja e kontratës . . . mund të kryhe[t] edhe me përfaqësues” (Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 72, par. 1), dhe në rast të një personi juridik, “[a]utorizimi për përfaqësim bazohet . . . në aktin e përgjithshëm të personit juridik” (*id.*, neni 72, par. 2). Akti i përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës është Statuti i Universitetit, i cili përcakton se “Universiteti është person juridik” (Statuti i Universitetit të Prishtinës, neni 13, par. 1), dhe autorizon rektorin e universitetit “të nënshkruajë kontrata në emër të Universitetit me palët e treta” (*id.*, neni 28, par. 1, nënpar. 11). Prandaj, rektori i atëhershëm Mujë Rugova përmbushte të gjitha kriteret ligjore për të përfaqësuar Universitetin e Prishtinës në nënshkrimin e *Memorandumit* me tri shoqatat e kategorive të dala nga lufta. Një kontratë e tillë, “të cilën e lidhë përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar . . . , e obligon drejtpërdrejt të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese” (Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 73, par. 1). Prandaj, megjithëse *Memorandumi* është nënshkruar nga ish-rektori Rugova, kjo nuk do të thotë se kishte fuqi vetëm përderisa Prof. Dr. Rugova mbante pozitën e rektorit. Përkundrazi, *Memorandumi* “e obligon drejtpërdrejt të përfaqësuarin”, në këtë rast Universitetin e Prishtinës, i cili, për rrjedhojë, mund të vazhdojë të obligohet edhe pas ikjes së ish-rektorit Rugova.

Pyetja e fundit që duhet të konsiderojmë është, a janë obligimet e përcaktuara në *Memorandum* në përputhje me ligjet? “Kur objekti i detyrimit është . . . i palejueshëm . . . kontrata është absolutisht e pavlefshme” (Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 35, theks i shtuar), dhe “[o]bjekti i detyrimit është i palejueshëm, në qoftë se është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik” (*id.*, neni 37, theks i shtuar). Sipas këtij standardi, nëse *Memorandumi* është në kundërshtim

me *Ligjet e 2011 dhe 2014*, të cilat bëjnë pjesë në “dispozitat e rendit publik”, atëherë *Memorandumi* do të ishte “absolutisht [i] pavlefsh[ëm]”.

Për të dalluar nëse *Memorandumi* është në kundërshtim me *Ligjet e 2011 dhe 2014*, është e nevojshme të gjykojmë midis dy interpretimeve të përmbajtjes së tij, të ofruara përkatësisht nga *Rektori* dhe ish-ministri Buja. Kemi parë më sipër që, sipas *Rektorit*, *Memorandumi* vetëm “parasheh lehtësime për regjistrimin e kandidatëve që u përkasin kategorive të lartpërmendura, por nuk përcakton kritere, procedura, apo kuota që do të aplikohen për këto raste.” Por, vendimi i ish-ministrit Buja, i mbështetur nga praktika e zbatimit të *Memorandumit* në vitet e mëhershme, e kupton ndryshe *Memorandumin*. Sipas këtij interpretimi, *Memorandumi* parasheh jo vetëm lehtësime të papërcaktuara për kategoritë e dala nga lufta, por gjithashtu parasheh që këto lehtësime të marrin një formë specifike: që kandidatët në listat e dërguara nga shoqatat nënshkruese të pranohen në Universitetin e Prishtinës, edhe pa përmbushur ndonjë kriter tjetër, si p.sh. kalimin e pragut minimal në provimet pranuese.

Të dy këto interpretime mund të gjejnë mbështetje në tekstin e *Memorandumit*. Nga njëra anë, *Memorandumi* përcakton se tri shoqatat nënshkruese “obligohen për dërgimin e listave të studentëve, të kategorive të lartcekura, që do të përfitojnë nga ndihmesat e UP-së” (*Memorandumi*, pika 3, theks i shtuar). Pjesa e theksuar e tekstit sugjeron se është roli ekzkluziv i shoqatave për të përcaktuar se cilëve kandidatë do t’u jepet përparësi në regjistrim, dhe që Universiteti i Prishtinës nuk ka të drejtë të pranojë vetëm disa kandidatë prej këtyre listave. Por nga ana tjetër, *Memorandumi* gjithashtu parasheh që “[m]e vendime të veçanta, palët do të përcaktojnë procedurat e ofrimit të ndihmës reciproke” (*id.*, pika 4, theks i shtuar). Kjo sugjeron se *Memorandumi*, në vetvete, nuk përcakton procedurat që duhen ndjekur pas dërgimit të listave nga shoqatat, dhe se i lë Universitetit të Prishtinës hapësirë të mjaftueshme të caktojë kriteret e veta për të

vendosur se, cilët kandidatë do të pranohen nga listat e dërguara, dhe cilët do të refuzohen.

Dy interpretimet e mësipërme nuk paraqesin ndonjë alternativë, sepse të dy interpretimet, në fund të fundit, shpiejnë në të njëjtin konkluzion: që Universiteti i Prishtinës ka përmbushur të gjitha obligimet e tij ligjore lidhur me *Memorandumin*. Nga njëra anë, nëse e pranojmë interpretimin e *Rektorit*, sipas të cilit *Memorandumi* nuk përcakton procedura ose kritere specifike që duhen ndjekur pas dërgimit të listave nga shoqatat, atëherë Universiteti i Prishtinës nuk e ka për obligim të pranojë të gjithë kandidatët në lista, dhe fakti që jo të gjithë kandidatët në lista janë pranuar, nuk përbën një shkelje të obligimeve të përcaktuara në *Memorandum*.

Nga ana tjetër, nëse e pranojmë interpretimin e ish-ministrit Buja, atëherë kjo do të thotë se *Memorandumi* parasheh pranimin e të gjithë kandidatëve në listat e dërguara nga shoqatat, pa dallim. Por në këtë rast, *Memorandumi* do të ishte “në kundërshtim me dispozitat e rendit publik”, sepse pranimi i të gjithë kandidatëve nga listat e dërguara, në kushte jo plotësisht të barabarta, do të ishte në kundërshtim me *Ligjet e 2011 dhe 2014*. Për rrjedhojë, *Memorandumi* do të përmbante një objekt detyrimi të palejueshëm, dhe do të ishte “absolutisht [i] pavlefsh[ëm]” (Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 35). Në këtë rast, Universiteti të Prishtinës nuk do të kishte asnjë obligim për të zbatuar *Memorandumin*.

Prandaj, nuk ka rëndësi se cili interpretim është më i saktë. Nëse e pranojmë interpretimin e *Rektorit*, atëherë Universiteti i Prishtinës nuk ka vepruar në kundërshtim me *Memorandumin*. Dhe nëse e pranojmë interpretimin e ish-ministrit Buja, atëherë Universiteti ka vepruar në kundërshtim me *Memorandumin*, por *Memorandumi* vetë nuk do të paraqiste asnjë obligim ligjor. Në të dyja rastet, mund të konkludojmë se **Universiteti i Prishtinës ka përmbushur plotësisht detyrimet e tij ligjore të vlefshme lidhur me *Memorandumin*.**

Tani duhet konsideruar ligjshmërinë e shkëputjes së njëanshme prej *Memorandumit* nga ana e Universitetit të Prishtinës. Në letrën e tij të datës 9 janar 2015, *Rektori* informoi tri shoqatat nënshkruese për shkëputjen, duke shprehur mendimin e tij që çështja e përparësisë për regjistrim “tanimë është rregulluar në masë të mjaftueshme me ligjet e Kosovës,”<sup>16</sup> dhe duke cituar “keqkuptimet në interpretimin e karakterit të [*Memorandumit*] dhe të obligimeve të palëve që dalin nga ky dokument”.

Mund të fillojmë duke vërejtur faktin se në tekstin e *Memorandumit* nuk përcaktohet kohëzgjatja e zbatimit të tij. Sipas një parimi të përgjithshëm të së drejtës së kontratës, secila palë e një kontrate të tillë pa afat, ka të drejtë të tërhiqet prej saj në mënyrë të njëanshme, me njoftimin e palës tjetër kontraktuese. Shih, p.sh., Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 339, par. 1 (“Në qoftë se kohëzgjatja e marrëdhënies së detyrimeve nuk është caktuar, secila palë mund ta ndërpret me denoncim”). Por, njëkohësisht, “[d]enoncimi mund të jepet në çdo kohë, por jo në kohë të papërshtatshme” (*id.*, neni 339, par. 3). Është pikërisht *koha* e tërheqjes së Universitetit të Prishtinës nga *Memorandumi*, dhe jo *fakti* i tërheqjes, që është objekt i konfliktit midis *Rektorit* dhe tri shoqatave nënshkruese: në komunikatën e saj për mediat, të datës 13 janar 2015, Organizata për Veteranët e Luftës nuk pretendon se Universiteti i Prishtinës nuk ka të drejtë për t’u tërhequr prej *Memorandumit*, por vetëm se “[p]rishja e njëanshme e *Memorandumit* nga Rektori, vlen për vitin e ardhshëm akademik, e asesi për vitin akademik 2014/2015, kur *Memorandumi* ishte në fuqi” (theks i shtuar).

---

<sup>16</sup> Në fakt, siç u pa në përmbledhjen e fakteve (shih Tabelën 1, *supra*), edhe në kohën kur u nënshkrua *Memorandumi*, në shtator të 2009, *Ligji i 2006* ishte në fuqi dhe rregullonte përparësinë për kategoritë e dala nga lufta.

Prandaj, pyetja kyçe në këtë mes është, a e ka ndërprerë *Memorandumin* Universiteti i Prishtinës “në kohë të papërshtatshme” për palët e tjera nënshkruese? Nëse po, atëherë prishja e *Memorandumit* ka qenë e kundërligjshme; nëse jo, atëherë Universiteti i Prishtinës ka vepruar brenda të drejtave të tij ligjore, për të shkëputur një kontratë pa afat të caktuar kohor. E vetmja arsye pse ndërprerja e *Memorandumit* në këtë kohë mund të kishte qenë “e papërshtatshme” për shoqatat nënshkruese është që, sipas njërit interpretim që kemi analizuar më sipër, zbatimi i *Memorandumit* do t’ua siguronte kandidatëve në listat e shoqatave pranimit në Universitetin e Prishtinës në vitin akademik 2014/2015, jashtë kritereve të tri vendimeve të Senatit, dhe në kushte jo të barabarta me të tjerët. Por, siç kemi evidentuar pak më lartë, *Memorandumi* nuk mund të zbatohet në këtë mënyrë. Pranimi i kandidatëve në kushte jo të barabarta me të tjerët, do të ishte në kundërshtim me “dispozitat e rendit publik”, dhe për këtë arsye, *Memorandumi*, i interpretuar në këtë mënyrë, do të ishte “absolutisht i pavlefshëm”. Prandaj, edhe po të mos prishej *Memorandumi* deri në vitin tjetër akademik, Universiteti megjithatë nuk do të kishte obligim ligjor që të pranonte kandidatët në kushte jo të barabarta me të tjerët. Dhe, meqenëse mbetja në fuqi e *Memorandumit* për këtë vit akademik, nuk mund të bëjë asnjë ndryshim sa i përket pranimin të të gjithë kandidatëve në listat e shoqatave, prishja e *Memorandumit* në këtë kohë nuk mund të quhet “e papërshtatshme”.

Për arsyet e lartpërmendura, Avokati i Popullit konsideron se **të gjitha veprimet e Universitetit të Prishtinës lidhur me *Memorandumin*, përfshirë edhe tërheqjen e njëanshme prej tij, ishin në përputhje të plotë me detyrimet ligjore të Universitetit.**

#### **A. Vlerësimi i ligjshmërisë së veprimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

Në vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duhet të përfshihen veprimet (dhe mosveprimet) e katër autoriteteve shtetërore: ish-kryeministri Hashim Thaçi; ish-ministri i

Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja; kryeministri aktual, Isa Mustafa; dhe ministri aktual i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami. Fillimisht duhet vlerësuar *Vendimi i MASHT-it*, dhe pastaj mospërgjegjja në kërkesën e Avokatit të Popullit për masë të përkohshme, nga ana e katër autoriteteve të lartpërmendura.

### **1. Vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

Ligjshmëria e *Vendimit të MASHT-it* duhet të vlerësohet nga dy aspekte. Nga aspekti procedural, duhet shqyrtuar nëse vendimi përbën një ndërhyrje të kundërligjshme në një fushë që i takon ekzkluzivisht Universitetit të Prishtinës, siç është argumentuar nga ministri Bajrami dhe *Rektori*. Sipas tyre, Universiteti ka autonomi të plotë në caktimin e kriterëve për regjistrimin e studentëve dhe Ministria nuk ka të drejtë të ndërhyjë. Nga aspekti substancial, duhet të vlerësohet nëse vendimi përbën një shkelje të *Ligjeve të 2011 dhe 2014*, të cilat përcaktojnë që gjashtë kategori të dala nga lufta duhet të gëzojnë përparësi në regjistrim, në kushte plotësisht të barabarta me të tjerët.

Sa i përket aspektit procedural, pikënisja e analizës duhet të jetë Ligji Nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Ligji për arsimin e lartë”), i cili përcakton se “[b]artësit e licencuar të arsimit të lartë kanë autonominë dhe lirinë akademike” (*id.*, neni 13, par. 1). Universiteti i Prishtinës, përderisa është universitet publik, konsiderohet i licencuar. Shih *id.*, neni 14, par. 6 (“Bartësi publik konsiderohet i licencuar”). Si pjesë e autonomisë së vet, Universiteti i Prishtinës gëzon të drejta në disa fusha të caktuara, duke përfshirë të drejtën “për të përcaktuar kushte lidhur me pranimin e studentëve” (*id.*, neni 13, par. 2, pika 3). Gjithashtu, Statuti i Universitetit të Prishtinës, përcakton se “Senati nxjerr rregullore, të cilat përcaktojnë në hollësi kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore” (Statuti i Universitetit të Prishtinës, neni 103, par. 3). Dhe përsëri: “Rregullat për shpalljen e konkursit dhe kriteret për regjistrim nxirren nga Senati” (*id.*, neni 106).

Megjithatë, sado të qarta që të duken këto dispozita në shikimin e parë, nuk mund të konsiderohen fjala e fundit për çështjen e autonomisë, sepse vetë Ligji për arsimin e lartë lë të kuptohet se bartësit e licencuar nuk gëzojnë autonomi *absolute* në pesë fushat e caktuara, sidomos jo nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Për shembull, pjesë e autonomisë së bartësve të licencuar për arsimin e lartë është e drejta “për të . . . zgjedhur autoritetet drejtuese menaxhuese dhe për të përcaktuar mandatet e tyre” (Ligji për arsimin e lartë, neni 13, par. 2, pika 1), por megjithatë, ligji përcakton se, në rrethana specifike, anëtarët e këshillit drejtues “mund të shkarkohen nga Ministria, me rekomandim të këshillit drejtues apo edhe pa të” (*id.*, neni 18, par. 6). Gjithashtu, pjesë e autonomisë e bartësve të licencuar është e drejta “për të . . . hartuar dhe zbatuar në mënyrë të pavarur kurrikul[a]t dhe projektet për kërkime shkencore, në këshillim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë” (*id.*, neni 13, par. 2, pika 4), por megjithatë, ligji përcakton se “Ministria . . . gëzon të drejtën të miratojë ose të refuzojë miratimin e kurrikulave të kurseve që çojnë në kualifikimin e një mësimitdhënësi për t’u punësuar në një shkollë” (*id.*, neni 16, par. 4), dhe se “[n]ë caktimin e fondeve për . . . kërkime shkencore me interes të përgjithshëm, Ministria mund t’u caktojë kushte bartësve” (*id.*, neni 22, par. 1).

Këto dispozita tregojnë se, edhe në ato fusha që Ligji për arsimin e lartë i përcakton si pjesë të autonomisë së bartësve të licencuar, po i njëjti ligj vendos kufij në këtë autonomi, duke i dhënë Ministrisë autorizim të veçantë për të ndërhyrë në këto fusha në kushte specifike.

Prandaj, për të kuptuar nëse *Vendimi i MASHT-it* ka shkelur autonominë e Universitetit të Prishtinës në këtë fushë, duhet të kontrollojmë nëse ka ndonjë dispozitë specifike ligjore që do të mund të shërbente si autorizim për ndërhyrjen në fushën e caktimit të kriterëve për pranim. Por, në mungesën e një autorizimi të tillë specifik, vendosja e kriterëve për pranimin e studentëve duhet të konsiderohet fushë e paprekshme e autonomisë së bartësit e arsimit të lartë, në të cilën Ministria nuk do të kishte të drejtë për të ndërhyrë.

*Vendimi i MASHT-it* citon disa dispozita ligjore dhe nënligjore në të cilat pretendon të bazohet (shih hyrjen). Mirëpo, gati të gjitha dispozitat e cituara përcaktojnë vetëm përgjegjësi të përgjithshme të Ministrisë, pa i dhënë ndonjë autorizim specifik lidhur me përcaktimin e kritereve për regjistrimin e studentëve. Këto dispozita, për shembull, përcaktojnë se një ndër qëllimet e administratës shtetërore është “zbatimi i ligjeve dhe dispozitave të tjera” (Ligji Nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, neni 4, par. 1, pika 4) “në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësive” (*id.*, neni 21), dhe se “Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë . . . zbaton legjislacionin për zhvillimin e arsimit duke përfshirë arsimin e lartë dhe në shkencën në Kosovë” (Rregullorja Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, shtojca 6). Këto citime tregojnë vetëm se, Ministria e ka për detyrë të zbatojë ligjet në fushën e arsimit, por nuk i referohen ndonjë ligji që jep një autorizim eksplicit për ndërhyrjen e Ministrisë në çështjen e pranimit të studentëve, një çështje që përbën pjesë të autonomisë së bartësve të licencuar të arsimit të lartë.

E vetmja dispozitë e cituar në *Vendimin e MASHT-it*, që mund të duket si autorizim i tillë eksplicit, është neni 16, par. 3 i *Ligjit të 2011*, i cili parashihet që “[p]ër realizimin e [t]ë drejtave në beneficione [të] tjera [përveç së drejtës për pension], sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Ministrinë dhe institucionet [e] tjera përkatëse”. Por, as kjo dispozitë nuk mund ta justifikojë *Vendimin e MASHT-it*. Fillimisht, vërejmë se e drejta për përparësi në regjistrim është vetëm njëra prej një sërë të drejtash që rregullohen nga *Ligji i 2011*. Vetëm disa prej tyre mund të zbatohen në bazë të kërkesës së paraqitur tek Ministria përkatëse, dhe këto përcaktohen në nenin 20 të *Ligjit të 2011*, i cili parashikon të gjitha “[a]ktet nënligjore për zbatimin e ligjit” që do të nxirreshin prej Ministrive të ndryshme. Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, neni 20 përcakton tri udhëzime administrative që do të nxirreshin: Udhëzimi Administrativ “për njohjen e të drejtës dhe përcaktimin e procedurave për ndarjen e



teksteve shkollore falas”; Udhëzimi Administrativ për “përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për realizimin e së drejtës në burse” dhe; Udhëzimi Administrativ për “caktimin e kushteve dhe kriterëve për vendosjen në konvikte, të anëtarëve të ngushtë të familjeve të kategorive të trajtuar në këtë ligj” (*Ligji i 2011*, neni 20, par. 1, pika 4). Siç shihet qartë, në këtë listë nuk përmendet asnjë udhëzim administrativ që do të nxirrej nga Ministria për realizimin e së drejtës për përparësi në regjistrim në institucione arsimore. Prandaj, fakti që *Ligji i 2011* përcakton se, “[p]ër realizimin e [t]ë drejtave . . . aplikuesi e paraqet kërkesën në Ministrinë dhe institucionet tjera përkatëse”, nuk i jep Ministrisë asnjë autorizim specifik për të ndërhyrë në çështjen e përcaktimit të kriterëve për regjistrim në Universitetin e Prishtinës. Pa një autorizim të tillë, kjo çështje mbetet plotësisht brenda autonomisë së universitetit, dhe për rrjedhojë, vetë Universiteti duhet të konsiderohet “institucion[i] . . . përkatës” tek i cili duhet të kërkohej zbatimi i së drejtës për përparësi në regjistrim. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se, **nga aspekti procedural, Vendimi i MASHT-it ka qenë ndërhyrje e kundërligjshme në një fushë që i takon ekzkluzivisht Universitetit të Prishtinës dhe, për rrjedhojë, moszbatimi i këtij vendimi nga ana e Universitetit të Prishtinës ishte brenda të drejtave ligjore të Universitetit.**

Sa i përket aspektit substancial, pyetja kryesore lidhur me *Vendimin e MASHT-it* është: a e ka respektuar ky vendim kërkesën e *Ligjeve të 2011* dhe *2014*, që t’u jepet përparësi në regjistrim gjashtë kategorive të përcaktuara, në kushte të barabarta me të tjerët? Siç kemi bërë edhe në vlerësimin e tri vendimeve të Senatit të Universitetit të Prishtinës, mund ta ndajmë këtë pyetje në dy dimensione. Së pari, duhet të gjykojmë nëse *Vendimi i MASHT-it* u jep përparësi të gjitha gjashtë kategorive të përcaktuara. E këto janë:

- (1) anëtarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së
- (2) invalidët e UÇK-së
- (3) anëtarët e familjeve të invalidëve të UÇK-së

- (4) veteranët e UÇK-së
- (5) anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së
- (6) anëtarët e familjeve të të zhdukurve të UÇK-së

*Vendimi i MASHT-it* kërkon që “të regjistrohen fëmijët e kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së, sipas Memorandumit të Bashkëpunimit” (*id.*, pika 1). Mirëpo, *Memorandumi*, njësoj si tri vendimet e Senatit, nuk përfshin të gjitha gjashtë grupet që duhet të përfshihen sipas ligjit. Sipas *Memorandumit*, kategoritë përfituese janë:

- (1) anëtarë të familjeve të dëshmorëve të UÇK-së
- (2) invalidët e UÇK-së
- (3) fëmijët e invalidëve të UÇK-së
- (4) veteranët e UÇK-së
- (5) fëmijët e veteranëve të UÇK-së

Siç është e dukshme nga krahasimi i dy listave, anëtarët e familjeve të të zhdukurve të UÇK-së nuk mbulohen nga *Memorandumi*.<sup>17</sup> Pastaj, lista shkurtohet edhe më shumë nga fakti se, *Vendimi i MASHT-it* kërkon që të regjistrohen vetëm *fëmijët* nga kategoritë e përcaktuara, duke përjashtuar invalidët dhe veteranët vetë, si dhe anëtarët e tjerë të familjeve të ngushta të dëshmorëve. Prandaj, ***Vendimi i MASHT-it, njëlloj si tri vendimet e Senatit të Universiteti i Prishtinës, është i kundërligjshëm për shkak se lë mënjanë disa prej kategorive që kanë të drejtë për përparësi në regjistrim, sipas Ligjeve të 2011 dhe 2014.***

Sa i përket dimensionit të dytë, i cili ka të bëjë me kushtet në të cilat kategoritë e dala nga lufta duhet të gëzojnë përparësi, edhe këtu

---

<sup>17</sup> Është e mundshme që kategoria (6) konsiderohen si të përfshirë në kategorinë (1), por kjo nuk është e qartë nga *Memorandumi*.

*Vendimi i MASHT-it* përbën shkelje ligjore. Siç kemi theksuar më parë, *Ligjet e 2011 dhe 2014* kërkojnë që përparësia t'u jepet kategorive të dala nga lufta, vetëm në kushte plotësisht të barabarta me të tjerët. Në këtë aspekt, *Vendimi i MASHT-it* përbën një shkelje edhe më të rëndë sesa tri vendimet e Senatit. Kemi parë që vendimet e Senatit, megjithëse ndryshojnë prej njëri-tjetrit lidhur me kriteret përkatëse që i vendosin, ato kanë qenë të njëzëshme mbi të paktën një pikë: të tri vendimet përcaktojnë se kandidatët, në mënyrë që të përfitojnë nga përparësia në regjistrim, duhet të arrijnë pragun minimal të kalueshmërisë. Prandaj, edhe pse këto vendime, përkundër *Ligjeve të 2011 dhe 2014*, u kanë dhënë përparësi kandidatëve në kushte jo plotësisht të barabarta, ato të paktën kanë qenë në përputhje me *Ligjin e 2006*, i cili kërkonte që kandidatët të cilët gëzonin përparësi të kenë kaluar pragun minimal. *Vendimi i MASHT-it*, duke kërkuar që kandidatët e listuara të regjistrohen pa asnjë kusht, përveç vetëm hyrjes në provim, nuk përmbush as kriteret e ligjeve aktualisht në fuqi, as edhe kriteret e ligjit të vjetër.

Prandaj, për arsytet e lartpërmendura, Avokati i Popullit konstaton se ***Vendimi i MASHT-it* është plotësisht i dështuar nga ana ligjore, si për arsye procedurale, ashtu edhe për arsye substanciale**. Nga ana procedurale, *Vendimi i MASHT-it* përbën një ndërhyrje të kundërligjshme në autonominë e Universitetit të Prishtinës. Nga ana substanciale, *Vendimi i MASHT-it* përbën shkelje në dy dimensione. Së pari, vendimi kërkon përparësi në regjistrim vetëm për disa nga kategoritë e dhura, dhe së dyti, kërkon përparësi për këto kategori në kushte jo të barabarta me të tjerët, përkundër *Ligjeve të 2011 dhe 2014*, madje edhe përkundër *Ligjit të 2006*.

## **2. Mospërgjigjia në kërkesën e Avokatit të Popullit**

Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit është detyrim kushtetues dhe ligjor i të gjitha institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 132, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[ç]do organ, institucion, ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në

Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit”. Gjithashtu, Ligji për Avokatin e Popullit, neni 23, par. 1, përcakton se “[t]ë gjitha organet e pushtetit shtetëror kanë për obligim ta ndihmojnë Avokatin e Popullit në zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij”.

Një ndër llojet e kërkesave që Avokati i Popullit ka të drejtë të paraqesë tek institucionet shtetërore përkatëse, është kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme: “Nëse gjatë hetimeve Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit” (Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 5). Një kërkesë të tillë, Avokati i Popullit u ka drejtuar katër autoriteteve shtetërore. Më 2 dhjetor 2014, Avokati i Popullit ua drejtoi kërkesën ish-ministrit Buja dhe ish-kryeministrit Hashim Thaçi, por ata kanë dorëzuar detyrat e tyre tek pasardhësit e tyre, përkatësisht më 10 dhe 12 dhjetor 2014, pa i dhënë asnjë përgjigje Avokatit të Popullit. Prandaj, më 15 dhjetor 2014, Avokati i Popullit u dërgoi kërkesa të ngjashme ministrit të ri të MASHT-it, Arsim Bajrami, dhe kryeministrit të ri, Isa Mustafa. Deri tani, Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje prej asnjërit nga këta dy zyrtarë.

Ligji për Avokatin e Popullit, neni 22, par. 2 përcakton që: “Avokati i Popullit cakton afatin brenda të cilit organi duhet t’ia dorëzojë të gjitha informatat e kërkuara në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe as më i gjatë se tridhjetë (30) ditë.” Por këto afate ligjore kanë të bëjnë vetëm me dorëzimin e “informata[ve] [të] kërkuara”, që jo domosdoshmërisht përbëjnë veprime urgjente. Në rast të kërkesës urgjente, veprimi duhet të ndodhë menjëherë pas marrjes së kërkesës së Avokatit të Popullit, por në asnjë rast pas 8 ditësh, sepse kemi të bëjmë me masë urgjente.

Përderisa ish-ministri Buja dhe ish-kryeministri Thaçi kishin tetë e më

shumë ditë midis dërgimit të kërkesës dhe largimit të tyre nga funksioni, Avokati i Popullit e konsideron mospërgjigjen e tyre si shkelje të Kushtetutës dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit. Ndërsa mospërgjigjen e ministrit Bajrami dhe kryeministrit Mustafa, më shumë se 60 ditë pas dërgimit të kërkesës, Avokati i Popullit e cilëson si dështim për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit dhe e konsideron mosbashkëpunim të qëllimshëm, që përbën shkelje edhe më të rëndë të ligjit dhe Kushtetutës, krejtësisht të papranueshme dhe të papërgjegjshme.

Mospërgjigjia e kryeministrit Mustafa dhe ministrit Bajrami janë edhe më shqetësuese për dy arsye të tjera. Së pari, në fjalimin e tij inaugurues si i nominuari për postin e kryeministrit, z. Mustafa theksoi se “Qeveria do t’i vendosë të drejtat e njeriut lart në axhendën e saj politike” dhe “do të sigurojë që rekomandimet e Ombudspersonit të adresohen në mënyrë adekuate” (theks i shtuar). Fakti që rekomandimin e parë të Avokatit të Popullit për Qeverinë e re, kryeministri Mustafa e ka trajtuar në mënyrë plotësisht shpërfillëse, tregon se sa të zbrazëta dhe fallco ishin fjalët e tij. Së dyti, po aq shqetësues është fakti se ministri Bajrami gjeti kohën për të shpallur mendimet e tij lidhur me autonominë e Universitetit të Prishtinës në RTK dhe në Facebook, por nuk gjeti kohë për t’i dhënë përgjigje, pozitive ose negative, Avokatit të Popullit lidhur me të njëjtën temë. Kur zyrtarët e Qeverisë i konsiderojnë më të rëndësishme rifreskimet në faqet e tyre në Facebook sesa komunikimet e detyrueshme ndërinstucionale, përkatësisht me Institutionin e Avokatit të Popullit, ky fakt i vetëm dëshmon mjaft për papërgjegjshmërinë ligjore dhe kushtetuese të institucioneve më të larta shtetërore dhe njëkohësisht për gjendjen shqetësuese të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

## I. VLERËSIMI I KUSHTETUTSHMËRISË SË LIGJEVE PËR PËRPARËSINË NË REGJISTRIM NË INSTITUCIONE ARSIMORE PËR KANDIDATËT E KATEGORIVE TË DALA NGA LUFTA

Në fillim të kësaj analize, kemi vërejtur se, për aq kohë sa një ligj mbetet në fuqi, të gjitha organet, institucionet dhe autoritetet shtetërore, janë të detyruara për ta zbatuar atë plotësisht. Mirëpo, është edhe roli i Avokatit të Popullit që të “rekomandojë . . . ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi” dhe “të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit të Kuvendit me standartet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 1, nënpar. 6 dhe 8). Prandaj, analiza e Avokatit të Popullit lidhur me përparësinë në regjistrim për kategoritë e dala nga lufta, nuk mund të përfshijë vetëm vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të mekanizmave veprues institucionalë, përkatësisht të Universitetit të Prishtinës dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit e ka për detyrë të vlerësojë gjithashtu vetë ligjet, posaçërisht nga aspekti i respektimit të drejtave të njeriut, dhe t’i rekomandojë Kuvendit ndryshimin e këtyre ligjeve, në rast se të njëjtat janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

A. Ndalimi i diskriminimit sipas nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e drejta për arsimin sipas nenit 47 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Objektet e vlerësimit kushtetues në këtë rast janë *Ligjet e 2011 dhe 2014*, të cilat përcaktojnë përparësi në regjistrim, në kushte të barabarta me të tjerët, për gjashtë kategori të dala nga Lufta e UÇK-së. Kjo përparësi rrezikon të paraqesë një shkelje të nenit 24, par. 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “*Kushtetuta*”), i cili përcakton se:

1. *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*
2. *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës,*

*gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”*

Përparësia në regjistrim gjithashtu rrezikon të paraqesë një shkelje të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “KEDNJ”), i cili ka titullin “Ndalimi i diskriminimit” dhe përcakton se:

*“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

Kjo e drejtë kundër diskriminimit, si të gjitha të drejtat e përcaktuara në KEDNJ dhe Protokollin e saj, “garantohe[t] me këtë Kushtetutë” (*Kushtetuta*, neni 22). Gjithashtu, sipas nenit 55 të Kushtetutës, “[t]ë drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (në tekstin e mëtejshëm: “GJEDNJ”). Prandaj, kushtetutshmëria e përparësisë në regjistrim për gjashtë kategoritë e dala nga lufta duhet të vlerësohet në bazë të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ, bashkërisht, në dritën e vendimeve gjyqësore të GJEDNJ.

Sipas vendimeve gjyqësore të GJEDNJ, jo çdo trajtim i ndryshëm mund të quhet diskriminim. Përkundrazi, fjala “diskriminim” ka një kuptim të veçantë në kontekstin e KEDNJ: “E drejta e përcaktuar në nenin 14 për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara nga Konventa, shkelet kur Shtetet trajtojnë ndryshe persona në situata të ngjashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm” (*Thlimmenos v. Greece*, Aplikimi Nr. 34369/97, GJEDNJ, 6 prill 2000, par. 44). Sipas këtij standardi, e drejta për barazinë para

ligjit shkelet kur: (1) ekziston një trajtim i ndryshëm midis personave në situata të ngjashme, (2) pabarazia është e lidhur me gëzimin e një ndër të drejtat e garantuara nga KEDNJ<sup>18</sup> dhe (3) nuk ka justifikim objektiv ose të arsyeshëm për pabarazinë.

Në rastin e përparësisë në regjistrim për kategoritë e dala nga lufta, dy kriteret e para përmbushen qartazi. Në linjë me kriterin e parë, kemi të bëjmë në këtë rast me një trajtim të ndryshëm midis personave në situata të ngjashme: kemi të bëjmë me kandidatët për pranim në Universitetin e Prishtinës, disa prej të cilëve, sipas *Ligjeve të 2011 dhe 2014*, gëzojnë përparësi ndaj kandidatëve që nuk u takojnë këtyre kategorive, të paktën në kushte të barabarta. Në linjë me kriterin e dytë, pabarazia në diskutim ka të bëjë me një të drejtë të garantuar nga KEDNJ, përkatësisht neni 2 i Protokollit 1, i cili përcakton se “Askujt të mos i mohohet e drejta për arsim”.

Me përmbushjen e dy kriterëve të para, vlerësimi i kushtetutshmërisë së përparësisë në regjistrim për kategoritë e dala nga lufta, do të duhet të përqendrohet kryesisht në kriterin e tretë: A ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për përparësinë e dhënë? Në mënyrë që ky justifikim të jetë objektiv dhe i arsyeshëm, ai duhet të kalojë dy hapa, të përcaktuar për herë të parë në rastin “Relating to Certain Aspects of the Laws on the Use of Languages in Education in Belgium” v. Belgium,

---

<sup>18</sup> Megjithëse neni 14 i KEDNJ kërkon që pabarazia të jetë e lidhur me një ndër të drejtat e tjera të përcaktuara në KEDNJ, neni 1 i Protokollit 12 përcakton një ndalim më të përgjithshëm të diskriminimit: “Gëzimi i çdo lloji të drejte të përcaktuar me ligj [edhe nëse jo me KEDNJ] të sigurohet pa diskriminim”. Megjithatë, deri tani, Protokollit 12 nuk ka luajtur një rol të rëndësishëm në jurisprudencën e GJEDNJ, sepse vetëm 19 nga 47 Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës e kanë ratifikuar. Shih listën tek  
<http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=177&CM=&DF=&CL=ENG>.



Aplikimet Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63, 2126/64, GJEDNJ, 23 korrik 1968. Së pari, duhet të ketë një “qëllim legjitim” për pabarazinë, dhe së dyti, duhet të ketë një “lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar” (*id.*, par. 10).

Sa i përket zbatimit të konceptit “proporcionaliteti”, GJEDNJ nuk ka përcaktuar ndonjë test me hapa të detajuar, të paktën jo në rastet e pretenduara të diskriminimit. Në këto raste, “parimi i proporcionalitetit [konsiderohet] si vlerësimi i ‘pershtatshmërisë’ midis masave të marra dhe qëllimit të avancuar, ose duke peshuar ashpërsinë e masave me rëndësinë e qëllimit të synuar” (O.M. Arnardóttir, *Equality and Non-Discrimination Under the European Convention of Human Rights* (2003), f. 48).

Por, neni 55 i Kushtetutës na jep një pikëpamje më të detajuar të konceptit në fjalë. Sipas Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës “testi i proporcionalitetit është përshkruar në nenin 55 të Kushtetutës” (Rasti Nr. KO131/12, Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim, 15 prill 2013). Neni 55, par. 4 i Kushtetutës përcakton pesë kritere për vlerësimin e proporcionalitetit të një kufizimi të një të drejte të njeriut:

*“Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik . . . e kanë për detyrë t’i kushtojnë kujdes (1) esencës së të drejtës që kufizohet, (2) rëndësisë së qëllimit të kufizimit, (3) natyrës dhe vëllimit të kufizimit, (4) raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe (5) të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.”*

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së një pabarazie, posaçërisht në të drejtën për arsimin, duhet të përfshijë edhe një hap të fundit: përveç vlerësimit të legjitimitetit të qëllimit dhe proporcionalitetit të kufizimit, neni 47, par. 2 i Kushtetutës përcakton se: “Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe

*nevojave të veçanta të tij/saj*” (theks i shtuar). Kjo do të thotë që, nëse një ligj paraqet një *pabarazi* midis individëve sa u përket mundësive për t’u arsimuar, atëherë kjo pabarazi është i justifikuar vetëm nëse mund të argumentohet se ka një bazë të arsyeshme në ndonjë aftësi ose nevojë të veçantë të individëve që gëzojnë privilegje. Nuk mund të argumentohet se kategoritë e dala nga lufta kanë ndonjë *aftësi* të veçantë kundrejt kandidatëve të tjerë që mund të shërbejë si bazë për përparësinë në regjistrim në institucione arsimore; prandaj, kjo përparësi do të mund të justifikohet vetëm në bazë të ndonjë *nevoje* të veçantë të këtyre kandidatëve.

Duke përmbledhur të gjitha këto standarde të vlerësimit, mund të themi se përparësia në regjistrim për kategoritë e dala nga lufta është në pajtim me Kushtetutën vetëm nëse mund të kalojë tre hapa: nëse kjo përparësi (1) ka një qëllim legjitim, (2) kalon testin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 55 të Kushtetutës dhe (3) ka një bazë të arsyeshme në ndonjë nevojë të veçantë të kandidatëve përfitues.

**B. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së përparësisë në regjistrim për kategoritë e dala nga lufta, në bazë të ndalimit të diskriminimit sipas nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe në bazë të së drejtës për arsimin sipas nenit 47 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës**

**1. Legjitimiteti i qëllimit**

Sa i përket hapit të parë të vlerësimit të kushtetutshmërisë, qëllimet e *Ligjeve të 2011* dhe *2014* janë të përcaktuara në nenin 1 të secilit ligj. Këto qëllime janë të ngjashme me njëri-tjetrin. Në *Ligjin e 2011* përcaktohet se “Qëllimi i nxjerrjes [së] këtij ligji është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit”, ndërsa në *Ligjin e 2014* përcaktohet se “Qëllimi i

nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në benificione të Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të cilët, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës”. Gjithashtu, të dy ligjet i arsyetojnë benificionet e veçanta, duke përfshirë të drejtën për përparësi në regjistrim, me “kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së” (*Ligji i 2011*, neni 4, dhe *Ligji i 2014*, neni 15). Në bazë të këtyre dispozitave vërejmë se, qëllimi i përgjithshëm i dhënies së përparësisë për kategoritë e dala nga lufta, për regjistrim në institucione arsimore është për t’u dhënë kontribuesve në luftë një farë kompensimi ose mirënjohjeje për kontributin e tyre.

Praktika e ndjekur nga GJEDNJ sugjeron se, “[n]ë mungesën e rasteve tepër të qarta të diskriminimit qëllimisht nënçmues, testi i qëllimit legjitim duket se mund të përmbushet në çdo rast” (Arnardóttir, *op. cit.*, f. 43). Qëllimi i kompensimit për kontributin e dhënë në luftë, nuk mund të cilësohet si qëllim i diskriminimit nënçmues ndaj ndonjë grupi të caktuar. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se, përparësia në regjistrim për kategoritë e dala nga lufta kalon hapin e parë të vlerësimit të kushtetutshmërisë.

### **1. Baza në nevojat e veçanta të kandidatëve**

Para se të kalojmë tek vlerësimi i proporcionalitetit të përparësisë në regjistrim si mjet për të arritur qëllimin e kompensimit të kontribuesve në luftë, le të kontrollojmë nëse kjo përparësi ka një bazë në nevojat e veçanta të kandidatëve të cilëve u jepet përparësia. Siç kemi parë më sipër, ky është një kusht i domosdoshëm i së drejtës për arsimin, sipas nenit 47, par. 2 të Kushtetutës.

Lidhur me këtë kusht, duhet të marrim parasysh dy vërejtje. Së pari, koncepti i “nevojës” duhet të kuptohet në dritën e konceptit të “barazisë”, sepse barazia është ideali shprehimisht i synuar i dispozitës kushtetuese në diskutim, neni 47, par. 2. Prandaj, ata me “nevoja të veçanta” përfshijnë jo vetëm personat të cilëve u mungojnë mundësi

*minimale* ose *bazike*, sipas ndonjë standardi të caktuar, por gjithashtu individët që, megjithëse gëzojnë mundësi minimale ose bazike, u mungojnë mundësi të *barabarta* me të tjerët. Prandaj, në mënyrë që anëtarët e kategorive të dala nga lufta të konsiderohen me nevoja të veçanta, mjafton që të argumentohet se ata nuk do të gëzonin mundësi të *barabarta* me të tjerët, në mungesë të ndonjë përkrahjeje të veçantë.

Së dyti, në mënyrë që një grup të konsiderohet me nevoja të veçanta, nuk ka nevojë që situata e secilit individ në atë grup të analizohet një nga një. Asnjë ligj nuk mund të parashikojë të gjitha rrethanat që do të mund të shfaqen në të ardhmen në fushën që rregullohet nga ai ligj. Në vend të kësaj, të gjitha ligjet mbështeten në kategorizimin e individëve në grupe të përgjithshme, dhe vetëm nëpërmjet këtij lloji kategorizimi përcaktojnë të drejta dhe detyrime të individëve. Madje, edhe vetë Kushtetuta mbështetet në kategorizime të tilla. Për shembull, sipas nenit 45, par. 1, “[ç]do shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”. Ky nen kategorizon shtetasit e Kosovës në dy grupe: ata nën tetëmbëdhjetë vjeç dhe ata mbi tetëmbëdhjetë vjeç, duke i dhënë të drejtat zgjedhore vetëm grupit të dytë. Por kjo pabarazi nuk shihet si shkelje e të drejtave të njeriut, edhe pse mund të ekzistojnë individë pak më pak se tetëmbëdhjetë vjeç që nuk gëzojnë të drejtat zgjedhore, megjithëse kanë cilësi intelektuale, morale dhe qytetare, në një masë superiore ndaj individëve që kanë kaluar tetëmbëdhjetë vjeç dhe që, për rrjedhojë, gëzojnë këto të drejta. Pabarazia midis dy grupeve justifikohet nga fakti që *në përgjithësi*, qytetarët mbi tetëmbëdhjetë vjeç kanë më shumë nga ato karakteristikat e duhura për të votuar dhe për t’u zgjedhur, sesa qytetarët që janë nën tetëmbëdhjetë vjeç, pavarësisht nga fakti se mund të ketë përjashtime në raste individuale. Në të njëjtën mënyrë, pra kur vlerësojmë nëse kategoritë e dala nga lufta janë me nevoja të veçanta, pyetja jonë nuk është nëse *secili individ* në këto grupe është me nevoja të veçanta. Në vend të kësaj, pyetja jonë duhet të jetë: A ka një bazë të arsyeshme për

të menduar që këto grupe, në përgjithësi, janë me nevoja të veçanta kundrejt personave të tjerë, pavarësisht nga fakti se mund të ketë përjashtime në raste individuale?

Duke bashkuar këto dy vërejtje, pyetja që duhet të bëjmë lidhur me nenin 47, par. 2, mund të formulohet si në vijim: A ka një bazë të arsyeshme për të menduar që anëtarët e kategorive të dala nga lufta, në përgjithësi, nuk do të gëzonin mundësi të barabarta me të tjerët në mungesë të ndonjë përkrahjeje në fushën e arsimit?

Le të konsiderojmë me radhë gjashtë kategoritë e dala nga lufta. Sipas standardit që kemi caktuar, invalidët e luftës dhe familjet e tyre mund të konsiderohen me nevoja të veçanta, për shkak të dëmeve të rënda dhe të përhershme që kanë pësuar në luftë. Pra, kemi një bazë të arsyeshme për të menduar se këto dëme mund t'i pengojnë ata në avancimin socioekonomik dhe në integrimin e plotë në sfera të ndryshme të shoqërisë. Invalidët janë personat “organizmi i të cil[ëve] është dëmtuar mbi 20%” (*Ligji i 2011*, neni 3, par. 1, pika 7), e cila, në shumë raste, mund ta bëjë të pamundur që ata të sigurojnë një vend pune jashtë shtëpisë apo edhe të kryejnë funksione të ndryshme elementare, gjë që mund të shkaktojë vështirësi ekonomike për ata dhe për familjet e tyre, dhe që mund të pengojë mundësitë arsimore të tyre dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, për shkak të kohës dhe energjisë që duhet të harxhohet për t'u kujdesur për nevojat e tyre mjekësore. Prandaj, invalidët dhe familjet e tyre nuk gëzojnë mundësi të barabarta me të tjerët, dhe për rrjedhojë, mund të konsiderohen me nevoja të veçanta. Përparësia në regjistrim për këtë grup e kalon testin e nenit 47, par. 2 të Kushtetutës.

Veteranët e luftës paraqesin një çështje pak më të vështirë. Nga njëra anë, mund të argumentohet se, fakti i vetëm që një person ka marrë pjesë në luftë, por nuk vuan nga plagë ose dëmtime të trupit nga aspekti fizik, nuk krijon asnjë vështirësi të veçantë për të, lidhur me arsimimin e tyre ose avancimin socioekonomik. Por, nga ana tjetër, nuk mund të mohohet fakti se një pjesë e konsiderueshme e veteranëve mund të jenë

viktima të traumës psikologjike, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në luftë. Ky grup më i ngushtë i veteranëve, do të mund të konsideroheshin persona me nevoja të veçanta, për shkak se trauma që vuajnë mund t'i pengojë deri diku në avancimin socioekonomik dhe në integrimin e plotë në sfera të ndryshme të shoqërisë, njëlloj si në rastin e invalidëve të luftës.<sup>19</sup> Mirëpo, *Ligji i 2014* përcakton se të gjithë veteranët, pa marrë parasysh fare nëse vuajnë nga trauma psikologjike ose jo, gëzojnë përparësi në regjistrim. Shih *Ligjin e 2014*, neni 3, par. 1, pika. 3.2 (“**Veteran luftëtar[] i UÇK-së** – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK- së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës”, theks në origjinal). Megjithatë, duhet marrë parasysh se dëmtime psikologjike janë shumë më të vështira për të matur sesa dëmtime trupore, dhe se një pjesë shumë e konsiderueshme e veteranëve, për shkak të vetë natyrës së luftës, mund të vuajnë, në nivele të ndryshme, nga pasoja psikologjike. Prandaj, edhe veteranët luftëtarë, ashtu siç përkufizohet kjo kategori në *Ligjin e 2014*, mund të konsiderohen një grup me nevoja të veçanta. Prandaj, edhe përparësia në regjistrim për këtë kategori e përbush standardin e nenit 47, par. 2.

Sa u përket anëtarëve të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, edhe këtu ka një bazë të arsyeshme për të besuar se mungesa e prindit ose i/e bashkëshortes/it mund të ketë pasoja serioze për një

---

<sup>19</sup> Për fat të keq, veteranët e luftës me trauma psikologjike nuk përfshihen në kategorinë e invalidëve të luftës. Shih *Ligjin e 2011*, neni 3, par. 1, pika 1.7, ku invalid i UÇK-së përkufizohet në bazë të dëmtimit trupor por jo edhe mendor: “pjesëmarrësi i UÇK, *organizmi* i të cilit është dëmtuar mbi 20% për shkak të plagës, lëndimit apo sëmundjes që ka pësuar në luftë, apo si i internuar (i burgosur) në burgjet apo kampet e armikut dhe shtetasi i huaj si veteran i UÇK –së, nga 1997- 1999” (theks i shtuar).

individ, qoftë nga ana e zhvillimit të tij arsimor, qoftë nga ana e avancimit të tij socioekonomik. Në rastin e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, fëmijët e tyre duhet të rriten nga vetëm një prind, gjë që shkakton vështirësi ekonomike, si për fëmijët ashtu edhe për prindërit që duhet t'i rrisin. Fëmijët që kanë vetëm një prind, gjithashtu kanë më shumë rrezik të ngelen mbrapa në progresin e tyre akademik, sidomos në fazat e hershme të arsimimit të tyre. Në këto rrethana, anëtarët e familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së nuk gëzojnë mundësi të barabarta me të tjerët, dhe prandaj mund të konsiderohen me nevoja të veçanta.

Megjithatë, këto argumente nuk vlejné edhe për anëtarët e familjeve të veteranëve të UÇK-së. Ndryshe nga anëtarët e familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, nuk mund të argumentohet se anëtarët e familjeve të veteranëve kanë humbur familjarin e tyre në luftë. Dhe, ndryshe nga anëtarët e familjeve të invalidëve të UÇK-së, nuk mund të argumentohet se veteranët, të cilët nuk kanë pësuar plagosje të rëndë dhe të përhershme në luftë, kanë vështirësi të veçantë në gjetjen e punës jashtë shtëpisë, ose që familjarët e tyre duhet të harxhojnë kohë dhe energji për t'u kujdesur për nevojat e tyre mjekësore. Kemi thënë më lartë që një pjesë e konsiderueshme e veteranëve mund të vuajnë nga pasoja psikologjike të luftës, dhe mund të ketë raste të veçanta në të cilat trauma psikologjike prej së cilës vuajnë, janë aq të rënda sa që krijojnë vështirësi po aq të mëdha për familjet e tyre sa një invalid i luftës me dëmtim trupor mbi 20%. Por nuk kemi një bazë të arsyeshme për të menduar se, veteranët në përgjithësi vuajnë nga trauma psikologjike deri në këtë nivel të skajshëm. Prandaj, megjithëse mund të argumentohet se *vetë veteranët* janë me nevoja të veçanta, për shkak të traumës psikologjike që në përgjithësi kanë vuajtur për shkak të luftës, nuk kemi një bazë të arsyeshme për të menduar që kjo traumë, në përgjithësi, arrin deri në atë masë që edhe familjet e tyre kanë nevoja të veçanta vetëm nga fakti ka një veteran në mesin e tyre. Prandaj, përparësia në regjistrim në Universitet, në rastin e familjeve të

veteranëve, nuk është në pajtim me standardin e përcaktuar nga neni 47, par. 2 të Kushtetutës.

## 2. Proporcionaliteti i kufizimit

Hapi i fundit është vlerësimi i proporcionalitetit të përparësisë që u jepet pesë kategorive që mbeten: invalidët dhe veteranët e luftës, si dhe anëtarët e familjeve të invalidëve, të zhdukurve dhe dëshmorëve të luftës. Siç kemi parë më sipër, neni 55, par. 4 i Kushtetutës përcakton pesë kritere që duhet të përmbushen, në mënyrë që një kufizim i të drejtave të njeriut të konsiderohet proporcional.

Së pari, duhet të vlerësojmë nëse esenca e së drejtës është mohuar. Ky kriter theksohet edhe në nenin 55, par. 5: “Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar”. Në rastin e *Ligjeve të 2011 dhe 2014*, përparësia në regjistrim nuk e mohon esencën e së drejtës kundër diskriminimit, sepse jepet jo në të gjitha rastet, po vetëm në kushte të barabarta me të tjerët. Prandaj, përparësia e parashikuar me ligj nuk mund të quhet ekstreme deri në atë masë që e mohon esencën e së drejtës për barazinë para ligjit. E njëjta gjë mund të argumentohet edhe sa i përket “natyrës dhe vëllimit të kufizimit” (Kushtetuta, neni 55, par. 4). Përderisa përparësia jepet jo në të gjitha rastet, por vetëm në kushte të barabarta me të tjerët, vëllimi i kufizimit nuk mund të quhet i tepërt.

Sa i përket “raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet” (Kushtetuta, neni 55, par. 4), ka një lidhje racionale të qartë midis dhënies së përparësisë në regjistrim dhe qëllimit të kompensimit të kontribuesve, përderisa një ndër mjetet e disponueshme për t’i kompensuar ata është, që t’u mundësohet atyre apo familjarëve të tyre regjistrim në institucione të larta arsimore.

Sa i përket “rëndësisë së qëllimit të kufizimit”, nuk mund të mohohet se, në rastin e veteranëve, invalidëve, të zhdukurve dhe dëshmorëve të luftës, kompensimi i tyre për sakrificën që i kanë dhënë Republikës sonë është një qëllim mjaft i rëndësishëm. Për shkak të këtyre sakrificave, Republika e Kosovës ka një obligim të veçantë ndaj



veteranëve, si dhe ndaj invalidëve dhe familjeve të tyre, për t'u siguruar atyre mundësi të barabarta në arsim, në avancim socioekonomik dhe në integrimin e tyre të plotë në shoqëri, duke marrë parasysh nevojat e tyre të veçanta që kemi analizuar më sipër. Të njëjtin obligim e ka edhe ndaj dëshmorëve dhe të zhdukurve të luftës dhe familjarëve të tyre, mbase në një shkallë edhe më të lartë. Është pikërisht për shkak se dëshmorët dhe të zhdukurit e UÇK-së kanë falur jetën e vet për themelimin e Republikës së Kosovës që familjet e tyre janë tani me nevoja të veçanta. Për këtë arsye, Republika e Kosovës ka një detyrë reciproke për të siguruar që familjet e tyre të kenë mundësi të paktën të barabarta me të tjerët. Për këto arsye, rëndësia e qëllimit të *Ligjeve të 2011 dhe 2014* arrin të justifikojë përparësinë në regjistrim që u jepet kategorive në diskutim, përderisa kjo përparësi është e një natyre dhe vëllimi të vogël, dhe nuk e mohon esencën e së drejtës për barazinë para ligjit.

Së fundi, duhet të shqyrtojmë “mundësinë e realizimit të . . . qëllimi[t] me kufizim më të vogël” (*id.*). Në këtë hap, duhet theksuar se po kërkojmë një mundësi për realizimin e qëllimit që “përmbush qëllimin . . . në të njëjtën nivel të intensitetit dhe efektshmërisë” si kufizimi në diskutim (A. Barak, *Proportionality: Constitutional Rights and Their Limitations* (2012), f. 323, theks i shtuar). Fillimisht vërejmë se, ndjekja e arsimit të lartë, si dhe diplomimi nga një institucion i arsimit të lartë, janë mjete të rëndësishme për integrimin e një individi në jetën sociale, ekonomike, dhe kulturore të një shoqërie demokratike. Megjithatë, mund të ekzistojnë alternativa të tjera që ndihmojnë në integrimin e kategorive në fjalë në shoqëri dhe që nuk kanë të bëjnë me regjistrim në fakultet. Ose, mund të ekzistojnë alternativa të tjera që i ndihmojnë kandidatët për të hyrë në fakultet, por që nuk japin ndonjë përparësi në fazën e regjistrimit. Për shembull, një alternativë e tillë mund të jetë edhe “program[i] [i] veçantë” që po zhvillon Universiteti i Prishtinës “për përkrahjen e kandidatëve që u takojnë kategorive të luftës”, i cili “nënkupton ofrimin e ndihmës për përgatitjen e kandidatëve për provimin shtetëror të maturës dhe provimin pranues, si

dhe këshillimin akademik gjatë studimeve” (Letra e *Rektorit* e datës 9 janar 2015).

Këto alternativa, duke u konsideruar një nga një, mund të jenë po aq efikase, ndoshta edhe më efikase, në përmbushjen e qëllimit të integritetit të kategorive të luftës në shoqëri dhe të kompensimit për sakrificat e tyre, sesa dhënia e përparësisë në regjistrim në institucione arsimore. Por, në mënyrë që të jetë një mjet proporcional, nuk është e domosdoshme që përparësia në regjistrim të jetë më efikase sesa çdo mjet tjetër i mundshëm, marrë ato një nga një. Ajo që është relevante është se, qëllimi i ligjit do të arrihej në një nivel edhe më të lartë të “intensitetit dhe efektshmërisë” nëse, bashkë me të gjitha mjetet e tjera, do t’u jepej kategorive të dala nga lufta edhe përparësia në regjistrim në institucione arsimore. Në këtë kuptim, dhënia e kësaj përparësie është e domosdoshme për të arritur qëllimin deri në shkallën maksimale të mundshme.

Për këto arsye, Avokati i Popullit konsideron se përparësia në regjistrim për veteranët dhe invalidët e UÇK-së, si dhe për familjet e invalidëve, të zhdukurve dhe dëshmorëve të UÇK-së, përbën një kufizim proporcional të së drejtës për barazinë para ligjit. Prandaj, përparësia për këto pesë kategori është në pajtim me Kushtetutën.

## **KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT**

### **A. Konstatimet e Avokatit të Popullit**

Në bazë të analizës së mësipërme, Avokati i Popullit konstaton se:

- (1) Vendimet e Senatit të Universitetit të Prishtinës, të datave 30 maj, 26 shtator dhe 16 tetor 2014, për përcaktimin e kriterëve për pranimin e studentëve për vitin akademik 2014/2015, nuk janë në përputhje me ligjin sepse (a) u japin përparësi në regjistrim vetëm disave nga kategoritë që duhet të gëzojnë këtë përparësi sipas ligjit, dhe (b) e japin këtë përparësi në kushte jo plotësisht të barabarta me kandidatët e tjerë.

- (2) Fakti se Vendimi i Senatit të Universitetit të Prishtinës, i datës 16 tetor 2014, i ndryshoi kriteret e konkursit për afatin e parë, nuk paraqet shkelje të obligimeve ligjore të Universitetit të Prishtinës.
- (3) Universiteti i Prishtinës ka kryer të gjitha obligimet e tij ligjore lidhur me Memorandumin e Bashkëpunimit, të nënshkruar në shtator të vitit 2009 me Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së.
- (4) Tërheqja e njëanshme e Universitetit të Prishtinës nga *Memorandumi* i Bashkëpunimit, nuk paraqet shkelje të obligimeve ligjore të Universitetit të Prishtinës.
- (5) Mostra e vogël e shqyrtuar nga rektori i Universitetit të Prishtinës përbën dëshmi serioze që, disa studentë që kanë përfitur nga statusi i anëtarit të familjes së dëshmorit, mund të mos kenë këtë status në të vertetë.
- (6) Vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i datës 13 nëntor 2014, për regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga lufta, nuk është në përputhje me ligjin, sepse: (a) shkel autonominë e Universitetit të Prishtinës, (b) kërkon përparësi në regjistrim vetëm për disa nga kategoritë që duhet të gëzojnë këtë përparësi sipas ligjit dhe, (c) e kërkon këtë përparësi në kushte jo të barabarta me të tjerë, madje edhe pa marrë parasysh nëse kandidatët përfitues kanë kaluar ose jo pragun minimal të pikëve.
- (7) Përderisa *Vendimi i MASHT-it* ishte një ndërhyrje e kundërligjshme në autonominë e Universitetit të Prishtinës, moszbatimi i këtij vendimi nga ana e Universitetit të Prishtinës ishte brenda të drejtave ligjore të Universitetit.
- (8) Mospërgjigjia në kërkesën e Avokatit të Popullit për masë të përkohshme nga ana e ish-ministrit të Ministrisë së Arsimit,

Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja, dhe ish-kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, para se t'u dorëzonin detyrat pasardhëse të tyre, përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit.

- (9) Mospërgjigjia në kërkesën e Avokatit të Popullit për masë të përkohshme nga ana e ministrit aktual të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami, dhe kryeministrit aktual të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, më shumë se 60 ditë pas dërgimit të kërkesës, përbën shkelje edhe më të rëndë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit të Avokatit të Popullit, si dhe dështim të plotë për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit.
- (10) Përparësia në regjistrim për invalidët e UÇK-së dhe veteranët e UÇK-së, si dhe për anëtarët e familjeve të ngushta të invalidëve, të zhdukurve dhe dëshmorëve të UÇK-së, është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- (11) Përparësia në regjistrim për anëtarët e familjeve të ngushta të veteranëve joinvalidë të UÇK-së, paraqet një shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

#### **B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit**

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon që:

#### **Universiteti i Prishtinës:**

- (1) Nëse mbeten kandidatë nga gjashtë kategoritë e dala nga lufta (veteranët e UÇK-së, invalidët e UÇK-së dhe anëtarët e

familjeve të ngushta të veteranëve,<sup>20</sup> invalidëve, dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së) që ende nuk janë regjistruar, por që kanë fituar të njëjtin numër pikësh sa ndonjë kandidat i suksesshëm në fakultetet ku kanë aplikuar, t'i regjistrojë ata, me kusht të verifikimit të statusit të tyre në përputhje me ligj.

- (2) Të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbaruar verifikimin e statusit të studentëve aktualë, që janë pranuar falë statusit të tyre si anëtarë të familjeve të dëshmorëve, dhe të marrë masa disiplinore në rast të zbulimit të paraqitjes së informacioneve të falsifikuara gjatë procesit të regjistrimit në Universitetin e Prishtinës.

**Kryeministri Mustafa dhe ministri Bajrami:**

- (3) Të shfuqizojë vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të datës 13 nëntor 2014, për regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga lufta.<sup>21</sup>
- (4) Të mos ndërhyjë në asnjë aspekt të përcaktimit të kriterëve për pranimin e studentëve nga Senati i Universitetit të Prishtinës.
- (5) Të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar në të ardhmen bashkëpunim adekuat me Avokatin e Popullit, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, dhe në përputhje me premtimin e vetë

---

<sup>20</sup> Nuk paraqet ndonjë kontradiktë fakti që Avokati i Popullit, nga njëra anë, po rekomandon zbatimin e plotë të ligjeve në fuqi, duke përfshirë dhënien e përparësisë në kushte të barabarta për anëtarët e familjeve të veteranëve, por nga ana tjetër, e konsideron kundërkushtetuese përparësinë për këtë kategori. Siç kemi theksuar më sipër, të gjitha institucionet shtetërore e kanë për detyrë të respektojnë ligjet në fuqi, derisa të njëjtat të ndryshohen ose shfuqizohen nga institucionet kompetente.

<sup>21</sup> Ky hap është i domosdoshëm edhe nëse, për momentin, as Universiteti i Prishtinës as Qeveria nuk po kërkon zbatimin e vendimit. Deri në shfuqizimin e tij zyrtar, vendimi mbetet me fuqi vepruese dhe paraqet rrezik për shkaktimin e konflikteve të mëtutjeshme.

kryeministrit Mustafa në fjalimin e tij inaugurues si i nominuar për postin e kryeministrit.

**Kuvendi i Republikës së Kosovës:**

- (6) Të ndryshojë nenin 30 të Ligjit Nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili përcakton se: “Përparësia e pranimit në institucionet arsimore publike, në kushte të barabarta, është e drejtë të cilën e realizojnë veteranët luftëtarë dhe anëtarët e ngushtë të familjes së tyre”, duke fshirë pjesën “dhe anëtarët e ngushtë të familjes së tyre”.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit (“Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për masa disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

**Kopje:**

- Z. Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Z. Isa Mustafa, kryeministër i Republikës së Kosovës
- Z. Arsim Bajrami, ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Prishtinë, më 19 shkurt 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIM**

**Ankesa nr. 369/2014**

**S. K. dhe të tjerët**

**kundër**

**Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)**

**Çështja:** Rekomandim, përkitazi me zvarritjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së z. S. K., z. Rr. M, dhe z. A. H., të datës 17 mars 2014, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të mosbashkëpunimit të MPMS me Avokatin e Popullit

**Palë përgjegjëse:** Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Z. Arban Abrashi, ministër

**Baza ligjore:** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 15 paragrafi 6

### **Qëllimi i raportit**

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, të parashtruar nga z. S. K., z. Rr. M. dhe z. A. H., më datë 17 mars 2014, pa vonesa të mëtutjeshme.

### **Përmbledhja e fakteve dhe provave**

1. Raporti është i bazuar në ankesat e z. S. K., z. Rr. M. dhe z.A. H. dhe mbështetet në provat e palëve dhe shkresat e lëndës, të cilat i posedon Avokati i Popullit, për zvarritjen e procedurës, për të vendosur lidhur me kërkesën e bërë më 17 mars 2014, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.
2. Sipas ankuesve që nga koha kur ishin transferuar në detyrën e re të punës, nga autoritetet përkatëse të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), disa herë kishin kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, mirëpo ato nuk u ishin kompensuar. Së fundi, më 17 mars 2014, ata sërish kishin parashtruar kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, mirëpo pa sukses, sepse autoritetet përkatëse të MPMS-së nuk u kishin dhënë përgjigje. Madje, ato ende nuk kanë vendosur lidhur me kërkesën në fjalë.

### **Kronologjia e rastit**

3. Z. A.K., z. Rr. Mazreku dhe z. A. Hyseini, inspektor të punës, në fillim të muajit shtator 2011 janë transferuar nga komunitat Malishevë, Dragash dhe Rahovec në Zyrën Rajonale të Inspektoratit të Punës në Prizren. Atyre, për muajt shtator – dhjetor 2011, u janë paguar shpenzimet e udhëtimit, ndërsa nga janari 2012, e tutje nuk u janë paguar. Kërkesën e fundit për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit në MPMS e kanë bërë më



17 mars 2014, mirëpo deri më sot kjo çështje ka mbetur e pazgjidhur.

4. Më 19 gusht 2014, ankuesit parashtruan ankesën e tyre në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës për shqyrtimin e çështjes së tyre, nga MPMS.
5. Më 2 shtator 2014, Avokati i Popullit i dërgoi letër MPMS në Prishtinë, në të cilën kërkoi informata për veprimet e ndërmarra ose ato që planifikoheshin të ndërmerren që rasti i ankuesve të shqyrtohej brenda një afati të arsyeshëm kohor, por IAP nuk mori përgjigje.
6. Më 22 tetor 2014, Avokati i Popullit, për herën e dytë i dërgoi letër MPMS-së, në të cilën kërkoi sërish të informohet se a janë ndërmarrë veprime për të shqyrtuar dhe vendosur për rastin e ankuesve, por edhe kësaj radhe MPMS nuk e pa të arsyeshme të përgjigjet në kërkesën e IAP.

### **Baza ligjore**

7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 31 përcakton se *“Çdo kujt i garantohet mbrojtja e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartëseve të kompetencave publike.”*
8. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), është dokument ligjor i zbatueshëm më Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Në paragrafin 1 të nenit 6, të KEDNJ-së shprehimisht theksohet: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm”.*

### **Ligji për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28**

9. Ligji për Procedurën Administrative (LPA), në nenin 11, përcakton shprehimisht obligimin për vendimmarrje: *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë”*.
10. Në nenin 38, të po këtij ligji, në mënyrë të hollësishme parashihet fillimi i procedimit administrativ nga pala dhe obligimi i organit për dhënie të përgjigjes me shkrim.
- “38.4 Drejtuesi i organit të administratës publike shqyrton menjëherë kërkesën për veprim drejtuar organit nga pala e interesuar dhe kryen veprime e mëposhtme:*
- a) *Njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar dhe se procedura administrative ka filluar ose*
  - b) *Njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa nuk është pranuar dhe se pala mund të ankohet kundër këtij vendimi sipas procedurës të parashikuar në nenin 101 të këtij Ligji ose*
  - c) *Njofton palën kërkuese se janë të nevojshme veprimet të mëtejshme administrative përpara se organi t’i përgjigjet kërkesës. Në këtë rast organi cakton edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme.”*
11. Neni 90 në paragrafin 1 të po këtij ligji, rregullon mënyrën e shpalljes së akteve administrative *“Aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afatin prej 30 ditësh.”*

### **Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149**

12. Neni 28 paragrafi 1 i Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.03/L-149 përcakton: *“Transferimi i nëpunësve civil mund të bëhet në formë të ricaktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera”*.

**Rregullorja për Transferimin e Nëpunësve Civil (RRTNC),  
Nr.06/2010**

13. Po ashtu, në nenin 5, paragrafi 5 të kësaj rregullore thuhet:  
*“Nëpunësi civil që transferohet në lokacion tjetër, më larg se pesë (5) km nga vendi i punës së tij, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit.”*

**Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil (LPNC), Nr. 03/L-147**

14. Ndërsa sipas neni 20, paragrafi 2.4 të këtij ligji, nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të bëra gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon: *“Shpenzimet e shkaktuara me rastin e zhvendosjes së përkohshme ose të përhershme në një vend tjetër pune.”*

**Analiza ligjore**

15. Duke pasur parasysh ankesat e ankuesve, lidhur me dështimin e MPMS-së për të vendosur për çështjen e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për më shumë se dy vite, procedura e së cilës është iniciuar që nga fillimi i vitit 2012 dhe ende nuk është vendosur, deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti (shkurt 2015), Avokati i Popullit vëren se kemi zvarritje të paarsyeshme të procedurës administrative nga MPMS, gjë që është në kundërshtim me të drejtën për një procedim të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ dhe nenet 11 dhe 38 të LPA.
16. Që në fillim, Avokati i Popullit ua përkujton se çështjet nga marrëdhënia e punës dhe ushtrimit të profesionit konsiderohen të jenë të drejta civile, për qëllime të nenit 6 të KEDNJ, i cili për këtë arsye është i aplikueshëm edhe në procedurat e rastit në fjalë.
17. Avokati i Popullit, gjithashtu thekson se mosndërmarrja e veprimeve përkatëse administrative nga MPMS, për shqyrtimin

e kërkesave për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, përbën shkelje të të drejtave të njeriut, përkatësisht të së drejtës për proces të rregullt, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kishte vendosur në favor të palës ankuese në një rast të ngjashëm (Shih Rastin Hornsby kundër Greqisë, më 5 qershor 1984), me ç'rast ajo: *“Shpall të pranueshme ankesat që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurës administrative [...]” dhe Konsideron se ka pasur shkelje të Nenit 6 paragrafi 1 të Konventës...”*

- 18.** Avokati i Popullit vëren se mosshqyrtimi i kërkesave të ankuesve për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit gjithashtu përbën shkelje dhe është në kundërshtim me nenet 38.4 dhe 90.1 të LPA, të cilët obligojnë organet përkatëse administrative që menjëherë t'i shqyrtojnë kërkesat e parashtruara nga palët dhe se aktet e nxjerra t'u dërgohen atyre në afat prej 30 ditësh. Aq më tepër neni 38.4 kërkon nga organet që palët t'i informojnë me shkrim për pranimin apo refuzimin e kërkesave në mënyrë që ato më pastaj të kenë mundësi veprimi apo të shfrytëzimit të mjeteve juridike. Në rastin konkret ankuesit nuk janë njoftuar me shkrim, lidhur me shkresën e parashtruar, nuk është nxjerrë kurrfarë vendimi lidhur me të dhe, si rrjedhojë, ata janë privuar edhe nga mundësia e shfrytëzimit të mjeteve juridike.
- 19.** Edhe pse ankuesit, në fillim të muajit shtator 2011, janë transferuar nga komunat Malishevë, Dragash dhe Rahovec, në Zyrën Rajonale të Inspektoratit të Punës në Prizren, sipas Rregullores për Transferimin e Nëpunësve Civil, nr. 06/2010, autoritetet përkatëse kanë dështuar në zbatimin e nenit 5, paragrafi 5 të kësaj rregulloreje, i cili përcakton që *“Nëpunësi civil që transferohet në lokacion tjetër, më larg se pesë (5) km nga vendi i punës së tij, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit.”* Autoritetet përkatëse, përkatësisht MPMS që nga janari i vitit 2012, ankuesve nuk u ka kompensuar shpenzimet e

udhëtimit përkundër faktit që ata kanë kërkuar kompensimin e tyre.

20. Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit gjatë ushtrimit të detyrave të punës me rastin e transferimit garantohet edhe me nenin 20, paragrafi 2.4 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, Nr. 03/L 147, i cili në rastin e ankuesve nuk është respektuar nga autoritetet përkatëse, sepse MPMS ka dështuar në përmbushjen e këtyre detyrimeve.
21. Avokati i Popullit vëren se për rastin në fjalë, çështja e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit duhet të përfshijë periudhën kohore, duke filluar nga janari 2012, atëherë kur MPMS ua ka ndërprerë pagesën e shpenzimeve të udhëtimit. MPMS ankuesve ua ka paguar shpenzimet e udhëtimit vetëm për muajt shtator – dhjetor 2011. Ndërsa sa i përket kërkesës së fundit të parashtruar më 17 mars 2014, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, ankuesit ende nuk kanë marrë përgjigje.
22. Avokati i Popullit konkludon se mosshqyrtimi i kërkesës të ankuesve, të parashtruar më 17 mars 2014, nga MPMS, përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ, si dhe nenet 11, 38.4 dhe 90.1 të LPA. Avokati i Popullit konsideron se procedura e shqyrtimit të kërkesës së ankuesve duhet të zhvillohet pa zvarritje të mëtejme, çështja e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, përfundimisht duhet të vendoset në mënyrë meritore nga MPMS.

**MOSBASHKËPUNIMI I MINISTRISË SË PUNËS DHE  
MIRËQENIES SOCIALE ME INSTITUCIONIN E AVOKATIT E  
POPULLIT**

Avokati i Popullit, me qëllim të hetimit të pohimeve ankimore të palëve, z. S. K., z.Rr. M. dhe z. A.H., për shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, më 2 shtator 2014 dhe më 22 tetor 2014, i dërgoi shkresë MPMS-së, por për asnjërën nga to nuk ka marrë përgjigje.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Avokatin e Popullit, përcaktojnë detyrimin e të gjitha autoriteteve shtetërore për t'u përgjigjur në kërkesat e Avokatit të Popullit

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

- 23.** Në nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shprehimisht theksohet se: *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”*.

### **Ligji për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195**

- 24.** Neni 16.4 i Ligjit për Avokatin e Popullit, shprehimisht thekson: *“Avokati i Popullit i ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas paragrafit 1. të nenit 15 të këtij ligji, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme të caktuar nga Avokati i Popullit. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e çështjes së ankesës sipas paragrafit 1. të nenit 15 të këtij ligji, nga autoritetet kompetente kërkohet të përgjigjen me nguti”*.
- 25.** Neni 16.6 i Ligjit për Avokatin e Popullit, shprehimisht thekson: *“Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet e çdo institucioni të Republikës së Kosovës dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo institucion i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, duke përfshirë edhe kopjen e*

*plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së Avokatit të Popullit”.*

- 26.** Neni 23 i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton obligimin e institucioneve publike të Republikës së Kosovës për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit. Në paragrafin 1 të këtij neni, shprehimisht theksohet: *“Të gjitha organet e pushtetit shtetëror kanë për obligim ta ndihmojnë Avokatin e Popullit në zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij”.*
- 27.** Neni 22 paragrafi 4 i Ligjit për Avokatin e Popullit shprehimisht thekson se: *“Refuzimi apo dështimi për t’iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit”.*
- 28.** Refuzimi apo dështimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit dhe për t’u përgjigjur në kërkesat e tij, përveç se është një veprim kundërkushtetues dhe i kundërligjshëm, është një papërgjegjësi institucionale e cila detyrimisht ka për rrjedhojë marrjen e masave ligjore ndaj personave përgjegjës në institucionet publike, në kuptimin e nenit 23 paragrafi 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.”*

### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

- 29.** Avokati i Popullit vëren se MPMS, edhe pse e ka obligim kushtetues dhe ligjor, nuk është përgjigjur në dy letrat e dërguara nga Avokati i Popullit, gjë që përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit. Veprimet e tilla ndikojnë negativisht në qeverisjen e mirë dhe

mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.

30. Avokati i Popullit rithekson se vetëm bashkëpunimi dhe komunikimi efektiv ndërmjet Avokatit të Popullit dhe institucioneve publike do të bëjë të mundur zgjidhjen sa më të shpjeg të ankesave, eliminimin efektiv të shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe do të përmirësojë mangësitë në punën dhe veprimet e administratës shtetërore, të konstatuara gjatë hetimeve të Avokatit të Popullit.
31. Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*” Prandaj, në pajtim me nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr.03/L-195, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës, lidhur me ndjekjen e procedurave në pajtim me ligjin dhe aktet tjera normative për shqyrtimin e kërkesave, *Avokati i Popullit;*

### **Rekomandon Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale**

1. *Marrjen e masave të menjëhershme, për shqyrtimin e kërkesës së z. Sahit Kastrati, z. Rrahman Mazreku dhe z. Agim Hyseini, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, pa zvarritje të mëtejme, bazuar në ligjet e cituara me lart.*
2. *Trajtimin e rasteve dhe vendosjen meritore, lidhur me kërkesat e ngjashme, për të gjithë kërkuesit, brenda një afati të arsyeshëm kohor, në pajtim me legjislacionin përkatës, të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.*
3. *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të përgjigjet në letrat e Avokatit të Popullit, të dërguara më 2 shtator 2014 dhe më 22*



*tetor 2014, si detyrim kushtetues dhe ligjor për bashkëpunim me Avokatin e Popullit.*

### **Rekomandimi për Kuvendin e Republikës së Kosovës**

- 1. Të përdorë autoritetin ligjor dhe kushtetues ndaj organeve të tjera shtetërore, në mënyrë që ato të përmbushin detyrimin e tyre kushtetues dhe ligjor, në raport me kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr.03/L-195, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se më **19 mars 2015**.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Kopje: Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Z. Isa Mustafa, Kryeministër i Republikës së Kosovës

Bashkëngjitur:- Kopjet e letrave dërguar MPMS, më 2 shtator 2014 dhe më 22 tetor 2014.

Prishtinë, më 23 shkurt 2015

## **RAPORT ME REKOMADIM**

**Ankesa nr. 302/2012**

**A. M.**

**kundër**

**Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**

**Çështja:** Zvarritja procedurale nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në vendosjen e lëndës SR-11-0315/C-III-12-1993, që ka të bëjë me dorëzimin e patundshmërisë nga KBI “Progres” në Prizren

**Drejtuar:** Z. Sahit Sylejmani, kryetar  
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rr. “Nazim Gafurri”, nr. 31  
10000 Prishtinë

**Baza Ligjore:** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135,  
paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 15, paragrafi 6

## Qëllimi i Raportit

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën SR-11-0315/C-III-12-1993, pa vonesa të mëtutjeshme.

## Përmbledhja e fakteve

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.1 të Ligjit të Avokatit të Popullit nr. 03/L-195, më 26 qershor 2012 ka pranuar ankesën e z. A.M. (në tekstin e mëtejme *Ankuesi*), kundër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për të vendosur për lëndën SR-11-0315, që ka të bëjë me dorëzimin e patundshmërisë në posedim nga KBI “Progres” në Prizren e privatizuar.

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit(IAP), të paraqitura nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

1. Në vitin 2005 *Ankuesi*, ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren, për përcaktimin e të drejtës së pronësisë në tokën e të paditurës KBI “Progres” në Prizren.
2. Më 19 prill. 2011, Gjykata Komunale në Prizren ka nxjerrë aktvendimin C. Nr. 1018/05 dhe është shpallur jokompetente, për shkak të inicimit të procedurës së likuidimit të KBI “Progres” në Prizren, në emër të së cilës janë të regjistruara ngastrat kontestuese.
3. Më 16 shtator 2011, lënda i është dërguar DHPGJSK për shqyrtim të mëtejshëm, e cila është regjistruar me numrin SR-11-0315.
4. Më 26 qershor 2012, *Ankuesi* ka parashtruar ankesë në IAP.
5. Më 11 korrik 2012, Avokati i Popullit i dërgoi letër kryetarit të DHPGJSK, përmes së cilës kërkoi të informohet për veprimet e

- ndërmarra apo ato që planifikoheshin të ndërmerren nga gjykata, për rastin e *Ankuesit*.
6. Më 14 gusht 2012, kryetari i DHPGJSK përmes shkresës e ka informuar Avokatin e Popullit, “*se sipas shënimeve nga baza e të dhënave del se nuk ka veprime procedurale, por sipas shënimeve në këtë lëndë janë ndërruar dy gjyqtarë dhe para pak kohe i është ri caktuar një gjyqtari të ri*”.
  7. Më 13 shkurt 2013, më 5 mars 2013 dhe 30 prill 2013, përfaqësuesja e IAP ka kontaktuar administratorin e gjykatës dhe ka kërkuar informata për rastin e *Ankuesit*.
  8. Më 30 prill 2013, përfaqësuesja e IAP-së, është njoftuar nga DHPGJS, se do të shikohet statusi i lëndës në fjalë dhe do të njoftohet.
  9. Më 10 maj 2013, Avokati i Popullit i është drejtuar edhe më një shkresë kryetarit të DHPGJSK, për t’u informuar se në cilën fazë të procedurës ndodhet çështja e *Ankuesit*, si dhe cilat veprime janë ndërmarrë nga kjo gjykatë që rasti në fjalë të procedohet brenda afatit të arsyeshëm kohor, në pajtim me ligjin dhe nenin 6 të konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
  10. Më 18 korrik 2013, Avokati i Popullit i dërgoi shkresë përsëritëse, DHPGJSK, lidhur me çështjen e lartpërmendur.
  11. Më 21 gusht 2013, DHPGJSK përmes shkresës e informon Avokatin e Popullit, “*se lënda SR-11-0315, më kërkesë të Gjykatës Themelore në Prizren më datë 19. 11. 2012, është dërguar për shikim, për lëndën civile C. Nr. 427/09, dhe sipas shënimeve të zyrës së regjistrimit lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren*”.
  12. Më 5 shtator 2013, IAP e informoi ankuesin me të dhënat e siguruar nga DHPGJS. Duke u nisur nga informatat e siguruar nga IAP, *Ankuesit* më 12 shtator 2013, i është drejtuar

Gjykatës Themelore në Prizren për t' u informuar për statusin e lëndës së tij.

13. *Ankuesit* është informuar nga gjykata në fjalë se shkresat e lëndës SR-11-0315 (C. Nr. 1018/05), të cilat kanë qenë në shikim në lëndën civile C. Nr. 427/09, i janë dërguar DHPGJS më 5 shkurt 2013 (akti përcjellës me të cilin janë dërguar).
14. Më 23 shtator 2013, Avokati i Popullit ia dërgoi edhe një shkresë kryetarit të DHPGJSK, përkritazi me çështjen.
15. Më 28 tetor 2013, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetari i DHPGJS, më të cilën informon:

*“se ai njoftim është bërë në bazë të shënimeve nga zyra e regjistrimit të gjykatës, sepse ka qenë koha e pushimeve dhe shumë gjyqtarë kanë qenë në pushime kështu që në atë kohë nuk kemi pasur qasje në lëndën. Më vonë kemi gjetur se lënda është kthyer nga Gjykata Themelore në Prizren më 6 shkurt 2013 dhe i është dorëzuar gjyqtarit të rastit në punë. Gjyqtari i rastit F. SH. ka paraqitur kërkesë për përjashtim nga vendimmarrja në këtë lëndë dhe nuk shihet data e saktë kur e ka pranuar kërkesën, Kryetari i Kolegjit David Wilcox. Pastaj, nga data 1 gusht 2013, z. Wilcox është emëruar anëtar i kolegjit të Apelit, ndërsa lëndët e tij, bashkë me kërkesën e gjyqtarit F. SH, i ka marrë gjyqtari i ri ndërkombëtar. Për kërkesën, kryesuesi-gjyqtari i ri i këtij kolegji ende nuk ka vendos.”*

16. Më 6 janar 2014, *Ankuesit* është udhëzuar të bëjë urgjencë në DHPGJS, në lidhje me shqyrtimin e lëndës së tij.
17. Më 10 shkurt 2014, *Ankuesi* informoi zyrën e IAP-së, se ka paraqitur një urgjencë në DHPGJS për shqyrtimin e lëndës së tij.

18. Më 20 maj 2014, përfaqësuesja e IAP-së, është informuar nga zyra për menaxhim të lëndëve të gjykatës dhe është njoftuar se lënda ka marrë numër të ri nga numri i pranimit, C-III-12-1993.
19. Më 7 korrik 2014, përfaqësuesja e IAP-së, është informuar nga DHPGJS se për momentin në panel ka mungesë të gjyqtarëve, pasi ka pasur ndërrime të shumta të gjyqtarëve dhe se nga 15 korrik 2014, pritet të vijë një gjyqtar i ri.
20. Më 22 dhjetor 2014, përfaqësuesja e IAP-së, përmes postës elektronike ka kërkuar informata nga zyra për menaxhim të lëndëve në DHPGJS, lidhur me çështjen e *Ankuesit*.
21. Më 30 dhjetor 2014, përfaqësuesja e IAP-së, është njoftuar se lënda e *Ankuesit* është në procedurë, mirëpo ende nuk është vendosur.

### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës**

22. Parimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 thekson: *“Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të parashikuara me këtë Kushtetutë”*.
23. Vend të posaçëm në mesin e këtyre të drejtave, sipas kuptimit të nenit 31 të Kushtetutës, zë e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ku theksohet:  
*“Çdokujt i garantohet mbrojtja e njëjtë e të drejtave para gjykatës, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Çdo kush gëzon të drejtën për shqyrtim publik, të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet brenda një afri të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”*.
24. Neni 54, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, i Kushtetutës së Kosovës, përcakton:

*“Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*

**25.** Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) është dokument ndërkombëtar, i cili në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është i zbatueshëm drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Prandaj, paragrafi 1 i nenit 6 i KEDNJ-ë garanton që: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor”.*

**26.** Ndërsa neni 13 i KEDNJ-së, përcakton:

*“Çdo njëri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara më këtë Konventë, ka të drejtën për mjete ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga ana e personave që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.*

**27.** Në raste të shumta, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

**28.** Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, në nenin 7 par. 2 përcakton:

*“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”.*

**29.** Neni 7 par. 3 i po këtij ligji përcakton:

*“Çdo person ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij të ligjshme. Çdo person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtën apo interesat e tij në mënyrën e caktuar me ligj”.*

- 30.** Neni 22 par. 1.5 i këtij ligji përcakton kompetencat e Gjykatës Supreme në *“Dhomën e Posaçme, në lëndët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, siç parashihet me ligj”.*
- 31.** Ligji nr. 04/L-033 për DHPGJS, neni 1, par. 3 i këtij ligji thotë: *“DHPGJS është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës siç përcaktohet në nenin 22 të ligjit nr. 03/L -199 “mbi gjykatat”.*
- 32.** Neni 4 i këtij Ligji përcakton: *“DHPGJS ka kompetencë ekskluzive mbi të gjitha rastet dhe procedurat në çështjet e Privatizimit dhe Likuidimit nga Agjencia Kosovare të Privatizimit (AKP), pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM)”.*
- 33.** Po ashtu, neni 14, par. 4 i këtij ligji përcakton: *“Në zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, DHPGJS do të zbatojë dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore”.*
- 34.** Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, në nenin 1. Përcakton *“rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe”.*
- 35.** Ndërsa sipas nenit 10, par. 1 të po këtij ligji *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”.*



### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

- 36.** Nisur nga analiza e informatave, dëshmime dhe fakteve që posedon, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura dhe, shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike në vendosjen e lëndës së ankuesit. Në procedurën civile, koha që duhet marrë parasysh, kur vendoset për zvarritjen e procedurës, fillon të rrjedhë nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, e që në rastin konkret fillon nga data kur parashtruesi i ankesës parashtroi padi (2005) e deri në datën e nxjerrjes së këtij raporti (23 shkurt 2015).
- 37.** Nga viti 2005, kur *Ankuesi*, ka iniciuar padi për vërtetim pronësie në Gjykatën Komunale në Prizren, kanë kaluar mbi 10 vite dhe atij ende nuk i është realizuar e drejta në bazë të kërkesës së parashtruar.
- 38.** Që nga data 16 shtator 2011, kur lënda është dërguar në DHPGJS, si gjykatë kompetente për të shqyrtuar lëndët nga procesi i privatizimit, e që kanë kaluar 4 vite, *Ankuesit* nuk i është dhënë mundësia e realizimit të së drejtës së tij, në bazë të ligjit dhe akteve të zbatueshme ndërkombëtare.
- 39.** Avokati i Popullit përkujton që, e drejta precedentale e GJEDNJ ka vërtetuar që, në rastet ku përfshihet përcaktimi i të drejtës civile, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore. Për rastin në fjalë, procedura gjyqësore ishte filluar në Gjykatën Komunale në Prizren, në vitin 2005, ndërsa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme më 16 shtator 2011, dhe vazhdon ende në vitin 2015.
- 40.** Po ashtu, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 par. 1 i KEDNJ, nuk parashkruan ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës.

41. Mirëpo, Avokati i Popullit rithekson se në rastin në fjalë, periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej vitit 2005, data kur *Ankuesi* paraqiti padinë në gjykatën komunale në Prizren, dhe 16 shtatori 2011, data kur lënda dërgohet në DHPGJS. Pasi ende nuk është marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin dhe se lënda është ende në fazën e parë të shqyrtimit, data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim, konsiderohet data e publikimit të këtij raporti. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se procedurat kanë zgjatur mbi 10 (dhjetë) vite.
42. Mosprocedimi i rastit të *Ankuesit* do të krijonte një situatë të përgjithshme të pasigurisë juridike, do të zvogëlonte dhe humbiste besimin e qytetarëve në drejtësi dhe në shtetin ligjor. Një situatë e tillë dhe veprime të tilla e detyrojnë qytetarin e pambrojtur nga shteti, të sillet në një rreth të humbur, pa gjetur zgjidhje për të vënë në vend të drejtën e tij të shkelur.
43. Në të vërtetë, mungesës se mjetit efektiv juridik, në kuptim të shkeljes së të drejtës së tij për shqyrtim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm kohor, që garantohet me nenin 6 të KEDNJ, përbën shkelje edhe të drejtës së tij për mjet efektiv juridik në bazë të nenit 13 të KEDNJ.
44. Neni 13 i KEDNJ, duke theksuar në mënyrë të veçantë obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojtë të drejtat e njeriut, përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo të gëzojë këto të drejta, në mënyrë efektive. Kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ-së. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Meqenëse rasti i ankuesit, ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës në shqyrtimin e rastit të tij, neni 13 i KEDNJ është i zbatueshëm.

45. Mosprocedimi i rastit gjyqësor të z. M. brenda afateve ligjore, ka cenuar të drejtat dhe liritë e njeriut, si një e drejtë kushtetuese që garantohet me nenin, 24 par. 1, si dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe se organet kompetente, duhet t'i përmbahen zbatimit të dispozitave ligjore, sa i përket afateve, që të dëmtuarit të kenë mundësinë e mbrojtjes së të drejtave gjyqësore.
46. Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk i është vënë në dispozicion *Ankuesit*, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës, në shqyrtimin e lëndës me parashikimin apo shpresën për të arritur çfarëdo lehtësimi, në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar nga gjykata.
47. Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, *“ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”* dhe me nenin 15 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L-195 datë 27 gusht 2010, për Avokatin e Popullit, sipas të cilit *“Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.”*, bazuar në atë që u tha më lart,

## **REKOMANDON**

### **Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**

- 1. Të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin dhe vendosjen meritorë, pa vonesë të mëtutjeshme, të lëndës gjyqësore të z. A. M. (lënda SR-11-0315/C-III-12-1993).*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë DHPGJS, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se më **23 mars 2015**.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Prishtinë, më 12 mars 2015

**RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa nr: 48/2012**

**Xh. K.**

**Ankesa.nr:176/2012**

**M. B.**

**Ankesa.nr:125/2013**

**A. M.**

**Ankesa nr: 36/2015**

**H. B.**

**Ankesa nr:49/2015**

**M. Sh.**

**kundër**

**Agjencisë Kosovare të Pronës**

Për: Znj. Florije Kika  
U.d. zëvendësdrejtoreshë ekzekutive e Agjencisë  
Kosovare të Pronës

Kopje: Z. Isa Mustafa  
Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Lënda: Rekomandime lidhur me ankesat për moszbatimin e  
vendimeve përfundimtare të Komisionit për Çështje  
Pronësore Banesore të Drejtorisë për Çështje Pronësore  
Banesore, në Komunën e Mitrovicës së veriut

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 1.2

## Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së institucioneve të Republikës së Kosovës, lidhur me moszbatimin e vendimeve përfundimtare të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (më tutje: *Komisioni*) në Komunën e Mitrovicës së veriut. Vendimet e komisionit kanë të bëjnë me rikthimin e posedimit të pronave personave të zhvendosur, si pasojë e luftës gjatë viteve 1998-1999, mbi të cilat ata kanë ndonjë të drejtë pronësore.

## Kompetenca e Avokatit të Popullit

2. Bazuar në nenin 16, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195 Avokati i Popullit është i autorizuar “*Të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.*”

## Përshkrimi i rastit

3. Ky raport është bazuar në një numër ankesash individuale të parashtruara nga z. A. M., z. Xh. K., z. M. B., z. H. B., z. M. Sh. (më tutje: *ankuesit*) dhe mbështetet në dëshmitë e *ankuesve*, si dhe shkresat e lëndës, të cilat i posedon Avokati i Popullit, lidhur me moszbatimin e vendimeve të *Komisionit*.
4. *Ankuesve*, me vendimet individuale të *Komisionit*, u është njohur e drejta, si bartës të të drejtave pronësore<sup>22</sup> mbi pronat të cilat ndodhen në pjesën veriore të Mitrovicës.

---

<sup>22</sup> Komisioni ka bërë *restitutio in integrum*, që do të thotë se e ka njohur atë të drejtë mbi pronën e cila ka ekzistuar para vitit 1999.

5. Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore (më tutje: *Drejtoria*) dhe Agjencia Kosovare e Pronave (më tutje: *Agjencia*), si trashëgimtare e një pjese të përgjegjësive të drejtorisë, kanë pranuar kërkesat e *ankuesve* për administrim të pronave<sup>23</sup> dhe përfshirjen e tyre në skemën e qirasë. Mirëpo, pagesa e qirasë në shumicën e rasteve nuk është realizuar apo është realizuar pjesërisht, për shkak se aktualisht pronat shfrytëzohen në mënyrë të kundërligjshme nga persona të paautorizuar ose persona të cilët janë vendosur nëpër prona nëpërmes administrimit të *agjencisë*, por refuzojnë të paguajnë qiranë.

### **Përmbledhja e fakteve**

6. Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmbliidhen si në vijim:

#### ***Rasti i z. Xh. K.***

7. Më 12 dhjetor 2003, *komisioni* me vendimin HPCC/D/99/2003/C, ka vendosur që z. Xh. K. t'i kthehet e drejta e posedimit të pronës së kërkuar.
8. Më 30 shtator 2004, pas plotfuqishmërisë së vendimit të *komisionit*, z. K. ka kërkuar administrimin e pronës nga *drejtoria*, e cila e ka dhënë pëlqimin për inkuadrimin e pronës në skemën e qirasë.
9. Më 19 janar 2012, z. K. ka paraqitur ankesë në IAP kundër *agjencisë*, për mospagesën e qirasë për pronën nën administrim të saj.
10. Më 20 shkurt 2012, Avokati i Popullit ka dërguar një letër zëvendës drejtorit të *agjencisë*, z. Xhevat Azemit dhe ka kërkuar

---

<sup>23</sup> Shih pikën 44 të këtij Raporti.

informata lidhur me veprimet që janë ndërmarrë ose me ato që planifikohen të ndërmerren nga *agjencia*, lidhur me çështjen e mospagesës së qirasë.

11. Më 22 shkurt 2012, z. Xhevat Azemi në përgjigjen e tij ka informuar Avokatin e Popullit se paketa e qirasë është dorëzuar në pronë më 18 prill 2007 dhe se qiraja e parë i është paguar *agjencisë* në nëntor të vitit 2009. Z. Azemi, më tutje ka theksuar se marrëveshja e dytë e qirasë është nënshkruar në gusht të vitit 2010 deri në korrik të vitit 2011 dhe së marrëveshja e fundit është nënshkruar në shkurt të vitit 2012 dhe se *agjencia* është në proces të transferimit të qirasë.
12. Më 6 mars 2014, IAP e ka kontaktuar z. Xh. K. për ta pyetur nëse ka marrë shumën e qirasë, sipas kontratave të cilat i ka nënshkruar *agjencia*. Z. Kalludra ka mohuar të këtë marrë ndonjë shumë nga *agjencia* në emër të qirasë.
13. Më 20 janar 2015, IAP ka kontaktuar me z. Xh. K., për të mësuar nëse ka ndonjë zhvillim lidhur me rastin. Z. Xh. K. ka informuar IAP-në se nuk ka asnjë zhvillim pozitiv, lidhur me pronën e kërkuar. Ai, për më shumë, ka pohuar se është duke provuar që të bie në kontakt me udhëheqësen e zyrës rajonale të *agjencisë* në Mitrovicë, por pa sukses.

**Rasti z. M. B.**

14. Më 12 dhjetor 2003, *Komisioni* me vendimin HPCC/D/99/2003/C, ka vendosur që z. M. B. t'i kthehet e drejta e posedimit të pronës së kërkuar.
15. Më 5 mars 2007, z. M. B. ka kërkuar administrimin e pronës nga *drejtoria*, e cila e ka dhënë pëlqimin për inkuadrimin e pronës në skemën e qirasë.
16. Më 2 prill 2012, z. M.B. ka paraqitur ankesë në IAP-së kundër *agjencisë*. Ai ka pohuar se *agjencia* nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për dëbimin e shfrytëzuesit të paautorizuar nga prona e tij



- dhe për zbatimin e skemës së qirasë, edhe pse prona është e përfshirë nën administrimin e *agjencisë*. Z. M. B., më tutje ka pohuar se për më shumë se 13 vite ai nuk ka qasje në pronën e tij.
17. Më 15 maj 2012, zyrtari përgjegjës i IAP-së i ka dërguar një letër zëvendës drejtorit të *agjencisë* z. Xhevat Azemit dhe ka kërkuar informata lidhur me veprimet që janë ndërmarrë ose me ato që planifikohen të ndërmerren nga *agjencia*, lidhur me çështjen e mospagesës së qirasë.
18. Më 15 maj 2012, z. Xhevat Azemi në përgjigjen e tij ka informuar zyrtarin përgjegjës të IAP-së se prona e z. M.B. është e përfshirë në skemën e qirasë, por që për shkak të gjendjes e cila ekziston në pjesën veriore të Mitrovicës, *agjencia* nuk ka mundur të zbatojë skemën e qirasë dhe as që të rikthejë posedimin e pronës së z. M. B.
19. Më 17 prill 2013, zyrtari përgjegjës i IAP-së është takuar me zëvendës shefin e zyrës së *agjencisë* në Mitrovicë z. Bedri Voca. Ai ka njoftuar se pagesa e qirasë nuk mund të realizohet, me gjithë tentimet e *agjencisë*. Ai ka pohuar se policia e veriut të Mitrovicës e ka informuar *agjencinë* se nuk mund të ofrojë siguri për zyrtarët e *agjencisë*, për shkak të rrezikshmërisë që ekziston atje.
20. Më 20 janar 2015, IAP ka kontaktuar me z. M. B., për të mësuar nëse ka ndonjë zhvillim, lidhur me rastin. Z. M. B. ka informuar IAP-në se nuk ka asnjë zhvillim pozitiv, lidhur me pronën e kërkuar. Ai për më shumë ka pohuar se për 15 vite e ka marrë qiranë vetëm për një muaj.

***Rasti i z. A. M.***

21. Më 17 tetor 2003, *komisioni* me vendimin HPCC/D/93/2003/C, ka vendosur që z. A. M. t'i kthehet e drejta e posedimit të pronës së kërkuar.

22. Më 4 qershor 2007, pas pëlqimit të z. A. M., *agjencia* e ka përfshirë pronën në skemën e qirasë.
23. Z. A. M. i është drejtuar *agjencisë* disa herë me kërkesë për zbatimin e qirasë ose dëbimin e shfrytëzuesit të paautorizuar dhe ka kërkuar informata lidhur me pronën e tij. Së fundi, z. A. M. i është drejtuar *agjencisë*, më 13 janar 2014, me ç'rast *agjencia* i është përgjigjur se asnjë pagesë për qira nuk është marrë nga *agjencia*, por që përpjekjet e *agjencisë* kanë qenë të vazhdueshme dhe se rasti i tij nuk është neglizhuar për mosveprim të *agjencisë*, por për shkak të mungesës së përkrahjes nga autoritetet e rendit.
24. Më 31 janar 2013, z. A. M. ka paraqitur ankesë në IAP-së kundër *agjencisë*. Ai ka pohuar se *agjencia* nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ndaj shfrytëzuesit të paautorizuar të pronës së tij që ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicës.
25. Më 17 prill 2013, zyrtari përgjegjës i IAP-së është takuar me zëvendësshefin e zyrës së *agjencisë* në Mitrovicë z. Bedri Voca. Ai ka njoftuar se pagesa e qirasë nuk mund të realizohet, me gjithë tentimet e *agjencisë*. Ai ka pohuar se policia e veriut të Mitrovicës e ka informuar *agjencinë* se nuk mund të ofrojë siguri për zyrtarët e *agjencisë*, për shkak të rrezikshmërisë që ekziston atje.
26. Më 20 janar 2015, IAP ka kontaktuar me z. A. M. për të mësuar nëse ka ndonjë zhvillim lidhur me rastin. Z. A. M. ka informuar IAP-në se shfrytëzuesi i deritanishëm i paautorizuar e ka lëshuar pronën dhe i ka marrë me vete të gjitha pajisjet shtëpiake. Për më shumë z. A. M. ka njoftuar se aktualisht një familje tjetër është vendosur në banesë nëpërmes skemës së administrimit të *agjencisë*, por akoma nuk ka marrë ndonjë shumë në emër të qirasë.

**Rasti i z. H. B..**

27. Më 20 gusht 2005, *komisioni* me vendimin HPCC/D/209/2005/A&C, ka vendosur që z. H. B. t'i kthehet e drejta pronësore mbi pronën e kërkuar.
28. Pas plotfuqishmërisë së vendimit të *komisionit*, z. B. ka kërkuar administrimin e pronës nga *drejtoria* dhe ka lënë pëlqimin për inkuadrimin në skemën e qirasë dhe prona është përfshirë nën administrimin e *agjencisë*.
29. Më 26 janar 2015, z. B. ka paraqitur ankesë në IAP kundër *agjencisë*. Ai ka pohuar se *agjencia* nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ndaj shfrytëzuesit të paautorizuar të pronës së tij, që ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicës.
30. Sipas përgjigjes që IAP ka marrë nga *agjencia*, më 2 shkurt 2015, paketa e qirasë është dorëzuar në pronë më 10 nëntor 2009 dhe se deri më tani *agjencia* nuk ka marrë qira, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme. Për më shumë *agjencia* ka theksuar edhe njëherë mospërkrahjen e autoriteteve të rendit për pronat të cilat gjenden në pjesën veriore të Mitrovicës.

***Rasti i z. M. Sh.***

31. Më 2 shkurt 2015, z. M. Sh. ka paraqitur ankesë në IAP kundër *Agjencisë*. Ai ka pohuar se *agjencia* nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ndaj shfrytëzuesit të paautorizuar, me gjithë kërkesat e vazhdueshme nga ana e ankuesit në drejtim të *agjencisë*.
32. Më 18 shkurt 2015, IAP i është drejtuar *agjencisë* për të kërkuar informata lidhur me ankesën, ndërsa *agjencia* ka kthyer përgjigje më 26 shkurt 2015, ku ka pohuar se prona është përfshirë nën administrim të *agjencisë*. Më tutje, *agjencia* ka pohuar se ka nënshkruar tri marrëveshje të qirasë për pronën në fjalë, të cilat janë realizuar pjesërisht. *Agjencia* për më shumë ka pohuar se përpjekjet e saj kanë qenë të vazhdueshme sa i përket realizimit të qirasë së pronës dhe kanë siguruar se ky rast nuk është neglizhuar për mosveprim të *agjencisë*, por për arsye për të cilat IAP është

informuar dhe që ka të bëjë me mungesën e përkrahjes së autoriteteve të rendit për pronat që gjenden në pjesën veriore të Mitrovicës.

### ***Komunikimi me Agjencinë dhe përmbledhja e fakteve***

**33.** Nga përmbledhja e fakteve shihet se IAP ka komunikuar me *agjencinë* lidhur me secilën ankesë veçmas. Gjithashtu, IAP ka pasur një komunikim me zyrtarët e *agjencisë*<sup>24</sup> për të siguruar informata, lidhur me numrin e përgjithshëm të rasteve që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të komisionit në pjesën veriore të Mitrovicës, me ç’ rast është mësuar se *agjencia* ka nën administrim gjithsej 390 prona, ndërsa janë ekzekutuar rreth 27 dëbime. Me këtë rast, IAP është njoftuar se *agjencia* ka për obligim implementimin e vendimeve të *komisionit*. *Agjencia*, gjatë zbatimit të vendimeve të *komisionit*, me kërkesë të paraqitësve të suksesshëm të kërkesave, mund të vë pronat nën administrim, e po ashtu mund të bëjë edhe lirimin e pronave. Në pjesën veriore të Mitrovicës procedura e administrimit të pronave apo lirimit të tyre zgjatë më shumë sesa në pjesët e tjera të Kosovës, pasi në këtë pjesë *agjencia* nuk e ka pasur mbështetjen e organeve të rendit në zbatimin e vendimeve për një kohë të gjatë. Mirëpo, sipas *agjencisë*, në muajin mars të vitit 2014, autoritetet e rendit kanë filluar të mbështesin *agjencinë*, por sipas informatave të fundit që IAP i ka siguruar nga *agjencia*, në fillim të vitit 2015, përsëri është theksuar mospërkrahja e organeve të rendit në zbatimin e vendimeve të *komisionit*.

### **Baza ligjore**

**34.** Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtat dhe liritë themelore.

---

<sup>24</sup> Komunikimi elektronik me znj. Elhame Gorani, nëpërmes znj Florije Kika, u.d. drejtoreshë ekzekutive e AKP-së, më 24, 25 dhe 26 nëntor 2014.

**35.** Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se:

*“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare [...] garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”.* Në mesin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare përfshihet edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

**36.** Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se:

*“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”* (GJEDNJ).

### ***Mbrojtja e pronës***

**37.** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 46, paragrafi 1 përcakton se *“E drejta e pronës është e garantuar.”*

**38.** Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së përcakton se:

*“Çdo person fizik apo juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.”*

### ***E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm/E drejta për një proces të rregullt***

**39.** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 31, paragrafi 1 përcakton se *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*

**40.** Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së përcakton se *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e*

*paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”*

***E drejta e privatësisë/E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare***

41. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 36, paragrafi 1 përcakton se “Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës [...]”.
42. Neni 8 i KEDNJ përcakton se “Çdokush ka të drejtë që t’i respektohet jeta private e familjare, vendbanimi [...]”.

***Ligji për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale 2008/03-L-079***

43. Neni 17 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale 2008/03-L-079 përcakton se:

*“Agjencia Kosovare e Pronës i ushtron kompetencat e ekzekutimit lidhur me çdo vendim apo urdhër për dëbim të Komisionit të Kërkesave për Çështje Banesore Pronësore që mund të ekzekutohen në ditën e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr.2006/10<sup>25</sup>, por që nuk janë ekzekutuar nga Drejtoria për Çështje Banesore e Pronësore. Në ushtrimin e kompetencave të tilla ekzekutive, Agjencia Kosovare e Pronës ka të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe kompetencat që i ka pasur Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr.2006/10.”*

---

<sup>25</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 përcakton themelimin dhe mandatin e Agjencisë Kosovare të Pronës.

44. Neni 15 i po kësaj Rregulloreje të UNMIK-ut, përcakton se:

*“Mjetet juridike për ekzekutimin e vendimit mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në dëbim, vendosjen e pasurisë nën administrim, marrëveshjen për qiradhënie, konfiskim dhe shkatërrimin e strukturave të paligjshme dhe ankandin.”*

45. Agjencia ka iniciuar skemën e qiradhënies për pronat nën administrimin e saj. Kjo skemë e bën të mundshme për bartësit e së drejtës pronësore të pranojnë të ardhura fikse nga prona e tyre, duke autorizuar *agjencinë* të lëshojë ato me qira, derisa ai/ajo vendosë të shfrytëzojë pronën në ndonjë mënyrë tjetër.<sup>26</sup> Rregullat dhe përgjegjësit për vendosjen e pronës nën administrim përcaktohen me nenin 23 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/05 mbi Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, të datës 1 qershor 2007.

## **Analiza ligjore**

### ***Lidhur me shkëljen e së drejtës për mbrojtje të pronës***

46. Avokati i Popullit që në fillim vëren se *ankuesve de jure* u është njohur e drejta e riposedimit nga komisioni me vendimet përfundimtare të cilat *“janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.”*<sup>27</sup>

47. Aktualisht, pronat mbi të cilat *ankuesit* kanë të drejtën pronësore apo banesore, janë nën administrim të *agjencisë* dhe janë të

---

<sup>26</sup> <http://www.kpaonline.org/sq/rental.asp>

<sup>27</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 për Themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, neni 2.7

- përfshira në skemën e qirasë me kërkesë dhe me pajtim të *ankuesve*. Kjo do të mund të interpretohej si një posedim i tërthortë që *ankuesit* do të mund ta kishin sikur pagesa e qirasë nga shfrytëzuesit aktualë të këtyre pronave të realizohej në mënyrë të rregullt. Avokati i Popullit vlerëson se skema e qirasë, e themeluar në pajtim me ligjin nga ana e *agjencisë*, paraqet një masë të përkohshme dhe në baza vullnetare të administrimit të pronave nga *agjencia*, për shkak të pamundësisë së bartësve të së drejtës pronësore që të rikthejnë posedimin mbi pronat, të cilat i kanë humbur si rezultat i luftës së viteve 1998 dhe 1999.
48. Avokati i Popullit më tutje vlerëson se kjo do të mund të interpretohej si një formë balanci në mes të interesave individuale (të drejtës pronësore të individëve, në këtë rast) dhe interesit të përgjithshëm (sigurisë së personave të zhvendosur, në rastet kur ata për arsye sigurie nuk mund të kthehen në pronat e tyre). Por, duke u bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, Avokati i Popullit konstaton se ky balanc nuk është arritur, për faktin se shtyrja e zbatimit të vendimeve të plotfuqishme të *komisionit* paraqet një barrë shtesë për *ankuesit*, duke marrë parasysh se ata prej vitit 1999 janë dëbuar nga pronat e tyre dhe ndodhen në një gjendje pasigurie për mundësinë e rikthimit të posedimit. Për më shumë, ata nuk kanë mundësi të marrin ndonjë kompensim për humbjet që rezultojnë nga pamundësia e tyre për rikthimin e posedimit mbi pronat (shih, *Aktgykimin Imobiliare Saffi kundër Italisë nr. 22774/93, i datës 28 korrik 1999, paragrafët 49-59, GJEDNJ*).
49. Avokati i Popullit konsideron se pengimi i posedimit të qetë, qoftë ai posedim i drejtpërdrejtë, me rikthim të posedimit faktik apo i tërthortë, me realizimin e qirasë, për një kohë kaq të gjatë, paraqet shkelje të Protokollit 1, neni 1 të KEDNJ-së. Avokati i Popullit, vëren se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (GJK) ka nxjerrë *Aktgykimin në Rastin Nr. K1187/13, i datës 1 prill 2014*, për një situatë të ngjashme, respektivisht moszbatimit



të vendimit të formës së prerë të vendimeve të komisionit. GJK në paragrafin 81 të aktgjykimit konstaton si në vijim:

“...Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës, nga zvarritja dhe mospërmbarimi i Vendimit KPCC/D/A/114/2011 është privuar pa të drejtë nga prona e saj. Në këtë mënyrë, e drejta e parashtrueses për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e saj, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së gjithashtu është shkelur”.

***Lidhur me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm/Së drejtës për një proces të rregullt***

**50.** Është i pamohueshëm fakti që e drejta në riposëdim të pronave e ankuesve është vërtetuar nga komisioni, me vendime përfundimtare. Sikur se është cekur në nenin 44 të këtij raporti, njëri ndër mjetet juridike për zbatimin e vendimit përfundimtar është vënia e pronës nën administrim të agjencisë, përkatësisht përfshirja e pronës në skemën e qirasë. Fakti se pronat, në pjesën veriore të Mitrovicës, janë në shfrytëzim të personave të paautorizuar apo personave që refuzojnë të paguajnë qiranë dhe pamundësia e agjencisë për të dëbuar ata pamundëson që vendimet e komisionit të kenë efekt juridik. Zbatimi i vendimeve duhet të jetë pjesë përbërëse e procedurës së gjyqimit (shih, Aktgjykimin në rastin *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, i datës 19 mars 1999, paragrafi 40), gjithashtu zbatimi i vendimeve garanton sundimin e ligjit.

Prandaj, Avokati i Popullit duke u bazuar në praktikën e GJEDNJ-së konstaton se ka shkelje të nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ-së. Edhe më këtë rast, Avokati i Popullit vëren se aktgjykimi i lartpërmendur i GJK (Aktgjykimi në Rastin Nr. K1187/13, i datës 1 prill 2014), konstaton si në vijim:

(79) “[...] mospërmbarimi i vendimit të KKPK nga AKP-ja dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për

*të siguruar mekanizma efikas në kuptim të përmbarimit të vendimeve të formës së prerë është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.”*

(80) “[...] Gjykata konkludon se mospërmbarimi i Vendimit të formës së prerë, KPCC/D/A114/2011, përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenit 54 të Kushtetutës.”

### ***Lidhur me të drejtën e privatësisë/Të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare***

**51.** *Drejtoria* e themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 e datës 15 nëntor 1999, ka pranuar vetëm kërkesa që kishin të bënin me pronën banesore, përkatësisht banesa dhe shtëpi, ndërsa më vonë mandati i *agjencisë* është zgjeruar edhe për kërkesat që kanë të bëjnë me pronën bujqësore dhe komerciale. Fakti se *komisioni* ua ka njohur *ankuesve* të drejtën e posedimit mbi pronat e kërkuara, dëshmon se ato prona janë prona të banueshme, ku *ankuesit* dhe familjet e tyre kanë jetuar dhe kanë pasur vendbanimin, respektivisht banesat, deri në vitin 1999. Prona e kërkuar për *ankuesit* paraqet banesë, jo vetëm në kuptimin e banesës si strukturë ndërtimore apo si pronë, por banesë në kuptim të vendbanimit. E drejta në banesë, tërheq mbrojtjen e nenit 8, paragrafit 1 të KEDNJ-së. Koncepti banesë ka të bëjë me një “vend, hapësirë fizikisht të definuar, ku zhvillohet jeta private dhe familjare” (shih Rastin Moreno Gomez kundër Spanjës, nr. 4143/02, paragrafi 53). E drejta në banesë është një koncept autonom i cili ka të bëjë me jetën private të individit. *Pacenueshmëria e banesës, është e lidhur ngushtë me*

*pacenueshmërinë e individit, lirinë dhe sigurinë e njeriut.*<sup>28</sup> Pas dëbimit të *ankuesve* nga banesat e tyre dhe për shkak të pamundësisë për t'u kthyer, ata janë strehuar tek familjarët ose në banesa me qira në pjesën jugore të Mitrovicës apo qytetet e tjera të Kosovës. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konsideron se ka shkelje së pacenueshmërisë së banesës, përkatësisht të së drejtës në banesë (shih Rastin *Gillow kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9063/80, paragrafi 58).

## KONKLUZION

1. Avokati Popullit është në dijeni se *agjencia* tanimë është në përfundim të mandatit dhe se është në pritje të miratimit të ligjit, i cili do t'i japë asaj një mandat të ri, me të cilin besohet se obligimet e trashëguara nga *drejtoria* do të barten në *agjencinë*, e cila pritet të krijohet me ligjin e ri. Kjo pasqyron një dështim, jo vetëm të *agjencisë* në zbatimin e vendimeve të *komisionit*, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, por edhe dështim të autoriteteve shtetërore në krijim e kushteve për zbatimin e vendimeve të plotfuqishme dhe sundimin e ligjit në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Avokati i Popullit, ua rikujton autoriteteve të Republikës së Kosovës dispozitat themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovë, si në vijim:

### *Neni 3 [Barazia para Ligjit]*

*“Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe*

---

<sup>28</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi 1, Prof. Dr. Enver Hasani/Prof. Dr. Ivan Cukalovic, f.23, paragrafi 3.

*në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre” dhe*

*Neni 7 [Vlerat]*

*“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës...”*

3. Avokati i Popullit, bazuar në informatat, dëshmitë, faktet dhe në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”*. Sipas kuptimit të nenit 16, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit *“(..) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...)”*.

Prandaj, Avokati i Popullit Rekomandon që:

1. *Agjencia Kosovare e Pronës të zbatojë vendimet e plotfuqishme të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore.*
2. *Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Policia e Kosovës, t’i ofrojë mbështetje Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të ndër marrë të gjitha masat, për krijimin e kushteve për rikthimin e posedimit për personat e zhvendosur, si e vetmja zgjidhje ligjore dhe e qëndrueshme.*
3. *Qeveria e Republikës së Kosovës të krijojë një fond për kompensim në emër të qirasë për pronat banesore të personave të zhvendosur, të cilat janë nën administrim të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe për të cilat dëshmohet se*

*janë shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar, ku agjencia nuk ka mundur të zbatojë skemën e qirasë.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerren, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më **10 prill 2015**.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Prishtinë, më 6 maj 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa nr.435/2013**

**N. J.**

**kundër**

**Agjencisë Kosovare të Pronës**

Për: Z. Marian Nieora, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë  
Kosovare të Pronës  
Rr. “Perandori Justinian”, nr. 5  
10000 Prishtinë

Lënda: Rekomandim në lidhje me ankesën për mosekzekutimin  
e vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI 187/13, të datës  
16 prill 2014

Baza ligjore: Kushtetuta e Kosovës, neni 135, paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 1.2

## **Qëllimi i raportit**

1. Qëllimi i këtij raporti është të tërheq vëmendjen e Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme AKP), për mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI187/13, të datës 16 prill 2014.

## **Kompetenca e Avokatit të Popullit**

2. Në bazë të nenit 16, paragrafit 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-95, Avokati i Popullit është i autorizuar që:

*“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;”*

## **Përshkrimi i rastit**

3. Ky raport është i bazuar në një ankesë, të cilën e ka paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) znj. N. J.. Ankesa është parashtruar në lidhje me punën e sekretariatit të AKP-së, në procedurën e ekzekutimit të vendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Supreme të Kosovës GSK-KPA-A-001/12, të datës 8 maj 2012, si dhe procedurën e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI 187/13, të datës 16 prill 2014.

## **Përmbledhja e fakteve**

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i disponon IAP mund të përmbliidhen si më poshtë:

4. Më 22 qershor 2011, me vendimin e Komisionit për kërkesa pronësore të Kosovës KPCC/D/A/114/2011, është konstatuar se znj. N. J. është pronare e ligjshme e pronës, e cila gjendet në lagjen Sofali të Prishtinës, nr. i parcelës 748/1. Vendimi i lëndës është konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës GSK-KPA-A-001/12, të datës 8 maj 2012 dhe me të njëjtin

- aktgjykim është konfirmuar se një person tjetër po e shfrytëzon në mënyrë të paligjshme pronën, e cila është objekt i lëndës.
5. Më 14 nëntor 2012, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, znj. N. J., i ka dorëzuar organit kompetent një kërkesë për kthimin e pronës në posedim të saj. Duke pasur parasysh se parashtruesja e ankesës, pas kalimit të më shumë se gjashtë muajve nga paraqitja e kërkesës, nuk ka marrë kurrfarë njoftimi, e njëjta më 5 qershor 2013, dërgoi një shkresë urgjente me qëllim të dorëzimit të informacionit mbi statusin e lëndës.
  6. Më 4 korrik 2013, përmes Zyrës së AKP në Beograd, znj. Jovanović mori një letër, me të cilën u informua se pas zbatimit të procedurës standarde, përkatësisht, pas procedurës së shqyrtimit të pasurisë nga ana e zyrtarit të agjencisë, më 16 janar 2013, është konstatuar se prona, që është objekt shqyrtimi i kësaj lënde, po shfrytëzohet nga një person i pandërgjegjshëm dhe se i njëjti ka ndërtuar objekte të reja mbi parcelë. Më tutje thuhet se në afatin e dhënë prej 30 ditësh nga data kur i është dorëzuar aktgjykimi, personi në fjalë nuk është larguar vullnetarisht nga prona dhe se AKP aktualisht nuk është në gjendje të rrënojë objektet e ndërtuara në mënyrë të paligjshme. Gjithashtu, AKP ka vënë në dukje mundësinë e ndërmjetësimit për një zgjidhje paqësore të shfrytëzimit të pronës së ankueses.
  7. Më 2 gusht 2013 znj. N. J.e ka paraqitur në IAP një ankesë kundër AKP-së që ka të bëjë me punën e sekretariatit të AKP në procedurën e ekzekutimit të vendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Supreme të Kosovës GSK-KPA-A-001/12, të datës 8 maj 2012.
  8. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-95, ka zhvilluar hetime në lidhje me ankesën e znj. N. J. për procedurën e ekzekutimit të aktgjykimit të plotfuqishëm dhe përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe pohimeve të ankueses për trajtim të pabarabartë dhe shkelje të parimit të barazisë para ligjit dhe mosrespektimit të Ligjit



nr.03/L-079 për ndryshime dhe plotësime të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën private, në lidhje me veprimet e ndërmarra në procesin e ekzekutimit të vendimeve.

- 9.** Avokati i Popullit në bazë të gjendjes së ekzistuese faktike, ka ndërmarrë veprime të caktuara, në mënyrë që të zgjidhet lënda e ankueses. Në të vërtet, Avokati i Popullit i është drejtuar AKP-së, me ç'rast ia ka paraqitur rastin e ankueses dhe i ka kërkuar informacione në lidhje me veprimet e ndërmarra në rastin në fjalë. Pala përgjegjëse i është përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit dhe e ka informuar, që ankuesja është informuar nga zyrtari i agjencisë për ndërmjetësim, si mjet juridik, me qëllim që kontesti të zgjidhet me pasoja sa më pak të dëmshme për të dyja palët, propozim të cilin ankuesja përsëri e ka refuzuar. Gjithashtu, është theksuar se ekzekutimi i një vendimi për rrënimin e ndërtimeve të paligjshme, nga ana e AKP-së nuk është i mundur për shkak të mungesës së mjeteve financiare. AKP ka parashtruar kërkesë për financim për punësim dhe furnizim me pajisjet e domosdoshme teknike për zbatimin e këtij mjeti juridik, në propozimin e buxhetit dhe në qoftë se ato miratohen do të fillohet me zbatimin e këtij mjeti juridik për zbatimin e vendimeve.
- 10.** Më 29 tetor 2013, për shkak të mos përmbarimit të vendimit të Gjykatës Supreme nga ana e AKP-së, znj. N. J. ka iniciuar procedurë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për ta vlerësuar kushtetutshmërinë e moszbatimit të vendimit të Panelit të Ankesave të DHPGJS-së, GSK-AKP-A-001/12, të datës 8 maj 2012 dhe vendimit KKPK nr. KPCC/D/a/114/2011, të datës 22 qershor 2011, në lidhje me kërkesën nr.16008, të cilën ankuesja e ka parashtruar në AKP, më 23 gusht 2005.
- 11.** Më 16 prill 2014 Gjykata Kushtetuese, nxori aktgjykimin nr. ref. AGJ565/14, me të cilin vendosi që kërkesën ta shpallë të pranueshme. Gjykata, me këtë aktgjykim, urdhëron AKP-në ta

përmbushë angazhimin e vet në ekzekutimin e vendimit të Komisionit për Kërkesat Pronësore në Kosovës (KKPK) nr. KPCC/D/A/114/2011, të datës 22 qershor 2011. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullës 63(4) të Rregullores së Punës, e cila parasheh që Gjykata Kushtetuese në vendimin e vet mund të specifikojë mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

12. Pas skadimit të afatit të cituar më parë, për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me kërkesë të Avokatit të Popullit të dërguar më 27 gusht 2014, pala përgjegjëse ka dërguar një përgjigje, në të cilën theksohet që nuk janë ndërmarrë masa konkrete që në afat të arsyeshëm përmes marrëveshjes së ndërmjetësimit të arrihet një marrëveshje e pranueshme, që nënkupton kompensimin monetar për vlerën reale të pronës. Mirëpo, në letër, gjithashtu thuhet se ekzekutimi i vendimit përmes rrënimit të ndërtimeve të paligjshme, nga ana e AKP nuk është i mundur, për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

### **Instrumentet ligjore**

13. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 24, që ka të bëjë me barazinë para ligjit përcakton:
  1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
  2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”*
14. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 31 përcakton se:

*“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*

**15.** Po ashtu, neni 46 i Kushtetutës, në lidhje me mbrojtjen e pronës përcakton se:

*1. E drejta e pronës është e garantuar.*

*2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*

*3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona (...).”*

**16.** Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme KEDNJ) është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse neni 22.2 i Kushtetutës e garanton të drejtën e zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës dhe Protokolleve të saj, e cila me Kushtetutën e Republikës së Kosovës u garantohet të gjithë qytetarëve të saj.

**17.** Me nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ, theksohet:

*“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.”*

**18.** Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50(e miratuar me Ligjin Nr.03/L-079), në nenin 16.4 është përcaktuar që: *“Gjatë zbatimit të urdhrimit për dëbim, çdo person që nuk u përmbahet udhëzimeve të nëpunësit përgjegjës për t’u larguar nga prona mund të largohet nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit.”*

**19.** Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI 187/13, i datës 16 prill 2014, në pikën VI:

*“Obligon AKP ta përmbarojë vendimin e KKKP nr. KPCC/D/A/114/2011, të datës 22 qershor 2011. Gjithashtu, në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës së gjykatës, AKP është e obliguar që në afat prej tre (3) muajsh ta informojë Gjykatën Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të kësaj gjykate.”*

### **Analiza ligjore**

- 20.** Pas shqyrtimit të këtij rasti, rezulton se AKP nuk ka vepruar sipas procedurës së caktuar ligjore, para se gjithash në procedurën e ekzekutimit të aktgjykimit të plotfuqishëm dhe përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-AKP-A-001/12, të datës 8 maj 2012, në lidhje me vendimin e KKKP nr. KPCC/D/A/114/2011, të datës 22 qershor 2011. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, AKP është kompetente të ndërmarrë veprime me rastin e zbatimit të vendimit të gjykatës. Gjithashtu, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI 187/13, në pikën VI obligon AKP ta përmbarojë vendimin e KKKP nr. KPCC/D/A/114/2011.
- 21.** Avokati i Popullit thekson se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e pronës personale dhe të pronës në përgjithësi, si dhe mbrojtja e kësaj të drejte në bazë të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zbatimi i drejtpërdrejtë i së cilës është i garantuar me Kushtetutë, si akti më i lartë juridik i një shteti, duhet të respektohet. Megjithatë, ekzistenca e kësaj të drejte, në qoftë se nuk mbrohet edhe në praktikë, nuk ka kurrfarë kuptimi, nëse qytetarët nuk janë në gjendje t’i mbrojnë të drejtat e tyre legjitime me anë të mjeteve dhe mekanizmave efektiv ligjor.
- 22.** Avokati i Popullit së pari e thekson rëndësinë e faktit se procedura e zbatimit për nga natyra e vet juridike është rast urgjent dhe urdhëron largimin e pasojave të dëmshme në afate sa më të shkurtra të mundshme. Refuzimi i debitorit ekzekutiv që ta lirojë vullnetarisht pronën, të cilën e shfrytëzon në mënyrë të

paligjshme nuk e zvogëlon obligimin e AKP-së, të veprojë në përputhje me kompetencat e veta ligjore, duke përdorur mekanizmat ekzistues, veçanërisht të veprojë në përputhje me nenin 16.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 (të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

- 23.** Në mandatin e AKP-së, me qëllim të përmbarrimit të vendimeve, është paraparë edhe rrënimi i objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme (neni. 15, Ligji nr. 03/L-079). Edhe pse pala përgjegjëse në shkresat e veta i ka pohuar Avokatit të Popullit se AKP nuk është në gjendje të rrënojë objektin e ndërtuar në mënyrë të paligjshme, me atë rast nuk janë arsyetuar faktet, mbi bazën e të cilave AKP i bazon pretendimet e veta, si dhe arsyet objektive dhe të vlefshme, në bazë të të cilave AKP-ja si agjenci e pavarur dhe e paanshme nuk është në gjendje ta zbatojë dhe përmbarrojë një vendim të plotfuqishëm dhe përfundimtar të gjykatës.
- 24.** Duhet theksuar se AKP ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 16.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 (të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079), me të cilin është i parashikuar detyrimi i AKP-së që parashtruesin e kërkesës për kthimin e pronës në posedim ta njoftojë për datën, kur është planifikuar dëbimi, meqë ankuesja nuk është njoftuar me kohë për faktin se prona ishte vizituar dhe se nga debitori përmbarrues është kërkuar që vullnetarisht ta lirojë pronën.
- 25.** Përmbarrimin e vendimit të marrë nga gjykata kompetente duhet konsideruar si pjesë përbërëse të së drejtës për një gjykim të drejtë, e drejtë e garantuar me nenet e cituara, siç përcakton praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilin thuhet se zbatimi i vendimit të gjykatës, si një zgjidhje efektive nuk duhet të mbetet vetëm në letër, por duhet të

realizohet edhe në praktikë.<sup>29</sup> Në këtë rast, ankuesja nuk duhet të privohet nga dobitë e një vendimi të plotfuqishëm, i cili është dhënë në favor të saj.

- 26.** Në funksion të analizës ligjore të ankesës së parashtruar në IAP dhe procedurave të AKP, pas skadimit të afatit për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI187/13, Avokati i Popullit vuri në dukje se, meqë marrëveshja për ndërmjetësim nuk është arritur, AKP është e obliguar të zbatojë mjete të tjera në dispozicion, siç është rrënimi i strukturave të ndërtuara nga shfrytëzuesi jo legjitim dhe kthimi i pronës në posedim pronares legjitime. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit thekson faktin se mungesa e mekanizmave të zbatimit të këtij institucioni, në asnjë mënyrë nuk duhet të paraqesë arsye për mohimin e të drejtave të ankueses që ta gëzojë pronën.

### **Konkludimi i Avokatit të Popullit**

- 27.** Duke i analizuar të gjitha faktet e ankesës e që kanë të bëjnë me mosekzekutimin e vendimit të plotfuqishëm dhe përfundimtar të Gjykatës Supreme, si dhe aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit konstaton arsyeshmërinë e saj, kur merren parasysh të gjitha faktet në lidhje me këtë rast. Avokati i Popullit vuri në dukje, se ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesit të ankesës në të drejtën e barazisë para ligjit, duke pasur parasysh rrethanën që fillimisht nuk është ekzekutuar vendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme, e më pas as vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, gjë që është në kundërshti me parimet e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe ligje. Bartësit e të drejtave të njeriut janë qytetarët, kurse obligimi i shtetit është që të drejtat

---

<sup>29</sup> Shih rastin *Hornsby kundër Greqisë*, aktgjykimi i GJEDNJ të datës 19 mars 1997, raporti 1997-11 dhe 510, paragrafi 40.

dhe liritë e parashikuara me Kushtetutë dhe ligje të mos shkelen, por të respektohen.

- 28.** Avokatit i Popullit, më tutje, thekson se mosekzekutimi i vendimit nga ana e AKP-së dhe dështimi i autoriteteve kompetente që të sigurojnë mekanizma efikas, në kuptim të ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme, është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me nenin 21 të Kushtetutës. Në këto rrethana Avokati i Popullit konstaton se mosekzekutimi i vendimit të plotfuqishëm përbën shkelje në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së. Për më tepër, Avokati i Popullit konstaton se ankueses, për shkak të zvarritjes dhe mosekzekutimit të vendimit, në mënyrë të padrejtë i është mohuar e drejta në pronën e saj.
- 29.** Avokati i Popullit në këtë rast vëren se për shkak të dështimit për veprim të autoriteteve ligjore kompetente ka ardhur deri te shkelja e të drejtave të garantuara kushtetuese: neni 24, Barazia para Ligjit; neni 31, E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm; neni 32, E drejta për Mjete Juridike; neni 46, Mbrojtja e pronës; neni 54, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, si dhe me nenet përkatëse të KEDNJ-së, neni 6 paragrafi 1, E drejta për një proces të rregullt; neni 13, E drejta për zgjidhje efektive; neni 14 Ndalimi i diskriminimit; neni 1 i Protokollit 1 të EKLJP, Mbrojtja e pronës.
- 30.** Avokati i Popullit, gjithashtu, konstaton se AKP, brenda kompetencave të veta duhet të gjejë mekanizmat efikas të natyrës ekzekutive, në kuptimin e përbushjes së detyrimeve të parapara me ligj dhe Kushtetutë. Si pasojë, AKP, me veprimet përkatësisht mosveprimet, bën diskriminim, sepse palët në të njëjtën situatë nuk trajtohen në mënyrë të barabartë, siç është definuar me Kushtetutë. Do të ishte e pakuptueshme që sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës të lejojë që një vendim gjyqësor i plotfuqishëm të mbetet i paefektshëm në dëm të palës. Pra,

procedurat joefikase dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte që na çojnë në një situatë që nuk është në përputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 21 i Kushtetutës), parim, të cilin autoritetet e Kosovës janë të detyruara ta respektojnë.

- 31.** Avokati i Popullit konsideron se AKP është e obliguar ta lirojë pronën nga të gjithë personat dhe gjësendet dhe pastaj të njëjtën pronë t’ia dorëzojë ankueses në cilësinë e pronarit të ligjshëm. Me vetë faktin që ankuesja është kundër që shfrytëzuesi i pandërgjegjshëm të vazhdojë ta shfrytëzojë pronën në mënyrë të paligjshme, është e nevojshme të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore e faktike për ekzekutimin e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës dhe në këtë mënyrë znj. N.J t’i sigurohet qasja në pronë dhe shfrytëzimi i qetë dhe i papengesë i saj.
- 32.** Avokati i Popullit, në kuptim të dhënësit të rekomandimeve AKP-së, në përputhje me parimet e respektimit të ligjshmërisë, me qëllimin e mirë që të përmirësohet performanca dhe të fuqizohet legjitimiteti dhe zgjidhjet ligjore për këtë problem, në bazë të të lartpërmendurave, në përputhje me nenin 135, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: "*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*". Në kuptim të nenit 16, paragrafit 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka obligim "*të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;*"

Prandaj, Avokati i Popullit rekomandon:

- ***Ndërmarrjen e masave të nevojshme dhe të domosdoshme për sigurimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI***



*187/13, të datës 16 prill 2014, në mënyrë që pa vonesë të mëtejme të mbrohen të drejtat në pronë të znj. Nadezhda Jovanović, në përputhje me ligjin, si dhe me normat dhe standardet në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut.*

Në përputhje me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr.03/L-195, Ju lutem të na informoni, në lidhje me veprimet që do t'i ndërmarrë AKP, në lidhje me këtë çështje, si përgjigje në rekomandimin e mësipërm.

Duke besuar në bashkëpunimin e ndërsjellë dhe duke Ju falënderuar për bashkëpunim në këtë çështje, Ju lutem të na përgjigjeni brenda një afati sa më të shkurtër të mundshëm, më së voni deri më **8 qershor 2015**.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Kopje:

- Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Z. Enver Peci, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- Z. Fejzullah Hasani, kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Prishtinë, më 7 maj 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ex officio**

**Rasti nr. 251/2012**

**kundër**

**Komunës së Prishtinës**

Për: Z. Shpend Ahmeti, kryetar  
Komuna e Prishtinës

Lënda: Rekomandime për lirimin e hapësirës publike në rrugën  
ndarëse në mes të objekteve të banimit dhe Parkut  
Arkeologjik të Kosovës, në rrugën “Ilir Konusheci”,  
p.n., në pjesën e mbrojtur të Komunës së Prishtinës

## Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Avokati i Popullit më 15 qershor 2012, ka filluar hetimet me iniciativën e vet (*ex officio*), lidhur me rindërtimin e pjesës shtesë të objektit të përkohshëm, në pjesën e poshtme dhe rrethojës në pjesën e epërme, të rrugës ndarëse, në mes të objekteve të banimit dhe Parkut Arkeologjik të Kosovës, në rrugën “Ilir Konushefci”, p.n., në pjesën e mbrojtur të komunës së Prishtinës.
2. Këto hetime janë zhvilluar, bazuar në nenin 15, paragrafi 3, të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195, sipas së cilit Avokati i Popullit, ka kompetencë të zhvillojë hetime *ex officio*, nëse nga “Njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut”.
3. Bazuar në nenin 16, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195, Avokati i Popullit është i autorizuar:

*“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*

## Qëllimi i raportit

4. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes komunës së Prishtinës, përkatësisht kryetarit të komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti:
  - në obligimin e Komunës së Prishtinës, për të liruar hapësirën/shtegun, që do të siguronte lëvizjen e lirë dhe të papenguar të qytetarëve;
  - në obligimin e organit kompetent komunal, Drejtorisë së Inspeksionit, për përmbushjen e obligimeve ligjore, që burojnë

- nga kompetencat e tyre vetanake dhe ekskluzive ligjore, për lirim e hapësirave publike;
- në obligimin ligjor të të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, në rastin konkret të komunës së Prishtinës, për bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit, obligim ky sipas kuptimit të nenit 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

### **Përshkrimi i çështjes**

5. Përkitazi me çështjen e lartpërmendur, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) në maj të vitit 2011, ka pranuar ankesë nga znj. L. S., A.174/2011, e cila është ankuar lidhur me uzurpimin e pronës publike dhe pengimin e qarkullimit të lirë.
6. Më 9 qershor 2011, me kërkesë të Avokatit të Popullit, një grup i përbërë nga përfaqësues të IAP-së, Drejtorisë së Inspeksionit (DI) dhe të Drejtorisë së Pronës të komunës së Prishtinës, dolën në vendin e ngjarjes, për të vërtetuar pretendimet e znj.Safqi, për uzurpimin e pronës.
7. Më 11 korrik 2011, ish-ushtuesi i detyrës së drejtorit të DI-së, lëshoi vendim për rrënimin e objektit. Kopjen e vendimit IAP, asnjëherë nuk e pranoi nga komuna e Prishtinës.
8. Edhe pse në aksionin për rrënim, të datës 21 tetor 2011, Inspeksioni Komunal rrënoi objektin në fjalë dhe hapësira/shtegu u lirua. Më vonë, nga ana e IAP-së është vërejtur se përsëri në të njëjtin vend u rindërtua objekt i ngjashëm i përkohshëm, duke bërë pengimin e tërësishëm të qarkullimit dhe lëvizjes së lirë të qytetarëve.
9. Më 15 qershor 2012, Avokati i Popullit, inicioi procedurën për hetimin e rastit *ex officio* lidhur me rindërtimin e pjesës shtesë të objektit biznesor dhe rrethojës në rrugën ndarëse në mes të objekteve/shtëpive të banimit, dhe Parkut Arkeologjik të

Kosovës, në rrugën “Ilir Konushefci”, p.n., në pjesën e mbrojtur të komunës së Prishtinës.

10. Më 9 korrik 2012, Avokati i Popullit iu drejtua me letër ish-drejtorit të DI-së, me kërkesë për vlerësimin e ligjshmërisë së rindërtimit të objektit shtesë.
11. Më 8 tetor 2012, Avokati i Popullit, meqenëse nuk pranoi përgjigje nga komuna e Prishtinës, iu drejtua me letrën e dytë përsëritëse ish-drejtorit të DI-së.
12. Më 10 janar 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit, mori përgjigje nga ish-drejtori i DI-së, përmes së cilës u njoftua se pas pranimit të shkresës së Avokatit të Popullit:  
*“Drejtoria ka konstatuar se terasa me mbulojë është rindërtuar përsëri. Lidhur me këtë informoheni se në momentin kur do të fillojë aksioni për rrënimin e vendosjes së terasave apo ndërtimeve të ndryshme ekzistuese, si në rastin konkret, në momentin kur do të plotësohen kushtet atmosferike, do të bëhet heqja e terasës së ndërtuar pa poseduar leje nga organi kompetent komunal”.*
13. Më 16 maj 2013, Avokati i Popullit, meqenëse gjatë zhvillimit të hetimeve vërejti se lidhur me çështjen komuna nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim, iu drejtua ish-kryetarit të komunës, me kërkesë për t’u informuar për arsyet e mosndërmarrjes së veprimeve përkatëse.
14. Më 10 qershor 2013, përfaqësuesja e AP, bisedoi me përfaqësues të DI, nga të cilët u njoftua se rrënimi i objektit është planifikuar nga komuna.
15. Më 25 tetor 2013, përfaqësuesja e AP, zhvilloi takim me ish-drejtorin e Drejtorisë së Kadastrës në komunën e Prishtinës, nga i cili u kërkuan informata shtesë për çështjen.

16. Më 13 mars, 15 dhe 24 prill 2014, përfaqësuesja e AP, ngriti çështjen me drejtorin e DI-së, të komunës së Prishtinës, nga i cili u njoftua që rrënimi i objektit në fjalë, është i paraparë në planin e punës së Inspeksionit Komunal.
17. Më 9 shtator 2014, përfaqësuesja e AP, zhvilloi takim me drejtorin e DI-së të komunës së Prishtinës, nga i cili u njoftua se arsyeja e mosndërmarrjes së veprimeve lidhur me çështjen është mbingarkesa në punë dhe mungesa e inspektorëve.
18. Më 6 shkurt 2015, përfaqësuesja e AP, zhvilloi takim me drejtorin e DI-së të komunës së Prishtinës, nga i cili u njoftua se arsyeja e mosrealizimit të planit të Drejtorisë së Inspeksionit, ishte mungesa e inspektorëve, pas arrestimeve të vitit 2014.

### **Analiza ligjore**

19. Meqenëse, me Kushtetutën e Republikës Kosovës, neni 7, paragrafi 1, përcaktohet që, “[...], *respektimi të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, [...]*”, renditen në vlerat në të cilat bazohet rendi Kushtetues i vendit, për Avokatin e Popullit është e pakuftueshme zvarritja e ndërmarrjes së veprimeve për lirimin e hapësirës publike/shtegut të lartpërmendur nga organet kompetente, duke pasur parasysh kohën e gjatë të ekzistimit dhe shfrytëzimit të hapësirës/shtegut nga qytetarët, vite më parë.
20. Bazuar në obligimin kushtetues nga neni 123, paragrafi 4 i KRRK-së, sipas të cilit “*Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike [...]*”, është i paarsyeshëm dhe kundërligjor mosreagimi përkatës i komunës, përkundër rëndësisë së ekzistimit të hapësirës/shtegut dhe ndikimit të tij në lirinë e lëvizjes së qytetarëve.
21. Edhe pse shtegu në fjalë gjendet në hapësirën e cila gjendet në të njëjtën rrugë, përkatësisht afër objektit të komunës së Prishtinës,

edhe përkundër obligimit ligjor sipas kuptimit të nenit 4.2, të LVL, i cili kërkon nga organet komunale që të kujdesen që qytetarët, “[...] të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve”, komuna e Prishtinës nuk ka vepruar deri më tani.

22. Avokati i Popullit, vëren se komuna nuk është përgjigjur në ankesën e znj. Safqi për lirimin e hapësirës publike të uzurpuar dhe se, vetëm pas ndërhyrjes së IAP-së, e njëjta është liruar përkohësisht, por ajo përsëri, brenda një kohe shumë të shkurtër është uzurpuar. Që nga ajo kohë, gjendja nuk ka ndryshuar, edhe pse kanë kaluar pothuajse 4 vite, pas nisjes së procedurave nga IAP.
23. Avokati i Popullit vëren se Rregullorja 01. nr. 110 – 157481, e miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, më 1 korrik 2014, për Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike (RRVNLOPPP), e cila parasheh *“llojet e objekteve të përkohshme (në tekstin në vazhdim objekti i përkohshëm), kushtet dhe procedurat për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve në pronën publike, në të cilën Komuna e ka të drejtën e udhëheqjes”* nuk është zbatuar nga autoritetet komunale.
24. Sipas Avokatit të Popullit, gjendja e tillë është e patolerueshme, kur kemi parasysh frekuentimin e lartë të qytetarëve në atë pjesë të qytetit, afërsinë e një numri të konsiderueshëm të institucioneve shkollore dhe të institucioneve të tjera si gjykatave dhe të tregut kryesor të gjelbër të komunës së Prishtinës. Në këtë kuptim neni 3 i RRVNLOPPP, përcakton në mënyrë shprehimore se:

*“Objektet e karakterit të përkohshëm mund të vendosen dhe ndërtohen në pronën publike, me kusht që të mos pengojnë funksionimin e institucioneve, bizneseve që veprimtarinë e ushtrojnë në objekte të karakterit të përhershëm, nuk rrezikojnë*

*ambientin jetësor (zhurma, largimi i mbetjeve të mbeturinave etj.)”*

- 25.** Meqenëse objekti në fjalë, pengon shfrytëzimin e objekteve në afërsi, nuk i ka plotësuar kushtet për sigurim nga zjarri, pengon lëvizjen e këmbësorve, komuna nuk ka prezantuar fakte që i është dhënë leja, nuk i ka të plotësuar kushtet e veçanta, të përcaktuara me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit, dhe si i tillë nuk i ka përmbushur kushtet e përshtatshmërisë, ashtu si parasheh neni 15 i RRVNLOPPP, është e pakuptueshme neglizhenca e organeve komunale kompetente, vite me rradhë për largimin e objektit.
- 26.** Shqetësuese për Avokatin e Popullit, është mosreagimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kur kemi parasysh që RRVNLOPPP, në nenin 7.1 dhe 7.2, përcakton që objektet e përkohshme të kësaj kategorie “*vendosen dhe ndërtohen në bazë të lejes për vendosjen/ndërtimin [...] nga ”organi kompetent për shërbime publike”, duke u respektuar kriteret e parapara në nenin 6:*
- “b) që me vendosjen e përkohshme të objekteve, nuk do të krijohen pengesa në lëvizjen e lirë në trotuare dhe hapësira të tjera;*
  - c) që në udhëkryqe dhe kënde të rrugëve, të mos zvogëlohet dukshmëria dhe të mos rrezikohet siguria në komunikacion;*
  - d) që të mos dëmtohet vlera mjedisore dhe kulturo - historike;*
  - e) që objekti i vendosur të bëhet sipas tërësisë së kompleksit arkitektonik;*
  - f) që vendosja e objektit të bëhet në distancë nga rrugët e kategorizuara, të parapara me Ligjin në fuqi për rrugët;*
  - g) që objekti i vendosur të mos pengojë shfrytëzimin normal të objekteve të përhershme.”*



- 27.** Po ashtu, shqetësues është edhe mos reagimi i Drejtorisë së Pronës, si dhe Drejtorisë së Inspeksionit, në përputhje me kompetencat e tyre të dala nga RRVNLOPPP, e cila në nenin 19, parasheh që:
- 1. Mbikëqyrjen për zbatimin e kësaj rregulloreje e bën organi kompetent për administrimin e pronës publike.*
  - 2. Punët e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e kësaj rregulloreje, i kryen Inspeksioni komunal i organit kompetent për punët e inspektimit”.*
- 28.** Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 (LVL), sipas së cilit *“Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë [...],”* në mënyrë të qartë përcakton detyrimet ligjore të komunës në raport me të drejtat e qytetarëve. Po ashtu, vendimet e organeve komunale janë akte administrative të natyrës ekzekutive, me të cilat komunat ushtrojnë pushtetin e tyre ligjor në të gjitha fushat e kompetencës ligjore. Avokati i Popullit, vëren se komuna e Prishtinës nuk ka zbatuar vendimin për rrënimin e objektit dhe lirimin e hapësirës për qarkullim të lirë të qytetarëve, ashtu siç është premtuar dhe thënë në takimet e mbajtura në datat e lartshënuara, po ashtu edhe përmes shkresës së datës 10 janar 2013, ashtu sikurse është caktuar në RRVNLOPPP, në fuqi. Heqja e apo rrënimi i objektit ka qenë po ashtu i paraparë me rregulloren, paraprahe 01. Nr.110-391, të datës 28 korrik 2010, për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Pronës Komunale për Vendosjen e Objekteve të Përkohshme.
- 29.** Në vazhdim, Avokati i Popullit, përkujton rëndësinë e nenit 17 të LVL, për kompetencat ekskluzive të komunës, në fushën e planifikimit urban dhe rural, mbrojtjes së mjedisit lokal, në ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, *“[...] menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal [...],”* si dhe *“mirëmbajtjes së parqeve dhe*

*hapësirës publike*”. Bazuar në këtë, Avokati i Popullit vlerëson se veprimet e komunës për rastin në fjalë, janë joproporcionale, në krahasim me rëndësinë për lirin e hapësirës publike nga uzurpimi arbitrar dhe sigurimin e lëvizjes së lirë të njerëzve.

- 30.** Bazuar në të dhënat e paraqitura më lartë, dëmin e shkaktuar dhe vonesat e komunës në sanimin e gjendjes faktike, Avokati i Popullit rikujton dhe thekson që edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, përkitazi me çështjet e ngjashme, ndërhyrjet arbitrarë të individëve në hapësira, si dhe dëmtimin e tyre pa asnjë përpjekje për t’u penguar nga institucionet përgjegjëse, ka konstatuar se *“jo vetëm autoritetet publike duhet të përmbahen nga mos ndërhyrja në të drejtat e individëve, por ata duhen ndërmarrë hapa konkretë në mbrojtjen e të drejtave të tyre”*.<sup>30</sup>

### **Përfundim**

- 31.** Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se *“Vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin të drejtave dhe detyrimeve për personat juridik dhe fizik”*, si dhe duke u bazuar në faktet e përmendura më lart, konstaton se mosndërmarrja e veprimeve përkatëse nga organet kompetente komunale, në rastin konkret nga Drejtoria e Inspeksionit e komunës së Prishtinës, për lirin e hapësirës në fjalë, është duke shkaktuar pengim të lëvizjes së lirë të qytetarëve.
- 32.** Pas analizimit dhe vlerësimit të fakteve dhe të rrethanave të rastit, Avokati i Popullit konstaton se në këtë rast, komuna ka dështuar për të parandaluar pengimin e efekteve negative të ndikimit në mjedis, nga mbyllja e shtegut, duke marrë parasysh frekuentimin e lartë të këmbësorëve, në atë pjesë të qytetit.

---

<sup>30</sup> GJEDNJ, rasti *Hatton and Others v. the United Kingdom*, Application no. 36022/97, 8 July 2003, paragrafi 100, 119, 123, në: <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-59686#%7B%22itemid%22:%5B%22001-59686%22%5D%7D> (07.05.2015).

33. Zvarritja e ndërmarrjes së veprimeve efektive nga viti në vit, nga organet kompetente komunale, konsiston në mosgatishmërinë dhe papërgjegjshmërinë e tyre për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse, në kuadër të detyrave zyrtare, në përputhje me obligimin e tyre ligjor.
34. Prandaj, me qëllim të lirimit të hapësirave publike për qarkullim të lirë të qytetarëve, të zvogëlimit të ndikimeve negative në mjedis, dhe në mënyrë që të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e tij, mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e punës së organeve shtetërore, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 25 të Ligjit nr.03/L-195, për Avokatin e Popullit

#### **Rekomandon Komunën e Prishtinës:**

1. *Të ndërmarrë masa të menjëhershme për lirimin e hapësirës/shtegut në pjesën e poshtme, dhe të rrethojës në pjesën e epërme, në rrugën ndarëse në mes të objekteve të banimit dhe Parkut Arkeologjik të Kosovës, në rrugën “Iliir Konushëfci”, p.n., në pjesën e mbrojtur të Komunës së Prishtinës.*
2. *Të sanojë gjendjen e shtegut, duke e kthyer atë në gjendjen e mëparshme.*
3. *Të bashkëpunojë me Avokatin e Popullit për çështjet të cilat ai i ka në shqyrtim, duke ofruar të gjitha informatat, dosjet dhe dokumentet e kërkuara nga ai dhe të përgjigjet brenda një afati të arsyeshëm kohor në letrat, kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, si obligim kushtetues dhe ligjor sipas nenit 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 23, paragrafi 1 dhe 2, Ligjit Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë komuna, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartcekura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më **8 qershor 2015**.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

**Kopje:**

- Z. Xhelal Sfeqla, drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit të komunës së Prishtinës,
- Z. Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim,
- Znj. Premtime Preniqi, koordinatore për të Drejtat e Njeriut në komunën e Prishtinës.

Prishtinë, më 13 maj 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa nr: 602/2014**

**S. R.**

**kundër**

**Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK)**

Për: Z. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë së Republikës së Kosovës

Ndërtesa e ish-Rilindjes, kati IX  
10000 Prishtinë

Lënda: Rekomandim lidhur me ankesën e z. S. R., për shkak të mosrealizimit të së drejtës në arsim, sipas *Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Nr.04/L-149*

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16

## **Qëllimi i raportit**

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës (MD), Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT), lidhur me rekomandimet për veprime që duhen ndërmarrë për zbatimin e të drejtës së arsimit, për personat që janë të privuar nga liria dhe gjinden në vuajtje të dënimit, sipas aktgjykimeve të plotfuqishme gjyqësore.

## **Kompetenca e Avokatit të Popullit**

2. Bazuar në nenin 16, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195, Avokati i Popullit është i autorizuar:

*“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*

## **Përshkrimi i çështjes**

3. Ky raport është bazuar në ankesën e pranuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), gjatë vizitave të rregullta në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Ankesa është paraqitur kundër SHKK-së, lidhur me kërkesën e personit të dënuar për realizimin e së drejtës për arsim, e përcaktuar me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) Nr. 04/L-149.

## **Përmbledhja e fakteve**

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon IAP, mund të përmbliidhen si në vijim:

4. Më 3 dhjetor 2014, gjatë vizitës në Burgun e Dubravës, IAP ka pranuar ankesën e z.Sali Rexhepi kundër Drejtorisë së Qendrës Korrektuese në Dubravë, lidhur me kërkesën e tij për t’i vazhduar provimet e mbetura në Fakultetin e Edukimit, sipas programit të MASHT-it, për Edukimin dhe Avancimin e Mësimdhënësve.

5. Më 16 dhjetor 2014, z. Sali Rexhepi i është drejtuar me shkresë Drejtorisë së Qendrës Korrektuese në Dubravë me kërkesë, që t’ia mundësojnë vazhdimin e semestrit të shtatë (dhe të fundit) në studimet e obliguara të mësimdhënësve në programin për Avancim dhe Kualifikim në Fakultetin e Edukimit me qendër në Prizren.
6. Ditën e njëjtë, përfaqësuesja e IAP i është drejtuar me email Drejtorit të përgjithshëm të SHKK-së, duke e njoftuar me kërkesën e ankuesit dhe njëherësh ka kërkuar informacione lidhur me veprimet e ndërmarra rreth kësaj çështje.
7. Më 17 dhjetor 2014, drejtori i Qendrës Korrektuese në Dubravë, përmes e-mailit, e ka informuar IAP-në, duke theksuar se: *”Ankuesi nuk kishte parashtruar kërkesë për vazhdim të shkollimit dhe se Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale neni 84 pika 2, e mundëson vazhdimin e shkollimit por nuk ka akt nënligjor për realizimin e kësaj të drejte, si dhe Ministria e Drejtësisë duhet të nxjerrë akt nënligjor për fillimin e zbatimit të këtij neni.”*
8. Më 5 janar 2015, udhëheqësi i Zyrës Ligjore në SHKK, i dërgoi email IAP-së me përmbajtje si në vijim: *”I burgosuri Sali Miftar Rexhepi i lindur 12.07.1956 i dënuar me 5 vite ka filluar mbajtjen e dënimit më 18 gusht 2014, deri me tani nuk ka parashtruar kërkesë për shkollim, gjithashtu nuk kemi akt nënligjor që rregullon më detajisht këtë pikë. Për këtë shumë shpejtë do të draftohet një akt nënligjor nga SHKK.”*
9. Të njëjtën ditë familjarët e ankuesit e njoftuan IAP-në, se më 16 dhjetor 2014, ankuesi kishte parashtruar kërkesë për vazhdimin e shkollimit dhe pohuan se ai deri atëherë nuk kishte marrë përgjigje nga SHKK dhe sollën në IAP kopje të kërkesës.
10. Më 2 shkurt 2015, përfaqësuesja e IAP, sërish iu drejtua me email Drejtorit të përgjithshëm të SHKK-së, me kërkesë për t’u informuar për veprimet e ndërmarra, në çështjen e ankuesit.
11. Më 27 shkurt 2015, Drejtori i përgjithshëm i SHKK, i përgjigjet me email IAP-së:

*”Lidhur me shkollimin universitar të të dënuarve, Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale parasheh mundësin e shkollimit universitar përmes programeve të veçanta që i mundëson institucioni korrektues, ku shkollim nënkupton organizimin nga ana e universitetit publik, në kuadër të institucioneve korrektuese të mbajë ligjërata dhe provimet për të burgosurit studentë, po ashtu Ligji parasheh nxjerrjen e një akti administrativ nga Ministria e Arsimit me pëlqimin e ministrit të Drejtësisë, por deri me tani nuk kemi një akt të tillë. Ne kemi informacione se disa të burgosur kanë vazhduar shkollimin me korrespondencë, duke shfrytëzuar (benificionet) pushimin jashtë burgu për dhënien e provimeve. Ne jemi të vetëdijshëm se ky problem duhet zgjidhur së bashku me Ministrinë e Arsimit pasi që është kompetente për arsimim në Republikën e Kosovës”.*

- 12.** Më 2 mars 2015, familjarët e ankuesit sollën në IAP vërtetim, përmes të cilit vërtetohet se:

*“Provimet nga lënda "Bazat e Punës me Kompjuter" është paraparë të mbahet me datë 14 mars 2015, në ora 09:00, kurse lëndët "Teoria e Letërsisë dhe Edukimi Inkluziv" janë paraparë të mbahen me datë 21 mars 2015, në ora 10:00 dhe në ora 12:00”.*

- 13.** Më 9 mars 2015, familjarët e ankuesit shprehën shqetësimin e z. Rexhepi, lidhur me mospërgjigjen e SHKK-së në kërkesën e tij për vazhdimin e arsimit dhe njoftuan se nëse ai nuk i nënshtrohet provimeve të mbetura në afatin e marsit apo prillit 2015, ai e humb të drejtën e vazhdimin të shkollimit, pasi është gjenerata e fundit sipas programit të MASHT-it. Ata pohuan se kanë informacione se disa të burgosurve u lejohet vazhdimi i arsimit dhe këtë fakt e kanë konfirmuar edhe zyrtarët e SHKK-së gjatë kontakteve me zyrtarë të IAP-së.

## **Baza ligjore**

- 14.** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, paragrafi 2, përcakton: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”* Kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton se:



*“Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 47, paragrafi 2 përcakton: *“Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas nevojave dhe aftësive të tij”*.
16. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), në Protokollin numër 1, në nenin 2 përcakton: *“Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën [...]”*.
17. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr 04/L-037), në nenin 5, paragrafi 1, përcakton: *“Në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë do të kenë qasje të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës [...]”*, kurse paragrafi 5 i këtij neni lejon mundësinë që: *“Arsimi i lartë mund të vijohet në mënyrë të rregullt, me korrespondencë, përmes të mësuarit në distancë dhe me kombinim të cilësdo prej këtyre mënyrave të studimit, ashtu sikurse parashihet në statutin e bartësit që jep kualifikim të arsimit të lartë.”*
18. Ligji për Procedurën Administrative (LPA) Nr.02/L-28, në nenin 11 përcakton se: *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë.”*
19. Neni 5 paragrafi 4 i LESP, përcakton:  
*“Gjatë ekzekutimit të sanksionit penal gjithmonë respektohen të drejtat e personit të dënuar. Këto të drejta mund të kufizohen vetëm në atë masë që është e domosdoshme për ekzekutimin e sanksionit penal në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”*.
20. LESP në nenin 83, paragrafi 7 përcakton po ashtu se: *“Me akt nënligjor, të cilin e nxjerrë Ministri për Arsim me pëlqimin e Ministrisë të Drejtësisë rregullohet arsimimi i personave të dënuar”*, kurse neni 84 përcakton se: *“Përmes programeve të*

*veçanta, drejtori i institucionit korrektues i mundëson personit të dënuar vijimin e shkollimit fillor, të mesëm, universitar, apo ndonjë shkollim tjetër [...]”.*

- 21.** LESP në nenin 249 paragrafi 1 përcakton se: *“Ministri nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas hyrjes në fuqi të ligjit”* kurse paragrafët 2 dhe 3 përcaktojnë: *“Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore të parapara me këtë ligj, zbatohen dispozitat e nxjerra sipas dispozitave ekzistuese, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me këtë ligj”*, kurse më tutje paragrafi 3 i këtij neni përcakton se *“Ministri i Arsimit me pëlqimin e Ministrit të Drejtësisë në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktin nënligjor me të cilin rregullohet arsimimi i personave të dënuar (neni 83 paragrafi 7).”*

### **Analiza ligjore**

- 22.** Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për të respektuar liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë përfshirë dhe SHKK-në.
- 23.** Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 47 përcakton detyrimin e të gjitha institucioneve publike që të sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas nevojave dhe aftësive të tij. Prandaj, në përputhje me nevojat specifike të personit, kjo dispozitë lejon mundësinë që institucionet të parashohin situata specifike që *“sipas nevojave dhe aftësive”* të personit, në çfarëdo rrethanash, t’i ofrohet mundësia për arsimim. E drejta e arsimit për personat e privuar nga liria, në mënyrë më të hollësishme është e definuar me LESP dhe njëherit janë përcaktuar shprehimisht edhe institucionet si MD, SHKK dhe MASHT, për zbatimin e ligjit, andaj kërkesa e ankuesit për t’i vazhduar provimet e mbetura në Fakultetin e

- Edukimit, sipas programit të MASHT-it, për Edukimin dhe Avancimin e Mësimdhënësve, është bazuar në ligj.
24. KEDNJ, në Protokollin Nr.1 të saj, përveç të tjerash e ka trajtuar edhe të drejtën e arsimit dhe përmes nenit 2 përcakton që: *“Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim”*. Mirëpo, në rastin konkret ankuesit i është mohuar e drejta e shkollimit, e garantuar sipas KEDNJ dhe akteve tjera normative në fuqi, në Republikën e Kosovës.
25. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës kërkon nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë që t’u ofrojnë mundësinë e qasjes në arsim të gjithë personave brenda apo jashtë territorit të Kosovës, duke lejuar mundësinë që: *“Arsimi i lartë mund të vijohet në mënyrë të rregullt, me korrespondencë, përmes të mësuarit në distancë dhe me kombinim të cilëndo prej këtyre mënyrave të studimit, ashtu sikurse parashihet në statutin e bartësit që jep kualifikim të arsimit të lartë”*. Me këtë ligj, ligjvënësi ka lejuar mundësi dhe mënyra të ndryshme të arsimit të përcaktuara me Ligjin për Arsimin, kurse me LESP, e ka përcaktuar dhe rregulluar të drejtën e arsimit për kategoritë e personave me liri të kufizuar. Mirëpo, këto mundësi ligjore, nuk janë funksionalizuar sa duhet nga SHKK, MD dhe MASHT, dhe ankuesit i është pamundësuar realizimi i së drejtës. Prandaj ky mohim i të drejtës së ankuesit në këtë rast nuk mund të arsyetohet me ndonjë lëshim nga vetë ankuesi. Por, ***lëshimi është bërë nga institucionet përgjegjëse për funksionalizimin dhe zbatimin e ligjeve.***
26. Ligji për Procedurën Administrative në nenin 11, përcakton se: *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë”*. Sipas kuptimit të këtij neni, organet e administratës para të cilave është paraqitur kërkesa kanë obligim që të kujdesen lidhur me kompetencën (gjatë gjithë procedurës administrative) dhe pastaj në mënyrë të ligjshme, efikase dhe efektive të vendosin për çdo kërkesë të personave fizik apo juridik lidhur me çështjen e caktuar. Në rastin konkret, kështu nuk është vepruar nga SHKK, ku fillimisht ishte drejtuar kërkesa e ankuesit për vazhdimin e shkollimit. Duke mos e shqyrtuar fare

- ankesën, SHKK-ja e ka penguar drejtpërdrejtë ankuesin që të përdorë mjetet e tjera juridike efektive kundër vendimit në shkallë të parë.
27. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, si dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, asnjë institucioni pa përjashtim, nuk i delegohet e drejta e kufizimit të drejtave dhe lirive të njeriut të parapara me Kushtetutë, me instrumentet ndërkombëtare dhe me ligjet në fuqi. Çdo kufizim mund të bëhet vetëm me ligj nga një gjykatë e rregullt në Republikën e Kosovës. Prandaj, **mosveprimi i organeve të cekura më lart, në kuptim të zbatimit të një të drejte ligjore, është veprim kundërligjor dhe paraqet shkelje të të drejtave të njeriut.**
28. LESP përmes nenit 4, përcakton se: *“Qëllimi kryesor i ekzekutimit të sanksioneve penale është risocializimi dhe riintegrimi i të dënuarit në shoqëri dhe përgatitja e tij për jetë, si dhe për sjellje të përgjegjshme”*. Prandaj pamundësimi i vazhdimit të arsimit pa asnjë arsyetim të bazuar në ligj dhe pa ndonjë vendim gjyqësor të formës së prerë lidhur me arsimin, bie ndesh me qëllimin kryesor të ekzekutimit të sanksioneve penale e që është risocializimi dhe riintegrimi i të dënuarit në shoqëri, si dhe përgatitja e tij për jetë.
29. Po ashtu, sipas nenit 84, paragrafi 1 të LESP lejohet vazhdimi i arsimit të personave në vuajtje të dënimit: *“Drejtori i institucionit korrektues përmes programeve të veçanta, i mundëson personit të dënuar vijimin e shkollimit fillor, të mesëm, universitar, apo ndonjë shkollim tjetër”*. Megjithëkëtë obligim ligjor të drejtorit të institucionit korrektues, ankuesi nuk ka mundur ta realizojë këtë të drejtë.
30. Ky fakt bëhet edhe me shqetësues kur kihet parasysh fakti që IAP ka hasur në raste kur të burgosurve të tjerë u është lejuar arsimimi pa pengesa, mbi bazën e lejeve administrative të lëshuara nga organet e SHKK-së. Por, kjo dëshmohet edhe nga vetë personat përgjegjës të SHKK-së, të cilët kanë njoftuar për rastet e tilla (shih pikën 12 të këtij raporti). Në këtë rast, përveç moskryerjes së obligimit ligjor nga udhëheqësit e institucionit korrektues, kemi të bëjmë edhe me veprime selektive ndaj të burgosurve në

këto institucione, që zgjon dyshimin për **sjellje diskriminuuese të institucioneve publike ndaj personave të caktuar të burgosur**.

31. LESP në nenin 249, paragrafin 3, përcakton: *”Ministri i Arsimit me pëlqimin e Ministrisë të Drejtësisë në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e LESP do të nxjerr aktin nënligjor me të cilin rregullohet arsimimi i personave të dënuar”*. Nxjerrja e akteve nënligjore do të ishte një ndihmesë në zbatimin e ligjit, por në rastin konkret, mungesa e aktit nënligjor është pengesa kryesore për zbatimin e ligjit dhe realizimin e se drejtës për arsim të ankuesit. Nxjerrja e akteve nënligjore ishte dashur të ndodhë gjatë kohës sa ka qenë në fuqi Ligji Nr. 03/L-91. Në ndërkohë, Kuvendi i Kosovës ka miratuar edhe Ligjin tjetër Nr. 04/L-149, i cili ka shfuqizuar ligjin paraprak, por aktet nënligjore për zbatimin e të drejtës së arsimit për personat e dënuar, mungojnë dhe pengojnë zbatimin e ligjit edhe sot e kësaj dite, për shkak të neglizhencës së organeve përgjegjëse.

### **Konstatimi i Avokatit të Popullit**

32. Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e ofruara dhe faktet e mbledhura, si dhe ligjet relevante, të cilat përcaktojnë të drejtën e arsimit në përgjithësi dhe në veçanti të personave të cilët gjenden në vuajtjen e dënimit, lidhur me kërkesën e datës 16 dhjetor 2014 të parashtruar në SHKK, për vazhdimin e shkollimit të lartë, **konstaton se kërkesa e ankuesit është e arsyeshme dhe e ligjshme**. Kushtetuta, ligjet mbi arsimin dhe LESP, njohin të drejtën për vazhdimin e arsimit dhe mbi këtë bazë ankuesi ka paraqitur kërkesë për t’i vazhduar provimet e mbetura në Fakultetin e Edukimit, sipas programit të MASHT-it, për Edukimin dhe Avancimin e Mësimdhënësve. Në rastin konkret, **Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesit të ankesës, në të drejtën e arsimit**, pasi nuk i është mundësuar vazhdimi i arsimimit.
33. Avokati i Popullit konstaton se mosshqyrtimi i kërkesës së ankuesit të datës 16 dhjetor 2014, parashtruar në SHKK, për vazhdimin e arsimit, pa lëshuar ndonjë vendim individual për refuzimin e kërkesës ose ndonjë arsyetim me shkrim, lidhur me kërkesën (*përveç në rastin e përgjigjes me email përfaqësueses së*

- IAP, e cila e ka marrë një përgjigje sipërfaqësore nga SHKK, që tërthorazi nënkuptohet si refuzim), paraqet shkelje të së drejtës për mjete juridike, pasi ankuesi është privuar nga e drejta në ankesë, si mjet i rregullt juridik i LPA që obligon të gjitha organet e administratës, që në afate ligjore të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridik.*
- 34.** Po ashtu, përvoja nga e kaluara, ku disa personave të cilët kanë qenë në vuajtje të dënimit dhe u është lejuar vazhdimi i shkollimit me leje administrative apo gjatë vikendeve, krijon perceptimin dhe ndjesinë e **një situatë diskriminuese në mes personave që gjenden në vuajtje të dënimit** dhe nuk u është lejuar vazhdimi i shkollimit. Sipas nenit 24 të Kushtetutës, të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe secili gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
- 35.** Avokati i Popullit konstaton se LESP është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 31, më 28 gusht 2013, dhe se kanë kaluar mbi 20 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit dhe përkundër obligimit ligjor, sipas kuptimit të nenit 223, për të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga hyrja e ligjit në fuqi, nuk është bërë një veprim i tillë nga MASHT-i dhe MD. **Mosnxjerrja e akteve sekondare për zbatimin e ligjit nuk do të duhej të mohonte të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi, përfshirë edhe LESP-në.**
- 36.** Avokati i Popullit konstaton se zvarritja në hartimin e akteve nënligjore, me të cilat do të rregullohej procedura e realizimit të së drejtës në arsim për personat e dënuar, vë në dyshim parimin e sigurisë juridike në Republikën e Kosovës, duke e krijuar përshtypjen e një paqëndrueshmërie juridike. Prandaj, ministritë përgjegjëse duhet që pa vonesa të mëtejme t'i nxjerrin ato dhe të eliminohen shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut në të ardhmen.
- 37.** Po ashtu, organet kompetente ligjore të cilave ligji iu ka deleguar kompetenca për nxjerrjen e akteve administrative, në rastin konkret SHKK, duhet t'i ushtrojnë kompetencat ligjore dhe të eliminojnë shkeljet e të drejtave të njeriut për personat që gjenden në vuajtje të dënimit.

**38.** Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”. Sipas kuptimit të nenit 16, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit “*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...)*”, si dhe “*të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*” (neni 16, paragrafi 1.6).

Prandaj, Avokati i Popullit

## **REKOMANDON**

- 1. Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit dhe SHKK-në të ndërmarrin masa të menjëhershme, për nxjerrjen e akteve nënligjore, që kërkohen sipas nenit 249 të LESP, përmes të cilave rregullohet procedura e vazhdimit të arsimit të lartë për personat që gjenden në vuajtje të dënimit.**
- 2. Të nxirret një vendim dhe, mbi bazën e lejeve administrative të cilat janë përdorur për raste të tjera nëpër institucionet korrektuese dhe në bashkëpunim me MASHT-in, t’i lejohet ankuesit që t’i nënshtrohet provimeve të mbetura.**
- 3. Që organet përgjegjëse të SHKK-së, për zbatimin e ligjeve, të përgjigjen brenda afateve ligjore me shkrim në të gjitha parashtrirat e drejtuara nga personat e dënuar, si një e drejtë kushtetuese dhe ligjore e të gjithë qytetarëve, për shfrytëzim të mjeteve juridike efektive dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe SHKK, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më **14 qershor 2015**.

Me nderime

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Kopje:           Z. Arsim Bajrami, ministër i Arsimit, Shkencës dhe  
Teknologjisë.  
Z. Emrush Thaçi, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit  
Korrektues të Kosovës.



Prishtinë, më 29 maj 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

*Ex officio*

**Rasti Nr. 498/2014**

**Për:** Z. Isa Mustafa, Kryeministër  
Qeveria e Republikës së Kosovës

**Lënda:** Ngritja e “Parkut të Paqes”, “Sheshit Car Lazar”,  
“Sheshit “UÇK” dhe “Sheshit Adem Jashari”, në  
komunën e Mitrovicës së Veriut

**Baza ligjore:** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, par. 3  
dhe

Ligji për Avokatin e Popullit, Nr. 03/L-195, neni 16,  
par. 1

## Qëllimi i raportit

Në fillim të qershorit 2014, janë ngritur ose kanë filluar të bëhen katër ndërtime në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Këto ndërtime janë të ashtuquajturat “Parku i Paqes”, “Sheshi Car Lazar”, “Sheshi Adem Jashari” dhe “Sheshi UÇK”.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se, ka munguar një trajtim i kësaj çështjeje dhe analizë ligjore dhe kushtetuese e situatës nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut. Në mënyrë që të plotësojë këtë zbrastësirë, Avokati i Popullit ka vendosur të hapë hetime me vetiniciativë lidhur me këto ndërtime, me dy qëllime kryesore: (1) për të vlerësuar nëse ngritja e katër ndërtimeve të lartcekura paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, posaçërisht të së drejtës për lëvizjen e lirë, sipas standardeve vendore dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe (2) për t’u dhënë rekomandime autoriteteve përgjegjëse në bazë të këtij vlerësimi.

## Baza ligjore

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Gjithashtu, Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195, neni 16, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash ka edhe këto përgjegjësi:

- *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”* (pika 2);
- *“të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të*

*bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut” (pika 4);*

- *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 5);*
- *“të përgati[s]ë raporte . . . mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës” (pika 7).*

Me dërgimin e këtij raporti tek autoritetet shtetërore përgjegjëse, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

## **Përmbledhja e fakteve**

### **I. Ngritja e katër ndërtimeve në Komunën e Mitrovicës së Veriut**

Ngritja e “Parkut të Paqes”, “Sheshit Car Lazar”, “Sheshit Adem Jashari” dhe “Sheshit UÇK”, përbën vetëm kapitullin e fundit të një historie të gjatë, e cila ka filluar më 25 korrik 2011, kur njësi speciale e policisë së Republikës së Kosovës, me urdhër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërmori aksionin për t’i futur nën kontroll pikat kufitare në veri të vendit, në mënyrë që të shtrijë sovranitetin e Republikës në të gjithë territorin e saj.

Si reagim ndaj këtij aksioni, “strukturat paralele” në veri, të cilat funksiononin dhe vepronin jashtë kontrollit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, vendosën barrikada gati në të gjitha vendbanimet e pjesës veriore të vendit, si dhe në rrugët magjistrale që ndërlidhin këto vendbanime, duke kufizuar në këtë mënyrë lëvizjen e njerëzve si dhe qarkullimin e mallrave në rajon. Një nga këto barrikada është vendosur tek ura kryesore e lumit Ibër, një prej dy vendkalimeve të vetme për automjete midis dy pjesëve të qytetit të Mitrovicës, asaj jugore dhe veriore.

Barrikada e vendosur në urën e lumit Ibër mbeti aty një kohë të gjatë. Shpresa e parë që barrikada do të hiqej eventualisht, ka ardhur me

arritjen e “Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve” mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, më 19 prill 2013. Një ndër qëllimet e kësaj marrëveshjeje, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 27 qershor 2013, ishte për t’i shuar “strukturat paralele” dhe për të integruar anëtarët e tyre me institucionet e Republikës së Kosovës.<sup>31</sup>

Në funksion të zbatimit të marrëveshjes e në përputhje me Kushtetutën, ligjin e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare, më 03.11.2014 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, me ndihmën e OSBE-së, organizoi zgjedhjet për kryetar komunash dhe këshilltarë për asamblatë komunale në Kosovë, përfshirë edhe komunat në pjesën veriore të vendit (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok). Në këto zgjedhje lokale, si shprehje e vullnetit të tyre për t’u integruar në institucionet dhe shoqërinë e Kosovës dhe të realizimit të të drejtave dhe lirive të tyre në institucione legjitime të Republikës së Kosovës, qytetarët me votën e tyre kishin legjitimuar udhëheqësit dhe përfaqësuesit e tyre nëpër komuna.

Por, me gjithë këto veprime pozitive të organeve të Republikës së Kosovës për zbatimin e marrëveshjes, me mbajtjen e zgjedhjeve lokale dhe me nxjerrjen e përfaqësuesve legjitim dhe me gjithë premtimin për integrimin e pjesës veriore të vendit me pjesën tjetër të Republikës së Kosovës, kjo marrëveshje nuk e solli heqjen e barrikadës mbi urën e

---

<sup>31</sup> *Ligji Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*), Pika 7 (“Në Kosovë do të ketë një forcë policore, e quajtur Policia e Kosovës. E tërë policia në Kosovën veriore do të integrohen në kornizën e Policisë së Kosovës.”), Pika 8 (“Pjesëtarëve të strukturave tjera serbe të sigurisë do t’u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.”), Pika 10 (“Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe do të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës.”), Pika 11 (“Zgjedhjet lokale në komunat e veriut do të organizohen në vitin 2013, me lehtësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjin e Kosovës.”)

lumin Ibër, për shkak të rezistencës së kryetarit të Mitrovicës së Veriut, Goran Rakiq, dhe drejtorit të të ashtuquajturës Zyra për Kosovën e Republikës së Serbisë, Marko Gjuriq. Më 27 mars 2014, thuhet një vit pas nënshkrimit të marrëveshjes, kryetari Rakiq ka deklaruar se: “Tani për tani nuk mund të flitet për largimin e barrikadës në urën kryesore të Ibërit, ndërsa ndërtimi i shtëpive të shqiptarëve në veri të Mitrovicës është i pamundur.”<sup>32</sup>

Megjithatë, disa muaj më vonë, më 18 qershor 2014, “[b]arrikada kryesore mbi lumin Ibër ka filluar të largohet rreth orës 1 të mëngjesit” nga grupe personash nga Komuna e Mitrovicës së Veriut.<sup>33</sup> Se kush e ka organizuar heqjen e barrikadës mbetet ende misterioze, por është raportuar gjatë aksionit se “një nga organizatorët serb[ë]” deklaroi thjesht që “[e] kemi bërë me vullnet tonë dhe mjete tona, ashtu siç e kemi vendosur” (*po aty*). Heqja e barrikadës përfundoi rreth orës 5 të mëngjesit, duke e hapur urën për komunikacion të automjeteve për herë të parë pas tri vitesh. Aksioni u vëzhguar nga afër nga njësitë e KFOR-it, EULEX-it dhe Policisë së Kosovës, dhe nuk është shënuar ndonjë incident (*po aty*).

Që në fillimin e asaj dite, largimi i barrikadës përshëndetej me radhë nga zyrtarë vendorë si dhe ndërkombëtarë. Disa ambasadorë të huaj edhe e vizituan urën. Një prej tyre ishte ambasadori i Belgjikës në Republikën e Kosovës, z. Paskal Gregorie, i cili “ka thënë se largimi i barrikadës është një veprim i rëndësishëm drejt normalizimit të situatës mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës” dhe se “heqja e barrikadës është një hap pozitiv”. Sipas ambasadorit Gregorie, “situata reale tregon se asgjë nuk po ndodh dhe se heqja është pranuar si veprim

---

<sup>32</sup> *Zëri*, 27 mars 2014, K. Gecaj, “As barrikada nuk hiqet, e as shtëpitë e shqiptarëve në veri nuk ndërtohen”.

<sup>33</sup> *Koha Ditore*, 18 qershor 2014, “Largohet barrikada mbi Ibër”.

normal nga njerëzit që jetojnë në të dy anët e lumit Ibër”.<sup>34</sup> KFOR-i, i cili e përshëndeti heqjen e barrikadës si një “moment të rëndësishëm”,<sup>35</sup> shtoi trupa të vet për të mbikëqyrur situatën, megjithëse, në një deklaratë për media të lëshuar më vonë, ka konfirmuar mungesën e plotë të incidenteve gjatë ditës: “Në orët e mëngjesit trupa shtesë të KFOR-it janë dërguar në zonë për të përforcuar dhe monitoruar situatën me qëllim për të shmangur çfarëdo lloji të incidenteve, për shkak të turmës së madhe që ishte mbledhur nga kurioziteti, si nga pjesa e veriut ashtu edhe e jugut.”<sup>36</sup> Deklarata ka shtuar se “[n]jë forcë e Reagimit të Shpejtë ishte vendosur në afërsi, e gatshme për të ndërhyrë” (*po aty*).

Politikanët e Kosovës gjithashtu e përshëndetën largimin e barrikadës dhe, natyrisht, filluan gati menjëherë të grindeshin me njëri-tjetrin se kujt i takonin meritat për lajmin e mirë.<sup>37</sup> Mirëpo, grindjet ishin të parakohshme. Rreth orës 13:00, vetëm 8 orë pas përfundimit të heqjes së barrikadës së vjetër, një grup personash sollën vazo betoni të mbjella me lule dhe pisha, duke vendosur një barrikadë të re në të njëjtin vend ku qëndronte barrikada e vjetër. Ky aksion ishte i papritur dhe nuk u kuptua mirë nga palët e përfshira. Për shembull, pasi është informuar se po vendoseshin lulet dhe pishat në urë, kryetari Bahtiri deklaroi se “S’ka ndodhur asgjë. Është duke ndodhur diçka e mirë. . . . Kam informacion të duhur dhe garantoj se do të ndodh[ë] diçka e mirë”.<sup>38</sup>

---

<sup>34</sup> *Koha Ditore*, 18 qershor 2014, “Ambasadorët vizitojnë urën mbi Ibër”. Shih gjithashtu *Lajmi.net*, 18 qershor 2014, “Reichel përshëndet heqjen e barrikadës”.

<sup>35</sup> *Balkan Web*, 18 qershor 2014, “KFOR: Heqja e barrikadës, moment i rëndësishëm”.

<sup>36</sup> *Telegrafi*, 18 qershor 2014, “KFOR: ‘Parku’ në urën e Ibrit i motivuar politikisht”.

<sup>37</sup> *Koha Ditore*, 18 qershor 2014, “Bahtiri thotë se ai e hoqi barrikadën”; *Telegrafi*, 18 qershor 2014, “Thaçi: Largimi i barrikadës, rezultat i marrëveshjes së 19 prillit”; *Telegrafi*, 18 qershor 2014, “Tahiri selam Bahtirit: Mos i merrni meritat që nuk iu takojnë”.

<sup>38</sup> *Zëri*, 18 qershor 2014, “Agim Bahtiri: Do të ndodhë diçka e mirë mbi urën e lumit Ibër”.

Në ndërkohë, Goran Rakiq, në cilësinë e kryetarit të Mitrovicës së Veriut, e emërtoi barrikadën e re “Parku i Paqes”. “Parku i Paqes” e ka bërë urën e lumit Ibër sërish të pakalueshme për automjete, megjithëse mbetet hapësirë për kalimin e këmbësorëve (shih Shtojcën, Figura 1). Sipas G. Rakiq, veprimin për riblokimin e urës e ndërmori ai, në koordinim të plotë me Qeverinë e Republikës së Serbisë: “Mbas diskutimeve të gjata dhe në konsultim me Qeverinë e Serbisë, kemi vendosur për ndërtimin e parkut të paqes mbi urën e Lumit Ibër”.<sup>39</sup> I pranishëm gjatë gjithë aksionit ishte edhe Marko Gjuriq. Ndërkohë që aksioni për riblokimin e urës po vazhdonte, forcat policore të pjesës veriore, ashtu si edhe ato të pjesës jugore, KFOR-i, EULEX-i, nuk ndërmorën asnjë hap, si reagim për ndalimin e këtij aksioni (*po aty*).

Pasi është bërë e qartë se nuk po ndodhte “diçka e mirë” në urën e Ibrit, merita mbeti jetim.<sup>40</sup> Kryetari Agim Bahtiri lëshoi një deklaratë të re, duke e vlerësuar rivendosjen e barrikadës si pengesë për qarkullimin e lirë të qytetarëve.<sup>41</sup> Të nesërmen, më 19 qershor 2014, kryeministri në largim Thaçi, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës shprehu kundërshtimin e tij pas rivendosjes së barrikadës.<sup>42</sup> Gjithashtu, zëvendëskryeministrja Tahiri “tha se me rivendosjen e të ashtuquajturit ‘Parkut të Paqes’ me dimensione të barrikadës, nga serbët e veriut të dirigjuar nga Beogradi, është shkelur marrëveshja e Brukselit për

---

<sup>39</sup> *Koha Ditore*, 18 qershor 2014, “Serbët tani barrikadën e rikthyer e quajnë ‘Parku i Paqes’”.

<sup>40</sup> Shih *Telegrafi*, 18 qershor 2014, “Krasniqi: Barrikada u rikthye, e kujt është merita?”

<sup>41</sup> Deklaratë zyrtare e kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, z. Agim Bahtiri, 18 qershor 2014.

<sup>42</sup> Deklaratë për media e Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi, 19 qershor 2014.

normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe lëvizja e lirë e qytetarëve”.<sup>43</sup>

Pas ndërtimit të “Parkut të Paqes”, tri ndërtime të tjera u ngritën shumë shpejtë. Më 9 korrik 2014, si vazhdimësi e projektit të “Parkut të Paqes”, z. Gjuriq, në cilësinë e drejtorit të të ashtuquajturës Zyra për Kosovën e Republikës së Serbisë, i shoqëruar edhe nga kryetari z. Rakiq, inauguroi ndërtimin e “Sheshit Car Lazar”.<sup>44</sup> Deri më sot, ndërtimi i sheshit duket se është ndërprerë (shih Shtojcën, Figura 2). Megjithatë, edhe në formën e tij të papërfunduar, vërehet një gropë e gjerë e bërë me makineri-eskavator menjëherë përpara rreshtit të pishave të “Parkut të Paqes”, në anën veriore të urës (shih Shtojcën, Figura 3). Kjo sugjeron se, në formën e tij përfundimtare, “Sheshi Car Lazar” do të përfshijë një strukturë ose trotuar të vendosur mu tek hyrja e urës. Në një intervistë për media, kryetarja e Kuvendit të Komunës të Mitrovicës së Veriut, znj. Ksenija Bozhoviq ka deklaruar se është planifikuar të ndërtohet një shëtitore ekskluzivisht për këmbësorët që “do të shtrihet prej ndërtesës së Telekomit të Lagjja e Boshnjakëve, deri te qarkorja pranë Tre Rrokaqiejve”.<sup>45</sup>

Brenda disa ditësh, në dy pjesë të ndryshme të qytetit të Mitrovicës, në “Lagjen e Boshnjakëve” dhe në hyrje të fshatit Suhodoll, në shenjë revolte ndaj nisjes së ndërtimit të “Sheshit Car Lazar”, grupe të tjera qytetarësh kanë vendosur vazo të betonit, me diametër prej 1.5 metra, duke i emërtuar përkatësisht “Sheshi Adem Jashari” dhe “Sheshi

---

<sup>43</sup> *Koha Ditore*, 23 qershor 2014, “Me ‘Parkun e Paqes’, është shkelur marrëveshja e Brukselit”.

<sup>44</sup> *Koha Ditore*, 9 korrik 2014, “Në Mitrovicë sot nis ndërtimi i Sheshit ‘Car Lazar’”.

<sup>45</sup> Bekim Bislimi, *Radio Evropa e Lirë*, 9 korrik 2014, “Nis ndërtimi i sheshit ‘Mbreti Lazar’”.



UÇK”.<sup>46</sup> “Sheshi Adem Jashari” përbëhet nga një vazo dhe një flamur i Republikës së Shqipërisë, ndërsa Sheshi “UÇK” ka një bazë të përbërë prej tri vazove, me disa të tjera përmbi, bashkë me flamurët e Republikës së Shqipërisë, Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (shih Shtojcën, Figurat 4 dhe 5). Siç vërehet qartë në këto foto, vazot e vendosura në këto dy sheshe janë me dimensione të atilla që nuk e bllokojnë lëvizjen e këmbësorëve apo automjeteve, dhe të paktën, sipas njërës prej organizorëve, ky nuk ka qenë qëllimi i vendosjes së tyre: “[Q]ëllimisht nuk kemi dashur të bllokojmë rrugën krejtësisht, për të mos e tensionuar situatën edhe ashtu të brishtë”.<sup>47</sup>

Më 11 korrik 2014, ministri i atëhershëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Dardan Gashi, vlerësoi se vendosja e njëanshme e parqeve, shesheve dhe barrikadave në Komunën e Mitrovicës së Veriut ishin akte ilegale, sepse ishin në kundërshtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës: “Veprimet e tilla përveç që janë ilegale, konsiderohen vepra penale dhe akterët e përfshirë në to pavarësisht pozitive që mbajnë rrezikojnë të ndiqen penalisht”.<sup>48</sup>

Më 16 korrik 2014, kryetari Rakiq dha një intervistë për *Radio Evropa e Lirë*, në të cilën ka bërë një justifikim për ndërtimin e “Parkut të Paqes”, duke pretenduar se: “Menjëherë pas heqjes së barrikadës mbi urë . . . , kam vendosur që t’i qasem ndërtimit të ‘Parkut të paqes’ sepse menjëherë pas heqjes së barrikadës, filluan provokimet nga ana jugore nga ana e shqiptarëve”.<sup>49</sup> Më tej në intervistë, kryetari Rakiq është

---

<sup>46</sup> *Kosova Press*, 10 korrik 2014, “Ndërtohet sheshi ‘Adem Jashari’ në veri të Mitrovicës”; *Koha Ditore*, 11 korrik 2014, “Sheshi ‘UÇK’ në Suhodoll të Mitrovicës veriore”.

<sup>47</sup> *Koha Ditore*, 11 korrik 2014, “Sheshi ‘UÇK’ në Suhodoll të Mitrovicës veriore”.

<sup>48</sup> *Telegrafi*, 11 korrik 2014, “Gashi: Barrikatat akte ilegale”.

<sup>49</sup> *Koha Ditore*, 16 korrik 2014, “Rakiq e cilëson ‘Parkun e paqes’ si përgjigje ndaj provokimit të shqiptarëve”.

përpjekur gjithashtu të dallojë statusin ligjor të Sheshit “Car Lazar” me atë të Shesheve “UÇK” dhe “Adem Jashari”, duke pretenduar se për Sheshin “Car Lazar” “ekziston vendimi i Kuvendit të Komunës”, ndërsa “shqiptarët, pa vendimin e Kuvendit [të Komunës] dhe pa asnjë leje nga pushteti lokal”, kanë ngritur Sheshet “Adem Jashari” dhe “UÇK” (*po aty*).

## **II. Hetimet e zhvilluara nga Institucioni i Avokatit të Popullit**

Pas ngritjes së katër ndërtimeve në veri të Mitrovicës, Avokati i Popullit, më 29 tetor 2014 vendosi të hapë hetime me vetiniciativë (*ex officio*), për të zbuluar nëse ngritja e këtyre ndërtimeve ka paraqitur një shkelje të të drejtave të njeriut, përkatësisht të së drejtës për lëvizjen e lirë, sipas standardeve të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe instrumente ndërkombëtare. Hetimet e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) janë përqëndruar kryesisht në dy aspekte faktike të kësaj çështjeje që janë relevante për analizën e situatës.

Së pari, Avokati i Popullit është interesuar për të ditur nëse, përkundër pretendimeve të ministrit Gashi, ndonjë institucion kompetent ka marrë ndonjë vendim, apo ka shpallur ndonjë plan urbanistik a zhvillimor, sipas të cilit ndërtimet mund të justifikoheshin ligjërisht, ashtu siç ka pretenduar kryetari Rakiq në rastin e “Sheshit Car Lazar”. Së dyti, në rastin e “Parkut të Paqes” në veçanti, Avokati i Popullit është interesuar për të shqyrtuar nëse pretendimi i kryetarit Rakiq, që “menjëherë pas heqjes së barrikadës, filluan provokimet nga ana jugore nga ana e shqiptarëve”, mund të verifikohej dhe të shërbente si justifikim për ribllokimin e urës, fillimisht me vendosjen e “Parkut të Paqes”, të mbështetur më vonë nga “Sheshi Car Lazar”.

Më 12 shtator 2014, përfaqësuesi i IAP-së, në lidhje me këto ndërtime kishte biseduar edhe para se të hapeshin hetimet zyrtarisht, me zyrtaren Kryesore Ekzekutive të Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore, znj. Adriana Hoxhiq, lidhur me katër ndërtimet. Ajo deklaroi se nuk kishte asnjë vendim, as nuk mund të kishte ndonjë vendim për veprime

të tilla, sepse kjo nuk ishte e lejuar sipas ligjit. Sipas saj, nuk mund të merrej një vendim për ndërtim në këtë pjesë dhe aq më pak në urën mbi lumin Ibër. Në këtë mënyrë, znj. Hoxhiq ka kundërshtuar plotësisht pretendimin e lartpërmendur të kryetarit Rakiq, sipas të cilit ndërtimi i Sheshit “Car Lazar” gëzonte miratimin e Kuvendit të Komunës, ndërsa Sheshet “UÇK” dhe “Adem Jashari” janë ndërtuar pa miratim të tillë.

Pasi që u hapën hetimet zyrtarisht, më 22 dhjetor 2014, Avokati i Popullit i dërgoi një letër zyrtares Hoxhiq, duke kërkuar që të përgjigjet me shkrim, nëse është në dijeni për ndonjë vendim të nxjerrë nga ndonjë institucion për ndërtimin e të ashtuquajturit “Parku i Paqes”, sheshi “Car Lazar”, “Sheshi Adem Jashari” dhe “Sheshi i UÇK”, ose a posedon ndonjë informatë nëse ka ndryshuar plani rregullues urban në këtë pjesë të qytetit, që do të mundësonte ndërtimin e këtyre “parqeve” dhe “shesheve”.

Në përgjigjen e saj, të dërguar tek IAP më 22 janar 2015, zyrtarja Hoxhiq sqaroi se: “Zyra jonë nuk është e njoftuar në lidhje me çfarëdo vendimi i cili është sjellur nga çfarëdo institucioni për ndërtimin e të ashtuquajturit ‘Park i Paqes’, ‘Sheshi Car Llazar’ apo ‘Sheshi Adem Jashari’ dhe ‘Sheshi UÇK’”. Zyrtarja Hoxhiq njoftoi gjithashtu se: “Për sa i përket planit urbanistik zhvillimor për komunën e Mitrovicës Veriore, si një komunë e sapoformuar, plani urbanistik akoma nuk është miratuar dhe për këtë arsye ka qenë e pamundur të bëhen çfarëdo ndryshimesh në të njëjtat, që do të mundësonte ndërtimin e këtyre parqeve, shesheve ose pengesave”. Së fundi, zyrtarja Hoxhiq nxori si “konstatim” se: “Të gjitha ngjarjet në lidhje me të ashtuquajturin Park të Paqes, sheshit të Car Llazarit, sheshit të ashtuquajtur Adem Jashari dhe sheshit të UÇK-së, janë politikisht lartë të motivuara dhe zgjidhje e kësaj [ç]ështje pritet të ketë në nivele të larta politike”.

Megjithatë, mes anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, ka dëshmi kundërtënëse sa i përket miratimit ose jo të “Sheshit Car Lazar” nga ky institucion. Pretendimin e kryetarit Rakiq, se “Sheshi Car Llazar” është miratuar, e ka kundërshtuar

zëvendëskryesuesi për komunitete në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Veriut, Emir Azemi. Më 8 dhjetor 2014, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi lidhur me këtë rast me zëvendëskryesuesin Azemi, i cili dëshmoi se çështja e ngritjes së katër ndërtimeve në fjalë nuk është diskutuar asnjëherë në Kuvendin e Komunës dhe se zyrtarisht nuk është marrë kurrfarë vendimi. Por, nga ana tjetër, është raportuar në media se znj. Ksenija Bozhoviq, kryetare e Kuvendit të Komunës, “ka thënë . . . se vendimin për shndërrimin e një pjese të rrugës në zonë të këmbësorëve, . . . e ka sjellë kuvendi i kësaj komune pas propozimit nga disa këshilltarë komunalë”.<sup>50</sup> Ky vendim, sipas saj, më pas i është dorëzuar kryetarit Rakiq para se të fillonin ndërtimet. Kryetarja Bozhoviq ka shtuar se “[k]jo është normale në përputhje me statutin” (*po aty*).

Sa i përket pretendimit tjetër të kryetarit Rakiq, se “menjëherë pas heqjes së barrikadës, filluan provokimet nga ana jugore nga ana e shqiptarëve”, Avokati i Popullit, më 22 dhjetor 2014, i drejtoi një letër komandantit të drejtorisë rajonale të Policisë së Komunës së Mitrovicës së Veriut, Nenad Gjuriq, duke kërkuar që të informohet nëse drejtoria rajonale e policisë ka ndonjë evidencë se, në periudhën prej tetë orësh midis heqjes së barrikadës së vjetër dhe vendosjes së “Parkut të Paqes”, ka pasur provokime nga qytetarët e pjesës jugore të Mitrovicës në drejtim të qytetarëve të pjesës veriore të Mitrovicës dhe anasjelltas, apo ndonjë incident tjetër që do të ndikonte në prishjen e paqes, acarimin e marrëdhënieve ndëretnike apo në cenimin e rendit dhe qetësisë publike. Dhe, në rast se ekzistonte evidencë për provokime të tilla, Avokati i Popullit kërkoj të informohej nëse policia ka ndërmarrë ndonjë veprim tjetër për parandalimin e tyre, para se të vendosej “Parku i Paqes”.

Më 19 janar 2015, komandanti Gjuriq, në përgjigjen e tij dërguar Avokatit të Popullit nëpërmjet postës elektronike, bashkëngjiti një

---

<sup>50</sup> Bekim Bislimi, *Radio Evropa e Lirë*, 9 korrik 2014, “Nis ndërtimi i sheshit ‘Mbreti Lazar’”.

dokument me titullin “18.06.2014, Turni i 08.00–20.00h”, në të cilën, sipas tij, “shihet raportimi dërguar qendrës operative të stacionit policor të Mitrovicës Veriore të cilët kanë hasur në sjellje negative në afërsi të urës së përmendur (koha dhe raportimi janë shënuar me shkronja të kuqe)”. Në dokumentin e bashkëngjitur me mesazhin e tij, ishin vetëm dy raportime me shkronja të kuqe, njëri i shënuar në orën 12:08 dhe tjetri në orën 12:16. Këto shënime kanë pohuar, përkatësisht, se: “Është e nevojshme ardhja e një patrulle deri tek ura kryesore, tek rrethrotullimi, janë disa persona aty” dhe se “Gjindem në urën kryesore, janë fotografuar në anën veriore të urës, disa persona u kanë hedhur fjalë, i kanë sharë, nuk ka pasur asgjë më shumë, do të përforcojmë patrullimin këtu”. Në letrën e komandantit Gjuriq, konfirmohet se, pas kësaj situatë, “policia ka marrë masa dhe veprime parandaluese në mënyrë që të parandalohet prishja e rendit dhe qetësisë publike”. Asnjë incident tjetër nuk është shënuar lidhur me urën e lumit Ibër, dhe asnjë informacion tjetër nuk iu ofrua Avokatit të Popullit.

## **ANALIZA JURIDIKE**

### **I. E drejta për lirinë e lëvizjes sipas nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 2 të Protokollit 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 12 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe nenit 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut**

Katër ndërtimet në fjalë rrezikojnë të paraqesin një shkelje të së drejtës për lirinë e lëvizjes, e cila është një ndër të drejtat universalisht më të njohura. Kjo e drejtë garantohet shprehimisht jo vetëm nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, por edhe nga tri instrumente ndërkombëtare që, sipas nenit 22 të Kushtetutës, janë të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Sipas nenit 35, pika 1 të Kushtetutës, “Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës”. E drejta për lirinë e

lëvizjes konfirmohet gjithashtu nga neni 2 i Protokollit 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të”), neni 12, pika 1 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (“Secili që ndodhet ligjërisht në territorin e një shteti ka të drejtë të lëvizë lirisht brenda këtij territori”) dhe neni 13, pika 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (“Secili ka të drejtën e lirisë së lëvizjes . . . brenda kufijve të një shteti”).

**II. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së katër ndërtimeve në Komunën e Mitrovicës së Veriut, në bazë të së drejtës për lirinë e lëvizjes, sipas nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 2 të Protokollit 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nenit 12 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe nenit 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut**

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së katër ndërtimeve në fjalë në bazë të së drejtës së lirisë së lëvizjes, mund të ndahet në dy hapa. Në hapin e parë, duhet të pyesim nëse katër ndërtimet në fjalë paraqesin një *kufizim* të së drejtës për lirinë e lëvizjes. Nëse konkludojmë që ka pasur një kufizim të tillë, atëherë në hapin e dytë duhet të pyesim nëse ky kufizim është i justifikuar sipas disa kritereve të përcaktuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare për lejueshmërinë e kufizimeve të tilla.

**A. Ekzistenca e kufizimit**

Tek hapi i parë, është e qartë, në rastin e “Parkut të Paqes”, që ky ndërtim paraqet një kufizim në të drejtën e lirisë së lëvizjes. Megjithëse këmbësorët kanë hapësirë për ta kaluar urën nëpër trotuare në dy anët e “Parku i Paqes” (shih Shtojcën, Figura 1), është po aq e qartë se automjetet nuk mund ta kalojnë urën. Duke e bërë të pamundur që automjetet të shfrytëzojnë këtë urë për të kaluar nga pjesa jugore e Mitrovicës në pjesën veriore dhe anasjelltas, “Parku i Paqes” kufizon të drejtën e individëve për lëvizjen e lirë në territorin e Republikës së Kosovës.

Për të njëjtën arsye, edhe “Sheshi Car Lazar” mund të konsiderohet se paraqet një kufizim në të drejtën e individëve për lëvizjen e lirë. Siç kemi vërejtur më sipër, nga ndërtimet e deritanishme të sheshit, një pjesë e tij do të përfshijë një strukturë ose trotuar ende të pavendosur tek hyrja e urës në anën veriore të saj. Kjo strukturë, çfarëdo që të bëhet, do të bllokojë edhe më shumë kalimin e automjeteve përmes urës, duke penguar më tej lëvizjen e automjeteve midis dy pjesëve të qytetit të Mitrovicës.

Megjithatë, e njëjta nuk mund të pretendohet në rastin e dy ndërtimeve të tjera, “Sheshi UÇK” dhe “Sheshi Adem Jashari”. Siç tregohet në foto, këto dy sheshe—të paktën tani për tani, pa paragjykuar ndonjë zgjerim të mundshëm në të ardhmen—nuk pengojnë lëvizjen as të këmbësorëve, as të automjeteve. Prandaj, nuk mund të thuhet se këto dy struktura e kufizojnë të drejtën e lirisë së lëvizjes.

Kundër këtij argumenti, a mund të kundërpërgjigjet se nuk mund të thuhet që këto dy sheshe nuk e kufizojnë të drejtën e lëvizjes së lirë *aspak*, por thjesht se e kufizojnë këtë të drejtë në një masë *më të vogël* sesa “Parku i Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar”? Natyrisht, çdolloj struktura fizike pengon lëvizjen e njerëzve deri në njëfarë mase, nga vetë fakti që zë një hapësirë, sado e vogël që të jetë ajo hapësirë. Por, fakti kyç në këtë rast është se dy sheshet në fjalë, “Sheshi UÇK” dhe “Sheshi Adem Jashari”, nuk zënë hapësirë deri në atë masë sa të pengojnë ose të bllokojnë kalimin e këmbësorëve apo automjeteve në rrugë. Nëse një shitës mallrash i vetëm, me hapësirën që zë duke qëndruar në rrugë me mallrat e tij, nuk mund të konsiderohet se e kufizon të drejtën e të tjerëve për lirinë e lëvizjes, atëherë as një ose disa vazo betoni që kanë diametër prej 1.5 metrash nuk mund të cilësohet si kufizim i tillë. Sigurisht, nëse vendosen në një rrugë një grup shitësish deri në atë masë sa të bëjnë të pamundur ose tejet të vështirë kalimin e këmbësorëve dhe automjeteve, atëherë kjo mund të konsiderohet një kufizim i së drejtës për lëvizjen e lirë. Në të njëjtën mënyrë, kur një strukturë, ose disa struktura bashkë, bëhen kaq të mëdha sa të pengojnë lëvizjen e njerëzve dhe automjeteve, atëherë

mund të konsiderohet kufizim i së drejtës për lëvizjen e lirë. Sipas këtij standardi, “Parku i Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar” përbëjnë kufizime të kësaj të drejte, ndërsa “Sheshi UÇK” dhe “Sheshi Adem Jashari” nuk paraqesin një kufizim të tillë.

## **B. Lejueshmëria e kufizimit**

Në pyetje tani mbetet vetëm kushtetutshmëria e dy prej katër ndërtimeve, ajo e “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar”, dy strukturat që paraqesin një kufizim të së drejtës për lirinë e lëvizjes. Në mënyrë që një kufizim i kësaj të drejte të jetë i lejueshëm, duhet të plotësojë tri kritere.

### **1. Kriteret e lejueshmërisë së kufizimit**

Së pari, Kushtetuta dhe instrumentet ndërkombëtare përcaktojnë shprehimisht se çdo kufizim i së drejtës për lëvizjen e lirë duhet të jetë **në përputhje me ligj**. Kushtetuta përcakton në përgjithësi që “[t]ë drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj” (neni 55, pika 1), kurse dy instrumente ndërkombëtare përcaktojnë, përkatësisht për të drejtat që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes, që këto të drejta “mund të kufizohen vetëm kur kjo parashikohet me ligj” (Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 12, pika 3) dhe që “[u]shtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj” (KEDNJ, Protokollu 4, neni 2, pika 3).

Së dyti, e drejta e lirisë së lëvizjes mund të kufizohet vetëm **për qëllime të përcaktuara**: “Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm . . . të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi”, dhe “[k]ufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar” (Kushtetuta, neni 55, par. 2 dhe 3). Në rastin e së drejtës për lirinë e lëvizjes, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike përcakton se kufizime të kësaj të drejte lejohen vetëm me qëllim “për të mbrojtur sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin ose moralin



publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve” (neni 12, par. 3), ndërsa KEDNJ, në mënyrë të ngjashme, përcakton se e drejta për lëvizjen e lirë mund të kufizohet vetëm “për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë të të tjerëve” (Protokolli 4, neni 2, par. 3).

Së treti, Kushtetuta dhe KEDNJ përcaktojnë se, në mënyrë që e drejta e lëvizjes së lirë të kufizohet, kufizimi duhet të jetë **i domosdoshëm në një shoqëri demokratike**: “Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme . . . në një shoqëri të hapur dhe demokratike” (Kushtetuta, neni 55, par. 2), dhe “[u]shtrimi i këtyre të drejtave [për lirinë e lëvizjes] nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato . . . të domosdoshme në një shoqëri demokratike” (Protokolli 4, neni 2, par. 3).

Termi ‘*i domosdoshëm në një shoqëri demokratike*’ ka një kuptim teknik në vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në harmoni me të cilat duhet të interpretohen të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të përcaktuara në Kushtetutë (shih Kushtetutën, neni 53). Sipas kësaj Gjykate, “[n]jë kufizim do të konsiderohet ‘i domosdoshëm në një shoqëri demokratike’ për një qëllim legjitim nëse i përgjigjet një nevoje të rëndësishme shoqërore dhe, në veçanti, nëse është *proporcional me qëllimin legjitim të synuar*” (theks i shtuar).<sup>51</sup> Lidhjen midis konceptit të ‘domosdoshmërisë në një shoqëri demokratike’ dhe konceptit të ‘proporcionalitetit’ e ka pohuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Sipas kësaj Gjykate, “[n]ocioni i termit ‘e nevojshme . . . në një shoqëri të hapur dhe demokratike’, duhet të lexohet në lidhje me kërkesat specifike të

---

<sup>51</sup> Rasti *Yordanova dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, Aplikimi Nr. 25446/06, GJEDNJ (2012).

dhëna në paragrafet 3, 4 dhe 5, të nenit 55”, i cili përmban “testi[n] e proporcionalitetit”.<sup>52</sup> Për të vlerësuar nëse një kufizim është proporcional, dhe në këtë mënyrë ‘i domosdoshëm në një shoqëri demokratike’, kufizimi duhet të konsiderohet nga pesë aspekte:

- a. *Thelbi i së drejtës kushtetuese;*
- b. *Rëndësia e qëllimit të kufizimit;*
- c. *Natyra dhe shkalla e kufizimit;*
- d. *Lidhja ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që duhet të arrihet; dhe*
- e. *Mundësia e arritjes së atij qëllimi me kufizim më të vogël (po aty, par. 132).*

Prandaj, në mënyrë që “Parku i Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar” të jenë kufizime të lejueshme të së drejtës për lirinë e lëvizjes, ngritja e tyre duhet të përmbushë tri kritere: (1) duhet të jetë në përputhje me ligj, (2) duhet të përmbushë një nga qëllimet e përcaktuara dhe (3) duhet të jetë ‘e domosdoshme në një shoqëri demokratike’ ose, me fjalë të tjera, duhet të jetë një mjet proporcional për të arritur qëllimin e përcaktuar.

## **2. Zbatimi i kriterëve të lejueshmërisë në rastin konkret**

Sa i përket kriterit të parë, që kufizimi të jetë në përputhje me ligj, pikënisja e analizës sonë duhet të jetë Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, i cili përcakton se: “Komunat i ushtrojnë kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin” (neni 16), ndërsa termi “kompetencat vetanake . . . do të thotë kompetencat që u jepen komunave me kushtetutë apo me ligj, për të cilat ato janë plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin” (neni 3). Në nenin 17 të po këtij Ligji, përcaktohen një sërë kompetencash vetanake, “duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm”. Një prej kompetencave vetanake të përcaktuara është kompetenca për “planifikimin urban dhe

---

<sup>52</sup> Rasti Nr. KO131/12, Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim, 15 prill 2013, par. 132 dhe 127.

rural” (neni 17, pika (b)) dhe për “ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike” (*po aty*, pika (p)).

Në të tri nenet e lartpërmendura, theksohet se kompetencat vetanake duhet të jenë “në përputhje me ligjin” (*po aty*, neni 3 dhe 16) dhe duhet të ushtrohen “duke i respektuar standardet e përcaktuar[a] në legjislacionin e zbatueshëm” (*po aty*, neni 17).

Prandaj, duhet të pyesim se cili është “legjislacioni i zbatueshëm” që rregullon fushën e ndërtimit të strukturave si “Parku i Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar”. Ndërtimi i këtij lloj strukture rregullohet nga Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor. Në veçanti, ky ligj parashikon një sërë “Dokumente[sh] për Planifikimin Hapësinor”, me të cilat të gjitha ndërtimet publike si dhe private duhet të përputhen: “Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Plani Hapësinor për Zona të Veçanta, Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Plani Rregullues i Hollësishëm” (neni 3, pika 1.1).

Tri nga këto dokumente (Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Plani Rregullues i Hollësishëm), ndodhen brenda jurisdiksionit të pushtetit lokal (shih *po aty*, neni 5, pika 1.2). Procedura e hartimit dhe miratimit të këtyre dokumenteve përbën disa hapa specifikë. Në hapin e parë, këto dokumente duhet të hartohen nga një “Autoritet përgjegjës Komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor . . . në përputhje të plotë me Planin hapësinor të Kosovës, Hartën zonale të Kosovës dhe me normat teknike të planifikimit hapësinor” (*po aty*, neni 11, pikat 1 dhe 1.2). Në hapin e dytë, këto dokumente duhet të miratohen nga “Drejtoritë sektoriale të Komunës” (*po aty*, neni 10, pikat 2.2 dhe 2.3). Dhe, në hapin e fundit, këto dokumente duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës (*po aty*).

Është me rëndësi të theksohet se procesi i hartimit dhe finalizimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor nuk zhvillohet në izolim. Përkundrazi, Ligji parashikon që: “Autoritetet e planifikimit hapësinor para se t’i finalizojnë të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor të paraparë në këtë ligj, përmes njoftimit publik ftojnë qytetarët dhe

zhvillojnë konsultime dhe shqyrtime publike” (*po aty*, neni 20, pika 1). Përfshirja e publikut në këtë proces, siguron që shfrytëzimi i hapësirave të Komunës u përgjigjet vlerave demokratike, “në mënyrë që . . . të inkurajojnë pjesëmarrjen transparente të publikut; . . . të përfshijë vlerësimet publike lidhur me ndikimet e mundshme sociale, ekonomike dhe mjedisore; . . . [dhe] të sigurohet pjesëmarrja e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor” (*po aty*, neni 20, pika 1.1., 1.2 dhe 1.4). Prandaj, ndërtimi i strukturave jashtë procesit të parashikuar me ligj, sidomos në raste kur këto struktura kufizojnë lëvizjen e lirë të individëve, nuk përbën thjesht një anashkalim të rregullave të rëndomta burokratike, por një shkelje të parimeve të demokracisë dhe transparencës publike.

Të gjitha këto dispozita duhet t’i marrim parasysh kur pyesim nëse “Parku i Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar”, si kufizime të së drejtës për lirinë e lëvizjes, janë në përputhje me ligj, ashtu siç kërkohet nga Kushtetuta dhe instrumente ndërkombëtare. Në mënyrë që të jenë të ligjshme, këto dy struktura duhet të përputhen me tri dokumentet e planifikimit hapësinor në nivelin komunal, dhe këto dokumente vetë duhet të kishin kaluar hapat e lartcekur, përfshirë edhe konsultime me publikun e gjerë, për hartimin dhe miratimin e tyre.

Në rastin e “Parkut të Paqes”, dështimi i tij ligjor është tepër i dukshëm. Kjo strukturë ka filluar të ndërtohej vetëm tetë orë pas heqjes së barrikadës së vjetër, dhe prandaj, nuk ka pasur mjaft kohë për t’u përfshirë në ndonjë dokument për planifikim hapësinor, edhe po të ekzistonte. Për më tepër, kryetari Rakiq, i cili ka qenë udhëheqësi i këtij projekti bashkë me z. Marko Gjuriq, nuk ka pretenduar të kishte marrë miratimin e ndonjë organi kompetent të Republikës së Kosovës para se të ndërtohej “Parku i Paqes”. Në fakt, siç u pa më sipër, sipas vetë kryetarit Rakiq, të vetmet autoritete të konsultuara lidhur me ngritjen e këtij ndërtimi ishin ato të Republikës së Serbisë dhe jo ato të Republikës së Kosovës. Prandaj, ngritja e “Parkut të Paqes” ka qenë një kufizim qartazi i kundërligjshëm i një të drejte të njeriut dhe, për këtë arsye, dështon që nga hapi i parë i vlerësimit të saj kushtetues.

Çështja e “Sheshit Car Lazar” është paksa më e ndërlikuar. Siç është cekur në përmbledhjen e fakteve, ka dëshmi kundërthënëse sa i përket miratimit ose jo të ndërtimit të kësaj strukture nga Kuvendi i Komunës. Nga njëra anë, kryetarja e Kuvendit të Komunës, znj. Bozhoviq ka mbështetur kryetarin Rakiq në pretendimin e tij, se ky projekt është miratuar nga Kuvendi i Komunës, në përputhje me statutin e Komunës. Nga ana tjetër, zëvendëskryetari i Kuvendit të Komunës, z. Azemi, dhe zyrtarja kryesore e Zyrës Administrative, znj. Hoxhiq, e kanë mohuar këtë pretendim.

Avokati i Popullit nuk është në pozitë për të konstatuar se cila palë ka të drejtë lidhur me këtë çështje. Megjithatë, Avokati i Popullit e konsideron jashtëzakonisht shqetësues faktin se katër nga zyrtarët më të lartë të Komunës kanë informata të ndryshme mbi një pikë kaq të rëndësishme, dhe njëkohësisht kaq të thjeshtë, faktike. Edhe po të dalin të vërteta pohimet e kryetarit Rakiq dhe kryetares së Kuvendit Bozhoviq, që projekti i “Sheshit Car Lazar” është miratuar nga Kuvendi komunal, ky rast tregon se ata po dështojnë plotësisht jo vetëm të bashkëpunojnë me zyrtarët e tjerë, por edhe t’i mbajnë të informuar për veprimtaritë më të thjeshta të Kuvendit të Komunës, edhe për çështje të rëndësishme zyrtare.

Megjithatë, lidhur me vlerësimin kushtetues të “Sheshit Car Lazar”, miratimi ose jo i kësaj strukture nga ana e Kuvendit komunal nuk është vendimtar për ligjshmërinë e saj. Ligji për Planifikimin Hapësinor nuk parashikon askund në nenin 10 të tij (“Përgjegjësitë e Kuvendit Komunal në Planifikimin Hapësinor”) kompetencën e Kuvendit Komunal për të miratuar një ndërtim individual jashtë kornizës së Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor. Përkundrazi, nga dispozitat ligjore të diskutuara më lartë, pyetja relevante nuk është thjesht, “A ka dhënë Kuvendi i Komunës miratimin e tij për ‘Sheshin Car Lazar’?”, por “A po ndërtohet ‘Sheshi Car Lazar’ në përputhje me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor që kanë kaluar tre hapat e hartimit dhe miratimit të parashikuar me ligj, duke përfshirë edhe konsultimin e qytetarëve të Komunës?”

Fatkeqësisht, këto kërkesa ligjore nuk janë plotësuar aspak. Në përmbledhjen e fakteve, kemi parë se zyrtarja kryesore për Komunën e Mitrovicës së Veriut, znj. Hoxhiq, ka njoftuar Avokatin e Popullit që, “si një komunë e sapo formuar, plani urbanistik akoma nuk është miratuar dhe për këtë arsye ka qenë e pamundur të bëhen çfarëdo ndryshimesh në të njëjtat, që do të mundësonte ndërtimin e këtyre parqeve, shesheve ose pengesave”, duke përfshirë “Parkun e Paqes” dhe “Sheshin Car Lazar”. Në bazë të kësaj informate, Avokati i Popullit konstaton se, pavarësisht nga miratimi ose jo nga ana e Kuvendit komunal, i cili mbetet një çështje e mjegullt, ndërtimi i “Sheshit Car Lazar” nuk ka qenë në përputhje me Ligjin për Planifikimin Hapësinor. Në veçanti, Avokati i Popullit e konsideron jashtëzakonisht shqetësues faktin se ndërtimi i një strukture të tillë, e cila ndodhet në një ndër pikat kryesore të Komunës, dhe e cila bllokoi hyrjen e një prej pikëkalimeve të vetme me komunën fqinje, është nisur në mënyrë krejt jotransparente dhe pa përfshirjen e publikut, përkundër kërkesave të qarta ligjore. Prandaj, “Sheshi Car Lazar”, bashkë me “Parkun e Paqes” përbën një kufizim të kundërligjshëm të së drejtës për lëvizjen e lirë dhe, për këtë arsye, mund të konsiderohet si **shkelje e Kushtetutës dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**.<sup>53</sup>

Megjithëse këto dështime më vete përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të quajtur ngritjen e “Parkut të Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar” një shkelje të të drejtave të njeriut, mund të jetë e dobishme për t’i vlerësuar këto struktura edhe nga këndvështrimi i kriterit të dytë dhe të tretë për lejueshmërinë e kufizimit të së drejtës për lirinë e lëvizjes. Këto kritere mund të trajtohen bashkë. Sipas tyre, çdo kufizim i së

---

<sup>53</sup> Kemi vërejtur që, në intervistën e saj për media, kryetarja e Kuvendit Bozhoviq ka pretenduar se procedura e miratimit të “Sheshit Car Lazar” të përcaktuar me Statutin e Komunës është zbatuar në këtë rast. Kjo është plotësisht e pavërtetë. Askund në statutin e Komunës nuk i jepet Kuvendit të Komunës e drejta për të miratuar ndërtime individuale jashtë kornizës së Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor.

drejtës për lëvizjen e lirë duhet të ketë një **qëllim legjitim** dhe duhet të jetë **një mjet proporcional** për të arritur këtë qëllim.

Siç u përmend më sipër, ka një listë qëllimesh specifike, të përcaktuara nga KEDNJ dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, për të cilat lejohen kufizimet e së drejtës për lëvizjen e lirë. Cili ka qenë qëllimi i ngritjes së “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar”? Sipas kryetarit Rakiq, bllokimi i urës është bërë për arsye se “menjëherë pas heqjes së barrikadës, filluan provokimet nga ana jugore nga ana e shqiptarëve”. Nëse e marrim si të mirëqenë këtë pretendim, do të mund të konsiderohej se ngritja e “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar” kishte një qëllim legjitim, sepse të dyja Konventat ndërkombëtare të lartpërmendura njohin ruajtjen e “rendit publik” si një ndër qëllimet për të cilat lejohet kufizimi i së drejtës për lëvizjen e lirë.

Megjithatë, kemi arsye për të dyshuar se këto dy struktura, në fakt, janë ngritur për këtë qëllim, sepse në të njëjtën ditë kur është ribllokuar ura me ndërtimin e “Parkut të Paqes”, kryetari Rakiq nuk ka përmendur fare çështjen e provokimeve si justifikim për ngritjen e saj. Ai ka thënë vetëm se “Parku i Paqes” është ngritur “[m]bas diskutimeve të gjata dhe në konsultim me Qeverinë e Serbisë”. Çështjen e provokimeve nuk e ka përmendur kryetari Rakiq deri më 16 korrik 2014, pothuajse një muaj pas ndërtimit të “Parkut të Paqes”. Kjo krijon të paktën një dyshim të arsyeshëm se qëllimi i vërtetë i ndërtimit të tij, dhe të “Sheshit Car Lazar” më pas, nuk kishte të bënte me ruajtjen e rendit publik.

Megjithatë, edhe nëse, për hir të argumentit, e marrim si të mirëqenë sinqeritetin dhe seriozitetin e pretendimit të kryetarit Rakiq, lidhur me qëllimin e ribllokimit të urës, mbetet për të vlerësuar nëse ky ribllokim mund të konsiderohet mjet *proporcional* për arritjen e këtij qëllimi. Siç kemi parë më sipër, për të vlerësuar nëse një kufizim i një të drejte të njeriut është proporcional, duhet të konsiderohet nga pesë aspekte:

- a. *Thelbi i së drejtës kushtetuese;*
- b. *Rëndësia e qëllimit të kufizimit;*

- c. *Natyra dhe shkalla e kufizimit;*
- d. *Lidhja [racionale] ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që duhet të arrihet; dhe*
- e. *Mundësia e arritjes së atij qëllimi me kufizim më të vogël (Rasti Nr. KO131/12, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, par. 132).*

Mund të argumentohet se kushti i parë përmbushet relativisht lehtë. “Parku i Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar” nuk arrijnë deri në atë masë që e mohojnë thelbin ose esencën e së drejtës për lirinë e lëvizjes. Megjithëse ato ndodhen në një vend kalimi të rëndësishëm, dhe e bëjnë më të vështirë kalimin midis Komunave të Mitrovicës së Veriut dhe Mitrovicës së Jugut, nuk e bëjnë tërësisht të pamundur lëvizjen midis dy komunave, përderisa ura mund të kalohet në këmbë, dhe ekziston një pikë tjetër, në Lagjen e Boshnjakëve, ku edhe automjetet mund të kalojnë midis dy pjesëve të qytetit. Prandaj, mund të argumentohet se asnjë individ nuk është privuar nga *esenca* e së drejtës së individëve për të lëvizur nëpër territorin e Republikës së Kosovës, megjithëse lëvizja e tillë është bërë më e vështirë.

Megjithatë, ngritja e “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar” dështojnë të përmbushin katër kushtet e tjera të proporcionalitetit. Mund të fillojmë duke vërejtur se në këtë rast nuk ka pasur ndonjë “lidhje [racionale] ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që duhet të arrihet”. Siç kemi theksuar disa herë, as gjysma e ditës nuk kishte kaluar pas përfundimit të heqjes së barrikadës së vjetër kur ka filluar të ribllokohet ura me ngritjen e “Parkut të Paqes”, të mbështetur më pas nga “Sheshi Car Lazar”. Gjatë kësaj periudhe disaorëshe, vetëm një incident, që mund të konsiderohet prishje e paqes, është shënuar nga Policia. Raportimi i orës 12:08 pohon se “janë disa persona” që u paraqitën në urë, të cilët, në orën 12:16, “u kanë hedhur fjalë” dhe “i kanë sharë” disa persona të tjerë. Por, raportimi i orës 12:16 thekson gjithashtu se “nuk ka pasur asgjë më shumë”.



Kur i vlerësojmë këto pretendime, duhet të marrim parasysh dëshmitë e aktorëve ndërkombëtarë që tregojnë, njëzëri, që asnjë problem nuk ka ndodhur tek ura pas heqjes së barrikadës së vjetër, përfshirë edhe dëshminë e KFOR-it, i cili kishte sjellë trupa shtesë posaçërisht për të monitoruar situatën. Avokati i Popullit e konsideron pothuajse të pamundur që, me gjithë këta dëshmitarë në skenë, askush tjetër përveç Policisë së Mitrovicës së Veriut, nuk ka vërejtur incidentin që pretendohet të kishte ndodhur. Por, duke lënë mënjanë edhe këtë dyshim, mund të pyesim, a do të mjaftonte ky incident i vetëm, edhe po të kishte ndodhur, për të krijuar një lidhje racionale midis bllokimit të urës dhe qëllimit të ruajtjes së rendit publik?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të vërejmë faktin që raportimi i policisë pretendon vetëm se “*janë disa persona aty [tek ura]*” (theks i shtuar). Nga ky raportim mund të logjikohet se personat në fjalë ishin disa këmbësorë që po qëndronin tek ura, jo shoferë ose pasagjerë të një automjeti që po kalonte urën. Por, “Parku i Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar” bllokojnë vetëm kalimin e automjeteve, jo qëndrimin e këmbësorëve. Nuk ka asnjë evidence që, brenda periudhës disaorëshe midis heqjes së barrikadës së vjetër dhe riblokimit të urës, ka pasur ndonjë prishje të rendit publik që është shkaktuar nga mundësia e kalimit të automjeteve tek ura e lumit Ibër, apo nga qasja më e lehtë në veri të Mitrovicës nga jugu. Incidenti i vetëm i shënuar nga Policia, duke përfshirë vetëm këmbësorë, do të mund të ndodhte edhe sot, me gjithë riblokimin e urës për automjetet. Për këtë arsye, ky incident nuk përbën asnjë bazë për të menduar se ngritja e “Parkut të Paqes” dhe “Sheshi Car Lazar”, duke bllokuar vetëm kalimin e automjeteve por jo edhe qëndrimin e këmbësorëve, i ka kontribuar qëllimit të ruajtjes së rendit publik. Prandaj, në këtë rast, Avokati i Popullit konsideron se **mungon një lidhje racionale midis kufizimit të së drejtës dhe qëllimit të pretenduar.**

Edhe tre faktorët e tjerë, që mbeten për vlerësimin e proporcionalitetit, janë mjaft problematikë për “Parkun e Paqes” dhe “Sheshin Car Lazar”.

Tek faktori i dytë, duhet të konsiderojmë “rëndësinë e qëllimit të kufizimit”. Në shikim të parë, mund të duket se qëllimi i supozuar për riblokimin e urës, ruajtja e rendit publik, është mjaft i rëndësishëm, përderisa përmendet shprehimisht në dy konventat ndërkombëtare të lartcekura, si një justifikim i lejueshëm posaçërisht për kufizimin e së drejtës që po analizojmë.

Por analiza e rëndësisë së qëllimit nuk mund të përfundojë me kaq. Dy elemente të tjera të analizës duhen marrë parasysh. Së pari, duhet të dallojmë midis kërcënimeve të shkallëve të ndryshme ndaj rendit publik. Për shembull, kërcënime ndaj rendit publik që paraqesin një rrezik të lartë të vdekjes së njerëzve mund të konsiderohen tepër serioze. Ruajtja e rendit publik prej kërcënimeve të tilla mund të cilësohet si një qëllim i rëndësisë shumë të lartë. Në ekstremin tjetër, kërcënime ndaj rendit publik mund të jenë të natyrave më të zakonshme, si p.sh. përleshje midis të dehurve apo përleshje midis tifozëve sportivë, që mund të gjenden lehtë në rrugët e çdo qyteti të madh në orët e vona të fundjavës. Ruajtja e rendit prej përleshjeve të tilla nuk është pa rëndësi fare, por kuptohet se rëndësia e saj është shumë më e ulët sesa rëndësia e ruajtjes së rendit në çështje më serioze që përfshijnë vdekjen e njerëzve ose lëndime të rënda trupore. Prandaj, pyetja jonë nuk duhet të jetë “A është qëllimi i ruajtjes së rendit publik një qëllim i rëndësishëm në abstrakt?”. Në vend të kësaj, pyetja jonë duhet të jetë “A është i rëndësishëm, dhe sa i rëndësishëm është, qëllimi i ruajtjes së rendit publik *prej kërcënimeve ndaj rendit publik të shfaqura në situatën specifike që po analizohet*”.

Së dyti, kur kemi të bëjmë me vlerësimin e proporcionalitetit të një kufizimi, çështja e rëndësisë së qëllimit të kufizimit nuk mund të analizohet e izoluar nga një prej faktorëve të tjerë të proporcionalitetit, “natyra dhe shkalla e kufizimit”. Rëndësia e qëllimit të një kufizimi gjithmonë duhet vlerësuar *si bazë e mjaftueshme ose jo e mjaftueshme për të justifikuar kufizimin në fjalë, duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e kufizimit*. Duke bashkuar këtë faktor me të parin, pyetja jonë nuk mund të jetë “A është qëllimi i ruajtjes së rendit publik një qëllim i

rëndësishëm abstrakt” por “A është *mjaft i rëndësishëm* qëllimi i ruajtjes së rendit publik *prej kërcënimeve të shfaqura në situatën specifike*, përkatësisht *për të justifikuar natyrën dhe shkallën e kufizimit të vendosur në këtë situatë specifike*”.

Duke e konkretizuar këtë pyetje me faktet e rastit tonë, ajo mund të formulohet si në vijim: “A është qëllimi i ruajtjes së rendit publik *prej hedhjes së fjalëve dhe sharjeve midis individëve* një qëllim mjaft i rëndësishëm për të justifikuar *bllokimin e plotë të lëvizjes së automjeteve në një ndër pikat e vetme ndërlidhëse midis dy komunave?*”

Avokati i Popullit konsideron që ky qëllim nuk është mjaft i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës për lëvizjen e lirë deri në këtë masë të skajshme. Sharjet dhe hedhja e fjalëve janë një fakt i jetës njerëzore në çdo qytet dhe fshat në mbarë botën. Paqen e plotë midis njerëzve, pa asnjë përjashtim verbal a fizik, mund ta synojmë si një ideal të rëndësishëm në një shoqëri demokratike ideale, por megjithatë, nuk mund të arrihet plotësisht. Nëse parandalimi i sharjeve dhe hedhjes së fjalëve do të shërbente si bazë e mjaftueshme për të justifikuar bllokimin e rrugëve nga kalimi i automjeteve, atëherë nuk do të kishim asnjë rrugë të hapur për automjete në tërë botën, e as në Republikën e Kosovës. Avokati i Popullit nuk mund të pranojë një rezultat të tillë kaq absurd, dhe për këtë arsye konsideron se qëllimi i ngritjes së “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar” nuk ka qenë mjaft i rëndësishëm për të justifikuar bllokimin e plotë të urës së lumit Ibër.

Mbetet për të vlerësuar faktorin e fundit në testin e proporcionalitetit, “mundësia e arritjes së atij qëllimi me kufizim më të vogël”. Edhe ky faktor duhet analizuar duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e kufizimit. Duhet të pyesim nëse ruajtja e rendit publik ka kërkuar në të vërtetë që të kufizohet e drejta e lëvizjes së lirë deri në atë shkallë sa të bllokohet kalimi i automjeteve në urën e lumit Ibër, ose a ka pasur ndonjë mënyrë tjetër për të ruajtur rendin publik, duke e kufizuar më pak lëvizjen e lirë?

Përgjigjja e kësaj pyetje është e thjeshtë. Së pari, vetë raportimi i Policisë tregon se policët në vendin e ngjarjes kanë ndërmarrë hapa menjëherë për ruajtjen e rendit publik (“do të përforcojmë patrullimin këtu”), dhe letra e komandantit Gjuriq lidhur me këtë çështje nënkupton se këto përpjekje kanë qenë të suksesshme: “policia ka marrë masa dhe veprime parandaluese në mënyrë që të parandalohet prishja e rendit dhe qetësisë publike”. Prandaj, sipas dëshmive të pranuar, mund të kuptohet se ruajtja e rendit publik është arritur pas incidentit të vetëm që është shënuar, pa pasur nevojë për ngritjen e “Parkut të Paqes”. Kjo do të thotë se qëllimi i kufizimit, jo vetëm që mund të arrihej me një kufizim më të vogël të së drejtës në fjalë, por qëllimi në fakt u arrit shumë lehtë, pa pasur nevojë për t’u kufizuar aspak e drejta për lëvizjen e lirë. Gjithashtu, ia vlen për të theksuar se në këtë rast kemi të bëjmë me një bllokim të plotë të lëvizjes së automjeteve. Edhe po të ishte e domosdoshme, për ruajtjen e rendit publik, për të kufizuar lëvizjen e automjeteve deri në një farë mase, nuk ka asnjë evidencë që sugjeron se bllokimi i plotë ishte i domosdoshëm. Një ndër themelet e testit të proporcionalitetit, kur kemi të bëjmë me “mundësi[në] e arritjes së ... qëllimi[t] me kufizim më të vogël”, është që autoritetet shtetërore “e kanë për detyrë për të konsideruar alternativa të arsyeshme dhe t’u shmangen atyre që paraqesin kufizime më të rënda”<sup>54</sup> Për shembull, në vend të bllokimit të plotë të urës mbi lumin Ibër, a mund të arrihej qëllimi i ruajtjes së rendit publik me vendosjen e një pike kontrolli të përkohshme në urë, ku do të kontrollohej çdo automjet që kalon? Nuk dihet se pse në këtë rast, autoritetet përgjegjëse për ngritjen e “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar”, nuk kanë konsideruar asnjë alternativë për të arritur qëllimin e tyre të supozuar, edhe po të merrej ky qëllim si i mirëqenë, para se të vendosnin për një bllokim të plotë të lëvizjes së

---

<sup>54</sup> A. Stone Sweet dhe J. Mathews, “All Things in Proportion?”, 60 *Emory Law Journal* 102-179, 107 (2011)

automjeteve. Ky është një rast flagrant i shkeljes së parimit të proporcionalitetit.

Për më tepër, po të ekzistonte ndonjë rrezik real dhe objektiv nga kalimi i automjeteve nga pjesa jugore në atë veriore të qytetit të Mitrovicës që nuk do të mund të parandalohet nga autoritetet e rendit pa e bllokuar plotësisht kalimin e tyre, policia do të duhej të bllokonte edhe vendkalimet e tjera në dy pjesë të ndryshme të qytetit të Mitrovicës, në “Lagjen e Boshnjakëve” dhe në hyrje të fshatit Suhodoll. Por asnjëra nga këto nuk është bllokuar për kalimin e automjeteve atë ditë dhe as më vonë. Ky fakt e bën edhe më të dyshimtë idenë se ndërtimi i “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar” ka qenë i domosdoshëm për të arritur qëllimin e ruajtjes së rendit publik.

Prandaj, edhe nëse, për hir të argumentit, e pranojmë si të mirëqenë pretendimin e kryetarit Rakiq që qëllimi i ndërtimit të “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar” ishte për të ruajtur rendin publik, ky aksion nuk mund të konsiderohet një mjet proporcional për të përbushur këtë qëllim, sepse (1) mungon një lidhje racionale midis kufizimit dhe qëllimit të caktuar (2) qëllimi i ruajtjes së rendit publik nga sharjet dhe hedhjet e fjalëve midis individëve nuk është mjaft i rëndësishëm për të justifikuar natyrën dhe shkallën e skajshme të kufizimit dhe (3) ekzistonte mundësia për të arritur qëllimin me një kufizim më të vogël, ose më saktë, pa asnjë kufizim fare të së drejtës në fjalë. Për këto arsye, dhe për arsye se kufizimi nuk është në përputhje me ligj, ndërtimi i “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar” përbën një **shkelje të së drejtës për lëvizjen e lirë**.

## **Konstatimet dhe rekomandimet e avokatit të popullit**

### **I. Konstatimet e Avokatit të Popullit**

Në bazë të analizës së mësipërme, Avokati i Popullit konstaton se:

1. Sheshi “UÇK” dhe Sheshi “Adem Jashari” nuk paraqesin asnjë kufizim të së drejtës për lëvizjen e lirë. Por, meqenëse nuk janë ngritur në përputhje me ligj, këto ndërtime janë të kundërligjshme.
2. Ngritja e “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar” përbën jo vetëm një shkelje të ligjit por edhe një shkelje të Kushtetutës dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përkatësisht një shkelje të së drejtës për lëvizjen e lirë.
3. Marko Gjuriq, duke marrë pjesë në mënyrë aktive dhe me veprime konkrete në ndarjen gjeoetnike të territorit të Republikës së Kosovës, respektivisht qytetit të Mitrovicës, z. Gjuriq ka shkelur Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, duke cenuar me këtë rast të drejtën për lirinë e lëvizjes së individëve në territorin e Republikës së Kosovës, dhe për këtë arsye “përbën kërcënim për sigurinë shtetërore [dhe] rendin publik . . . në Republikën e Kosovës” (Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 31.1).
4. Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Veriut, z. Goran Rakiq, dhe kryetarja e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, znj. Ksenija Bozhoviq, kanë dështuar plotësisht për të bashkëpunuar me zyrtarët e tjerë të Komunës.

### **II. Rekomandimet e Avokatit të Popullit**

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon që:

- (1) Zyra Administrative e Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin më të shkurtë

kohor, të largojnë “Parkun e Paqes” nga ura kryesore e lumit Ibër, si dhe të ndalin punimet në “Sheshin Car Lazar” dhe ta kthejnë rrugën në gjendjen e mëparshme, duke lejuar lëvizjen e lirë në këtë urë, si për këmbësorët ashtu edhe për automjetet.

- (2) Zyra Administrative e Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin më të shkurtë kohor, të largojnë të gjitha pengesat e ndërtuara fizike në Lagjen e Boshnjakëve dhe në hyrje të fshatit Sudoholl, respektivisht të “Sheshi Adem Jashari” dhe “Sheshi UÇK”.
- (3) Ndaj të gjithë personave përgjegjës për vendosjen e “Parkut të Paqes”, sidomos ndaj udhëheqësve të tyre, kryetarit Rakiq dhe z. Marko Gjuriq, të ndërmerren masa të parashikuara me ligj për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke përfshirë edhe ndjekje penale.
- (4) Qeveria e Republikës së Kosovës t’i refuzojë hyrjen në territorin e Republikës së Kosovës, shtetasit të huaj Marko Gjuriq, në bazë të Ligjit për të Huajt, neni 31.1 (“I huaji mund të lejohet të hyjë në Republikën e Kosovës . . . nëse ai [mes të tjerash] nuk përbën kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik, shëndeti[n] publik në Republikën e Kosovës”) dhe neni 32.1 (“Të huajt i cili nuk i plotëson kushtet për hyrje të përcaktuara me nenin 31 të këtij ligji, i refuzohet hyrja në territorin e Republikës së Kosovës”).
- (5) Kryetari Rakiq dhe kryetarja Bozhoviq, të marrin të gjitha masat e nevojshme për të bashkëpunuar në nivelin e duhur me zyrtarët e tjerë të Komunës.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së

Kosovës<sup>55</sup> dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit,<sup>56</sup> mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që janë ndërmarrë apo planifikoni të ndërmerri lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartcekura.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

**Kopje:**

- Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Z. Ferid Agani, Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Z. Ljubomir Maric, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal
- Z. Mahir Yagcilar, Ministër i Ministrisë së Administratës Publike
- Z. Goran Rakiq, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Veriut
- Znj. Ksenija Bozhoviq, Kryetare e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut
- Znj. Adriana Hoxhiq, Zyrtare Kryesore e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut

---

<sup>55</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 132, paragrafi 3: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”

<sup>56</sup> *Ligji për Avokatin e Popullit, Nr. 03/L-195*, neni 26: “Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për masa disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”



## SHTOJCA



*Figura 1: “Parku i Paqes”, përmbi urën e lumit “Ibër”*



*Figura 2: “Sheshi Car Lazar” tek hyrja e urës së lumit “Ibër” në anën veriore*



*Figura 3: “Parku i Paqes”, me “Sheshin Car Lazar” në sfond*



*Figura 4: “Sheshi Adem Jashari”, në Lagjen e Boshnjakëve të Mitrovicës së Veriut*



*Figura 5: “Sheshi UÇK” në hyrjen e fshatit Sudoholl të Mitrovicës së Veriut*

Prishtinë, më 22 shtator 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIM**

**Ankesa nr. 337/2014**

**M.B.**

**kundër**

**Gjykatës Themelore në Prizren**

**Çështja:** Zvarritjet procedurale nga gjykata në vendosjen e lëndës C.nr.702/03, që ka të bëjë me vërtetimin dhe dorëzimin e pronësisë.

**Palë përgjegjëse:** Gjykata Themelore në Prizren  
Z. Ymer Hoxha, kryetar

**Baza ligjore:** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135,  
paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8

## Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës Themelore në Prizren, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr.231/02, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. M.B. (në tekstin e mëtejme *ankuesi*) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për të vendosur lidhur me vërtetimin dhe dorëzimin e pronësisë.
3. Rasti i ankuesit ka filluar të procedohet në gjykata nga 16 prill 2002 dhe deri më sot ende nuk është vendosur. Pra, ankuesi për 12 vite është në pritje të vendimit, lënda e të cilit sillet në gjykata pa u vendosur përfundimisht me vendim merititor. Gjykata e shkallës së dytë vendimet e gjykatës së shkallës së parë për dy herë më radhë i ka kthyer në rigjykim.

## Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i posedon IAP, të paraqitura nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë mund të përmbliidhen si në vijim:

4. Më 16 prill 2002, *ankuesi* parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren, për vërtetimin dhe kthimin e pronës.
5. Më 26 shtator 2002, Gjykata Komunale në Prizren, lidhur me çështjen e ankuesit nxjerr aktgjykimin C.nr.231/02, me të cilin miratohet pjesërisht kërkesëpadia e ankuesit, për vërtetimin dhe kthimin e pronës.
6. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.231/02 të datës 26 shtator 2002, *ankuesi* ushtron ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e cila me aktvendim Ac.nr.68/2003 të datës 29

- tetor 2003, e hedhë poshtë ankesën dhe e kthen çështjen në rigjykim.
7. Më 13 dhjetor 2006, Gjykata Komunale në Prizren, për dallim të herës së parë që pjesërisht aprovon kërkesëpadinë e ankuesit, tani ajo me aktgjykimin e dytë C.nr.702/03 të datës 13 dhjetor 2006, e refuzon kërkesëpadinë e ankuesit si të pa bazë.
  8. Më 7 prill 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren me aktvendim Ac.nr.185/007 të datës 7 prill 2008, aprovon ankesën e paditësit – kundër të paditurve si të bazuar dhe prish aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.702/03 të datës 13 dhjetor 2006 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në vendosje të sërishme.
  9. Më 24 korrik 2014, *ankuesi* paraqet ankesën e tij në IAP, lidhur me zvarritjen e procedurës për shqyrtimin e lëndës së tij që nga prilli 2002 e deri në paraqitjen e ankesës në IAP ( përfundimin e këtij raporti), duke theksuar se, për shkak të moszgjidhjes 12-vjeçare të këtij kontesti nga gjykata, palët në kontest për pronën kontestuese, më 29 qershor 2014 ngatërrohen mes vete dhe për pasojë një person vritet dhe disa të tjerë lëndohen rëndë dhe lehtë.
  10. Më 30 korrik 2014, më kërkesën e përfaqësuesit të IAP, pala solli aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.231/02 të datës 26 shtator 2002 vendosur në favor të ankuesit, aktgjykimin e dytë të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.702/03, që tani vendimi i kësaj gjykate është në disfavor të ankuesit dhe aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë (Gjykata e Qarkut në Prizren) Ac.nr.185/2007 të datës 7 prill 2008, që lëndën e kthen në rigjykim.
  11. Më 11 gusht 2014, Avokati i Popullit i dërgoi një letër Gjykatës Themelore në Prizren, në të cilën kërkoi informata për veprimet e ndërmarra ose ato që planifikonte të ndërmernte që rasti i ankuesit të shqyrtohej brenda afatit të arsyeshëm bazuar në ligj.



12. Më 21 gusht 2014, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren ku u njoftua se *“Më 8 tetor 2012, gjyqtari i çështjes ka aprovuar kërkesën për caktimin e masës së përkohshme ashtu që me aktvendim C.nr.266/2012 ka caktuar masën e përkohshme në këtë lëndë, por që nga ajo kohë e deri më tani gjyqtari i çështjes nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër për këtë lëndë”*.
13. Më 5 maj 2015, përfaqësuesi i IAP bisedoi me gjyqtarin e lëndës, të cilit iu përkujtua letra dërguar gjykatës nga Avokati i Popullit më 11 gusht 2014 dhe përgjigjen në këtë letër të datës 21 gusht 2014. Pas kësaj, gjyqtari ofroi aktvendimin për ndërprerjen e procedurës kontestimore C.nr.266/2008 të datës 30 janar 2015, në arsyetimin e të cilit shkruan: *“Në bazë të aktvendimit për fillimin e hetimeve HP.nr. 181/2014 të datës 30.06.2014, pas përlëshjeve që kanë ndodhur mes familjes Berisha dhe Avdylaga (familjes së ankuesit), humb jetën paditësi. Pasi që paditësi ka vdekur, fakt i cili u vërtetua nga aktvendimi për fillimin e hetimeve Hp.nr.181/2014 datë 30.06.2014 dhe nga shkresat tjera penale të këtij rasti, gjykata në kuptim të nenit 277 par. 1 germa (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurë Kontestimore, është e detyruar të ndërpret procedurën kontestimore në këtë çështje juridike”*.

### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës**

14. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 31 përcakton: *“Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
15. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Prandaj, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ, garanton që: *“Në*

*përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm.”*

16. Ndërsa, neni 13 i KEDNJ përcakton: “Çdo njeri, të cilit i janë shkëlur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për **mjetet ligjore efektive** për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtare, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.
17. Po ashtu, neni 7.5, i Ligjit për Gjykatat, nr.03/L-199, përcakton mandatin dhe detyrën e punës së gjykatave, në zgjidhjen e lëndëve, me kërkesë ekskluzive, që: “Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve”.
18. Sipas nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.03/L-006, “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet **pa zvarritje** dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”
19. Neni 12 i këtij ligji obligon gjykatën që ”Procedura e shkallës së parë, si rregull, përbëhet prej dy seancave: a) seancës përgatitore; b) seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.”
20. Neni 420, paragrafi 2 i LPK përcakton mënyrën e konvokimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes: “Seanca kryesore do të mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore”. Dhe në paragrafin 4 po të nenit 420 thuhet: “Po që se gjykata çmon se shqyrtimi kryesor do të zgjatë më tepër se një ditë, seanca do të konvokohet për aq ditë më radhë sa është e domosdoshme që shqyrtimi të bëhet në vazhdimësi”

21. Ndërsa neni 441, paragrafi 1, shprehimisht përcakton se: “*Seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pa caktuar*”. Dhe paragrafi 2 i po të njëjtit përcakton po ashtu se: “*Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, [...]*”.
22. Neni 442 përcakton: “*Po qe se seanca e filluar nuk mund të përfundoj brenda një dite, gjyqtari do ta përcaktojë vazhdimin e seancës për ditën e ardhshme të punës (vazhdimi i seancës).*”

### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

23. Nisur nga analiza ligjore e fakteve dhe dëshmive, lidhur me rastin që posedon, Avokati i Popullit vëren se e **drejta për proces të rregullt gjyqësor**, brenda një afati të arsyeshëm dhe e **drejta për mjete efektive juridike**, të garantuara me aktet ligjore të lartpërmendura, nuk është përmbushur, pasi qe gjykatat (dy nivelet) kane zvarritur vendosjen e lëndës së *ankuesit* nga marrëdhënia e pronësore, për më shumë se 12 vite, procedurat e së cilës janë iniciuar që nga viti 2002, dhe ende nuk janë vendosur përfundimisht deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti (shtator 2015); se zvarritje të tepruara të procedurave gjyqësore dhe pa një vendim përfundimtar të formës së prerë, janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ dhe nenin 10.1 të LPK.
24. Avokati i Popullit ua përkujton se çështjet nga marrëdhënia pronësore konsiderohen të jenë të drejta civile, për qëllime të nenit 6 të KEDNJ, i cili për këtë arsye është i aplikueshëm në procedurat e rastit në fjalë. Zvarritjet në zgjidhjen e lëndëve pronësore të qytetarëve nga ana e gjykatave, në njërën anë ndikon drejtpërdrejt në të drejtat pronësore dhe në anën tjetër i bënë gjykatat të pa besueshme për qytetarët e Kosovës. Kështu rrezikohet jo vetëm drejtësia, por edhe siguria e qytetarëve, për

shkak se i shtynë individët që mosmarrëveshjet pronësore t'i zgjidhin jashtë kornizës së sistemit gjyqësor, me vetë gjyqësi.

- 25.** Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka vërtetuar që në rastet ku përfshihet përcaktimi i të drejtës civile, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Boddaert kundër Belgjikës*, më 12 tetor 1995). Për rastin në fjalë, procedura gjyqësore ishte filluar në Gjykatën Komunale në Prizren, më 16 prill 2002 dhe vazhdon ende në vitin 2015, pa një vendim përfundimtar.
- 26.** Po ashtu, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 (1) i KEDNJ nuk parasheh ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës, por, ai përcaktim varet nga rrethanat e veçanta të rastit, veçanërisht nga ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve të përfshira, si dhe prej asaj se çfarë është në interes për ankuesin.
- 27.** Mirëpo, sipas GJEDNJ-së, është e domosdoshme të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i procedurave me qëllim të përcaktimit të arsyes për zgjatje të procedurës. Kjo do të thotë që, vonesat e caktuara lidhur me një pjesë të procedurave mund të mos përbëjnë shkelje nëse zgjatja e tërësishme e procedurës nuk ka qenë e tepruar. Nga provat dhe dëshmitë e prezantuara, Avokati i Popullit nuk gjen arsye për zvarritje të procedurës, ngase në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një proces të ndërlikuar.
- 28.** Avokati i Popullit vëren se për rastin në fjalë, periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej 16 prillit 2002, data kur *ankuesi* paraqiti padinë e tij në Gjykatën Komunale në Prizren. Pasi ende nuk është marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin, lënda tani gjendet për rigjykim në Gjykatën Themelore në Prizren. Data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim, konsiderohet data e publikimit të këtij raporti. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se procedurat kanë zgjatur mbi 12 (dymbëdhjetë) vite.

- 29.** Lidhur me sjelljen e autoriteteve gjyqësore, Avokati i Popullit vëren se, që nga muaji prill 2002 e deri në vitin 2012, Gjykata Komunale në Prizren, kishte nxjerrë dy (2) aktgjykime: aktgjykimin C.nr.231/02 dhe aktgjykimin C.nr.702/03, por që më vonë të atakuar me ankesë, Gjykata e Qarkut në Prizren të dy aktgjykimet i kthen në rigjykim: *“Me arsyetimin se aktgjykimet e atakuara kanë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, njëherit edhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, e si pasoj edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht”*. Kjo vendimmarrje e gjykatave/gjyqtarëve paraqet një dështim të tyre në vendosjen përfundimtare të rastit, në dëm të ankuesit dhe paraqet dështim për mbrojtje gjyqësore të drejtave të njeriut të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- 30.** Lidhur me fushën e zbatueshmërisë së nenit 13 të KEDNJ-së, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ, në disa raste shprehimisht e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, përbëjnë një kërcënim serioz për sundimin e ligjit të vendit. Kufizimet e theksuara në nenin 13 të KEDNJ, GJEDNJ i komenton kështu: *“Për sa i përket dështimit të supozuar për të siguruar seancë brenda një afati të arsyeshëm, nuk mund të shquhet asnjë kualifikim i tillë në fushën e nenit 13. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të paraparë me konventë, më shumë favorizon mbajtjen në minimum të kufizimeve të nënkuptuara me nenin 13.”*
- 31.** Neni 13 i KEDNJ-së, duke theksuar në mënyrë të veçantë dhe shprehimisht obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojtë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo gëzon këto të drejta në mënyrë efektive. Kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave, sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe

të arsyeshme. Meqenëse rasti i z. Bytyçi ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i KEDNJ-së është i zbatueshëm.

- 32.** Avokati i Popullit përkujton se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet, pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme. Nga informatat në dispozicion nuk mund të konstatohet se ankuesi, me veprimet/mosveprimet e tij, ka kontribuar në çfarëdo zvarritje të procedurës, ndërsa zvarritjet pa një vendim përfundimtar, i kanë kontribuar shkeljeve të drejtave për mbrojtje gjyqësore, në dëm të ankuesit, të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- 33.** Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk i është vënë në dispozicion ankuesit, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës, me parashikimin apo shpresën për ta arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar. **Kjo mënyrë e veprimit të gjyqësorit dëshmon për mohimin e drejtësisë dhe ligjshmërisë për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.**
- 34.** Avokati i Popullit konstaton që ka pasur **shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm**, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura dhe se ka pasur **shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike**, duke u trajtuar rasti i tij nga ana e gjykatave/gjyqësorit në një rreth të vendimeve të pafundme.
- 35.** Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “*Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të*

ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rasteve kur ka zvarritje të procedurës”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës.

## **Rekomandon**

### ***Gjykatën Themelore në Prizren***

- 1. Të garantojë shqyrtimin e të gjitha rasteve brenda një afati të arsyeshëm kohor, në pajtim edhe me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së***

### ***Këshillin Gjyqësor të Kosovës***

- 2. Të iniciojë përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zvarritje të procedurës gjyqësore.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerren Gjykata Themelore në Prizren, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, më së largu brenda tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të këtij raporti.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Kopje: Z. Enver Peci, kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Znj. Tonka Berishaj, u.d. e kryetarit, Gjykata e Apelit të Kosovës

Prishtinë, më 16 tetor 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

*Ex officio*

**Rasti Nr. 517/2015**

në lidhje me

Procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për  
shpronësimin e pronës së paluajtshme

**drejtuar**

**Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**



## QËLLIMET E RAPORTIT

Ligji Nr. 03/L-139 (i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme, përcakton një procedurë të veçantë për ankesat gjyqësore kundër vendimeve preliminare për shpronësim të nxjerra nga Qeveria ose komuna. Sipas kësaj procedure, me rastin e paraqitjes së një ankese kundër vendimit preliminar, “gjykata . . . nxjerr aktgjykimin mbi rastin brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues [ndaj ankesës së paraqitur]” (*id.*, neni 35, par. 6, nënpar. 3) dhe, “[n]ëse gjykata nuk e nxjerr aktgjykimin brenda periudhës tridhjetë (30) ditore . . . , gjykata konsiderohet përfundimisht se ka nxjerrë aktgjykim për refuzimin e ankesës në tërësi menjëherë pas skadimit të kësaj periudhe tridhjetë (30) ditore” (*id.*, neni 35, par. 8).

Ky raport ka dy qëllime kryesore:

- (1) të vlerësojë nëse procedura e sipërpërmendur përbën një shkelje të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe bie në kundërshtim me praktikën më të mirë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe
- (2) t’i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Kosovës ndryshime dhe plotësime të mëtejshme të Ligjit Nr. 03/L-139, në bazë të këtyre vlerësimeve.

## BAZA LIGJORE

Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor” (neni 16, par. 8);
- “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjnë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë

mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (neni 18, par. 1, nënpar. 2);

- “të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
- “të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës”(neni 18, par. 1, nënpar. 8);
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

## **SFONDI LIGJOR**

Procedurat administrative dhe gjyqësore për çështje të shpronësimit janë rregulluar fillimisht nga Ligji Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Këto procedura iu nënshtruan modifikimeve të

mëtejshme me hyrjen në fuqi të dy ligjeve të mëvonshme: Ligji Nr. 03/L-205 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-139; dhe Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat.

### **A. Procedurat administrative dhe gjyqësore për shpronësim sipas Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme**

Procedurat administrative dhe gjyqësore të përcaktuara nga Ligji Nr. 03/L-139 (në tekstin e mëtejshëm: *Ligji i 2009*) janë si në vijim.

#### **1. Procedura administrative për shpronësim sipas Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme**

Sipas *Ligjit të vitit 2009* procedura administrative për shpronësim zhvillohet nga “Organi Shpronësues”, i cili “nënkupton një Komunë ose Qeverinë që është e autorizuar për kryerjen e shpronësimit” (*id.*, neni 2, par. 1). Mirëpo, autorizimi i Organit Shpronësues për kryerjen e shpronësimit nuk është pa kufi. Përkundrazi, neni 4 i ligjit përcakton shprehimisht disa kushte substanciale për ligjshmërinë e shpronësimit: (1) “shpronësimi bëhet . . . për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik”<sup>57</sup>; (2) “qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e Shpronësimit”; (3) “përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga Shpronësimi”; dhe (4) “objekt[i] i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues”.<sup>58</sup> Vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve të përcaktuara në nenin 4, Organi Shpronësues mund të fillojë

---

<sup>57</sup> *Ligji 2009* përcakton një listë specifike të qëllimeve të ligjshme publike në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 4. Në mënyrë që të jetë i ligjshëm, shpronësimi duhet bërë vetëm për një ndër qëllimet e përcaktuara.

<sup>58</sup> Përveç këtyre katër kushteve substanciale, ka edhe një kusht proceduralë për ligjshmërinë e shpronësimit, përkatësisht që “Organi Shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji” për sa i përket zhvillimit të procedurave për shpronësim (*id.*, neni 4, par. 1, nënpar. 5).

“ushtrimin e procedurës së shpronësimit” (*id.*, neni 7, par. 1).

Me përbushjen e kushteve, “[p]rocedura e shpronësimit mund të iniciohet nga Organi përgjegjës Shpronësues . . . , me vetiniciativë ose pas dorëzimit të një kërkesë në organin shpronësues” (*id.*, neni 7, par. 2). Kur Organi Shpronësues është Komuna, kërkesat për shpronësim mund të dorëzohen nga “një autoritet publik ose NP [ndërmarrje publike]”, ndërsa kur Organi Shpronësues është Qeveria, “kërkesat gjithashtu duhet të dorëzohen nga . . . një Partneritet Publiko-Privat; njëra nga palët në një Kontratë të Infrastrukturës të dhënë nga një Organ Tenderues; ose cilido trashëgimtar, pasardhës si dhe cilido subjekt i caktuar nga Partneriteti ose pala e lartpërmendur” (*id.*, neni 7, par. 3). Në rast se procedura e shpronësimit iniciohet nga vetë Organi Shpronësues, “ky Organ shpronësues do të urdhëroj[ë] një ose më shumë nga anëtarët ose zyrtarët e tij që të përgatisin dhe dorëzojnë kërkesën” (*id.*).

Brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës, “Organi Shpronësues do të bëjë një shqyrtim *prima facie*” të saj, kryesisht për të konstatuar nëse kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 4 të ligjit janë përbushur ose jo (*id.*, neni 8, par. 5). Nëse Organi Shpronësues vendos që kërkesa *nuk* i plotëson këto kushte *prima facie*, ia kthen kërkesën Subjektit Kërkues bashkë me një arsytim të refuzimit me shkrim. Dhe, nëse Organi Shpronësues vendos që kërkesa i plotëson kushtet *prima facie*, ai nxjerr një vendim me shkrim për pranimin formal të kërkesës për shqyrtim të mëtejshëm (*id.*).

Në rastin e pranimit formal të kërkesës, njoftohen zotëruesit e pronës së paluajtshme dhe palët e tjera të përfshira për vendimin për pranim, si dhe shpallet ky vendim, bashkë me të dhënat e kërkesës në Gazetën Zyrtare dhe “një gazetë me tirazh të madh në Kosovë” (*id.*, neni 8, par. 7-8). Pas këtyre njoftimeve dhe shpalljeve, përcaktohet një periudhë 30-ditore në të cilën “Personat e interesuar kanë të drejtë të paraqesin në Organin Shpronësues komentet e tyre me shkrim mbi Shpronësimin e kërkuar” (*id.*, neni 9, par. 1) dhe, në vijim, një

periudhë tjetër pesëmbëdhjetëditore brenda së cilës Organi Shpronësues është i detyruar të mbajë “një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar në secilën Komunë në të cilën ndodhet prona/t përkatëse” (*id.*, neni 9, par. 2).

Organi Shpronësues ka tridhjetë ditë në dispozicion për të shqyrtuar komentet e pranuar dhe mendimet e shprehura gojariht në dëgjimin publik. Brenda kësaj periudhe 30-ditore, ai “do të miratojë një vendim me shkrim ‘Vendimi Preliminar’ në të cilin përcakton nëse dhe deri në ç’masë është konstatuar nga Organi Shpronësues se shpronësimi i kërkuar i plotëson secilin nga kushtet e parapara [për ligjshmërinë e shpronësimit] në . . . neni[n] 4 të këtij ligji” (*id.*, neni 10, par. 1, nënpar. 1). Pastaj, brenda dhjetë ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, “Organi Shpronësues e shpall në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.” (*id.*, neni 10, par. 4). Në datën e shpalljes së Vendimit Preliminar, vendimi hyn në fuqi.

## **2. Procedura gjyqësore për ankesat kundër Vendimit Preliminar për shpronësim sipas Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme**

Në kontekstin e *Ligjit* 2009, vendimi quhet preliminar, për shkak se është i ankimeshëm në sistemin e rregullt gjyqësor: Nëse një “Pronar ose zotërues i një interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i procedurës së shpronësimit” mendon se vendimi preliminar bie në kundërshtim me të paktën njërin prej kushteve të përcaktuara në nenin 4 për ligjshmërinë e shpronësimit, “ky person ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e vendimit preliminar, pjesërisht ose plotësisht” (*id.*, neni 35, par. 1).<sup>59</sup> Në këtë kontekst, “gjykata kompetente” për secilën

---

<sup>59</sup>Ky raport trajton vetëm procedurat gjyqësore për ankesat kundër ligjshmërinë e shpronësimit, të cilat rregullohen sipas nenit 35 të *Ligjit të 2009*. Ankesat mbi shumën

ankesë, sipas *Ligjit 2009*, varet prej statusit të Organit Shpronësues. Nëse organi shpronësues është komuna, “ankesa paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale”, ndërsa, nëse organi shpronësues është Qeveria, “ankesa paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës” (*id.*, neni 35, par. 2).

Por, cilado që të jetë “gjykata kompetente” në një rast të caktuar, *Ligji 2009* përcakton qartë se ankuesi ka vetëm 30 ditë kalendarike, pas datës së hyrjes në fuqi të vendimit preliminar për të paraqitur ankesën e tij: “Nëse ankesa dorëzohet pas skadimit të kësaj periudhe tridhjetë (30) ditore kalendarike, ajo do të refuzohet nga gjykata” (*id.*, neni 35, par. 3). Gjithashtu, pasi të marrë kopje të ankesës, Organi Shpronësues ka vetëm dyzet e pesë ditë kalendarike për të dorëzuar përgjigjen e tij (*id.*, neni 35, par. 5).

Pas dorëzimit të ankesës, si dhe përgjigjes së organit shpronësues ndaj ankesës, gjykata kompetente fillon shqyrtimin e lëndës me një procedurë të përsheptuar. *Ligji 2009* përcakton se: “Gjykata e trajton rastin në mënyrë urgjente; i jep prioritet rastit mbi të gjitha rastet tjera në pritje pranë gjykatës; nxjerr aktgjykimin brenda nëntëdhjetë (90) ditëve kalendarike pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues; dhe i cakton afatet për zhvillimin e procedurës në mënyrë që t’i mundësojë nxjerrjen e aktgjykimit brenda periudhës së lartpërmendur” (*id.*, neni 35, par. 6). Shpronësimi i propozuar nga Vendimi Preliminar nuk mund të zbatohet në këtë fazë të procedurës, duke u mbetur pezull: “Organi Shpronësues nuk nxjerr Vendimin Përfundimtar mbi një pronë ose të drejtë . . . , përderisa gjykata në të cilën është dorëzuar ankesa të nxjerrë aktgjykim mbi ankesën (*id.*, neni 35, par. 8).

---

e kompensimit për shpronësimin e pronës, ankesat për kompensimin e dëmeve të pësuar nga shpronësimi i pjesshëm dhe ankesat kundër ligjshmërisë së vendimit për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës, rregullohen përkatësisht nga nenet 36, 37 dhe 38 të *Ligjit të 2009* dhe nuk vuajnë nga problemet që nxirren në pah në këtë raport.

*Ligji 2009* parashikon të drejtën e apelit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nëse njëra ose të dyja palët mbeten të pakënaqura. Në rast të tillë, pala ankuese ka tridhjetë ditë kalendarike për të paraqitur ankesën e saj në gjykatën e shkallës së dytë (*id.*, neni 35, par. 10), pas së cilës pala tjetër ka tridhjetë ditë kalendarike për të paraqitur përgjigjen e saj ndaj ankesës së parashtruar (*Ligji 2009*, neni 35, par. 10).<sup>60</sup>

Sikurse në gjykatën e shkallës së parë, *Ligji 2009* përcakton një procedurë të përsheptuar edhe në gjykatën e shkallës së dytë, por vetëm nëse ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë parashtrohet nga Organi Shpronësues: “Gjykata e Apelit e trajton rastin në mënyrë urgjente; i jep prioritet rastit mbi të gjitha rastet tjera në pritje pranë gjykatës së apelit; nxjerr aktgjykimin mbi ankesën brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas pranimit të ankesës; dhe i cakton afatet për zhvillimin e procedurës në mënyrë që t’i mundësojë nxjerrjen e aktgjykimit brenda periudhës së lartpërmendur” (*id.*, neni 35, par. 13, nënpar. 3 dhe 4).

Gjithashtu, duhet theksuar që ka një dallim të rëndësishëm midis procedurës në gjykatën e shkallës së parë dhe procedurës në gjykatën e shkallës së dytë, sa i përket statusit dhe fuqisë ligjore të vendimit preliminar gjatë shqyrtimit të rastit. Kemi vërejtur më sipër që, gjatë

---

<sup>60</sup> Megjithëse “Ndaj aktgjykimit të gjykatës [së parë] . . . mund të paraqitet ankesë në përputhje me ligjin e aplikueshëm mbi këto ankesa” (*Ligji i 2009*, neni 35, par. 9), mbetet e misterhme se në cilën gjykatë mund të paraqitet ankesë kundër aktgjykimit në rast se Qeveria është Organi Shpronësues dhe, rrjedhimisht, gjykata e shkallës së parë bie që të jetë Gjykata Supreme. Në raste të tilla, nuk është e qartë se ku mund të paraqitet ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës sepse, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 102, par. 5, “[m]e ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe **për të tilla raste nuk ka të drejtë ankesë**” (theks i shtuar). Megjithatë, nuk ka nevojë të përqendrohemi tek ky problem, ngaqë u zgjidh me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat. Shih Sfondin Ligjor, pjesa C të këtij raporti.

kohës kur ankesa është në shqyrtim e sipër *në gjykatën e shkallës së parë*, organi shpronësues nuk është i autorizuar për të nxjerrë vendimin përfundimtar dhe, rrjedhimisht, pezullohet zbatimi i shpronësimit derisa të nxirret aktgjykimi. Ndërsa, *në gjykatën e shkallës së dytë*, *Ligji 2009* përcakton rregullën e kundërt: “Nëse aktgjykimi [në gjykatën e shkallës së parë] është pozitiv për Organin Shpronësues . . . , parashtimi i ankesës [në gjykatën e shkallës së dytë] nuk e pengon në asnjë mënyrë të drejtën e Organit Shpronësues për të marrë masat e përcaktuara në aktgjykim, duke përfshirë vazhdimin e procedurës së shpronësimit, nxjerrjen e vendimit përfundimtar për shpronësim dhe zbatimin e tij” (*id.*, neni 35, par. 11). Prandaj, edhe pse mund të apelohej një aktgjykim kundër ankesës në gjykatën e shkallës së parë, një aktgjykim i tillë ka pasoja të rëndësishme juridike: pas nxjerrjes së tij, organi shpronësues nuk ka asnjë pengesë ligjore për të vazhduar me shpronësimin e pronës në fjalë.

### **B. Procedurat administrative dhe gjyqësore për shpronësim sipas Ligjit Nr. 03/L-205 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-139**

Më pak se dy vjet pas hyrjes në fuqi të *Ligjit 2009*, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi një ligj tjetër, *Ligji Nr. 03/L-205* për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit të mëparshëm (në tekstin e mëtejshëm: *Ligji 2010*). *Ligji 2010* solli disa ndryshime të rëndësishme në procedurat administrative dhe gjyqësore për shpronësim. Këto ndryshime, në përgjithësi, e kanë bërë shumë më të shpejtë dhe të lehtë për Qeverinë ose komunën për të nxjerrë dhe zbatuar vendime për shpronësim dhe, njëkohësisht, shumë më të vështirë për pronarët ose zotëruesit e një interesi në pronë për të kundërshtuar shpronësimet e propozuara.

Kategoria e parë e ndryshimeve në *Ligjin 2010* ka vendosur një shkurtim dramatik i afateve në procedurat administrative dhe gjyqësore për nxjerrjen e Vendimeve Preliminare dhe si dhe për



shqyrtimin e ankesave kundër tyre. Në këtë mënyrë, procedurat që kishin qenë të përshpejtuara në *Ligjin e 2009*, janë bërë edhe më të ngutshme në *Ligjin e 2010*. Përkatësisht:

- Sipas *Ligjit të 2009*, ka një periudhë 30-ditëshe gjatë së cilës “Personat e interesuar kanë të drejtë të paraqesin në Organin Shpronësues komentet e tyre me shkrim mbi Shpronësimin e kërkuar” (*id.*, neni 9, par. 1), kurse në *Ligjin e 2010*, kjo periudhë shkurtohet deri në dhjetë ditë kalendarike (shih *id.*, neni 2, par. 1, nënpar. 1; neni 9, par. 1 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar).
- Sipas *Ligjit 2009*, pronari ose zotëruesi i një interesi në pronën e paluajtshme ka tridhjetë ditë kalendarike për të paraqitur ankesë në gjykatën e shkallës së parë kundër ligjshmërisë së vendimit preliminar (*id.*, neni 35, par. 3), kurse në *Ligjin e 2010*, kjo periudhë shkurtohet deri në pesëmbëdhjetë ditë kalendarike (shih *id.*, neni 2, par. 1, nënpar. 7; neni 35, par. 3 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar).
- Sipas *Ligjit 2009*, organi shpronësues ka në dispozicion 45 ditë për të dorëzuar përgjigjen e tij në gjykatën përkatëse (*id.*, neni 35, par. 5), kurse në *Ligjin 2010*, kjo periudhë shkurtohet deri në pesëmbëdhjetë ditë kalendarike (shih *id.*, neni 2, par. 1, nënpar. 7; neni 35, par. 5 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar).
- Sipas *Ligjit 2009*, gjykata e shkallës së parë është e detyruar të “nxjerrë aktgjykimin brenda nëntëdhjetë (90) ditëve kalendarike pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues” (*id.*, neni 35, par. 6, nënpar. 3), kurse në *Ligjin e 2010*, kjo periudhë shkurtohet deri në tridhjetë ditë (shih *id.*, neni 2, par. 1, nënpar. 7; neni 35, par. 6, nënpar. 3 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar).
- Sipas *Ligjit të 2009*, ka një periudhë prej 30 ditëve brenda së cilës pala e pakënaqur me aktgjykimin e shkallës së parë mund të paraqesë një apel përpara gjykatës së shkallës së dytë dhe një

periudhë tjetër prej 30 ditëve, brenda së cilës pala tjetër ka të drejtë t'i japë përgjigje ankesës së parashtruar (*id.*, neni 35, par. 10). Pastaj, “gjkata e apelit . . . nxjerr aktgjykimin mbi ankesën brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas pranimit të ankesës dhe i cakton afatet për zhvillimin e procedurës në mënyrë që t'i mundësojë nxjerrjen e aktgjykimit brenda periudhës së lartpërmendur” (*id.*, neni 35, par. 13, nënpar. 3 dhe 4). Ndërsa, në *Ligjin e 2010*, periudhat për paraqitjen e ankesës dhe paraqitjen e përgjigjes ndaj ankesës, përkatësisht, shkurtohen deri në pesëmbëdhjetë ditë kalendarike (shih *id.*, neni 2, par. 1, nënpar. 7; neni 35, par. 11 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar). Pastaj, gjykata e shkallës së dytë “nxjerr aktgjykimin e saj mbi apelin brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas datës në të cilën ka pranuar përgjigjen e palës tjetër ose pas datës së skadimit të periudhës 15-ditore për dorëzimin e përgjigjeve, cilado që ndodh më herët” (shih *id.*, neni 2, par. 1, nënpar. 7; neni 35, par. 13, nënpar. 3 dhe 4 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar).

Përveç këtyre shkurtimeve drastike të afateve procedurale, *Ligji 2010* solli edhe një ndryshim tjetër. Sipas ligjit të ri, “[n]ëse gjykata [e shkallës së parë] nuk e nxjerr aktgjykimin brenda periudhës tridhjetë (30) ditore . . . gjykata konsiderohet përfundimisht se ka nxjerrë aktgjykim për refuzimin e ankesës në tërësi menjëherë pas skadimit të kësaj periudhe tridhjetë (30) ditore” (*id.* neni 2, par. 1, nënpar. 7; neni 35, par. 8 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar).

Ia vlen të theksohet që, shprehja “konsiderohet përfundimisht se ka nxjerrë aktgjykim për refuzimin e ankesës në tërësi”, do të thotë që dështimi i Gjykatës për të nxjerrë aktgjykim brenda afatit 30-ditore ka pikërisht të njëjtat pasoja juridike që do të rezultonin po të nxirrej në të vërtetë një aktgjykim për refuzimin e ankesës. Nga njëra anë, kjo do të thotë se refuzimi automatik i ankesës për shkak të kalimit të afatit mund të apelohej në gjykatën e shkallës së dytë, njëlloj si një aktgjykim i vërtetë: “çdo aktgjykim mbi një ankesë *ose refuzim i një*

*ankese nga gjykata sipas paragrafëve të mëparshëm të këtij neni mund të apelohej” (Ligji i 2010, neni 2, par. 1, nënpar. 7, theks i shtuar; neni 35, par. 10 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar).*

Por nga ana tjetër, refuzimi automatik i ankesës për shkak të kalimit të afatit, gjithashtu i hap rrugën organit shpronësues për të nxjerrë vendimin përfundimtar për shpronësim dhe për të ndërmarrë hapa për zbatimin e vendimit. Njësoj si në *Ligjin e 2009, Ligji i 2010* përcakton se “Organi shpronësues nuk nxjerr vendimin përfundimtar mbi një prone ose të drejtë e cila është objekt i një ankese . . . përderisa gjykata [e shkallës së parë] në të cilën është dorëzuar ankesa të nxjerrë aktgjykim mbi ankesën, *ose përderisa gjykata të konsiderohet se ka nxjerrë vendimin sipas paragrafit 8 më lartë”* (*id.*, neni 2, par. 1, nënpar. 7, theks i shtuar; neni 35, par. 9 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar). Pas një refuzimi automatik të ankesës për shkak të kalimit të afatit, asnjë gjë nuk e pengon Organin Shpronësues nga vazhdimi i procedurës për shpronësim: “Parashtrimi i apelit nuk e pengon në asnjë mënyrë të drejtën ose autorizimin e organit shpronësues për të marrë masat e përcaktuara në aktgjykimin kundër të cilit është ngritur apeli, duke përfshirë . . . vazhdimin e procedurës së shpronësimit, nxjerrjen e një ose më shumë vendimeve përfundimtare për shpronësim si dhe zbatimin e këtyre vendimeve” (*Ligji i 2010, neni 2, par. 1, nënpar. 7; neni 35, par. 12 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar*). Në këtë mënyrë, *Ligji i 2010* e krijon mundësinë që një ankesë kundër ligjshmërisë së një Vendimi Preliminar për shpronësim, të hidhet poshtë, dhe që shpronësimi të kryhet, pa u shqyrtuar ankesa fare nga asnjë trup gjyqësor.

### **C. Ndryshimi i procedurës gjyqësore për ankesat kundër ligjshmërisë së Vendimit Preliminar për shpronësim sipas Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat**

Procedura gjyqësore për ankesat kundër ligjshmërisë së vendimit preliminar për shpronësim ka pësuar një ndryshim të fundit nga Ligji Nr. 03/L-199 për gjykatat, pjesa më e madhe e të cilit hyri në fuqi më

1 janar 2013.<sup>61</sup> Siç u pa më sipër, *Ligji 2009* parashikon që gjykata kompetente e shkallës së parë për shqyrtimin e ankesave të tilla është, ose gjykata përkatëse komunale në rast se organi shpronësues është komunë, ose Gjykata Supreme në rast se organi shpronësues është Qeveria (*id.*, neni 35, par. 2). Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykata, “çfarëdo referimi në cilindo ligj . . . që i mvesh juridiksioni i shkallës së parë . . . Gjykatës Komunale . . . apo Gjykatës Supreme, do të formulohet asisoj që të nënkuptojë Gjykatën Themelore” dhe “[ç]farëdo referimi në cilindo ligj . . . që i mvesh juridiksion të shkallës së dytë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, Gjykatës së Qarkut apo Gjykatës Supreme do të formulohet asisoj që të nënkuptojë Gjykatën e Apelit” (Ligji për Gjykatat, neni 42, par. 2).

Në bazë të kësaj dispozite, mund të konsiderohet që, pavarësisht nëse organi shpronësues është Qeveria ose komuna, të gjitha ankesat kundër ligjshmërisë së vendimeve preliminare për shpronësim paraqiten në Gjykatën Themelore, dhe që të gjitha ankesat kundër aktgjykimit të nxjerrë (ose të konsideruar si të nxjerrë) nga Gjykata Themelore, trajtohen nga Gjykata e Apelit.

## **VLERËSIMI**

Procedura gjyqësore kundër vendimeve preliminare për shpronësim, siç përcaktohet nga ligjet e diskutuara më sipër, ka rrezik të paraqesë shkelje të dy të drejtave të njeriut:

- (1) e drejta e pronës, e garantuar nga neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 1 i Protokollit të Parë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe

---

<sup>61</sup> Disa dispozita të Ligjit për Gjykatat, përkatësisht nenet 29, 35, 36, 38 dhe 40 të këtij ligji, hynë në fuqi dy vjet më herët, më 1 janar 2011.

(2) e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

**A. Vlerësimi i procedurës gjyqësore për ankesat kundër vendimit preliminar për shpronësim, në bazë të së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 1 i Protokollit të Parë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut**

Neni 46, par. 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: *Kushtetuta*) përcakton që: “E drejta e pronës është e garantuar”. Kjo nuk do të thotë se shpronësimi i pronës është i ndaluar në mënyrë kategorike. Përkundrazi, Kushtetuta pohon shprehimisht që “Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin [shpronësimin] e pronës” (*id.*, neni 46, par. 3). Megjithatë, autorizimi kushtetues për të bërë shpronësimin e pronës nuk është pa kufi. Në veçanti, sipas *Kushtetutës*, shpronësimi mund të kryhet vetëm nëse “është *i autorizuar me ligj*” (neni 46, par. 3, theks i shtuar).

Kërkesa që shpronësimi të kryhet vetëm në përputhje me ligj, gjen mbështetje gjithashtu nga dy burime të tjera kushtetuese. Së pari, neni 1 i Protokollit të Parë i KENDJ përcakton se: “Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse . . . *në kushtet e parashikuara nga ligji*” (theks i shtuar). E drejta e përcaktuar me këtë dispozitë, njësoj si të gjitha të drejtat e përcaktuara në KEDNJ dhe Protokollet e saj, “garantohe[t] me këtë Kushtetutë” (*Kushtetuta*, neni 22). Së dyti, neni 55, par. 1, i Kushtetutës përcakton, gjithashtu për të gjitha të drejtat e njeriut në përgjithësi, që: “Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen *vetëm me ligj*”.

Në interpretimin e këtyre dispozitave, duhet marrë parasysh që, “[t]ë drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ)

(Kushtetuta, neni 53). Prandaj, për interpretimin e kërkesës kushtetuese që privimi dhe kufizimi i së drejtës së pronës duhet të jetë i autorizuar me ligj, duhet të bazohemi kryesisht në vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

Sipas GJEDNJ-së, vendime ose autorizime për shpronësim përbëjnë kufizim të së drejtës së pronës, edhe në rastet ku këto vendime dhe autorizime nuk janë aktualisht duke u ekzekutuar. Shih *Sporrong dhe Lonroth kundër Suedisë*, GJEDNJ, aplikimet nr.7151/75 dhe 7152/75 (1982), par. 60 (“Megjithëse autorizimet për shpronësim kanë lënë të paprekur, në ligj, të drejtën e pronarëve për të përdorur dhe shfrytëzuar posedimet e tyre, ato prapëseprapë, në praktikë, kanë ulur mundësinë e ushtrimit të asaj [të drejte]”). Dhe, përderisa afati tridhjetëditor, pas të cilit një ankesë kundër ligjshmërisë së një vendimi preliminar refuzohet automatikisht, e bën shumë më të lehtë për Qeverinë ose Komunën për të kryer shpronësime të pronës, rrjedhimisht bie që ky aspekt i procedurës së përcaktuar nga *Ligji i 2010* përbën një kufizim të qartë të së drejtës së pronës. Prandaj, në mënyrë që të jetë në përputhje me Kushtetutën, kjo procedurë, si kufizim i qartë i së drejtës së pronës, duhet të jetë “i parashikuar me ligj” ose “i autorizuar me ligj”.

Në të paktën një aspekt, është e tejdukshme që procedura në fjalë e përmbush këtë kërkesë kushtetuese: burimi i kësaj procedure është vetë *Ligji i 2010*. Në këtë mënyrë, është “i parashikuar me ligj” dhe “i autorizuar me ligj”. Megjithatë, vlerësimi ynë nuk mund të përfundojë me kaq. Sipas vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së, shprehjet “i parashikuar me ligj” dhe “i autorizuar me ligj”, nënkuptojnë *parimin e sigurisë ligjore* dhe, në mënyrë që një procedurë gjyqësore ose administrative të jetë në përputhje me këtë parim, nuk mjafton thjesht që të ndjekë kërkesat e përcaktuara në ligjin kombëtar. Ka edhe një kërkesë tjetër më të rreptë: procedura në fjalë gjithashtu duhet të jetë “e drejtë dhe e përshtatshme [fair and proper]” dhe “*nuk duhet të jetë arbitrare*” (*Winterwerp kundër Holandës*, GJEDNJ, aplikimi nr. 6301/73 (1979), par. 45, theks i

shtuar). Në këtë mënyrë, shprehjet “e parashikuar me ligj” dhe “e autorizuar me ligj” mishërojnë parimet elementare të sundimit të ligjit.

Duke marrë parasysh këtë standard më të rreptë, procedura gjyqësore e përcaktuar nga *Ligji 2010 nuk* mund të konsiderohet “e parashikuar me ligj” dhe “e autorizuar me ligj”. Siç u pa më sipër, duke përcaktuar që ankesa e parashtruesit do të hidhet poshtë automatikisht në rast se Gjykata Themelore dështon të marrë vendim brenda afatit tridhjetëditor, *Ligji 2010* e lë të hapur mundësinë që ankesa të refuzohet në mënyrë arbitrare, pa u shqyrtuar fare meritat substanciale të ankesës. Prandaj, procedura e përcaktuar në *Ligjin 2010* nuk e respekton parimin e sigurisë ligjore.

Arbitrariteti gjyqësor që mundësohet nga *Ligji 2010*, bëhet edhe më i rrezikshëm kur i marrim parasysh dy aspekte të tjera të procedurës që u përmendën më sipër. Së pari, *Ligji 2010*, duke shkurtuar afatin e nxjerrjes së aktgjykimit deri në 30 ditë kalendarike, i lë gjykatës fare pak kohë për të shqyrtuar katër kushtet substanciale për ligjshmërinë e vendimit preliminar për shpronësim. Këto kushte, të identifikuara më lart që shpronësimi të bëhet për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik; që ky qëllim nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit; që përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga shpronësimi; dhe që objekti i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues janë çështje të ndërlikuara faktike që mund të kërkojnë shumë kohë për t’u shqyrtuar me kujdes. Kjo e ka për pasojë rritjen e mundësisë që afati tridhjetëditor të mos respektohet nga Gjykata Themelore dhe, rrjedhimisht, që ankesa kundër vendimit preliminar të refuzohet në mënyrë arbitrare.

Edhe më shqetësues është fakti se, pas një refuzimi të tillë automatik të ankesës, nuk ka asnjë pengesë për organin shpronësues për të vazhduar me zbatimin e shpronësimit, edhe nëse ky refuzim

kontestohet në Gjykatën e Apelit. Kjo do të thotë se *Ligji i 2010* krijon mundësinë që një individ të privohet nga prona e tij, në bazë të një refuzimi arbitrar dhe të paarsyetuar të ankesës së tij kundër vendimit preliminar për shpronësim.

Për shkak të rrezikut të lartë të refuzimit arbitrar të ankesave kundër vendimeve preliminare për shpronësim, bashkë me pasojat e rënda juridike të një refuzimi të tillë, Avokati i Popullit konstaton se *Ligji i 2009*, i ndryshuar dhe plotësuar nga *Ligji i 2010*, nuk përmbush kërkesën kushtetuese për sigurinë ligjore dhe, rrjedhimisht, paraqet një shkelje të së drejtës së pronës.

**B. Vlerësimi i procedurës gjyqësore për ankesat kundër Vendimit Preliminar për shpronësim, në bazë të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar nga neni 31i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut**

Sipas nenit 31, par. 2 të *Kushtetutës*, “[ç]dokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet . . . brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”. Në mënyrë të ngjashme, KEDNJ përcakton se: “Në vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve civile . . . , çdokush ka të drejtë për një shqyrtim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj” (*id.*, neni 6, par. 1).

Vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së kanë konstatuar se “e drejta e pronës është, pa dyshim, ‘e drejtë civile’” që hyn në fushëveprimin e “të drejtave dhe detyrimeve civile” rreth të cilave çdokush ka të drejtë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 6, par. 1, të KEDNJ-së (*Sporrong dhe Lonroth kundër Suedisë*, GJEDNJ, Aplikimet nr. 7151/75 dhe 7152/75 (1982), par. 79). Shih, gjithashtu, *Kudla kundër Polonisë*, GJEDNJ, Aplikimi nr.30210/96 (2000), par. 146 (“Ku e drejta e Konventës e cituar nga individi është ‘e drejtë civile’ e njohur



nga ligji kombëtar, *si p.sh. e drejta e pronës*, mbrojtja e garantuar nga neni 6, par. 1, gjithashtu do të jetë në dispozicion”, theks i shtuar).

Siç u konstatua më sipër, procedura gjyqësore e përcaktuar nga *Ligji i 2010* përbën një kufizim të qartë së drejtës së pronës, ngaqë e bën shumë më të lehtë për Qeverinë ose komunën për të kryer shpronësime të pronës. Prandaj, vendosja e çështjeve të shpronësimit përfshihet në kategorinë “vendosja e të drejtave dhe detyrimeve civile” dhe u nënshtrohet kërkesave të nenit 6, par. 1, të KEDNJ-së.

Të paktën në Gjykatën Themelore, procedura e përcaktuar në *Ligjin 2010* nuk plotëson kriteret e nenit 6, par. 1, të KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, “e drejta për gjykim të drejtë, siç garantohet nga neni 6, par. 1, i Konventës, përfshin të drejtën e palëve në procedurë që të parashtrorjnë ndonjë vërejtje që ata konsiderojnë relevante për çështjen” (*Perez kundër Francës*, GJEDNJ, aplikimi nr. 47287/99 (2004), par. 80). Mirëpo, “kjo e drejtë mund të shikohet si efektive vetëm nëse vërejtjet ‘dëgjohen’ në të vërtetë”, gjë që “detyron ‘tribunalin’ që të ndërmarrë shqyrtimin e duhur të parashtrësive, argumenteve dhe dëshmive të parashtruara nga palët” (*id.*, par. 80, duke cituar *Van de Hurk kundër Holandës*, GJEDNJ, Aplikimi nr. 16034/90, par. 59). Për më tepër, në çështje të shpronësimit dhe çështje të tjera që “kanë të bëjnë me ‘të drejtat dhe liritë’ të garantuara nga Konventa dhe Protokollat e saj, gjykatat kombëtare e kanë për detyrë që t’i shqyrtojnë këto [parashtrësia, argumente dhe dëshmi] *me vëmendje dhe kujdes të veçantë*” (*Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, GJEDNJ, Aplikimi 76240/01 (2007), par. 96) (theks i shtuar).

Procedura e përcaktuar nga *Ligji i 2010* nuk e respekton të drejtën e palëve që parashtrësia, argumentet dhe dëshmitë e tyre të dëgjohen në të vërtetë, sepse, siç kemi theksuar disa herë, ankesa e parashtruesit hidhet poshtë automatikisht në rast se Gjykata Themelore dështon të marrë vendim brenda afatit tridhjetëditor. Në këtë mënyrë *Ligji i*

2010e lë të hapur mundësinë që ankesa të refuzohet pa asnjë shqyrtim, aq me pak “me vëmendje dhe kujdes të veçantë”.

Në këtë aspekt, rrethanat e rastit *Ruiz Torija kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aplikimi nr.18390/91 (1994), janë relevante. Në këtë rast GJEDNJ ka gjetur një shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak se gjykatat kombëtare kanë hedhur poshtë pretendimet e ankuesit pa shqyrtuar *njërin* prej argumenteve të ankuesit. Nëse shpërfillja e *një argumenti të vetëm* të parashtruesit nga gjykatat kombëtare mund të konsiderohet shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, atëherë, *a fortiori*, shpërfillja e *ankesës së plotë* të parashtruesit nga gjykatat kombëtare do të përbënte një shkelje edhe më të rëndë të kësaj të drejte.

Mirëpo, me gjithë dështimin e *Ligjit* që të plotësojë kriteret e nenit 6 të KEDNJ-së për shqyrtimin e ankesave kundër ligjshmërisë së Vendimeve Preliminare për shpronësim *në Gjykatën Themelore*, analiza nuk mund të përfundojë këtu, sepse GJEDNJ ka theksuar se detyrimi për të respektuar nenin 6 është detyrim i *“gjykatave kombëtare” duke u konsideruar si sistem i tërë*, jo detyrim i secilit trup administrativ ose gjyqësor që përfshihet në procedurë. Përkundrazi, “[n]evojat e fleksibilitetit dhe efikasitetit, të cilat janë krejtësisht në përputhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund të justifikojnë përfshirjen . . . e trupave administrativë ose profesionalë dhe, *a fortiori*, trupave gjyqësorë, që nuk përmbushin kërkesat [e nenit 6, par. 1] në çdo aspekt” (*Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, GJEDNJ, Aplikimet nr. 6878/75, 7238/75 (1981), par. 51). Në raste të tilla, “asnjë shkelje e Konventës nuk mund të gjendet nëse shqyrtimi përpara [trupave të tillë] ‘i nënshtrohet kontrollit të mëtejshëm nga një trup gjyqësor që ka juridiksion të plotë dhe ofron garancionet e nenit 6, par. 1’” (*Sigma Radio Television Ltd. kundër Qipros*, GJEDNJ, Aplikimet nr. 32181/04 dhe 35122/05 (2011), par. 151, duke cituar *Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës*, GJEDNJ, Aplikimet nr. 7299/75 dhe 7496/76 (1983), par. 29).

Për shembull, në rastin *Zumtobel kundër Austrisë*, Aplikimi nr. 12235/86 (1993), GJEDNJ ka konstatuar që, megjithëse procedura e ndjekur nga Qeveria për shpronësimin e pronës së ankuesit nuk përmbushi kriteret e nenit 6, par. 1 të KEDNJ-së, prapëseprapë nuk ka pasur shkelje të Konventës sepse kishte një instancë më të lartë gjyqësore e cila shqyrtoi rastin e ankuesit dhe i përmbushi kriteret e nenit 6, par. 1 (shih *id.*, par. 27–32).

Prandaj, për të vlerësuar nëse *Ligji i 2010* është në përputhje me nenin 6, par. 1 të KEDNJ-së, nuk mund të bazohemi vetëm mbi vlerësimin e procedurës së përcaktuar për ankesa në Gjykatën Themelore, sado e mangët që të jetë kjo procedurë. Në vend të kësaj, duhet shqyrtuar i tërë procesi i shpronësimit, duke përfshirë edhe procedurat e zhvilluara nga Organi Shpronësues para nxjerrjes së Vendimit Preliminar për shpronësim, si dhe procedurat për ankesat e mëtejshme kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Në mënyrë që procedura e përcaktuar nga *Ligji i 2010* të jetë në përputhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mjafton që “ose vetë organet juridiksionale të përputhen me kërkesat e nenit 6, par. 1, ose nuk përputhen në këtë mënyre por i nënshtrohen kontrollit të mëtejshëm të një trupit gjyqësor që ka juridiksion të plotë dhe ofron garancionet e nenit 6, par. 1” (*Albert dhe Le Compte*, GJEDNJ, *op. cit.*, par. 29).

*Ligji i 2009* (i modifikuar nga Ligji për Gjykatat) përcakton tri organe kompetente që përfshihen në vendosjen e çështjeve të shpronësimit: organi shpronësues, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit.

Kemi konstatuar se Gjykata Themelore nuk plotëson kriteret e nenit 6, për shkak të mundësisë së refuzimit të ankesës pa asnjë shqyrtim.

Po aq i qartë është dështimi i organit shpronësues që të plotësojë kriteret e nenit 6. Neni 6 kërkon që gjykimi të kryhet nga një tribunal “i pavarur dhe i paanshëm”. Për sa i përket pavarësisë, “duhe[t] marrë parasysh, mes të tjerash, . . . nëse [tribunali] paraqet një dukje të pavarësisë”, ndërsa, për sa i përket paanshmërisë, “tribunali duhet të

jetë subjektivisht i lirë nga paragjykim apo anshmëri . . . [dhe] duhet gjithashtu të jetë i paanshëm nga pikëpamje objektive” (*Kleyn dhe të tjerë kundër Hollandës*, Aplikimet nr. 39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99 (2003), par. 190–191).

Në vendosjen e çështjeve të shpronësimit, Organi Shpronësues nuk e plotëson as kriterin e pavarësisë, as kriterin e paanshmërisë. Siç kemi vërejtur më lart, “[p]rocedura e shpronësimit mund të iniciohet nga Organi përgjegjës Shpronësues . . . me vetiniciativë” (*Ligji i 2009*, neni 7, par. 2). Në raste të tilla, “ky organ shpronësues do të urdhëroj[ë] një ose më shumë nga anëtarët ose zyrtarët e tij që të përgatisin dhe dorëzojnë kërkesën [për shpronësim]” (*id.*, neni 7, par. 3, nënpar. 3), miratimin ose refuzimin e së cilës vetë Organi Shpronësues ka kompetencë për ta vendosur (shih *id.*, nenin 10, par. 1). Por, në raste të tilla, ku Organi Shpronësues efektivisht vendos për një shpronësim që vetë e ka iniciuar, nuk mund të pretendohet se ky organ është një tribunal i pavarur dhe i paanshëm në kuptimin e nenit 6, par. 1 të KEDNJ-së.

Megjithatë, Gjykata e Apelit, me procedurat e përcaktuara në *Ligjin 2010*, u shmanget mangësive procedurale të Gjykatës Themelore dhe Organit Shpronësues. Ndryshe nga Gjykata Themelore, në Gjykatën e Apelit ankesa nuk mund të refuzohet automatikisht pas kalimit të afatit tridhjetëditor. Prandaj, e drejta e ankuesit për t’u dëgjuar “në të vërtetë” nuk shkelet, të paktën jo në të njëjtën mënyrë. Gjithashtu, Gjykata e Apelit nuk vuan nga mungesa e pavarësisë dhe paanshmërisë që kemi gjetur tek Organi Shpronësues, sepse Gjykata nuk vendos për një shpronësim që ka propozuar ajo vetë.

Por, megjithëse Gjykata e Apelit arrin t’u shmanget mangësive procedurale të Gjykatës Themelore dhe Organit Shpronësues, ajo fatkeqësisht ka një mangësi tjetër që ia pengon përmbushjen e kriterëve të nenit 6 të KEDNJ-së: nuk mund të thuhet se Gjykata e Apelit ka juridiksion të plotë mbi ankesa kundër Vendimit Preliminar për shpronësim.

Një tribunal konsiderohet me juridiksion të plotë kur “ka juridiksion të shqyrtojë të gjitha çështjet faktike dhe ligjore që janë relevante për kontestin përpara tij” (*Terra Woningen B.V. kundër Holandës*, GJEDNJ, Aplikimi nr. 20641 (1996), par. 52). Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë shpjegon që, në mënyrë që një gjykatë të konsiderohet tribunal me juridiksion të plotë, “gjykata duhet të ketë të drejtën dhe detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore dhe kontestimore për çdo ankesë kundër një akti administrativ në të cilën një e drejtë ose detyrë civile po vendoset, d.m.th. duhet të jetë e detyruar të thërrasë dhe mbajë seancë dëgjimore kurdo që një palë në procedurë ta kërkojë” (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë, Rasti Nr. CRO-2000-3-017, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Shpronësim).

Për të konstatuar nëse ky kriter plotësohet nga Gjykata e Apelit, fillojmë me *Ligjin 2010*, ku thuhet se “çdo aktgjykim mbi një ankesë ose refuzim i një ankese nga gjykata [themelore] . . . mund të apelohej ***në përputhje me ligjin e aplikueshëm mbi këto apele***” (Ligji i plotësuar dhe i ndryshuar, neni 35, par. 10, theks i shtuar). Pastaj, për të marrë vesh se cili është “ligji i aplikueshëm mbi këto apele”, duhet vërejtur që vendimet preliminare për shpronësim klasifikohen si “akte administrative” në kuptimin e nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, sepse nxirren nga “organet e qeverisjes qendrore” ose “organet e vetëqeverisjes lokale”, përkatësisht Qeveria ose komuna. Megjithatë, Ligji për Konfliktet Administrative nuk përcakton drejtpërdrejt procedurat e shqyrtimit të ankesave nga Gjykata e Apelit. Në vend të kësaj, ai parashikon që: “Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konflikte administrative, do të zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore” (*id.*, neni 63).

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore përcakton se: “Aktgjykimi [i gjykatës së shkallës së parë] mund të goditet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore; për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike; për

shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale” (*id.*, neni 181, par. 1). Megjithatë, ajo që duhet theksuar në këtë kontekst, është se Ligji për Procedurën Kontestimore bën të qartë që thirrja ose jo e seancës dëgjimore, në shumicën e rasteve mbetet në diskrecionin e Gjykatës: “Gjykata e shkallës së dytë vendos për ankesën në seancë të trupit gjykues ose në bazë të shqyrtimit të çështjes në seanca gjyqësore” (*id.*, neni 190, par. 1). Gjykata është e detyruar të caktojë seancë gjyqësore vetëm “kur vlerëson se për konstatimin e gjendjes faktike, saktësisht dhe plotësisht, duhet vërtetuar fakte të reja dhe marrë prova të reja”, ose “kur në seancën e kolegjit vlerëson se aktgjykimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë (*id.*, neni 190, par. 2 dhe 3). Por, përveç në këto rrethana specifike, Gjykata e Apelit mund të vendosë të zgjidhë rastin vetëm “në seancë të trupit gjykues” (*id.*, neni 190, par. 1) dhe nuk është “*e detyruar* te thërrasë dhe mbajë seancë dëgjimore kurdo që një palë në procedurë ta kërkojë” (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë, *op. cit.*). Për më tepër, afati tepër i ngushtë që përcaktohet nga *Ligji 2010* për shqyrtimin e lëndës tridhjetë ditë pas paraqitjes së përgjigjes ndaj ankesës së parashtruar (shih *Ligjin e 2010*, neni 2, par. 1, nënpar. 7; neni 35, par. 13, nënpar. 3 dhe 4 i Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar) ka rrezik të ulë edhe më shumë mundësinë që Gjykata e Apelit do të caktojë seancë dëgjimore në raste të shpronësimit, në vend që të shqyrtojë rastin vetëm në bazë të seancës së trupit gjykues.

Për këto arsye, Gjykata e Apelit nuk mund të konsiderohet të jetë gjykatë me juridiksion të plotë në çështje të shpronësimit. Prandaj, asnjë nivel i procedurës administrative ose gjyqësore, as për nxjerrjen e vendimit preliminar për shpronësim, as për ankesat kundër tij, nuk plotëson kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së.

Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se *Ligji 2009*, i ndryshuar dhe plotësuar nga *Ligji 2010*, paraqet një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

## KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

### A. Konstatimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se:

(12) Ligji Nr. 03/L-139 (i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme, paraqet një shkelje të së drejtës së pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 1 të Protokollit të Parë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

(13) Ligji Nr. 03/L-139 (i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme, paraqet një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

### B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që:

(7) Të hiqet në tërësi neni 35, par. 6, nënpar. 3 dhe 4 i Ligjit Nr. 03/L-139 (të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme: “Menjëherë pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues, gjykata . . . *nxjerr aktgjykimin mbi rastin brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues; dhe i cakton afatet për zhvillimin e procedurës mbi rastin në mënyrë që t’i mundësojë nxjerrjen e aktgjykimit brenda periudhës së lartpërmendur prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike*”.

- (8) Të hiqet në tërësi neni 35, par. 8 i Ligjit Nr. 03/L-139 (të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme: ***“Nëse gjykata nuk e nxjerr aktgjykimin brenda periudhës tridhjetë (30) ditore të përcaktuar në nënparagrafin 6.3 paragrafi 6 i këtij neni, gjykata konsiderohet përfundimisht se ka nxjerrë aktgjykim për refuzimin e ankesës në tërësi menjëherë pas skadimit të kësaj periudhe tridhjetë (30) ditore”***.
- (9) Të hiqet në tërësi neni 35, par. 13, nënpar. 3 dhe 4 i Ligjit Nr. 03/L-139 (të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme: ***“Pas pranimit të apelit, gjykata e apelit . . . nxjerr aktgjykimin e saj mbi apelin brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas datës në të cilën ka pranuar përgjigjen e palës tjetër ose pas datës së skadimit të periudhës pesëmbëdhjetë (15) ditore për dorëzimin e përgjigjeve, cilado që ndodh më herët; dhe i cakton afatet për zhvillimin e procedurës në mënyrë që t’i mundësojë nxjerrjen e aktgjykimit brenda periudhës së lartpërmendur tridhjetë (30) ditore”***.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit



Prishtinë, më 23 tetor 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa nr. 201/2015**

**B.K.**

**kundër**

**Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të  
dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së apo të internuarit të  
UÇK-së**

- Për: Z. Isa Mustafa, kryeministër i Republikës së Kosovës  
Z. Arban Abrashi, ministër  
Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS)  
Z. Agim Çeku, kryetar  
Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
- Lënda: Rekomandime lidhur me zbatimin e nenit 8, paragrafit 2 të Ligjit Nr.04/L-054, për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre
- Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1.7

### **Qëllimi i raportit**

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (më tutje: *Komisioni Qeveritar*), lidhur me nenin 8, paragrafin 2 të Ligjit Nr.04/L-054, Për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktima civile dhe familjeve të tyre (më tutje: *Ligji*).

### **Kompetenca e Avokatit të Popullit**

2. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit është i autorizuar “*të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.*”

### **Heqja dorë nga përgjegjësia**

3. Asgjë nga përmbajtja e këtij raporti nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë të Avokatit të Popullit nga e drejta e tij për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e pushtetit rreth çështjeve lidhur me ligjin dhe praktikën e lartpërmendur ose të shqyrtojë dekretet e ngjashme ligjore për pajtueshmërinë e tyre me standardet e njohura ndërkombëtare. Avokati i Popullit i rezervon të gjitha të drejtat për të ushtruar juridiksionin e tij lidhur me këto ose çështje tjera të ngjashme.

### **Përshkrimi i rastit**

4. Ky raport është bazuar në ankesën e parashtruar nga z. B.K., anëtar i Komisionit të Familjeve të Dëshmorëve të Kombit kundër

*Komisionit Qeveritar*, për shkak të mosnjohjes së statusit të dëshmorëve të rënë brenda periudhës 1968-1990.

5. Ankuesi me rastin e paraqitjes së ankesës së tij në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) ka pohuar se neni 8, paragrafi 2 i *Ligjit* përcakton se të drejtat në pension e beneficione për familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit, të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike. Ankuesi ka sjellë në IAP listën me 168 emra që sipas Komisionit të Familjeve të Dëshmorëve të Kombit janë emrat e dëshmorëve të kombit, të rënë në periudha të ndryshme të rezistencës kombëtare.
6. Ankuesi ka pohuar se *Komisioni Qeveritar* ka refuzuar kërkesat e familjareve të dëshmoreve të kombit të rënë brenda periudhës 1968-1990. Sipas ankuesit, ai në mënyrë joformale kishte mësuar se arsyet e refuzimit ishin se *Komisioni Qeveritar* kishte deklaruar se nuk është kompetent për të vendosur lidhur me kategorinë e dëshmorëve të kombit të rënë brenda kësaj periudhe.
7. Më 12 maj 2015, Avokati i Popullit i është drejtuar kryetarit të *Komisionit Qeveritar*, z. Agim Çeku për të mësuar se për cilat kategori bëhet fjalë në nenit 8, paragrafin 2 të *Ligjit*.
8. Kryetari i *Komisionit Qeveritar* nuk është përgjigjur në letrën e datës 12 maj 2015, prandaj Avokati i Popullit, më 1 qershor 2015 ka dërguar një letër përsëritëse, në të cilën ai përsëri nuk ka marrë përgjigje.

#### **Mosbashkëpunimi i Komisionit Qeveritar me Avokatin e Popullit**

9. Avokati i Popullit nuk ka arritur të sigurojë informata lidhur me qëndrimin zyrtar të *Komisionit Qeveritar* në raport me kërkesat e familjarëve të dëshmorëve të rënë gjatë periudhave të ndryshme historike, për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana *Komisionit Qeveritar*.

- 10.** Avokati i Popullit me këtë rast rikujton se mosbashkëpunimi i organeve, institucioneve ose autoriteteve, që ushtrojnë pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, paraqet shkelje të nenit 132, paragrafit 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 25 të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit.

### **Legjislacioni në fuqi**

- 11.** Avokati i Popullit vëren se neni 8 i *Ligjit* përcakton të drejtën në pension dhe beneficione për familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, ndërsa paragrafi 2 i nenit 8, në veçanti përcakton se:

*“Këto të drejta i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmoreve të kombit të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike”*

- 12.** Avokati i Popullit vëren se sipas *Ligjit*, neni 3 paragrafi 1.6, Dëshmor i Kombit konsiderohet pjesëmarrësi i UÇK-së që:

*1.6.1. ka rënë në luftë për lirinë e vendit nga viti 1997-1999;*

*1.6.2. është plagosur në luftë për lirinë e vendit në periudhën 1997-1999 dhe ka vdekur nga plagët e marra brenda tri (3) viteve.*

### **Pritjet legjitime**

- 13.** Koncepti i pritjeve legjitime në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Rrënjët e parimit të pritjeve legjitime gjenden në të drejtën publike gjermane, parim ky i cili është në përdorim të gjerë nga gjykatat administrative të këtij vendi.
- 14.** Po ashtu, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka integruar konceptin e pritjeve legjitime në shqyrtimin e rasteve të ngritura pranë kësaj gjykate.
- 15.** Sipas nenit 22, paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe

Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Ndërsa, sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “[t]ë drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

16. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, para 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII), “pritja legjitime” duhet të jetë e një natyre më konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore ose në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e familjarëve të dëshmorëve të kombit të rënë në periudha të ndryshme historike bazohet në ligj të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili është në zbatim nga 1 janari 2012.
17. Avokati i Popullit konsideron se neni 8, paragrafi 2 i *Ligjit* ka krijuar pritje legjitime tek familjarët e dëshmorëve të kombit të rënë në periudha të ndryshme historike lidhur me realizimin e të drejtave të tyre. Mos përbushja e pritjeve legjitime të krijuara nga familjarët e dëshmorëve të kombit nga ana e autoriteteve të Republikës së Kosovës, përbën shkelje të të drejtave të tyre të përcaktuara me ligj.

### **Konkluzion**

18. Avokati i Popullit vëren se *Ligji* nuk e përkufizon në mënyrë të qartë dhe koncize kategorinë e dëshmorit të kombit. Sipas përkufizimeve të *Ligjit*, neni 3, paragrafi 1.6 përcakton se dëshmor i kombit konsiderohet personi që ka rënë në luftë për lirinë e vendit nga viti 1997-1999 ose është plagosur në luftë për lirinë e vendit në periudhën 1997-1999 dhe ka vdekur nga plagët e marra brenda tri (3) viteve. Ndërsa, neni 8, paragrafi 2 përcakton se të drejtat dhe beneficinet të përcaktuara me nenin 8

të *Ligjit* i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike. Praktikisht, bëhet fjalë për dy kategori të ndryshme me të njëjtin emër.

19. Avokati i Popullit konsideron se gjatë hartimit të *Ligjit* do të mund të jenë shkelur disa parime themelore për hartimin e legjislacionit që janë paraparë nga Këshilli i Bashkimit Evropian<sup>62</sup>. Këto parime zbatohen edhe nga Qeveria e Kosovës gjatë hartimit të legjislacionit.<sup>63</sup>
20. Sidoqoftë, Avokati i Popullit konsideron se mangësitë në *Ligj* nuk do të duhej të ndikonin në sigurinë juridike të personave ndaj të cilëve zbatohet akti. Me sigurinë juridike, në mes tjerash, kërkohet që premtimet e dhëna individëve nga shteti (*pritjet legjitime*), duhet të respektohen. Po ashtu, siguria juridike nënkupton që ligji të jetë i zbatueshëm dhe që ai zbatohet në praktikë.<sup>64</sup>

Në bazë të kësaj që u tha më lart, si dhe duke u nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të organeve të administratës publike, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 18 paragrafi 1.7 të *Ligjit për Avokatin e Popullit*:

### **Rekomandon që:**

---

<sup>62</sup> Rezoluta e Këshillit të Bashkimit Evropian, 8 qershor 1993, mbi kualitetin e hartimit të legjislacionit të BE-së, (93/C 166/01), 8 qershor 1993.

<sup>63</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PERMBLEDHJE\\_LEGJISLACIONI\\_PER\\_PROCESIN\\_E\\_HARTIMIT\\_TE\\_POLITIKAVE\\_DHE\\_LEGJISLACIONIT\\_B.M.PDF](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PERMBLEDHJE_LEGJISLACIONI_PER_PROCESIN_E_HARTIMIT_TE_POLITIKAVE_DHE_LEGJISLACIONIT_B.M.PDF) (qasur më 1 shtator 2015).

<sup>64</sup> EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)  
REPORT ON THE RULE OF LAW Adopted by the Venice Commission at its 86th plenary session  
(Venice, 25-26 March 2011) (44-51).

4. *Që Qeveria e Republikës së Kosovës të jap mandat Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ose të themelojë një komision të ri i cili do të shqyrtonte kërkesat për njohje të statusit të dëshmorëve të kombit të rënë në periudha të ndryshme historike sipas përcaktimit të vet Ligjit.*
5. *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të ndërmerre iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054, Për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në mënyrë që përkufizimet e ligjit të jenë në harmoni me përmbajtjen e ligjit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më **23 nëntor 2015**.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Kopje për:     Z. Kadri Veseli  
                  Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 30 tetor 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa nr. 23/2014**

**P.S. dhe të tjerët**

**Ankesa nr.473/2014**

**Z.V. dhe të tjerët**

**kundër**

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit**

Për: Z. Kadri Veseli  
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Z. Isa Mustafa  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Lënda: Mosemërimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të  
Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3  
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1.2



### **Qëllimi i raportit**

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me vonesat në emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tutje Bordi).

### **Kompetenca e Avokatit të Popullit**

2. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit ka përgjegjësi *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandime që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*

### **Përshkrimi i rastit**

3. Ky raport është bazuar në një numër ankesash që Avokati i Popullit i ka pranuar kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tutje AKP), lidhur me vonesat në shpërndarjen e mjeteve apo kompensim të kreditorëve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim. Ankesat e pranuar nga Avokati i Popullit janë si në vijim:

#### *P.S. dhe të tjerët*

4. Më 20 janar 2014, Avokati i Popullit, ka pranuar ankesën e z. P.S. dhe të tjerëve (tetë kolegëve të tij), kundër AKP-së, lidhur me pagesën e disa rrogave të cilat u kanë mbetur borxh nga ndërmarrja NSH "Fabrika e Metalit" në Klinë. Ankuesi pohon se lidhur me pagat e papaguara, ai dhe kolegët e tij, me kohë kanë paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Klinë (C.nr. 4/06, datë 30/11/2006), e cila ua ka miratuar kërkesën, mirëpo një vendim i tillë i gjykatës ende nuk është ekzekutuar nga ana e AKP-së, e cila fillimisht u ka thënë se do të kompensohen në fazën e likuidimit të ndërmarrjes. Ankuesi dhe kolegët e tij më 06/09/2013 kanë paraqitur kërkesë edhe te kryesuesi i Autoritetit të Likuidimit në

AKP, për kompensim të pagave dhe ekzekutim të vendimit të gjykatës, por pagesa nuk është kryer ende.

5. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e AKP-së, më 17 nëntor 2014 dhe më 9 qershor 2015, ku në mes të tjerash, është diskutuar për vonesat në shpërndarjen e mjeteve dhe kompensim. Në të dy rastet IAP është njoftuar nga AKP-ja se vonesat janë pasojë e mungesës së Bordit të AKP-së.

*Z.V. dhe të tjerët*

6. Më 30 shtator 2014, Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e z. Z.V. dhe të tjerëve (14 kolegë të tij,) kundër AKP-së, për moskompensimin e të ardhurave personale. Sipas pohimeve të ankuesit dhe të tjerëve dhe në bazë të dokumenteve të pranuar, ata kanë punuar në ndërmarrjen shoqërore "Pionir", e cila është privatizuar dhe për punën e kryer, ish-ndërmarrja u ka mbetur borxh për pagesën e të ardhurave personale në vlerë prej 9.900 eurove. Më 11 gusht 2006, Autoriteti i Likuidimit në kuadër të AKP-së ka aprovuar kërkesën e ankuesit dhe të tjerëve, për kompensim të pagave në shumën prej 6.000 eurosh, kompensim ky i cili nuk është kryer ende.
7. Avokati i Popullit i ka qenë në kontakt me AKP-në, lidhur me rastin, me ç'rast ai ia ka dërguar dy letra të njëpasnjëshme AKP-së, njërën më 10 nëntor 2014 dhe tjetrën më 28 korrik 2015. AKP ishte përgjigjur në të dy letrat. Në përgjigjen e parë, të cilën Avokati Popullit e kishte marrë nga AKP-ja, më 12 nëntor 2014, ishte theksuar se në mënyrë që pretenduesit të paguhen nga Autoriteti i Likuidimit nevojitet konfirmimi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (më tutje DHPGJS) se nuk ka ankesa të mbetura ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, por gjithashtu nevojitet që Kuvendi i Republikës së Kosovës të emërojë anëtarët e Bordit të AKP-së. Ndërsa në përgjigjen e fundit të cilën Avokati i Popullit e kishte marrë më 11 gusht 2015,

theksohet se AKP-ja nuk mund të kryejë kurrfarë shpërndarje apo kompensim kreditorëve të NSH “Pionir”, pa u emëruar Bordi nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili duhet të miratojë pagesat ndaj pretenduesve.

8. Bordi i AKP-së përbëhej nga 8 anëtarë, tre prej të cilëve ndërkombëtarë, të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe 5 anëtarë të tjerë vendorë, të cilët ishin emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mandati i tre anëtarëve ndërkombëtarë kishte skaduar më 31 gusht 2014 dhe që nga atëherë Bordi i AKP-së është jofunksional, për shkak të mungesës së kuorumit, ndërsa në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, Bordi i AKP-së ka mbetur edhe pa anëtarët vendorë.
9. Sa i përket përbërjes dhe emërimit të anëtarëve të Bordit të AKP-së, Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 12, përcakton se:

*1. Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë.*

*2. Kuvendi i Kosovës do të emërojë pesë (5) Drejtorë, duke përfshirë një përfaqësues nga një komunitet jo-Shqiptar si dhe përfaqësuesin e sindikatave të punëtorëve, dhe të caktojë njërin nga të emëruarit që të shërbejë si Kryesues i Bordit.*

*3. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar emëron tre ndërkombëtarë si Drejtorë të Bordit. Pas pëlqimit nga PCN, Bordi do të emëroje një qytetarë të Kosovës si Drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit; ky person nuk do të jetë anëtar i Bordit...”*

10. Ligji nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, neni 4, para. 2 dhe 3 përcaktojnë:

*2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:*

*3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një*

*shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.*

11. Pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, nga shtatori i vitit 2012 dhe pas skadimit të mandatit të të emëruarave nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, më 31 gusht 2014, përgjegjësia për emërimin e anëtarëve të Bordit të AKP-së bie mbi autoritetet e Kosovës.
12. Bordi i bartë të gjitha kompetencat e AKP-së. Për më shumë, neni 15, paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/1-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se: *“Bordi ka përgjegjësi të përgjithshme për aktivitetet e Agjencisë dhe për përmbushjen e kësaj përgjegjësie ndërmerr veprimet e duhura apo të lejuara me këtë ligj.”*

## **Përfundim**

13. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II, garanton të drejtat dhe liritë themelore.
14. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare [...] garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”*. Në mesin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare përfshihet edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).
15. Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë,*

*interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

16. Avokati i Popullit konsideron se mosemërimi i anëtarëve të Bordit të AKP-së ka shkaktuar vonesat në shpërndarjen e mjeteve dhe kompensim të kreditorëve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim.
17. Avokati i Popullit vlerëson se mosemërimi i Bordit të AKP-së, i cili ka rol qenësor, më mes të tjerash, në miratimin e shpërndarjes së mjeteve dhe kompensimin e kreditorëve, paraqet ndërhyrje në të drejtën pronësore të ankuesve dhe po ashtu paraqet shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

#### ***Ndërhyrje në të drejtën pronësore***

18. Me gjithë faktin se ankuesit nuk i kanë bërë referencë dispozitave të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe Protokolleve të saj ata kanë pohuar se bëhet fjalë për kompensimin e pagave të papaguara apo/dhe shpërndarjen e mjeteve në vlerë prej 20 % nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Avokati i Popullit vlerëson se ankesat kanë të bëjnë me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili përcakton se: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.*
19. Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për privim nga prona, pasi ankuesve u është e njohur e drejta në kompensim apo shpërndarje të mjeteve, por bëhet fjalë për privimin nga gëzimi paqësor i pasurisë, të shkaktuar me vonesat në emërimin e Bordit të AKP-së.
20. Lidhur me këtë Avokati i Popullit vëren se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka nxjerrë një aktgjykim në Rastin Nr.

KI187/13, të datës 1 prill 2014, respektivisht moszbatimit të vendimit të formës së prerë të vendimeve të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore për kthimin e posedimit të pronës, GJK në paragrafin 71 të aktgjykimit konstaton si në vijim: *“Sa i përket shkëljes së pretenduar, për mbrojtjen e pronës, Gjykata konstaton se Vendimi i KKKP-se, përbente pritje legjitime për parashtruesen, me të cilin është konstatuar se e njëjta është pronare legjitime e asaj prone. Prandaj, parashtruesja ka të drejtë ta gëzojë në mënyrë paqësore atë pronë, ashtu siç garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Në këto rrethana, asaj i është mohuar e drejta e gëzimit dhe posedimit të pronës (shih, mutatis mutandis, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII). Po ashtu, në paragrafin 81 të aktgjykimit thuhet: “...Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës, nga zvarritja dhe mospërmbarimi i Vendimit KPCC/D/A/114/2011 është privuar pa të drejtë nga prona e saj. Në këtë mënyrë, e drejta e parashtrueses për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e saj, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së gjithashtu është shkelur”.*

### ***Shkelja e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm***

**21.** Ankuesit, në rastin konkret, posedojnë vendimet e AKP-së, lidhur me kompensimin e mjeteve. Vendimet e AKP-së bëhen të plotfuqishme kur DHPGJS konfirmon se nuk ka ankesa kundër vendimeve të autoritetit të likuidimit apo kur vendos lidhur me ankesat në favor të kreditorëve. Në rastet e caktuara DHPGJS i dërgon rastet në gjykatat e rregullta për shkak të jo kompetencës, sikur në rastin e z. P.S. i dhe të tjerëve. Në çdo rast vendimet e plotfuqishme janë rezultat të një procesi gjyqësor, të cilat kanë mbetur të pazbatuara, për shkak të mungesës së Bordit të AKP-së.

22. Avokati i Popullit konsideron se kjo paraqet cenim të së drejtës në një proces të rregullt, të përcaktuar me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij...”
23. Avokati i Popullit, me të drejtë, i referohet nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ-së dhe atë për dy arsye:
- a) Çështjet lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore i nënshtrohen një procedure gjyqësore;
  - b) Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ është i zbatueshëm në rastet konkrete, përkatësisht në rastet e moszbatimit të vendimeve të plotfuqishme. GJEDNJ ka gjetur se zbatimi i vendimit të lëshuar nga çdo gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e “gjykimit” për qëllimet e nenit 6 (*shih Hornsby kundër Greqisë, paragrafi 40; Immobiliare Saffi kundër Italisë, paragrafi 63*). GJEDNJ në çdo rast rikujton se e drejta për një gjykim të drejtë dhe për qasje në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor i brendshëm i një shteti do të lejonte një vendim përfundimtar të gjykatës të mbetet i pazbatueshëm në dëm të njëjës palë. Do të ishte e paparamendueshme që neni 6, paragrafit 1 i KEDNJ-së të përshkruaj detajisht të gjitha garancitë procedurale që u ofrohen palëve në procedurë pa zbatimin e vendimeve të gjykatës. Interpretimi i nenit 6 në atë mënyrë sipas së cilës ai ka të bëjë ekskluzivisht me qasje në gjykatë dhe procedurën pranë gjykatës do të rezultonte me një situatë jokompatible me parimin e sundimit të ligjit të cilin shtetet kontraktuese

kanë marrë obligim ta respektojnë me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së.

- 24.** Avokati i Popullit vëren se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka nxjerrë një aktgjykim në Rastin Nr. KI187/13, të datës 1 prill 2014, lidhur me moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore, të cilën Agjencia Kosovare e Pronës ka dështuar ta zbatojë, për shkak të mungesës së mjeteve dhe ka konstatuar se:

(79) *“[...] mospërmbarimi i vendimit të KKKP nga AKP-ja dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas në kuptim të përmbarimit të vendimeve të formës së prerë është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.”*

(80) *“[...] Gjykata konkludon se mospërmbarimi i Vendimit të formës së prerë, KPCC/D/A114/2011, përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenit 54 të Kushtetutës.”*

- 25.** Në fund, Avokati i Popullit ua rikujton autoriteteve të Republikës së Kosovës njërën nga dispozitat themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

*Neni 7 [Vlerat]*

*“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës...”*



Prandaj, Avokati i Popullit

**Rekomandon që:**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmerr të gjitha veprimet e domosdoshme për propozimin e tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, sipas nenit 4, paragrafit 3 të Ligjit nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës të emërojë anëtarët e Bordit të AKP-së, në mënyrë që Bordi të kompletohet dhe të bëhet funksional ose së paku ta ketë kuorumin e duhur, sa më shpejtë që është e mundur, në mënyrë që të ndalohen shkeljet e shkaktuara nga mungesa e Bordit.
3. Nga akterët e përfshirë në çështjet e propozimit dhe emërimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së të vendoset procedura për emërimin e tre anëtarëve, të cilët deri më 31 gusht 2014 i kishte emëruar Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimet e lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më **22 nëntor 2015**.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Prishtinë, më 3 nëntor 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa nr: 89/2015**

**Sh.J.**

lidhur me të drejtën në jetë

**Për:** Z. Shpend Maxhuni, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Z. Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë

Z. Curr Gjocaj, drejtor i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 135, paragrafit 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 paragrafit 8 dhe nenit 27 të Ligjit për Avokatin e popullit nr. 05/L-019, më 3 nëntor 2015 publikon raportin në vijim:

### **Veprimet e institucionit të avokatit të popullit**

1. Më 10 shkurt 2015 z. Sh.J. (në tekstin e mëtejshëm “ankuesi”) ka paraqitur një ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm IAP), kundër Policisë së Kosovës, stacionit policor në Gjakovë, që ka të bëjë me mungesën e një hetimi efektiv në rastin e zhdukjes së djalit të tij z. Xh.J., si dhe me pretendimet se policia në Gjakovë ka kontribuar në zhdukjen e djalit të tij.
2. Më 26 shkurt 2015, ankesa është regjistruar në IAP (nr.i ankesës 89/2015).
3. Më 26 shkurt 2015, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me komandantin e stacionit policor në Gjakovë, i cili informoi se me këtë rast është duke u marrë njësia e hetimeve e stacionit të policisë në Gjakovë dhe e arsyetoi se deri tani janë kryer operacione të kërkim shpëtimor me ndihmën e njësive të zhytje, me njësinë e qenve gjurmues (njësi K9), por pa ndonjë rezultat konkret.
4. Më 6 mars 2015, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me hetuesin policor, që punon në rastin konkret dhe me atë rast mori informatat që njësia e hetimeve i ka ndërmarrë të gjitha veprimet operative, lidhur me këtë rast, që e njëjta i ka kontrolluar vendet potenciale ku në bazë të pretendimeve të ankuesit mund të ndodhej i zhdukuri. Hetimi përfshin këto veprime: kërkimet e policisë me qentë ndjekës, kërkimet me ekipet e zhytësve, është kontrolluar zona kufitare, është kontrolluar sistemi kompjuterik i regjistrimit të hyrje dhe daljeve kufitare, mirëpo të gjitha këto veprime nuk kanë rezultuar me ndonjë gjurmë në kuptim të vendndodhjes, apo marrjes së informacioneve për ndonjë drejtim të lëvizjes së personit të zhdukur.
5. Më 10 mars 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me shefin e Repartit të Psikiatrisë në Spitalin Rajonal "Isa Grezda" në

Gjakovë dhe me atë rast u informua që pacienti z.Xh.J., më 31 janar 2015, në orën 19<sup>30</sup> ishte sjellë nga policia në pavijonin e tij. Shefi i Repartit të Psikiatrisë theksoi se pacienti me atë rast ka marrë terapi parenterale *diazepam* dhe është hospitalizuar në këtë repart. Sipas pohimeve të shefit të Repartit të Psikiatrisë, z.Xh.J., po atë mbrëmje ka ikur nga spitali, kurse personeli mjekësor kujdestar këtë e ka kuptuar vetëm të nesërmen orën 06<sup>30</sup>, përkatësisht më 1 shkurt 2015. Për ikjen e pacientit, personeli i spitalit menjëherë e kanë njoftuar policinë, por policia, sipas pohimeve të shefit të Repartit të Psikiatrisë, ka ardhur në spital pas dy ditësh dhe me atë rast ata e kanë kërkuar historinë e sëmundjes së pacientit të ikur. Sipas fjalëve të tij, ky repart është repart i tipit të hapur, ashtu që pacientët mund të largohen nga aty pa asnjë lloj vështirësie.

6. Më 14 prill 2015, zyrtari policor i stacionit të policisë që merrej me rastin e z.Xh.J., të zhdukur, e informoi përfaqësuesin e IAP se rasti në fjalë ka kaluar në kompetencat e Drejtorisë së Policisë Rajonale në Gjakovë, Sektori për Vrasje dhe Persona të Zhdukur.
7. Gjithashtu, më 14 prill 2015, hetuesi përgjegjës i policisë rajonale në Gjakovë e informoi përfaqësuesin e IAP-së që rasti është publikuar në media dhe është kërkuar ndihma e qytetarëve lidhur me informatat, ku mund të ndodhej eventualisht personi i zhdukur, po ashtu është kërkuar ndihmë nga stacionet e tjera policore, por janë ndërmarrë edhe veprime të tjera operative, megjithatë, nuk ka pasur asnjë rezultat konkret.
8. Më 3 qershor 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me shefin e Sektorit Rajonal për Hetime në Drejtorinë e Policisë Rajonale në Gjakovë, me të cilin bisedoi, lidhur me ankesën e paraqitur të ankuesit. Përfaqësuesi i policisë sqaroi që policia ka ndërmarrë të gjitha masat dhe se hetimet për personin e zhdukur janë ende duke vazhduar, por deri tani pa ndonjë rezultat konkret.

9. Më 17 qershor 2015, ankuesi e njoftoi IAP-në, që lidhur me zhdukjen e djalit të vet, ai i ka dërguar një letër ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe një ankesë në punën e policisë në Gjakovë.
10. Më 11 shtator 2015, ankuesi e njoftoi IAP-në, se ka parashtruar një ankesë në Inspektoratin Policor të Kosovës kundër departamentit kompetent të policisë në Gjakovë, për neglizhencë dhe sjellje të pahijshme ndaj ankuesit (nr.03-2004, më 10 shtator 2015).
11. Më 14 shtator 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me zëvendësin e shefit të Sektorit Rajonal për Hetime dhe me mbikëqyrësin e Sektorit për Vrasje dhe Persona të Zhdukur, në Drejtorinë e Policisë Rajonale në Gjakovë, me të cilët bisedoi lidhur me lëndën e ankuesit dhe me atë rast kërkoi nga ata kopjen fizike të dosjes së lëndës. Me atë rast përfaqësuesi i IAP-së u informua për rrjedhën e hetimeve dhe se mund të merrte vetëm një raport me shkrim për rrjedhat e hetimeve, kurse për ta marrë kopjen fizike të lëndës në fjalë, IAP duhet t'i drejtohet me shkrim drejtorit të Policisë Rajonale në Gjakovë. Përveç kësaj, përfaqësuesi i IAP-së me atë rast u informua që Prokuroria Themelore në Gjakovë i ka iniciuar hetimet e veta në lidhje me rastin e ankuesit. (2015 EA-164 dhe 2015 HRGJ-06)
12. Gjithashtu, më 14 shtator 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me kryeprokuroren e Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe me prokurorin e lëndës, të cilët e informuan që prokuroria nuk ka hapur rast lidhur me këtë çështje, sepse në rastin konkret nuk ka të dyshuar dhe vetëm prokuroria është kontaktuar nga ana e policisë, në mënyrë që të ndihmonte në hetimet e policisë.
13. Të njëjtën ditë, përfaqësuesi i IAP-së, sipas udhëzimeve të zyrtarëve përgjegjës të Sektorit të Hetimeve Rajonale, i dërgoi një kërkesë përmes postës elektronike drejtorit të Drejtorisë së

Policisë Rajonale në Gjakovë, që IAP-së t'i dërgohet kopja fizike e shkresave të lëndës së ankuesit.

14. Më 21 shtator 2015, zëvendësi i udhëheqësit të Sektorit të Hetimeve Rajonale në Gjakovë e njoftoi përfaqësuesin e IAP-së, që kërkesa i është dërguar zëdhënësit të policisë (shefit të zyrës së administratës së drejtorit të Përgjithshëm të Policisë) për veprime të mëtutjeshme.
15. Më 23 shtator 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me shefin e zyrës së administratës të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, me ç' rast mori informatën se zyra në fjalë, përmes postës elektronike e ka informuar Zyrën Rajonale të Hetimeve në Gjakovë që derisa rasti të jetë nën hetime, IAP mund të marrë vetëm një raport përmbledhës lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e policisë në lidhje me rastin konkret, ndërsa kur hetimet të përfundojnë, IAP-së mund t'i dërgohet një kopje e dosjes së plotë.
16. Gjithashtu më 23 shtator 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me shefin dhe zëvendës shefin e Zyrës Rajonale të Hetimeve në Gjakovë, i cili e informoi se ka marrë përgjigjen në fjalë nga shefi i zyrës së administratës së drejtorit të Përgjithshëm të Policisë (shih paragrafin e mësipërm 15). Ai sqaroi se lidhur me këtë rast i është drejtuar përmes postës elektronike edhe Departamentit Ligjor të Policisë së Kosovës, prej të cilit ka kërkuar interpretim juridik lidhur me kërkesën e IAP-së, por ende nuk ka marrë përgjigje.

## **I. Rrethanat e rastit**

Faktet, të cilat deri tani kanë mund të vërtetohen, bazohen në pretendimet e ankuesit, si dhe në bazë të informatave të tjera që Avokati i Popullit i pati në dispozicion, mund të paraqiten si më poshtë:

17. Më 31 janar 2015, rreth orës 10<sup>00</sup>, djali i ankuesit z. Xh.J. (person i moshës madhore, të cilit në vitin 1992 i është caktuar diagnoza

“Schizophrenia” dhe “Pshychosis”), i kishte thyer xhamat e banesës së tij, prandaj njëri nga fqinjët e kishte lajmëruar policinë për këtë. Sipas pohimeve të ankuesit, i biri në atë moment gjendej i vetëm në banesë dhe nga frika se policët, të cilët kishin ardhur me ftesë të fqinjtit, do ta keqtrajtonin fizikisht, kishte tentuar t’u shmangej policëve duke u fshehur në banjë. Kur policia kishte hyrë në banesën e ankuesit, e kishte gjetur djalin e ankuesit dhe e kishte dërguar në Repartin Psikiatrik të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë (pa vendim paraprak të gjykatës).

- 18.** Më 1 shkurt 2015, i biri i ankuesit pas hospitalizimit në repartin e Psikiatrisë në Gjakovë mori terapinë e caktuar dhe pasi kaloi disa orë në spital, nga i njëjti iku pa u vënë re, në drejtim të panjohur dhe që atëherë i humbi çdo gjurmë. Parashtruesi i ankesës pohon se që nga ajo kohë, askush nuk di asgjë për fatin e djalit të tij dhe pohon se policia kishte kontribuar me qëllim në zhdukjen e djalit të tij.
- 19.** Më 10 shkurt 2015, ankuesi ka parashtruar ankesë kundër Policisë së Kosovës, stacionit policor në Gjakovë
- 20.** Më 16 shkurt 2015, ankuesi e njoftoi IAP-në se përkundër faktit që e ka publikuar zhdukjen e djalit të tij (përmes *televizionit, radios dhe gazetave ditore*) dhe ka kërkuar ndihmë nga kushdo qoftë që mund të ketë ndonjë informacion për vendndodhjen e djalit të tij, ai shprehu shqetësim, sepse deri tani askush nuk ka ndonjë njohuri lidhur me rrethanat e zhdukjes, duke i konsideruar përgjegjës zyrtarët policor dhe duke i akuzuar për joefikasitet të hetimeve.
- 21.** Në periudhën nga muaji shkurt deri në ditën e publikimit të këtij raporti, ankuesi pothuajse çdo ditë e ka vizituar njësinë përgjegjëse të policisë në Gjakovë duke kërkuar informata në lidhje me progresin e hetimit, i cili po zhvillohej me rastin e zhdukjes së djalit të tij. Sipas pohimeve të ankuesit, zyrtarët e policisë në zyrën e pranimit e pengojnë atë që të takohet dhe të

bisedojë me hetuesit përgjegjës të departamentit të hetimit, si dhe se disa herë i janë drejtuar me fjalë fyese të një natyre personale.

22. Nga data e publikimit të këtij raporti, nuk ka informacione se hetimi ishte efikas në cilëndo fazë dhe se në çfarëdo mënyre i ka kontribuar ndriçimit të rrethanave të zhdukjes së djalit të ankuesit.

## II. Instrumentet relevante

23. Neni 21, paragrafi 2 dhe 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “Kushtetuta”) përcakton si në vijim:

*“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”*

*“Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*

24. Nenin 25, paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton si në vijim:

*“Secili individ gëzon të drejtën për jetën”.*

[...]

*“Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj [...]”.*

25. Neni 2, paragrafi 2 i Ligjit për Policinë nr. 04/L-076 thotë:

*“Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme”.*

26. Neni 10 i Ligjit për Policinë, me të cilin përcaktohen detyrat dhe kompetencat e përgjithshme të policisë, si detyrë parësore përcakton si në vijim:



*”Të mbrojtë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat [...]”.*

**27.** Neni 19, paragrafi 1 i Ligjit për Policinë përcakton, si në vijim:

*“Zyrtari policor është i autorizuar të jap vërejtje gojore, me shkrim, vizuale ose vërejtje të tjera ndaj çdo personi që paraqet rrezik për sigurinë personale apo publike, paraqet rrezik për pronën private apo publike, prish rendin dhe qetësinë publike, paraqet rrezik për sigurinë në komunikacion ose ekziston dyshimi i bazuar se është duke kryer apo duke u përgatitur për të kryer një vepër penale ose është duke e detyruar personin tjetër të kryejë vepër penale”.*

Neni 4, paragrafi 1 i Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor nr.2004/38 (në tekstin e mëtejme “Ligji për mbrojtjen shëndetësore”) thotë:

*4.1. Çdo qytetar ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa diskriminim”,*

*4.2. ”Kujdesi shëndetësor është adekuat, në rast se është në përputhje me rregullat etike dhe profesionale, si dhe me udhëzimet relevante, të shërbimit të caktuar shëndetësor”.*

**28.** Nenet 78, 79 dhe 82 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore nr. 03/L-007 (në tekstin e mëtejme “Ligji për Procedurën Jokontestimore”) përcaktojnë:

Neni 78: *”Kur institucioni shëndetësor e pranon për shërim personin e sëmurë mendërisht pa pëlqimin e tij dhe pa vendim të gjykatës, ka për detyrë që për një gjë të këtillë ta njoftoj menjëherë me anë të një shkrese, e më së voni brenda 24 orëve, gjykatën në territorin e së cilës ndodhet ky institucion”.*

Neni 79: *”Njoftimi me shkrim nga neni 78 i këtij ligji duhet t’i përmbajë të dhënat për personin e mbajtur në institucion, si dhe*

*për personin që e ka sjell atë në institucionin shëndetësor. Bashkë me shkresën njoftuese institucioni shëndetësor, nëse ka mundësi, ia dërgon gjykatës edhe të dhënat lidhur me natyrën dhe shkallën e sëmundjes me dokumentacionin mjekësor që disponon”.*

Neni 82: *”Në qoftë se pranimi në institucionin shëndetësor nuk është bërë në bazë të vendimit të gjykatës kompetente, gjykata në territorin e të cilës ndodhet institucioni shëndetësor ka për detyrë që menjëherë pasi t’i arrijë njoftimi nga neni 78 ose 80 i këtij ligji, si dhe kur në mënyrë tjetër njoftohet për ndaljen e personit të sëmurë mendërisht pa pëlqimin e tij në institucionin shëndetësor, sipas detyrës zyrtare ta filloj procedurën për mbajtjen e tij të mëtejme në institucionin shëndetësor”.*

- 29.** Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950), (në tekstin e mëtejme “Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut”, ose “Konventa”) thotë:

*“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj [...]”*

- 30.** Neni 5, paragrafi 1 Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut”:

*“Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj [...]”.*

## **Analizat**

- 31.** Kushtetuta si akti më i lartë juridik i një vendi mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë përfshirë këtu edhe policinë dhe institucionet shëndetësore.

32. Kushtetuta në nenin 25, paragrafin 1 përcakton: “*Secili individ gëzon të drejtën për jetën*”. Nga ky paragrafi shihet qartë se drejta për respektimin e jetës së qytetarit gjendet në qendër të sistemit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe e drejta për jetën (pacenueshmëria e saj) është e drejtë absolute e njeriut, e cila nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë, shmangia nga kjo e drejtë nuk lejohet.
33. Avokati i Popullit vëren që Kushtetuta në nenin 26 definon që secili person ka të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përveç tjerash përfshin edhe të drejtën që: “*Askush të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj, përveç rasteve që janë në pajtim me ligjin.*”

[...]

Sa i përket sjelljes së autoriteteve policore, Avokati i Popullit gjithashtu thekson që kur bëhet fjalë për të drejtën e integritetit personal dhe të drejtën në jetë, shteti ka **detyrim pozitiv** të ndërmarrë të gjitha masat dhe për të mbrojtur pacenueshmërinë e integritetit fizik dhe psikik të personave, veçanërisht kur rrezikohet integriteti dhe jeta e njeriut. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në aktgjykimin KI. 41-12, ka gjetur se ka shkelje të së drejtës për jetë, në rastet kur organet gjyqësore apo organet tjera të shtetit nuk u ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme qytetarëve kur këtë e kërkojnë rrethanat e rastit. Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta për jetë është e drejta më e rëndësishme prej të gjitha të drejtave njerëzore, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera dhe sqaron që ekzistojnë detyrime pozitive për organet e pushtetit që të ndërmarrin masa parandaluese dhe operative për ta mbrojtur jetën e të gjithë atyre, që i janë ekspozuar rrezikut.

34. Në kuptim të dispozitës së nenit 2 dhe nenit 5 paragrafit 1 të Konventës, Avokati i Popullit rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet

gjqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “Gjykata Evropiane”).

35. Neni 2 i Konventës paraqet detyrat e përgjithshme të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë dhe përfshin aspektet **pozitive dhe negative**: a) **obligimin pozitiv** për ta mbrojtur jetën dhe b) **obligimin negativ** që të përmbahet nga marrja e paligjshme e jetës. Obligimi pozitiv imponon detyrime të **parandalimit dhe hetimit**. **Detyrimet e parandalimit** (shih rastin *Osmani kundër Britanisë së Madhe të datës 28 shkurt 1998*) i obligon qeveritë e shteteve t’i pengojnë dhe luftojnë veprat penale. Nëse vërtetohet që qeveritë kishin njohuri, ose do të duhej të kishin njohuri në kohën e ekzistimit të rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë për jetën e një personi të identifikuar, nga veprat penale të palëve të treta dhe nëse nuk kanë ndërmarrë masa të duhura në kuadër të kompetencave të veta, të cilat sipas një vlerësimi të arsyeshëm, mund të priteshin, në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë, të njëjtat duhet të jenë përgjegjëse për moszbatim të detyrimeve pozitive.
36. Neni 2 i Konventës, gjithashtu ia imponon detyrimin shtetit për t’i hetuar incidentet vdekjeprurëse duke përcaktuar që elementet kyçe të hetimit në përputhje me nenin 2 janë:
- që të jetë i iniciuar nga shteti sipas vullnetit të vet;
  - që të jetë i pavarur;
  - që të jetë efektiv;
  - që publiku të ketë njohuri të mjaftueshme lidhur me të njëjtin hetim, (të jetë i hapur për publikun);
  - që të jetë mjaft i shpejtë dhe
  - që të afërmit/familja të jenë të përfshirë.
37. Në bazë të vendimeve të Gjykatës Evropiane fushëveprimi dhe natyra e detyrës që të hetohen incidentet mortore/fatale janë të shpjeguara, në veçanti, në lëndën *Tanrikulu kundër Turqisë*, aktgjykimi i datës 8 korrik 1999. Gjykata Evropiane e ka vlerësuar që obligimi që të hetohen rastet e vdekjes nuk ka të bëjë vetëm me rastet e vdekjeve, për të cilat përgjegjës kanë qenë zyrtarët e shtetit, por të gjitha ato raste të vdekjeve për të cilat

autoritetet kanë qenë të informuara, domethënë, për të cilat kanë pasur njohuri. Autoritetet duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm/të domosdoshëm që të sigurojnë prova relevante (përfshirë edhe dëshmitë e dëshmitarëve okularë dhe provat e forenzikës), në mënyrë që hetimi të jetë i dobishëm dhe efikas. Prandaj, dështimi për t'u vazhduar rrjedha e qartë e ekzaminimit gjatë hetimeve mund të çojë në konstatimin e një shkeljeje të nenit 2. Në të vërtetë, Gjykata Evropiane erdhi në konstatimin që: *“Çdo mangësi gjatë hetimit që e dëmton mundësinë për ta identifikuar autorin ose autorët e veprës kriminale do të jetë në rrezik të shkeljes së këtij standardi”*, gjë që në pjesën më të madhe mund të ketë të bëjë edhe me rastin e ankuesit në lëndën kundër Policisë së Kosovës në lidhje me kryerjen e hetimeve në rastin e zhdukjes së djalit të tij.

38. Gjykata Evropiane në lëndën *Ramsahai dhe të tjerët kundër Holandës*, aktgjykimi i datës 15 maj 2007, konstatoi që: *“Ata që janë përgjegjës për bërjen e hetimeve duhet të jenë të pavarur nga personat që janë të përfshirë në incident, qoftë në aspektin e pavarësisë hierarkike dhe institucionale, qoftë në aspektin e pavarësisë praktike”*. Gjykata konstatoi që fakti që policët nga e njëjta njësi policore, si dhe policët që janë përfshirë në këtë incident kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në fillim të hetimeve, para se ta marrë përsipër hetimin Departamenti i Shtetit për Hetime Kriminale, pesëmbëdhjetë orë e gjysmë, pas vdekjes së personit nga të shtënat e policisë. Në pajtim me këtë Trupi i Lartë Gjykues konstatoi që ka ardhur deri te shkelja procedurale e nenit 2, për shkak se hetimet e policisë nuk kanë qenë mjaft të pavarura. Kur autoritetet janë të informuara për rastin e vdekjes, ose marrin informacion në lidhje me atë ngjarje në ndonjë mënyrë tjetër, ato janë të obliguara ta bëjnë hetimin, pa marrë parasysh a e ka parashtruar familja e të vdekurit domosdoshmërisht ankesën formale dhe organet hetuese duhet gjithashtu të veprojnë shpejt dhe në mënyrë të arsyeshme. Nga analiza e këtij rasti shihet se njësia e hetimeve e stacionit policor në Gjakovë ka vepruar në kundërshtim me nenin 2 të Konventës (në bazë të rasteve të Gjykatës Evropiane), meqë në rastin konkret nuk mund të flitet për pavarësi, sepse hetuesit kanë mund të jenë nën ndikimin e *personave që janë të përfshirë në incident, qoftë në aspektin e*

*pavarësisë hierarkike dhe institucionale, qoftë në aspektin e pavarësisë praktike.* Avokati i Popullit përkujton që fakti që ankuesi edhe më parë kishte parashtruar ankesa kundër policëve të këtij stacioni policor, të cilët kishin ushtruar dhunë fizike kundër djalit të tij dhe kishin refuzuar t'i japin informata ankuesit lidhur me rrjedhën hetimeve rreth zhdukjes së djalit të tij dhe po ashtu të njëjtit zyrtarë kanë qenë nën hetimin e Inspektoratit të Policisë së Kosovës, krijon dyshim akoma më të fuqishëm se **nuk ka pasur hetime të pavarura.**

39. Gjykata Evropiane gjatë interpretimit të nenit 2 të Konventës në rastin *Branko Tomashiq dhe të tjerët kundër Kroacisë, të datës 15 janar 2009*, lidhur me detyrimet pozitive **ka konstatuar** që **autoritetet** ishin në dijeni për seriozitetin e kërcënimeve, por **dështuan në detyrimet e veta pozitive**, para së gjithash **për shkak të trajtimit të pamjaftueshëm psikiatrik** duke konsideruar që shërimi zgjati shumë shkurtë, por nuk është e qartë, nëse shërimi ishte aplikuar në të vërtetë dhe siç duhet, gjë që mund të aplikohet edhe në rastin konkret të ankuesit.

40. Ligji për Policinë në nenin 2, paragrafin 2 definton:

*“Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme”, kurse paragrafi 3 përcakton: “Kodi i Etikës duhet të jetë në përputhje me parimet e lartpërmendura dhe me Kodin Evropian të Etikës Policore”.*

Veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës në bazë të këtij ligji udhëhiqen nga parimet e trajtimit të barabartë, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, paanshmëria dhe neutraliteti, lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave, integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik etj., prandaj sjellja e policëve në pajtim me këto parime gjatë kryerjes së detyrës zyrtare përbën bazën kryesore për bashkëpunim me qytetarë.

41. Ligji për Policinë në nenin,19, paragrafi 1, përcakton: *“Zyrtari policor është i autorizuar të jap vërejtje gojore, me shkrim, vizuale ose vërejtje të tjera ndaj çdo personi që paraqet rrezik për sigurinë personale apo publike, paraqet rrezik për pronën private apo publike, prish rendin dhe qetësinë publike, paraqet rrezik për sigurinë në komunikacion ose ekziston dyshimi i bazuar se është duke kryer apo duke u përgatitur për të kryer një vepër penale ose është duke e detyruar personin tjetër të kryejë vepër penale”*. Në bazë asaj që u tha më sipër, zyrtari policor është i autorizuar të bëjë kontroll të arsyeshëm të njerëzve dhe pronës në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të veta, të japë dhe të zbatojë urdhra dhe udhëzime ligjore, të cilat vlejnë për anëtarët e shoqërisë në përgjithësi, me qëllim të arritjes së objektivave ligjore të policisë. Autorizimet e cekura në këtë ligj përcaktojnë autorizimet dhe kufizimet e përgjithshme të zyrtarit policor në kryerjen e detyrave të tij lidhur me parandalimin e rrezikut dhe mbajtjen e rendit dhe të sigurisë publike. Ligji i jep autorizim policisë, që kur të ndërmarrë masa parandaluese për ta kufizuar lirinë e personit, duhet ta marrë parasysh maturinë, shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e kryerjes së veprës penale në situatën e dhënë, me qëllim që të përcaktohet shkalla e kufizimit të lirisë së personit në pajtim me ligjin. Ky ligj më tutje arsyeton që zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë përkohësisht personin, kur kjo gjë është e domosdoshme, në përputhje me afatet ligjore në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, kurse në rastet kur personi në mbajtje **është i paaftë për të vepruar**, zyrtari policor përpiqet që ta njoftojë një anëtar të familjes, ose ndonjë person tjetër të besueshëm, përveç nëse një gjë e tillë do të ishte në dëm të personit në mbajtje. Nga analiza e këtyre neneve shihet qartë, se në rastin konkret, zyrtarët policorë duke vepruar në kundërshtim me ligjin për policinë e kanë marrë vet rolin e gjykatës dhe pa asnjë lloj autorizimi e kanë dërguar të birin e ankuesit në institucion psikiatrik në trajtim.
42. Ligji për mbrojtjen shëndetësore në nenin 4, paragrafin 1 përcakton: *“Çdo qytetar ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa diskriminim”*, ndërsa i njëjti ligj në paragrafin 2

përcakton: “Kujdesi shëndetësor është adekuat, në rast se është në përputhje me rregullat etike dhe profesionale, si dhe me udhëzimet relevante, të shërbimit të caktuar shëndetësor”.

Qëllimi i këtij ligji sipas ligjvënësit është që të definohen të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, si dhe të vendosen mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave dhe përgjegjësiave. Ligji i obligon institucionet shëndetësore që t’i kushtojnë kujdes shëndetit të pacientit gjatë gjithë kohës, derisa i njëjti gjendet në institucione shëndetësore, në pajtim me rregullat etike dhe profesionale. Ky ligj në vete përmban më shumë të drejta në raport me ofrimin e shërbimeve shëndetësore duke i obliguar institucionet shëndetësore **t’i respektojnë të drejtat e qytetarëve** për kujdes cilësor shëndetësor, të drejtën e zgjedhjes së profesionistit shëndetësor, të drejtën në dinjitetin njerëzor, të drejtën e komunikimit, të drejtën e largimit nga institucioni, të drejtën për të qenë i informuar, të drejtën e vendimit personal etj.

Neni 8 i këtij ligji përcakton: “Qytetari, ka të drejtë, që të largohet nga institucioni shëndetësor. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në mënyrën e përcaktuar me ligj, në rastet kur me këtë veprim, rrezikohet siguria fizike ose shëndeti i të tjerëve”, ndërsa neni 8, paragrafi 3 definojnë: “Në rast se, qytetari largohet nga institucioni shëndetësor pa paralajmërim, mjeku përgjegjës duhet ta evidentojë këtë fakt në dokumentacionin e tij, shëndetësor atëherë kur, largimi i paparalajmëruar nga institucioni shëndetësor, është i kushtëzuar me gjendjen shëndetësore të qytetarit, duhet të njoftohen autoritetet kompetente, ndërsa në rastin e qytetarit, i cili nuk ka aftësi veprimi, ose ka aftësi të zvogëluar veprimi, duhet të njoftohet përfaqësuesi ligjor i tij.”

Nga analiza e këtyre neneve shihet se ligji kërkon qasje etike dhe profesionale ndaj pacientit, kurse në rastin konkret shihet se institucioni shëndetësor kishte dështuar të ofrojë kujdesin



obligativ ndaj pacientit, i cili duke e shfrytëzuar moskujdesin e personelit mjekësor, pa u vërejtur, është larguar nga spitali.

43. Ligji për Procedurën Jokontestimore, në nenin 78 përcakton: “*Kur institucioni shëndetësor e pranon për shërim personin e sëmurë mendërisht pa pëlqimin e tij dhe pa vendim të gjykatës, ka për detyrë që për një gjë të këtillë ta njoftoj menjëherë me anë të një shkrese, e më së voni brenda 24 orëve, gjykatën në territorin e së cilës ndodhet ky institucion.*

Avokati i Popullit, nga hetimet e këtij rasti, vëren që Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, edhe më tutje vazhdon si më parë të ballafaqohet me raste të pranimit të pacientëve me çrregullime mendore, të cilët në këtë spital i sjell policia (*pa vendim të gjykatës*), por gjithashtu që as ky institucion shëndetësor asnjëherë nuk e ka informuar gjykatën, në pajtim me nenin 78 të Ligjit për procedurën jokontestimore me arsyetimin se ata nuk e kanë ditur që kanë obligime të tilla ligjore.

44. Neni 79 i Ligjit për Procedurën Jokontestimore përcakton qartë se njoftimi me shkrim i institucionit shëndetësor drejtuar gjykatës duhet t’i përmbajë të dhënat për personin e mbajtur në institucion, si dhe për personin që e ka sjellë në atë institucionin shëndetësor. Gjithashtu, bashkë me shkresën njoftuese institucioni shëndetësor ia dërgon gjykatës edhe të dhënat lidhur me natyrën dhe shkallën e sëmundjes, si dhe lidhur me dokumentacionin mjekësor që disponon. Ky ligj e ngarkon më tej gjykatën kompetente, në territorin e të cilës ndodhet institucioni shëndetësor, që menjëherë pasi ta marrë njoftimin (sipas nenit 78 ose 80 Ligjit për Procedurën Jokontestimore), ose pasi në çfarëdo mënyre tjetër të njoftohet për ndaljen e personit të sëmurë mendërisht pa pëlqimin e tij në institucionin shëndetësor, **sipas detyrës zyrtare** ta fillojë procedurën për mbajtjen e tij të mëtejme.

45. Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmimeve të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve relevante, të cilat e përcaktojnë të drejtën për jetë, **konstaton se ankesa e ankuesit është e arsyeshme dhe e ligjshme**. Në rastin konkret, **Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të Drejtave dhe**

**Lirive Themelore të Njeriut**, meqë zyrtarët policorë me vetë faktin që personin, tani të zhdukur, e kanë dërguar në trajtim të detyrueshëm psikiatrik pa vendim të gjykatës kanë vepruar në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi duke i tejkaluar autorizimet policore dhe kanë ndërmarrë veprime që janë në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën Evropiane, Ligjin për Policinë, si dhe me Kodin e Etikës Policore.

46. Avokati i Popullit konsideron që institucioni shëndetësor, i cili e ka pranuar në shërim personin me çrregullime mendore, të njëjtit nuk ia ka ofruar ndihmën e nevojshme profesionale, *meqë nga momenti i pranimit të tij në institucionin shëndetësor deri në momentin e arratisjes së tij nga ky institucion, atë asnjëherë nuk e ka vizituar psikiatri, por vetëm personeli mjekësor kujdestar (shih më lartë paragrafin 5)*. Është shqetësues fakti se, si pasojë e mostrajtit adekuat dhe mosmbajtjes nën vëzhgim të pacientit ka ardhur deri te arratisja e tij nga ky institucion pa u vërejtur nga askush, prandaj rrethanat e zhdukjes së këtij personi nga institucioni në fjalë, mbeten të paqarta deri në një njoftim të mëtejshëm, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme. Avokati i Popullit gjatë hetimit të këtij rasti është informuar se ka pasur edhe raste të tjera të largimit të personave me çrregullime mendore nga ky institucion, pra raste të tilla kanë ndodhur edhe më parë. Sipas pohimeve të prokurorisë në Gjakovë, një rast i ngjashëm ka ndodhur para katër vitesh dhe për fatin e personit të zhdukur nuk është mësuar asnjëherë.
47. Avokati i Popullit konsideron, që me mosinformimin e gjykatës nga ana e institucionit shëndetësor ka ndodhur shkelja e nenit 78 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, kurse arsyetimi i dhënë nga institucioni shëndetësor, se nuk i kanë ditur obligimet e tyre ligjore, është i pabazë. Avokati i Popullit ka prova që në të kaluarën kanë ndodhur veprime të njëjta, madje edhe keqtrajtime të djalit të ankuesit nga ana policisë<sup>65</sup> dhe ende po vazhdohet me

---

<sup>65</sup> Shih ankesën e paraqitur në IAP Shaban Jashari kundër Policisë së Kosovës (A.nr.58/2014), datë 10 shkurt 2014, ku ankuesi pretendon se djali i tij z. Xhemshit Jashari tij po keqtrajtohet fizikisht nga zyrtarët policor.

praktika të ngjashme edhe kundër personave të tretë, gjë që kërkon urgjencë në kuptim të ndalimit përfundimtar të kësaj praktike, sepse në këtë mënyrë po krijohet përshtypja e një paqëndrueshmërie juridike. Në kuptim të asaj që u tha më lartë, është e domosdoshme që organet përgjegjëse shëndetësore pa vonesa të mëtejme t'i publikojnë udhëzimet me detyrimet ligjore të institucioneve shëndetësore dhe të njëjtat të shpërndahen nëpër të gjitha institucionet shëndetësore, në mënyrë që lidhur me këtë çështje dhe çështje të ngjashme të eliminohen shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut në të ardhmen.

48. Avokati i Popullit konstaton se, organet shtetërore përgjegjëse dështuan në ndërmarrjen e masave në lidhje me **detyrimet pozitive**, respektivisht mbrojtjen e pacenueshmërisë së integritetit fizik dhe psikik të njeriut, sidomos në rastet kur integriteti dhe jeta e njeriut janë të rrezikuara, kurse në rastin konkret si pasojë e mosndërmarrjes së masave të tilla tani gjenden para ballafaqimit me pasojat. Avokati i Popullit konstaton se ankesat e mëhershme të ankuesit të parashtuara kundër zyrtarëve policor të këtij stacioni policor në Gjakovë, lidhur me pretendimet se ata kanë ushtruar dhunë fizike kundër djalit të tij (*rasti është paraqitur në Inspektoratin Policor, Ministrit të Punëve të Brendshme dhe EULEX-it*) e bëjnë hetimin të padenjë para ankuesit, prandaj do të ishte e dëshirueshme që hetimet të zhvilloheshin nga ndonjë njësi tjetër jashtë këtij stacioni dhe në pajtim me konstatimet dhe mendimet e Gjykatës Evropiane (*shih paragrafin 32*).
49. Avokati i Popullit është i mendimit se, kur djali i ankuesit u dërgua nga policia në trajtim psikiatrik, policia nuk e informoi për këtë familjen konform detyrave dhe përgjegjësive që i ka, kurse ankuesi pohon se është informuar për këto ngjarje vetëm dy ditë më vonë. Sipas pohimeve të ankuesit, po të kishte qenë i informuar për vendin ku gjendej biri i tij, ai do të kujdesej vetë për djalin e tij dhe në këtë mënyrë do të shmangej situata, e cila u krijua më vonë. Avokati i Popullit, gjithashtu nuk e liron nga përgjegjësia ankuesin, i cili nuk i kishte shpërfillur këshillat Institucionit të Avokatit të Popullit, që nga gjykata të kërkojë heqjen e zotësisë së veprimtimit të djalit të tij dhe caktimin e kujdestarit (*shih A.nr.58/2014*). Mirëpo, Avokati i Popullit

konsideron që për mosveprim përgjegjëse janë edhe *institucionet*, të cilat kanë mandat që sipas detyrës zyrtare ta iniciojnë kërkesën për heqjen e zotësisë së veprimit para gjykatës kompetente.

50. Kur është fjala për mos bashkëpunimin e Policisë së Kosovës me IAP-në (shih paragrafët 15. dhe 16.), Avokati i Popullit konsideron që dështimi për ta dërguar kopjen e dosjes së lëndës nga ana e policisë, sipas kërkesës së IAP-së, është **veprim kundërkushtetues dhe veprim kundërligjor**. Avokati i Popullit është i mendimit që pamundësimi i qasjes në dosjen e policisë në lëndën e djalit të zhdukur të ankuesit ia ka pamundësuar IAP-së t'i verifikojë pretendimet për shkelje të tjera të të drejtave të personit të zhdukur, të cilat parashtuesi i ankesës i ka cekur në ankesën e vet dhe për të cilat pohon se kanë ndodhur. Mirëpo, meqë IAP nuk ka një pasqyrë të qartë të ngjarjeve të situatës konkrete sipas dosjes së policisë, kurse në lidhje me sjelljen e policisë në këtë rast, ekziston dyshimi që pamundësimi i qasjes në dosjen në fjalë po bëhet pikërisht me qëllim të mbrojtjes së veprimeve të paligjshme të policisë.

51. Avokati i Popullit rikujton se neni 132, paragrafi 3 i Kushtetutës përcakton: “*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj*”.

Më tutje, Ligji për Avokatin e Popullit nr.05/L-019, në nenin 18, paragrafin 6, përcakton: “***Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet, të çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, duke përfshirë dosjet mjekësore për personat e privuar nga liria, në pajtim me ligj, dhe mund t’i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit***”.

Neni 25, paragrafi 2, i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”* kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton: *“Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare”*.

## REKOMANDIMET

52. Avokati i Popullit i rekomandon Policisë së Kosovës që:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, si dhe në bashkëpunim me të gjitha agjencitë e tjera të sigurisë (duke mos përjashtuar ato të inteligjencës dhe ndihmën ndërkombëtare), të ndërmarrë masa urgjente për gjetjen e personit të zhdukur.*
- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, të ngritë kapacitetet profesionale të Policisë së Kosovës, lidhur me të drejtën në jetë dhe aspektet procedurale për hetime efektive të rasteve të tilla.*

53. Avokati i Popullit i rekomandon drejtorit të Policisë që:

- *Të nxjerrë një udhëzim me shkrim dhe t'i informojë të gjitha stacionet dhe njësitë e policisë që është detyrë dhe obligim i tyre të bashkëpunojnë me IAP-në dhe të njëjtit me kërkesë t'ia ofrojnë të gjitha informacionet e kërkuara, përfshirë edhe dosjen e plotë apo të pjesshme të lëndës, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.*

54. Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës:

- *Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës të nxjerrë një udhëzim, me të cilin do t'i njoftojë të gjitha institucionet shëndetësore për detyrat dhe përgjegjësitë që kanë, kur përballen me raste të pranimit të personave me çrregullime mendore pa vullnetin e tyre, si dhe t'i obligojnë institucionet të veprojnë në përputhje me nenin 78 dhe 79 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore. Gjithashtu, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës t'i ndër marrë të gjitha veprimet e domosdoshme për ngritjen e nivelit etik dhe profesional të personelit dhe të kërkojë nga punëtorët shëndetësor që t'i trajtojnë pacientët me përgjegjësi dhe profesionalizëm maksimal, duke u ofruar shërbime shëndetësore profesionale dhe duke i mbikëqyrur edhe vizualisht gjatë gjithë orarit të punës, derisa personat e tillë gjenden në institucionin shëndetësor.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutem të na informoni për veprimet që do t'i ndër marrë Policia e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartshënuara. Gjithashtu, Ju lutem që përgjigjet lidhur me këtë çështje, t'i dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 3 dhjetor 2015.

Me nderime

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Kopje: Z. Skender Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Prishtinë, më 6 nëntor 2015

## **RAPORT**

**Ankesa nr. 66/2015**

**N.F.**

lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë

Për: - Z. Hamdi Ibrahim, kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë,  
- Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
- Z. Isa Mustafa, kryeministër i Republikës së Kosovës,,  
- Z. Enver Peci, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Avokati i Popullit në Kosovë, në pajtim me nenin 135, paragrafin 3. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 16, paragrafin 8 dhe nenin 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, më datën 26 tetor 2015 publikon raportin në vijim:

### **Veprimet e institucionit të avokatit të popullit**

1. Më 5 shkurt 2015, z. N.F., (në tekstin e mëtejshëm "ankuesi") e ka paraqitur një ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm "IAP") që ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës në rastin e kontestit të punës kundër Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "i padituri"). Ankuesi e inicioi një padi në asokohe Gjykatën Komunale në Prishtinë, kurse tani Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë, më 25 maj 2009 dhe të njëjtën e zgjeroi dhe e plotësoi, më 3 shkurt 2011 (P.1084/09). Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë nuk ka nxjerrë aktgjykim të shkallës së parë për lëndën e ankuesit. Ankuesi pohon që Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë në mënyrë të panevojshme vonohet në procedimin e lëndës së tij.
2. Më, 5 shkurt 2015, ankesa është regjistruar në IAP (nr. i ankesës 66/2015).
3. Më 12 shkurt 2015, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit e vizitoi gjyqtarin e procedurës dhe kërkoi që për shkak të natyrës së kontestit të merret rasti në punë dhe të sigurohet që në afat sa më të shpejtë të nxirret aktgjykimi. Gjyqtari i procedurës në takim ia shpjegoi këshilltares përgjegjëse ligjore se rasti i ankuesit do të trajtohet si rast me prioritet dhe se do të fillojë punën në këtë lëndë, posa të marrë miratimin nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që mund të vazhdojë punën në gjykatën e Graçanicës. Në fakt, angazhimi i tij në këtë gjykatë ka skaduar më 31 dhjetor 2014 dhe që atëherë ai nuk mund të punojë dhe të caktojë gjykime, për shkak se nuk ka marrë asnjë njoftim zyrtar, apo konfirmim për vazhdimin e emërimit për të punuar në Graçanicë dhe deri sa të mos plotësohet ai kusht formal nga Këshilli Gjyqësor, ai nuk është në gjendje të vazhdojë punën e vet.
4. Më 15 maj 2015, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit e vizitoi Gjykatën Themelore në Prishtinë, Degën në Graçanicë dhe u



informua që gjykata ende nuk është funksionale, sepse gjyqtari ende nuk e ka marrë miratimin për punë, as nuk është emëruar ndonjë gjyqtar i ri në këtë degë të Gjykatës Themelore në Graçanicë.

5. Më 29 korrik 2015, Avokati i Popullit ia dërgoi një letër kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilën kërkoi që t'i dërgojnë informacione në lidhje me veprimet e ndërmarra dhe/ose të planifikuara me qëllim që lënda e ankuesit të procedohet brenda një afati kohor të arsyeshëm.
6. Më 11 gusht 2015, Avokati i Popullit mori një përgjigje nga gjyqtari i lëndës të Degës së Gjykatës Themelore në Graçanicë, në të cilën e informoi që lënda ka qenë e ndarë në punë në vitin 2013 kur janë caktuar tri seanca dhe se veprimi i fundit në këtë rast është ndërmarrë, më 26 nëntor 2013. Pas kësaj Dega e Gjykatës Themelore në Graçanicë nuk ka ndërmarrë lidhur me këtë lëndë asnjë veprim tjetër, deri në emërimin e gjyqtarit të tanishëm të lëndës, më 1 qershor 2015. Gjithashtu, në të njëjtën letër të gjyqtarit të lëndës thuhet që kjo gjykatë ka disa qindra lëndë, të cilat i janë ndarë në punë dhe se do të përpiqet sa më shpejt të jetë e mundur të fillojë me shqyrtimin e lëndës së ankuesit.
7. Më, 05 tetor 2015, ankuesi e informoi IAP që deri më sot, Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë nuk e ka caktuar asnjë seancë lidhur me lëndën e tij.

## **SIPAS FAKTEVE**

### **I. Rrethanat e rastit**

Faktet që janë konstatuar deri tani, mund të prezantohen si më poshtë:

8. Më, 25 maj 2009, ankuesi ka parashtruar ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, Dega në Graçanicë, kundër Policisë së Kosovës për shkak të largimit të paligjshëm nga vendi i punës dhe të njëjtën ankesë e zgjeroi dhe plotësoi më 3 shkurt 2011, për shkak të kompensimit të të ardhurave personale nga marrëdhënia

e punës (P.br.1084/09). Pas paraqitjes së ankesës së ankuesit, Dega e Gjykatës themelore në Graçanicë deri më 26 nëntor 2013 ka mbajtur vetëm tri seanca dhe nga ajo datë, gjykata në fjalë nuk ndërmoi më asnjë veprim në lëndën e ankuesit.

- 9.** Ankuesi paraprakisht, më 8 shkurt 2011, ka paraqitur një ankesë në IAP për shkak të vendimit të drejtorit të Policisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës për shkak të vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të ankuesit, i cili punoi në polici në pozitën e rreshterit në Departamentin për bashkëpunim me komunitete në Prishtinë, kurse më vonë u transferua në Obiliq. Ankesa u pranua nga IAP dhe u evidentua me numrin 25/2011.
- 10.** Më 11 korrik 2011, Avokati i Popullit në procedurën e hetimit, konstatoi që Policia e Kosovës me veprimet e veta, sipas ankuesit, në rastin konkret ka bërë shkeljen e të drejtave të ankuesit për punë dhe ushtrim të profesionit, me të cilën garantohet e drejta për të punuar në kuptim të Kategorisë kushtetuese (Raporti i IAP N.F. kundër Policisë së Kosovës, i publikuar më 11 korrik 2011). Avokati i Popullit me atë rast arriti në përfundim që ankuesi në mënyrë të paligjshme dhe të padrejtë është larguar nga vendi i punës dhe i ka dhënë rekomandim Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës që të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të domosdoshme dhe që pa vonesa të mëtejshme të mbrohen të drejtat e parashtruesit të ankesës, në kuptim të të drejtës për punë. Mirëpo, Ministria e Punëve të Brendshme asnjëherë nuk i është përgjigjur Raportit të AP-së, as nuk i ka zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit.
- 11.** Pas publikimit të Raportit në fjalë, IAP e përcolli lëndën e ankuesit në Gjykatën Komunale në Prishtinë, Dega në Graçanicë. Pasi gjykata në fjalë i caktoi dy seanca gjyqësore për lëndën e ankuesit, Avokati i Popullit më 01 gusht 2013 vendosi të mbyllë rastin nr. 25/2011. Mirëpo, pas mbylljes së rastit të ankuesit kundër Policisë së Kosovës, gjykata kompetente në Graçanicë,

pas marrjes së raportit të ekspertit të fushës financiare, më 26 nëntor 2013, e pezulloi punën në lëndën e ankuesit në Gjykatën në fjalë.

12. Në periudhën prej muajit janar të vitit 2014 deri në muajin shkurt të vitit 2015 ankuesi disa herë i ka dërguar urgjenca me shkrim Gjykatës themelore në Prishtinë, Degës në Graçanicë, por pa sukses.
13. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, Gjykata Themelore, në Prishtinë, Dega në Graçanicë edhe pas gjashtë vjetësh nga dorëzimi i ankesës, nuk nxori aktgjykim lidhur me lëndën e ankuesit (P.br.1084/09).

## II. Instrumentet relevante

14. Neni 1 i Ligjit për Procedurën kontestimore nr. 03/L-006 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën kontestimore 04/L-118 (në tekstin e mëtejshëm "Ligji për Procedurën Kontestimore"), në pjesën përkatëse thekson:

*“Me Ligjin për procedurën kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe..”*

15. Neni 10 pika 1. e Ligjit për Procedurën kontestimore thotë:

*“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”*

16. Neni 475. i Ligjit për Procedurën kontestimore në mënyrë të qartë thekson:

*“Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata*

*gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.”*

17. Paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut (4 nëntor 1950) (në tekstin e mëtejshëm “Konventa Europiane për të drejtat e njeriut” ose “Konventa”), thotë:

*“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga [...].”*

18. Neni 13 i Konventës Europiane për të drejtat e njeriut thotë:

*“Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instancë kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”*

## ANALIZA

### **E drejta për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm: Neni 6. i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut**

19. Ankuesi ka parashtruar ankesë për shkak të kohëzgjatjes së procedurës civile kundër asokohe Gjykatës komunale, kurse tani Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Graçanicë. Ai ankohet se është ende në pritje nxjerrjes së aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës themelore, më shumë se gjashtë vjet. Pasi gjykata në fjalë, pas katër viteve të mos veprimit në lëndën e ankuesit, caktoi tri seanca në vitin 2013, nga veprimi i fundit deri më tani ka kaluar dy vjet dhe gjykata nuk ka ndërmarrë asnjë hap procedural lidhur me lëndën në fjalë, e cila nga natyra e vet kërkon urgjencë në veprim, meqë bëhet fjalë për një kontest në fushën e marrëdhënieve të punës. Ankuesi ankohet që rasti qëndron i pazgjidhur një kohë relativisht të gjatë dhe pikërisht kjo përbën shkelje të të drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati

të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë:

*“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile [...] çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].”*

Parimi i njëjtë ekziston në nenin 10 të Ligjit për procedurën kontestimore, i cili thotë:

*“Gjykata ka për detyrë të përpiket që procedura të zhvillohet pa zvarritje [...].”*

- 20.** Në fillim, Avokati i Popullit vëren se kontestet e punës, konsiderohen si të drejta civile, në kuptim të nenit 6 të Konventës, i cili për këtë arsye është i zbatueshëm në procedurat e këtij rasti.
- 21.** Avokati i Popullit rikujton që praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane ka konstatuar që në rastet, të cilat përfshijnë caktimin e të drejtës civile, kohëzgjatja e procedurave llogaritet zakonisht nga koha e fillimit të procedurës gjyqësore (shih shembullin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, aktgjykimi i 30 shtatorit 2003.) deri në kohën kur për çështjen vendoset përfundimisht dhe/ose aktgjykimi ekzekutohet (shih *Vocaturò kundër Italisë* (II), aktgjykimi i datës 24 maj 1991).
- 22.** Avokati i Popullit vëren se procedurat e iniciuara në asokohe Gjykatën Komunale, kurse tani Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë, më 25 maj 2009 zgjasin edhe sot e kësaj dite dhe atë më se gjashtë vjet në instancën e parë gjyqësore.
- 23.** Avokati i Popullit përkujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të caktuara të çështjes, duke marrë parasysh kriteret e caktuara nga praktika gjyqësore, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndërlikueshmërinë e çështjes, sjelljen e palëve në procedurë dhe autoriteteve që punojnë në rast, si dhe asaj se çfarë është në interes të ankuesit

(shih rastin *Gollner kundër Austrisë*, aktgjykimi i datës 17 janar 2002).

24. Avokati i Popullit vëren se rasti i ankuesit nuk ishte i ndërlikuar dhe se sjellja e ankuesit nuk ka kontribuar në ndonjë vonesë.
25. Sa i përket procedurave të organeve gjyqësore, Avokati i Popullit konstaton që sipas përgjigjes nga Gjykata themelore, Degës në Graçanicë, vonesa në shqyrtimin e lëndës së ankuesit ka ndodhur për shkak se dega e Gjykatës Themelore në Graçanicë është jofunksionale, përkatësisht për shkak të mos-emërimit të gjyqtarëve në këtë degë, si dhe për shkak të stërngarkesës së gjyqtarit të procedurës (shih më lart paragrafët 3, 4 dhe 6).
26. Avokati i Popullit rikujton se në lëndën e lartpërmendur *Vocaturò kundër Italisë*, qeveria italiane deklaroi se arsyeja për vonesë në procedurë ka ardhur si rezultat i numrit të madh të lëndëve të vjetra në gjykata. Në këtë rast, Gjykata ka konsideruar që neni 6, paragrafi 1 ua imponon shteteve detyrimin që t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të tillë që gjykatat t'i plotësojnë kërkesat e Konventës. Megjithatë, ngecja e përkohshme në punë nuk e përfshin përgjegjësinë e shtetit, me kusht që me kohë të ndërmerren masat e duhura dhe të merren me situata të kësaj natyre (shih *Milasi kundër Italisë*, aktgjykimi i 25 qershorit 1987. Shih, gjithashtu, *Foti dhe të tjerët kundër Italisë*, aktgjykimi i 10 dhjetor 1982.).
27. Duke marrë parasysh sjelljen e organeve gjyqësore, Avokati i Popullit vëren se në periudhën prej 26 nëntorit 2013 deri në ditët e sotme, përkatësisht gati dy vjet Gega e Gjykatës Themelore në Graçanicë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me lëndën e ankuesit. Avokati i Popullit është i mendimit se pa marrë parasysh që dega Gjykatës Themelore në Graçanicë nuk ka qenë funksionale për një periudhë të caktuar para dhe pas vitit 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë është dashur të ndërmarrë veprime të caktuara, në mënyrë që lëndët që kërkojnë urgjencë në

zgjidhje, siç është rasti me lëndën e ankuesit, të zgjidhen brenda afatit të arsyeshëm. Fakti që Gjykata nuk e ka bërë këtë dhe me vetë mos ndërmarrjen e veprimeve e ka krijuar *status quo*-në, që tashmë zgjat gjashtë vjet që nga koha, kur ankuesi e ka parashtruar ankesën në gjykatë dhe e cila është pothuajse në të njëjtën situatë si në vitin 2009, kur e ka paraqitur padinë në gjykatë që të mbrojë të drejtat e veta në fushën e marrëdhënies së punës.

- 28.** Madje edhe nëse e marrim parasysh faktin që gjyqësori ballafaqohet me problemin e mbingarkesës me numrin e madh të lëndëve të vjetra për shkak të mungesës së gjyqtarëve, gjykatat kompetente edhe më tej janë të obliguara ta sigurojnë drejtësinë me kohë. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit gjithashtu përkujton se Neni 10 i Kodit të Procedurës Civile thotë se gjykatat do t'i "zhvillojnë procedurat pa vonesa të panevojshme".
- 29.** Në periudhën nga 26 nëntori 2013 deri në ditën e sotme, dega e Gjykatës themelore në Graçanicë nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash lidhur me lëndën e ankuesit. Si pasojë ajo as nuk e ka trajtuar rastin me kujdesin e duhur, që kërkohet në nenin 6, paragrafin 1 të Konventës dhe nenin 10 të Kodit të Procedurës Civile. Rasti para Gjykatës themelore në Prishtinë, në degën në Graçanicë nuk ishte i ndërlikuar dhe ka mund të zgjidhet lehtë dhe nuk ka ekzistuar asnjë pengesë që nuk mund të mënjanohej nga gjykata, por e cila mund të kontribuonte në një vonesë të ligjshme të shqyrtimit të lëndës. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren që çështja është e një rëndësie të veçantë për ankuesin, sepse ka të bëjë me çështjen e vendit të tij të punës dhe kthimit në vendin e punës, kurse gjykata në rastin konkret edhe pas gjashtë vjetësh nuk ka nxjerrë aktgjykim të shkallës së parë.
- 30.** Në dritën e asaj që u tha më sipër, Avokati i Popullit konsideron që dështimi i autoriteteve të rekrutojnë numrin adekuat të gjyqtarëve në degën e Gjykatës Themelore në Graçanicë (shih më

lart paragrafët 3, 4, 6), të cilët do të merreshin me vëllimin e punës, nuk mund të konsiderohet arsyetim i vlefshëm për vonesa të tilla në procedurë në degën e Gjykatës themelore në Graçanicë. Avokati i Popullit vë në pah që kjo është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të garantojnë me kohë ndarjen e kontesteve civile përmes emërimit të numrit adekuat të numrit të gjyqtarëve, ose përmes mjeteve të tjera përkatëse.

### **Konstatimi**

- 31.** Avokati i Popullit konstaton se për këtë shkak ka ardhur deri te shkelja e të drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **E drejta për zgjidhje efektive: Neni 13 i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut**

- 32.** Ankuesi parashtroi ankesë në mungesën e një mjeti efektiv në kuptim të shkeljes të të drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që përbën shkelje të të drejtës së tij për një zgjidhje efektive sipas nenit 13 të Konventës, i cili thotë:

*“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.*

- 33.** Për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut disa herë ka theksuar që vonesat e tepërta në administrimin e drejtësisë në aspektin, kur pala nuk ka mjet ligjor në dispozicion, përbën kërcënim të sundimit të ligjit brenda sistemit juridik vendor (shih, për shembull, *Bottazzi kunder Italsë*, aktgjykimi i 28 korrikut



1999 dhe *Di Mauro kundër Italisë* aktgjykimi i 28 korrikut 1999.). Avokati i Popullit rikujton gjithashtu që ndonëse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konsideron se kërkesat për një mjet efektiv ligjor duhet të interpretohen në kuptimin që mjeti juridik mund të jetë efektiv në aspektin e fushëveprimit të kufizuar të kërimit të ndihmës thelbësore në kontekstin e caktuar (*Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë* aktgjykimi i 6 shtatorit të vitit 1978.), e njëjta ka konsideruar si vijon:

*“Lidhur me dështimin e cekur që të sigurohet gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor [...] asnjë kualifikim thelbësor brenda fushëveprimit të nenit 13 nuk mund të dallohet. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, të parapara në Konventë do të diskutoheshin në favor të kufizimeve të theksuara të nenit 13 dhe do të mbaheshin minimalisht. (Kudla kundër Polonisë, aktgjykimi i datës 26 tetor 2000.). ”*

- 34.** Neni 13 pasqyrohet drejtpërdrejt në detyrimin e shteteve që përmes sistemeve të veta gjyqësore t’i mbrojnë të drejtat e njeriut dhe në këtë mënyrë t’i krijojnë garanci shtesë individit, gjë që do t’i siguronte atij ose asaj që këto të drejta t’i gëzojë në mënyrë efikase. Shikuar nga kjo perspektivë, e drejta e një personi për gjykim brenda një kohe të arsyeshme kohore do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston asnjë mundësi që të paraqitet një ankesë te autoritet shtetërorë. Dispozitat e nenit 13 i përforcojnë ato të nenit 6 (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*). Për këtë arsye neni 13 garanton një mjet ankimi efikas para autoriteteve kombëtare për shkeljen e pretenduar të dispozitave të nenit 6, për përfundimin e çështjes brenda një kohe të arsyeshme. Meqë ky rast ka të bëjë me një ankesë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
- 35.** Në kuptim të dispozitave të nenit 13 të Konventës Evropiane, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është që të kërkojë sigurimin e një mjeti ligjor vendor që të merret me

çështjen e "ankesës kontestuese" sipas Konventës dhe të japë kompensimin e duhur financiar (*Kaya kundër Turqisë* gjykimi i 19 shkurtit 1998.). Çdo mjeti i tillë juridik duhet të jetë efektiv në praktikë dhe në ligj (*Ilhan kundër Turqisë* aktgjykimi i 27 qershorit 2000.). Në lidhje me ankesën në kohëzgjatjen e procedurës, Avokati i Popullit rikujton që "mjeti ligjor efektiv" në kuptim të nenit 13 të Konventës duhet të jetë në gjendje ta parandalojë shkeljen e pretenduar, ose vazhdimin e të njëjtës, ose sigurimin e kompensimit adekuat për çfarëdo shkelje që ka ndodhur tashmë (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).

36. Avokati i Popullit vëren se nuk ekziston asnjë qasje ligjore, përmes së cilës ankuesi në rastin konkret ka mund të ankohej për zvarritjen e procedurës me mundësi të realizimit të ndihmës parandaluese apo kompensuese.

### ***Konkludim***

37. Për këtë arsye, Avokati i Popullit konstaton që ka pasur shkelje të të drejtave të ankuesit për mjet ligjor efektiv të garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **REKOMANDIME**

38. Avokati i Popullit rekomandon që kryetari i Gjykatës themelore në Prishtinë, duhet të:

- **Sigurojë, duke marrë parasysh vonesat e mëhershme, që Gjykata themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë të vazhdojë me procedimin e lëndës së ankuesit, pa vonesa të mëtejshme.**

39. Avokati i Popullit rekomandon që Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës duhet të:

- **Sigurojnë mjete financiare dhe të emërojnë numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve në Gjykatat themelore dhe degët e tyre, ose të ndërmarrin masa të tjera të nevojshme për të siguruar shqyrtimin e lëndëve si dhe dorëzimin e**

**aktgjytimeve të gjitha palëve brenda një afati të arsyeshëm kohor.**

**40.** Avokati i Popullit rekomandon që Kuvendi i Kosovës ose Qeveria e Kosovës duhet të:

- **Miratojë Ligjin ose Rregulloren, me të cilën e siguron mjetin ligjor efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, e cila do të sigurojë ndihmën parandaluese dhe kompensuese në kuptim të ankesave lidhur me kohëzgjatjet e tepruara të procedurës në rastet civile.**

Në përputhje me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr.05/L-019, Ju lutem të na informoni lidhur me veprimet që do të ndërmarrin Gjykata themelore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës në këtë drejtim, si përgjigje në rekomandimet e dhëna më sipër. Gjithashtu, Ju lutem që përgjigjet lidhur me këtë çështje t'i dërgoni jo më vonë se më 26 nëntor 2015.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Prishtinë, më 6 nëntor 2015

## **RAPORT**

**Ankesa nr. 305/2015**

**A.Z.**

Lidhur me mos ekzekutimin e vendimit të plotfuqishëm në rastin E.nr.193/2008, të datës 18 mars 2008, nga Gjykata Themelore në Prishtinë

**Për:** Z. Hamdi Ibrahim, kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë

Avokati i Popullit në Kosovë, në pajtim me nenin 135, paragrafin 3. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 16, paragrafin 8 dhe nenin 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, më datën **6 nëntor 2015** publikon raportin në vijim:

## Qëllimi i Raportit

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për ekzekutimin e vendimit të plotfuqishëm të lëndës E.nr.193/2008, të datës 18 mars 2008, pa vonesa të mëtutjeshme.

Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. A.Z., z. A.Z. dhe z. S.R. (në tekstin e mëtejshëm *ankuesi*) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

## Baza ligjore

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave”.*

## Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), të paraqitura nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

1. Më 10 mars 2008, ish Gjykata Komunale në Prishtinë, ka vërtetuar vendimin e formës së prerë për lëndën C.nr.182/2002 sipas së cilit *ankuesit* i është njohur e drejta në pronë dhe i njëjti vendim ka qenë i përbarueshëm.

2. Më 18 mars 2008, *ankuesi* ka parashtruar në gjykatë propozimin për përbarim vendimin e formës së prerë për lëndën C.nr.182/2002.
3. Më 8 dhjetor 2009, ka marrë formën e prerë aktvendimi mbi përmirësimin e aktgjykimit nr. C.nr.182/2002, të Gjykatës Komunale në Prishtinë, më 1 dhjetor 2009, sipas të cilit *ankuesi* ka fituar të drejtën të marrë në posedim pronën kontestuese.
4. Më 8 janar 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktvendimin E.nr.994/2009 ka lejuar përbarimin e lëndës.
5. Më 4 maj 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, sipas prapësimit me aktvendimin E.nr.994/2009, ka hedh kundërshtimin e personave të tretë si të palejuar.
6. Më 30 gusht 2010, Gjykata e Qarkut, me aktvendimin Ac.nr.625/2010 ka vendosur sipas ankesave të palëve të treta dhe i ka refuzuar ankesat si të pabazuara dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet për përbarim të aktgjykimit të formës së prerë.
7. Më 9 nëntor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin nr. Mlc.nr.13/2010, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit Ac.nr.625/2010, të datës 30 gusht 2010, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, E.nr.994/2009, të datës 4 maj 2010.
8. Më 10 qershor 2015, *ankuesi* ka parashtruar ankesë në IAP për zvarritje të procedurës për ekzekutim të vendimit gjyqësor nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
9. Më 2 korrik 2015, Avokati i Popullit i dërgoi letër kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes së cilës kërkoi të informohet për veprimet e ndërmarra apo ato që planifikoheshin të ndërmerren nga gjykata, për rastin e *ankuesit*.

10. Avokati i Popullit në afatin e paraparë ligjor nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata Themelore e Prishtinës.
11. Më 16 shtator 2015, Avokati i Popullit përmes letrës së dytë e ka përsëritur kërkesën për t'u informuar lidhur me veprimet e ndërmarra apo me ato që planifikoheshin të ndërmerren nga gjykata, për rastin e *ankuesit*.
12. Më 30 shtator 2015, gjyqtarja znj. M.K., përmes administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë e ka informuar Avokatin e Popullit përmes shkresës, *“Se me lëndën në fjalë është ngarkuar më 6 nëntor 2013, duke e cekur se përpjekja e Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 28 dhjetor 2011, në prezencë të Policisë së Kosovës për ekzekutim të lëndës është shtyrë për përmbarrim për datën 17 janar 2012, me arsyetim të mungesës së punëtorëve fizik të kreditorëve për ta zbrazur lokalit nga gjësundet. Në drejtim të zbatimit të përmbarrimit të lëndës E.994/09 janë të njëjtat palë si në lëndën E.nr.193/2008 dhe më 25 mars 2015, është caktuar seancë dëgjimore. Por meqenëse gjyqësori gjatë muajit mars ka qenë në grevë seanca është shtyrë ashtu si edhe lëndët tjera. Në fund të shkresës gjyqtarja bën me dije Avokatin e Popullit se gjykata në kontinuitet është duke u përpjekur që ti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme që të zbatoj deri në fund këtë procedurë përmbarrimore ”.*

### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës**

#### ***E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm/E drejta për një proces të rregullt***

13. Parimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 paragrafi 2. thekson: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të parashikuara me këtë Kushtetutë”.*
14. Vend të posaçëm në mesin e këtyre të drejtave, sipas kuptimit të nenit 31, paragrafi 1 të Kushtetutës, zë e drejta për gjykim të

drejtë dhe të paanshëm, ku theksohet: “Çdokujt i garantohet mbrojtja e njëjtë e të drejtave para gjykatës, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”. Ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen thekson: “Çdo kush gëzon të drejtën për shqyrtim publik dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

15. Neni 54, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, i Kushtetutës së Kosovës, përcakton:

“Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

16. Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së përcakton se: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”

17. Neni 13 i KEDNJ-së, parasheh të drejtën për zgjidhje efektive sipas së cilës: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

18. Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, në nenin 7 par. 2 përcakton: “Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”.



19. Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, në nenin 1. Përcakton: *“Rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe”*.
20. Ndërsa sipas nenit 10, par. 1 të po këtij ligji: *“Gjykata ka për detyrë të përpiket që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”*.

### **Analiza ligjore e rastit**

#### ***Lidhur me shkëlqen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për një proces të rregullt***

21. Duke pasur parasysh ankesën e parashtruesit lidhur me dështimin e gjykatave themelore për të vendosur në rastin e tij, Avokati i Popullit, bazuar në analizën e dëshmimeve dhe fakteve, vëren se e drejta për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm dhe e drejta për mjete efektive juridike, të garantuara me aktet ligjore të lartpërmendura, nuk është përmbushur, pasi gjykata themelore, ka zvarritur ekzekutimin e lëndës së ankuesit për më shumë se 7 vite, procedurat e së cilës janë iniciuar që nga viti 2002 dhe ende nuk janë vendosur përfundimisht deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti; se zvarritje të tepruara të procedurave gjyqësore dhe pa një zbatim të vendimit gjyqësor janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ
22. Avokati i Popullit vëren se nga viti 2002, kur *ankuesi* ka iniciuar padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kanë kaluar mbi 13 vite. Ndërsa nga data 18 mars 2008, kur *ankuesi* e ka parashtruar në gjykatë propozimin për përmbarimin e vendimit të formës së

prerë për lëndën C.nr.182/2002, kanë kaluar më tepër se 7 vite dhe se atij ende nuk i është dhënë mundësia e realizimit të së drejtës së tij pronësore, pasi lënda e tij mbetet ende në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret që rasti të mbyllet në përputhje me ligjet në fuqi.

- 23.** Avokati i Popullit konsideron se është shqetësues fakti se nga koha kur Gjykata Themelore në Prishtinë ka bërë përpjekjen e parë, më 28 dhjetor 2011, që në prezencë të Policisë së Kosovës të ekzekutojë lëndën dhe e cila është shtyrë për përmbarrim për datën 17 janar 2012, kanë kaluar më tepër se 3 vite. Për më tepër edhe sot nuk vërehet ndonjë përpjekje e gjykatës që procedurën ta përfundojë, në përputhje me ligjet në fuqi.
- 24.** Avokati i Popullit përkujton se neni 6 par. 1 i KEDNJ, nuk parashikon ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës. Në rastin konkret Gjykata Themelore në Prishtinë nuk mund të përdorë si justifikim ndërlikueshmërinë e rastit për përmbarrim të vendimit të formës së prerë me përpjekje që në kontinuitet është duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të zbatojë deri në fund këtë procedurë përmbarrimore.
- 25.** Në raste të shumta, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih rasti *Azdajic v. Slovenia*, 8 tetor 2015).
- 26.** Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në neni 6 të KEDNJ, sipas së cilës çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj (...). Në këtë rast dështimi në përmbarrimin e vendimit të formës së prerë për lëndën C.nr.182/2002, përbën shkelje të këtij neni.

- 27.** Avokati i Popullit konsideron se është shqetësues fakti se një procedurë gjyqësore 13-vjeçare, si në rastin e *ankuesit* do të krijonte një situatë të përgjithshme të pasigurisë juridike, do të zvogëlonte dhe humbiste besimin e qytetarëve në drejtësi dhe në shtetin ligjor.
- 28.** Në të vërtetë, mungesës se mjetit efektiv juridik, në kuptim të shkeljes së të drejtës së tij për shqyrtim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm kohor, që garantohet me nenin 6 të KEDNJ, përbën shkelje edhe të drejtës së tij për mjet efektiv juridik në bazë të nenit 13 të KEDNJ (shih rasti *M.A v. Qipros*, 23 korrik 2013).
- 29.** Neni 13 i KEDNJ, duke theksuar në mënyrë të veçantë obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojë të drejtat e njeriut, përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo të gëzojë këto të drejta, në mënyrë efektive.
- 30.** Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ-së. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Meqenëse rasti i *ankuesit*, ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës në shqyrtimin e rastit të tij, neni 13 i KEDNJ është i zbatueshëm.
- 31.** Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk i është vënë në dispozicion *ankuesit*, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës, në shqyrtimin e lëndës me parashikimin apo shpresën për të arritur çfarëdo lehtësimi, në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar nga gjykata.
- 32.** Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës*

*publike dhe organeve të tjera shtetërore”, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës,*

## REKOMANDON

### Gjykatën Themelore në Prishtinë

- 2. Të marrë masa të menjëhershme për ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë në lëndën E.nr. 193/2008, të datës 18 mars 2008, të ankuesit z. Alinexhat Zeqiri.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Gjykata Themelore në Prishtinë, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se më **6 dhjetor 2015**.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Kopje: - Z. Enver Peci, kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Prishtinë, më 24 nëntor 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa nr. 124/2015**

**B.P.**

**kundër**

**Komunës së Parteshit**

Për: Z. Dragan Nikoliq, kryetar i komunës së Parteshit

Lënda: Rekomandim lidhur me moszbatimin e vendimit të Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës nr.09/442, të datës 15 prill 2015, sipas të cilit ishte anuluar vendimi i kryetarit të Komunës së Parteshit nr.54/15, i datës 10 shkurt 2015, që ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 135, paragrafit 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 paragrafit 8 dhe nenit 27 të Ligjit për Avokatin e popullit nr. 05/L-019, më 24 nëntor 2015 publikon raportin në vijim:

## Qëllimi i raportit

1. Raporti është bazuar në ankesën individuale të z. B.P. (në tekstin e mëtejshëm *ankuesi*). Raporti mbështet në faktet dhe provat e palës, si dhe në shkresat e lëndës, të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me moszbatimin e vendimit të Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës nr.09/442, që ka të bëjë me shkarkimin e *ankuesit* nga pozita e asistentit administrativ të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Parteshit.
2. Ky raport ka qëllim të vlerësojë pretendimet e *ankuesit* se i janë shkelur të drejtat e tij sipas nenit 49 paragrafi 1 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas nenit 6, par.1 dhe nenit 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

## Përmbledhja e fakteve

3. Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmbliidhen si në vijim:
4. Më 2 prill 2014, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Parteshit, me vendimin nr.26/2014, e emëron *ankuesin* në pozitën e asistentit administrativ të kryesuesit të Kuvendit Komunal, në përputhje me Udhëzimin Administrativ MAPL nr.02/2014 dhe MAP nr.01/2014.
5. Më 2 prill 2014, *ankuesi* e nënshkruan kontratën e punës nr.29/2014, me Kuvendin komunal të Parteshit.
6. Më 20 maj 2014, ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, i dërgoi një përgjigje nr. 400-774, Kryetarit të Komunës së Parteshit, në të cilën thuhet: “[...] *Ju si Kryetar i Komunës duhet të ekzekutoni Vendimin e Kryesuesit të Kuvendit për futjen në listën e pagave të emëruar in e tij Asistentin Administrativ [...]*.”

7. Më 23 qershor 2014, kryetari i komunës së Parteshit, nxjerr vendim numër 622/14, sipas të cilit *ankuesi* emërohet në pozitën e asistentit administrativ.
8. Më 5 shkurt 2015, ministri i Ministrisë së Financave, i dërgoi një njoftim zyrtarëve kryesorë financiarë të organizatave buxhetore, duke ua përkujtuar Ligjin nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike.
9. Më 9 shkurt 2015, drejtori i Administratës së Komunës së Parteshit, i dërgoi një kërkesë nr.04/15, sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke kërkuar sqarim ligjor lidhur me futjen e *ankuesit* në listën e pagave të asistentit administrativ.
10. Më 10 shkurt 2015, kryetari i komunës së Parteshit, merr vendim me numër 54/15, me të cilin *ankuesit*, i ndërpritet marrëdhënia e punës në pozitën e asistentit administrativ të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Parteshit.
11. Më 13 shkurt 2015, kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës *ankuesi* ka paraqitur ankesë te kryetari i komunës së Parteshit.
12. Më 13 shkurt 2015, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Parteshit, i dërgon një njoftim kryetarit të komunës së Parteshit, sipas të cilit e njofton se vendimi i tij për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për *ankuesin* është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MAPL nr.02/2014.
13. Më 19 shkurt 2015, ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, i dërgoi një përgjigje drejtorit të Administratës së Komunës së Parteshit, në të cilën thuhet se “[...] vendimi i Kryetarit të Komunës së Parteshit për shkarkimin e asistentit administrativ të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës është në kundërshtim me nenin 5.2 Udhëzimin Administrativ MAPL nr.02/2014 dhe MAP nr.01/2014, për caktimin e stafit mbështetës

*në Komuna, ku është paraparë që marrëdhënia e punës së stafit mbështetës/asistentit administrativ pushon me përfundimin e mandatit të kryesuesit të kuvendit. MAPL, kërkon nga Kryetari i Komunës së Parteshit që të rishqyrtoj vendimin e tij për shkarkimin e asistentit administrativ të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës si dhe i njëjti të përfshihet në listën e pagave.”*

- 14.** Më 23 shkurt 2015, drejtori i Administratës së Komunës së Parteshit, i dërgoi një kërkesë nr.13/15, ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, për miratimin e pozitës së *ankuesit* si asistent administrativ i kryesuesit të Kuvendit Komunal.
- 15.** Më 10 mars 2015, *ankuesi* paraqet ankesë në Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale-Trupin Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës në Prishtinë, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga kryetari i komunës së Parteshit.
- 16.** Më 19 mars 2015, Avokati i Popullit, i dërgoi një letër kryetarit të komunës së Parteshit, duke kërkuar informata në lidhje me fazën në të cilën ndodhet procedura e *ankuesit*
- 17.** Më 7 prill 2015, përfaqësuesi i IAP-së, bisedoi me kryeinspektorin e Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, i cili deklaroi se lidhur me çështjen e *ankuesit* së shpejti do të nxirret vendim.
- 18.** Më 10 prill 2015, Avokati i Popullit, e pranoi një përgjigje nga kryetari i komunës së Parteshit, në të cilën thuhet se *“Ju siguroj se pozita e asistentit administrativ do të aktivizohet me sigurimin e mjeteve buxhetore për pozitën e lartpërmendur.”*
- 19.** Më 15 prill 2015, Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës, merr Vendim me numër 09/442, sipas të cilit aprovohet ankesa e *ankuesit* dhe anulohet vendimi i kryetarit të Komunës së Parteshit nr.54/15, i datës 10 shkurt 2015, për shkak se vendimi i kryetarit të komunës së Parteshit, është marr në kundërshtim me ligjin dhe



Udhëzimin Administrativ MAPL nr.02/2014 dhe MAP nr.01/2014.

20. Më 24 prill 2015, kundër vendimi të organit të shkallës së parë të Inspektoratit të punës në Gjilan, drejtori i Administratës së Komunës së Parteshit, parashtroi ankesë nr.51/15, në organin e shkallës së dytë i Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
21. Më 6 maj 2015, drejtori i Administratës së Komunës së Parteshit, sërish i dërgoi një kërkesë nr.59/15, Ministrisë së Administratës Publike, për qëndrim ligjor mbi ligjshmërinë e vendimit nr.26/2014 dhe kontratës së punës nr.29/2014, të datës 2 prill 2015, të nxjerra për *ankuesin* nga ana e të kryesuesit të kuvendit komunal nr.02.04.2014.
22. Më 30 maj 2015, organi i shkallës së dytë i Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, me vendimin nr.67/2015, e vërteton vendimin e shkallës së parë të Trupës Ekzekutive Inspektoratit të Punës nr.54/15, të datës 10 shkurt 2015 dhe e refuzon si të pabazuar ankesën e komunës së Parteshit nr.51/2015, të datës 4 maj 2015.
23. Më 18 qershor 2015, Avokati i Popullit, i dërgoi një letër përkujtuese kryetarit të komunës së Parteshit, duke kërkuar informacion lidhur me atë se çfarë planifikon apo çfarë ka ndërmarrë tashmë, komuna në drejtim të zbatimit të vendimit të inspektoratit, lidhur me rastin e lartpërmendur.
24. Më 6 korrik 2015, Avokati i Popullit, e mori një përgjigje nga kryetari i komunës së Parteshit, në të cilën thuhet “[...] Lidhur me zbatimin e vendimit të TEIP, nr.67/2015, të datës 02.06.2015, Ju lutem të kontaktoni kryesuesin e Kuvendit Komunës së Parteshit.”
25. Më 29 qershor 2015, Kuvendi i Komunës së Parteshit, me vendimin nr.57/15 për rishikim të buxhetit për vitin 2015, parasheh edhe shumën prej 2.100 euro për pagesën e pagave të

asistentit administrativ të kryesuesit të Kuvendit Komunal për periudhën korrik-dhjetor 2015 si dhe shumë prej 1.750 euro për pagesën retroaktive të pagave për asistentin administrativ (*ankuesin*), për periudhën shkurt-qershor 2015.

26. Më 2 shtator 2015, Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës në Gjilan, me vendimin nr.02/b-1095/15, ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej pesëmijë euro kryetarit të komunës së Parteshit, për shkak të mos përfilljes së dispozitave të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-212 i Punës, lidhur me mos pagesën e pagave të *ankuesit*.

### **Baza ligjore e veprimit të Avokatit të Popullit**

27. Neni 135, par.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozoj masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Gjithashtu, neni 53 i Kushtetutës, përcakton *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
28. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 1, *“Avokati i Popullit ka kompetenca për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.”*
29. Ndërsa, neni 18 par.1.2. përcakton se Avokati i Popullit, ka edhe këto përgjegjësi: *“Të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë*

*mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”.*

### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Kosovë**

- 30.** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 53, përcakton se:  
*“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”* Ndërsa neni 49 paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton se: *“E drejta e punës garantohet.”*
- 31.** Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejtë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike.
- 32.** Në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se :*“Në përcaktimin e drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm.”*
- 33.** Neni 13 i KEDNJ garanton: *“Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*
- 34.** Ligji nr.03/L-212 i Punës, neni 55 paragrafi.1, përcakton se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.”*
- 35.** Ndërsa sipas nenit 67 pika 1, të Ligjit të Punës, kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet:
  - 1.1. me vdekjen e punëtorit;*
  - 1.2. me vdekjen e punëdhënësit, kur puna e kryer apo shërbimet e ofruara nga punëtori janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vazhdohet me pasardhësit e punëdhënësit;*
  - 1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;*

- 1.4. kur i punësuar i e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjetëve;
- 1.5. në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësive për punë;
- 1.6. nëse i punësuar i shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se gjashtë(6) muaj;
- 1.7. me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërprerjen e marrëdhënies së punës;
- 1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes;
- 1.9. raste tjera të përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.

**36.** Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) nr.02/2014 dhe Ministrisë së Administratës Publike (MAP) nr.01, përcakton se:

*“Me qëllim të ofrimit të mbështetjes së kryetarit të komunës në ushtrimin e përgjegjësive dhe ofrimit të ndihmës teknike/administrative, kryetari mund të emëroj deri në tre(3)nëpunës në kabinetin e tij, ndërsa Kryesuesi një(1) nëpunës. “(neni 2 paragrafi.1)*

*“Nëpunësi i cili emërohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës do të ketë pozitën asistent/e administrative. “( neni 2, parag.3)*

*“Asistent/e e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës 280 €( dyqind e tetëdhjetë euro). “( neni 3, parag.1.4)*

*“Stafi mbështetës në zyrën e kryetarit të komunës dhe kryesuesit të kuvendit të komunës nuk e kanë statusin e nëpunësit civil. “( neni 5, parag.1)*

*“Marrëdhënia e punës e stafit mbështetës i cili emërohet nga kryetari i komunës/kryesuesi i Kuvendit të komunës pushon me përfundimin e mandatit të kryetarit/kryesuesit, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët. “(neni 5, parag.2)*

**Analiza ligjore**

- 37.** Duke pasur parasysh ankesën e parashtruesit, i cili ankohet për dështimin e komunës së Parteshit, për të vendosur lidhur me rastin e tij, Avokati i Popullit, vëren se kemi zvarritje të

paarsyeshme për zbatimin e vendimit të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, të datës 15 prill 2015, gjë që është në kundërshtim me të drejtën e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 (*shih. Vihlo Eskelien dhe të Tjerë k. Finlandës [GC],nr. 63235/00, 19 prill 2007*) dhe me nenin 13 të KEDNJ-së, i cili thekson në mënyrë të veçantë dhe shprehimisht obligimin e shtetit që, në radhë të parë, të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit ligjor, të ofroj garanci shtesë për një individ që ai t'i gëzoj këto të drejta në mënyrë efektive. Pra neni 13 i garanton individit, mjete efektive ankimit te autoritetet vendore, për shkelje të pohuara të të drejtave, ndërsa neni 6, parasheh shqyrtimin e rastit brenda një kohe të arsyeshme.

38. Avokati i Popullit, vëren se vendimi i organit të shkallës së dytë i Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, i datës 30 maj 2015, ishte i formës së prerë dhe detyrues dhe se deri më sot nuk është zbatuar nga ana e komunës së Parteshit.
39. Po ashtu, Avokati i Popullit dëshiron të vë në dijeni se të drejtat e *ankuesit*, janë të garantuara edhe sipas nenit 49 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe vendimi i kryetarit të komunës së Parteshit në këtë rast nuk ka të bëjë me zbatimin e ligjit, por ka të bëjë me pengimin e zbatimit të ligjit.
40. Avokati i Popullit thekson se vendimi i kryetarit të komunës Parteshit, për shkarkimin e *ankuesit* nga pozita e asistentit administrativ të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës është në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MAPL nr.02/2014 dhe MAP nr.01/2014 për caktimin e stafit mbështetës në komuna ku është paraparë që marrëdhënia e punës së stafit mbështetës/asistentit pushon me përfundimin e mandatit të Kryesuesit të Kuvendit.
41. Avokati i Popullit konstaton se veprimet e Komunës së Parteshit, përkatësisht vendimi i kryetarit të komunës, ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, përkatësisht nenin 31 të Kushtetutës i cili përcakton se
42. *”Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*

**43.** Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”. Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2. të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit “(..) *ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.*”

Prandaj, Avokati i Popullit

### **Rekomandon që**

- **Kryetari i Komunës së Parteshit të ndërmerr masa të menjëhershme për zbatimin e vendimit të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, Nr.09/442, të datës 15 prill 2015.**

Në pajtim me nenin 135 pika 3 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutemi që të na informoni për veprimet që do të ndërmerr komuna e Parteshit, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje, ta dërgoni në një afat të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se më 24 dhjetor 2015.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Kopje: Ministrin të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Njësisë për të Drejtat e Njeriut, Komuna e Parteshit.

Prishtinë, më 25 nëntor 2015

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

**Ankesa nr. 290/2015**

**H.B.**

**kundër**

Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, Azil  
dhe Migrim (DSHAM)

Komisioni i ankesave për shtetësi (KASH)

Për: Z. Skender Hyseni

Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Slaviša Mladenović

Komisar për gjuhë

Avokati i Popullit i Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 135, paragrafin 3, si dhe Ligjin për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, nenin 16, paragrafin 1 dhe nenin 18, paragrafin 1.2, më 25 nëntor 2015 publikon raportin në vijim:

## I. PËRMBLEDHJA E FAKTEVE NË RAST

Faktet, provat dhe informacionet të cilat i disponon IAP mund të paraqiten si më poshtë:

1. Më, 17.6.2014, z. H.B. (në tekstin e mëtejme: *ankuesi*) përmes komunës së Istogut parashtrori kërkesë për shtetësinë e Republikës së Kosovës (RK), e regjistruar me nr.1724/14.
2. Më 24.9.2014. DSHAM, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave të bashkëngjitura në procedurën e shkallës së parë, mori vendimin nr.1724/14, me të cilin refuzohet e drejta e ankuesit për regjistrimin e shtetësisë RK në regjistrin e shtetasve.
3. Më 5.12.2014, ankuesi mori vendimin nr.1724-1714, nga DSHAM, i cili është nxjerrë në gjuhën serbe dhe e nënshkroi konfirmimin për pranimin e vendimit në fjalë, i cili konfirmim ankuesit i është dhënë për nënshkrim vetëm në gjuhën shqipe. Në vendimin në fjalë mbiemri i ankuesit është shkruar gabimisht, nuk është shkruar ashtu siç ai e ka shkruar në kërkesën e tij dhe dokumentacionin e bashkëngjitur.
4. Më 23.12.2014, ankuesi përmes avokatit të tij, me kohë e parashtrori një ankesë në MPB-DSHAM-KASH, kundër vendimit të shkallës së parë nr. 1724/14, të cilës ia bashkëngjiti dëshmitë shtesë, të cilat janë evidentuar siç duhet në tekstin e ankesës dhe i njëjti gjithashtu tërhoqi vëmendjen dhe kërkoi që gabimi në mbiemrin e tij të korrigjohet.
5. Më 10.2.2015, KASH në procedurën e shkallës së dytë, e shqyrtoi ankesën e ankuesit kundër vendimit të shkallës së parë dhe mori vendimin nr.15/2015, me të cilin refuzohet ankesa e ankuesit dhe konfirmohet vendimi i shkallës së parë nr. 1724/14, i datës 24.9.2014. Edhe në këtë vendim është përsëritur i njëjti gabim në mbiemrin e ankuesit.
6. Më 4.6.2015, ankuesi shkoi në MPB-DSHAM, me qëllim që të informohet a ka mbajtur KASH ndonjë seancë dhe a ka nxjerrë



ndonjë vendim lidhur me ankesën e tij të paraqitur kundër vendimit të shkallës së parë, të datës 23.12.2014. Me atë rast, ai mezi ia doli të merret vesh në gjuhën serbe me zyrtarin dhe më pas ai e mori vendimin e KASH nr.15/2015, në gjuhën shqipe dhe ankuesit ia japin të nënshkruajë konfirmimin për pranimin e vendimit në fjalë, nr.1322, të datës 4.6.2015, i cili gjithashtu ishte në gjuhën shqipe, të cilën ankuesi e kupton shumë pak. Ankuesi shprehu pakënaqësinë e tij para zyrtarit të DSHAM dhe kërkoi që vendimi në fjalë të përkthehet dhe t'i jepet në gjuhën serbe, për çka zyrtari iu përgjigj duke i thënë që për përkthimin e vendimit në fjalë ai duhet të bëjë një kërkesë të veçantë.

## **II. Veprimet e institucionit të avokatit të popullit**

7. Më 4.6.2015, z. H.B. paraqiti një ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), me akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare në procedurë para organit kompetent, të drejtës për shtetësi, si dhe mosrespektimin e rregullores së punës të KASH, me rastin e ushtrimit të autorizimeve ligjore, gjatë vendosjes sipas kërkesës së ankuesit për pranimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës. Ankuesi, gjithashtu, thekson se në vendimet e organit në fjalë në shkallën e parë dhe të dytë, emri i tij është shkruar gabimisht.
8. Më 8.6.2015, z. H.B. parashtoi ankesën në IAP kundër MPB-së lidhur me refuzimin e kërkesës për shtetësi dhe përdorim të gjuhëve zyrtare, e cila u regjistrua me numrin A.nr.290/2015.
9. Më 9.6.2015, në procesin e hetimeve, këshilltarja ligjore e IAP në një takim me drejtorin e DSHAM, e prezantoi rastin e ankuesit dhe kërkoi qasje në lëndën e ankuesit, me ç' rast u morën vesh për një takim të dytë për më 12.6.2015, me qëllim që të diskutohet për vendimin e shkallës së parë të DSHAM-së. Të njëjtën ditë, këshilltarja ligjore e IAP-së vizitoi edhe kryetarin e Komisionit të ankesave për shtetësi në lëndën e ankuesit, por ai nuk ishte në dispozicion për bisedë.

10. Më 12.6.2015, në takimin e dytë me drejtorin e DSHAM-së dhe shefin e Divizionit për Shtetësi/palë përgjegjëse, këshilltarja ligjore e IAP-së e shikoi dosjen e rastit, në bazë të kërkesës nr.1724/14 të datës 17.6.2014 dhe më pas nga pala përgjegjëse kërkoi shpjegime lidhur me: mos respektimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, në kuptim të nenit 1, 2 dhe 4, mënyrën se si është bërë vlerësimi i dokumenteve të dorëzuara të ankuesit për shtetësi, informimin e ankuesit për datën e shqyrtimit të ankesës në kuptim të nenit 10 të UA për themelimin dhe përcaktimin e rregullores së punës të Komisionit të ankesave për shtetësi dhe njoftimin e palës për vendimin e KASH-it.

Pala përgjegjëse deklaroi se konsideron që dokumentacioni i paraqitur në rastin e ankuesit nuk e dëshmoi plotësimin e kushteve sipas kuptimit të nenit 32 të Ligjit për shtetësi nr.04/L-215, si dhe nenit 3 dhe 4 të UA nr.05/2014 për kriteret që përfshijnë dëshmi për shtetësinë e ish RSFJ dhe banimit të përhershëm në territorin e Kosovës deri më 1 janar 1998, kurse çështja e përdorimit të gjuhës së palës në procedurë në vendimin e shkallës së dytë, KASH është dashur ta marrë parasysh përdorimin e gjuhëve si dhe respektimin e procedurave të parapara me UA. nr. 06/2014. Sa i përket informimit të palës për vendimin e KASH-it, është konstatuar që ankuesi nuk është njoftuar brenda afatit të paraparë ligjor, edhe pse ankuesi në kërkesën e tij ka shënuar numrat e telefonave të tij kontaktues, ndërsa në dosje gjendej edhe ankesa me adresën e avokatit të autorizuar. Këshilltarja ligjore e IAP-së gjatë takimit i rekomandoi palës përgjegjëse, që në afat sa më të shkurtër të bëhet përkthimi i vendimit të KASH, nr. 15/2015, në gjuhën serbe, të cilën e flet ankuesi, si dhe të bëhet përkthimi i shkresës për konfirmim të pranimin të vendimit, të cilat i janë dhënë ankuesit për t'i nënshkruar, kurse në vendimet nr.1724/2014 dhe nr.15/2015 të korrigjohet gabimi në mbiemrin e ankuesit dhe të njëjtat vendime t'i dërgohen ankuesit.

11. Më 26.6.2015, ankuesi e njoftoi këshilltaren ligjore të IAP-së, se më 24.6.2015 e mori një thirrje me telefon nga DSHAM, me të cilën e ftuan që të vijë ta marrë vendimin në fjalë të KASH-it, të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe se në të dy vendimet e DSHAM është bërë korrigjimi i gabimit në mbiemrin e ankuesit. Më 26. 6.2015, ankuesi i mori të njëjtat dhe nënshkroi një konfirmim të ri për pranim nr.2971, të datës 26.6.2015, i cili kësaj radhe i është dhënë i shtypur në të dy gjuhët zyrtare dhe nga kjo ditë i rrjedh afati për përdorimin e mjeteve ligjore në dispozicion.
12. Më 27.7.2015, ankuesi e informoi këshilltaren ligjore të IAP-së, se më 23.7.2015 e parashtroi një ankesë kundër vendimit të KASH nr. 15/2014, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, departamenti për çështje administrative.
13. Më 10.8.2015, këshilltarja ligjore e IAP-së, pas disa përpjekjesh, caktoi dhe mbajti një takim me kryetarin e KASH-it, lidhur me rastin e ankuesit. Në takim u shqyrtua procedura në procesin e marrjes së vendimit nr.15/2015, në kuptim të nenit 10 dhe 14 UA nr.06/2014, si dhe vlerësimi i dokumenteve të bashkangjitura ankesës së ankuesit. Këshilltarja ligjore e IAP-së kërkoi qasje në procesverbalin e mbledhjes së KASH-it, me qëllim që nga ai të mund të informohet për rrjedhat e seancës dhe shqyrtimin e dëshmive në rastin konkret, por i njëjti nuk iu dha, kështu që mbeti e paqartë a është mbajtur apo jo ndonjëherë procesverbal, gjë që është obligim sipas nenit 14, paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2014. Kryetari i KASH-it deklaroi se sa i përket procedurës Komisioni nuk i ka kushtuar vëmendje, nëse në rastin e ankuesit, DSHAM, që kryen punët e sekretarisë për KASH, i ka përmbushë detyrimet e veta, në kuptim të nenit 10 të udhëzimit në fjalë, as që ua ka përkujtuar Komisioni, me rastin e caktimit të takimit, detyrimin e paraparë me Rregulloren e punës. Pasi këshilltarja ligjore kërkoi një opinion mbi vlerësimin e disa provave, të cilat i paraqiti ankuesi në IAP si: kopjen e dokumentit

rezervë të letërnjoftimit të ish-Jugosllavisë nr. SK119805, një kopje të letërnjoftimit CP10774513, vërtetimin e Komunës së Istogut nr.05/2014, të datës 11.06.2014, me të cilin konfirmohet qëndrimi i ankuesit në Kosovë nga viti 1965 deri në vitin 1999, i cili është lëshuar për qëllim të rregullimit shtetësisë së ankuesit dhe një kopjeje të pasaportës së RSFJ-së nr. 095.456, e vlefshme prej 22.8.1994 deri 22.8 1999. Kryetari i KASH shpjegoi se në dosjen e ankuesit nuk kanë qenë të gjitha provat e shënuara në ankesën e ankuesit, ndër të tjera, edhe kopja e pasaportës së Jugosllavisë, sepse po t'i kishte parë ai këto dëshmi, me siguri do të kishte vendosur në favor të ankuesit. Këshilltarja ligjore e IAP-së, pas parashtrimit të kryetarit të KASH-it, konstatoi që KASH-i nuk i ka shqyrtuar dhe vlerësuar me kujdes të gjitha provat, sepse i njëjti dokument është i evidentuar në arsyetimin e vendimit të KASH-it, që do të thotë se ai dokument i është paraqitur KASH-it si provë, që në mënyrë të pakontestueshme e vërteton rezidencën e ankuesit në pajtim me nenin 32. të Ligjit për shtetësi të Kosovës dhe nenet 3 dhe 4 të UA nr.05/2014, si dhe vërtetimi i cituar i lëshuar nga komuna e Istogut.

### III. Instrumentet relevante

14. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta e RK), në nenin 5 paragrafin 1 definojnë: *“Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.”*
15. Kushtetuta e RK, në nenin 14 definojnë: *“Fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me ligj.”*
16. Kushtetuta e RK, në nenin 24, paragrafët 1 dhe 2 definojnë:  
*“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*

2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*”
17. Kushtetuta e RK, në nenin 31 definon: *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
18. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi Nr. 05/L -021, në nenin 1, paragrafi 1 theksohet: *“[...] Përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, [...] ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”*
19. Ligji për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37 (në tekstin e mëtejme Ligji për përdorimin e gjuhëve) thotë: *“Status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të drejta të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës.”*
20. Ligji për përdorimin e gjuhëve në nenin 2 thotë:
- “2.1. Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës”*
- 2.2. Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës.”*
21. Ligji për përdorimin e gjuhëve në nenin 4 thotë:

*“4.1. Në institucionet qendrore të Kosovës zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare.”*

*4.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga institucionet qendrore të Kosovës në cilëndo gjuhë zyrtare. Të gjitha institucionet qendrore kanë për detyrë të sigurojnë që çdo person mund të komunikojë dhe mund të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga organet dhe institucionet e tyre në cilëndo gjuhë zyrtare.”*

22. Ligji për Shtetësinë e Kosovës Nr. 04/L-215, në nenin 32, paragrafët 1, 3 dhe 4 thuhet:

*“1.Të gjithë personat të cilët më 1 janar 1998 kanë qenë shtetas të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe që me këtë datë e kanë pasur banimin e përhershëm në Republikën e Kosovës konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës dhe regjistrohen si të tillë në regjistrin e shtetasve pa marrë parasysh vendbanimin ose shtetësinë që posedojnë aktualisht.*

*3.Regjistrimi i personave të përcaktuar në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni në regjistrin e shtetasve bëhet me kërkesë të personit që plotëson kushtet e parapara në këtë nen.*

*4.Organi kompetent përcakton me akt nënligjor kriteret në bazë të të cilave vërtetohet posedimi i shtetësisë së Republikës Federative të Jugosllavisë dhe banimi i përhershëm në Republikën e Kosovës më datën 1 janar 1998.”*

23. Ligji për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 (në tekstin e mëtejshëm: LPA) neni 3, paragrafi 1 thotë: *“Parimi i ligjshmërisë 3.1. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”*

24. LPA, neni 5, paragrafi 2, thotë: “5.2. Organet e administratës publike nuk bëjnë dallimet lidhur me personat fizikë dhe juridikë si: gjini, racë, ngjyrë, gjuhë, opinion politik ose opinion tjetër, origjinë kombëtare ose sociale, pasuri, lindje ose ndonjë status tjetër, gjatë veprimtarisë administrative.”
25. LPA, neni 55, paragrafi 1, thotë: “Organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara me Ligj.”
26. LPA, neni 56, paragrafi, 2 thotë: “Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët e interesuara mund t’iu bashkëngjisin kërkesave për fillimin e procedimit administrativ dokumente ose fakte të ndryshme. Palët e interesuara munden gjithashtu t’i kërkojnë organit kompetent të administratës publike që të marrë masat e nevojshme për të siguruar përdorimin e provave të zotëruara prej tij gjatë zhvillimit të procedimit administrativ.”
27. LPA, nenin 112 thotë: “Aktet administrative duhet të njoftohen brenda tetë ditëve nga dita kur është nxjerrë, akti me përjashtim të rasteve kur me ligj është paraparë afat tjetër.”
28. Udhëzim administrativ (MPB) nr. 05/2014 për kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish RSFJ-së dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës me 1.1.1998 (në tekstin e mëtejshmë UA. nr.05/2014), në nenin 3 paragrafët 1, 3 dhe 4 thuhet:
- 1.Të gjithë persona që me 1 janar 1998 kanë qenë shtetas të ish Republikës Federative të Jugosllavisë dhe që me këtë datë kanë pasur banimin e përhershëm në Kosovë dhe që dokumentojnë statusin e tyre, konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës dhe regjistrohen si të tillë në regjistrin e shtetasve.”
- 3.Për të dëshmuar shtetësinë e ish RFJ-së, personi duhet të paraqes një nga dokumentet zyrtare të përcaktuara me poshtë dhe të lëshuara para 1 janarit 1998 ose ndonjë dëshmi tjetër:

3.1. *Certifikata e shtetësisë së ish RFJ;*

3.2. *Certifikata e lindjes, certifikata e martesës;*

3.3. *Pasaporta e RFJ-së letërnjoftimi i RFJ-së;*

3.4. *Çdo dokument tjetër që vërteton shtetësinë e RFJ-së.”*

4. *Në mungesë të dokumenteve zyrtare nga paragrafi 3 i këtij neni mund të merret parasysh edhe ndonjë dëshmi tjetër përfshirë edhe dëshmitë që vërtetojnë se ky person i ka plotësuar të gjitha kushtet në shtetësinë e RFJ-së. DSH në kuadër të MPB-së i vlerëson këto dëshmi dhe merr vendimin përkatës.”*

29. UA.05/2014, neni, 4 paragrafi 1, pika 1.2, thotë:

*“Personi e dëshmon se ka qenë banor i përhershëm i Kosovës me 1 janar 1998, sipas nenit 32 të Ligjit Nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, pavarësisht vendbanimit dhe shtetësisë së tanishme të tyre, nëse plotëson ndonjërin nga këto kritere:*

*1.2.Ka banuar në Kosovë për një periudhë të pandërprerë prej së paku 5 vjetësh para 1 janarit 1998;”*

30. Udhëzimi administrativ (MPB) nr. 06/2014 për themelimin dhe përcaktimin e rregullave të punës së KASH-it. (në tekstin e mëtejshëm UA.nr. 06/2014), në nenin 4 thotë: *“DSHAM/DSH do të shërbej si sekretari e Komisionit të Ankesave për Shtetësi.”*

31. UA.nr. 06/2014 për themelimin dhe përcaktimin e rregullave të punës së KASH, neni 10, paragrafët 1, 2 dhe 3 thotë:

*“1.Sekretaria do ta njoftojë palën ankuese jo më vonë se tetë (8) ditë para datës së seancës së Komisioni të Ankesave për Shtetësi, se do ta shqyrtoj ankesën.*

*2.Ky njoftim do t'i ofroj palës ankuese mundësinë të kërkoj që brenda afatit prej tri (3) ditësh, në qoftë se pala ankuese dëshiron të ketë një dëgjim para Komisionit të Ankesave për Shtetësi.*



*Qëllimi i dëgjimit është që palës ankuese t'i jepet mundësia për të sqaruar ankesën.*

*3.Në qoftë se pala ankuese nuk paraqet kërkesë për dëgjim brenda afatit kohor, Komisioni i Ankesave për Shtetësi mund ta shqyrtoj ankesën në seance duke u bazuar në shkresat e dorëzuara.”*

32. UA.nr. 06/2014, nenin 11, paragrafët 1, 2 dhe 3 thotë:

*“1.Pala ankuese dhe DSH kanë të drejtë të jenë prezent në seancën e shqyrtimit të ankesës.*

*2.Pala ankuese mund të përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar ligjor me shkrim.*

*3.Palët do të lajmërohen me shkrim për kohën datën dhe vendi ku do të mbahet seanca, më së paku tre (3) ditë para se të mbahet seanca.“*

33. UA.nr. 06/2014, neni 14, paragrafët 1 dhe 2, thotë: *“1. Për çdo seancë të Komisionit të Ankesave për Shtetësi mbahet procesverbal me shkrim i cili nënshkruhet nga kryesuesi të gjithë anëtarët e pranishëm dhe procesmbajtësi.“*

34. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (10 dhjetor 1948), neni 15 thotë:

*“1.Secili ka të drejtën e një shtetësie.*

*2.Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij, e as nga e drejta për të ndërruar shtetësinë.“*

35. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950), në nenin 6, paragrafi 1 (në tekstin në vijim Konventa), në pjesën përkatëse thotë: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet [...].”*

#### IV ANALIZA

36. Që në fillim, Avokati i Popullit vëren se dispozita koncize e nenit 15 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut e vitit 1948, çdo individ, pa marrë parasysh ku ndodhet, i jep të drejtën për një lidhje ligjore me shtetin në bazë të shtetësisë, si një nga të drejtat themelore të njeriut.
37. Meqë statusi i shtetësisë është një kusht i rëndësishëm për fitimin e shumë të drejtave (politike, civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera), është e domosdoshme zgjidhja urgjente e kësaj çështjeje dhe autoritetet kompetente shtetërore janë të detyruara t'i respektojnë aktet ligjore dhe t'i heqin pengesat administrative, të cilat mund të çojnë deri te ndonjë formë e diskriminimit të cilitdo qytetar në procesin e fitimit të shtetësisë, me qëllim që të lehtësohet realizimi i çështjeve të statusit, sepse shtetësia mund të përshkruhet si *“e drejtë për t’u gëzuar të drejtat”*.
38. I njëjti parim është përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 24, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 31, i cili çdo personi i garanton mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim në çfarëdo baze, si dhe mbrojtje të barabartë të të drejtave para organeve shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike, gjë që më konkretisht është e rregulluar me Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi nr. 05/L-021.
39. Në rastin konkret, Avokati i Popullit përkujton se çështja e statusit të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, si dhe përdorimi i tyre i barabartë në të gjitha institucionet e Kosovës, është rregulluar me Kushtetutë (neni 5) dhe me Ligjin për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37 dhe kjo çështje si e tillë, pa përjashtim dhe plotësisht duhet të respektohet dhe zbatohet, sepse në bazë të fakteve të pakontestueshme në lëndën e ankuesit, të renditura në pikat 10 dhe 11 të këtij raporti, kjo nuk është respektuar.

40. Avokati i Popullit konstatoi se ka pasur shkelje të të drejtës së ankuesit në përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës. Kjo e drejtë e ankuesit, është sjellë në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, vetëm pas rekomandimeve të këshilltares juridike të IAP.
41. Avokati i Popullit përkujton që parimi i trajtimit të ligjshëm, në kuptim të nenit 3, paragrafit 1 të LPA, u jep parashtruesve të kërkesave garanci të caktuara, përfshirë edhe që *“Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjislacionin [...] brenda kufijve të kompetencave [...] dhe konform qëllimit.”*
42. Sa i përket vetë procedurës së organeve kompetente të MPB-së, në rastin konkret, duke u nisur nga faktet e pakontestueshme, të përcaktuara në pikën 12 të këtij raporti, Avokati i Popullit konstaton që në kuptim të nenit 10 të UA nr. 06/2014, nuk është respektuar rregullorja e punës dhe ankuesi nuk është informuar për datën shqyrtimit të ankesës së tij para KASH, me çka ankuesit nuk i është dhënë mundësia dhe i është mohuar e drejta të marrë pjesë, ose të jetë i përfaqësuar nga një avokat në procesin e shqyrtimit të të njëjtës dhe të ofrojë sqarime shtesë në lidhje me kërkesën e tij. Përkatësisht, atij i është mohuar mundësia t'i përcjellë procedurat, të marrë pjesë në të dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e lejuara ligjërisht në procedurat administrative në kuptim të dispozitave përkatëse të LPA-së. Një veprim i tillë mund të karakterizohet si arbitraritet i autoritetit kompetent të MBP gjatë ushtrimit të juridiksionit të vet dhe si i tillë paraqet pengesë për qasje në të drejta.
43. Avokati i Popullit është i mendimit që DSHAM-KASH, në kuptim të nenit 55, paragrafi 1, të LPA, për shkak të rëndësisë të të drejtës për të cilën vendoset, është dashur të shfrytëzohë edhe metoda të tjera për të dëshmuar, të cilat për një autoritet kompetent, janë shumë lehtë të qasshme për të bërë verifikimin e

provave, të bëjë inspektimin në evidencën ekzistuese të dokumenteve personale të qytetarëve nga periudha para 1 janarit 1998, të cilat i disponon ministria.

*“55.1. Organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara me Ligj.”*

44. Sa i përket shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të paraqitura në rastin konkret dhe në bazë të fakteve të verifikuara të paraqitura në pikën 12 të këtij raporti, interpretimit të ligjit dhe vetë procedurës, Avokati i Popullit vëren se MBP-DSHAM-KASH nuk i kanë shqyrtuar me kujdesin e duhur të gjitha provat në shkresat e lëndës dhe për këtë arsye në procesin e vendimmarrjes janë bërë gabime materiale dhe formale.
45. Në kuptim të vlerësimit të provave të paraqitura në rastin konkret, duke u nisur nga gjendja faktike e paraqitur në pikën 12 të këtij raporti, Avokati i Popullit është i mendimit se ankuesi i plotëson kërkesat në pajtim me nenin 32 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës; nenin 3, paragrafin 1.3 dhe 4, dhe nenin 4, paragrafin 1.2. UA 05/2014. Për regjistrimin në regjistrin e shtetasit të Republikës së Kosovës.

## **KONKLUDIMI**

46. Si rrjedhojë e asaj që u tha më lart, Avokati i Popullit konstaton se gjatë procedurës administrative MBP-DSHAM-KASH, si organ kompetent në rastin konkret e ka shkelur të drejtën e ankuesit për shtetësi, të drejtën e ankuesit për të përdorur gjuhën dhe të drejtën për një gjykim të drejtë, të drejta këto të garantuara me dispozitat ligjore në fuqi.

## REKOMANDIMET

Avokati i Popullit rekomandon Ministrinë e Punëve të Brendshme që:

- *Të sigurojë që gjatë veprimtarisë administrative DSHAM-KASH të marr në konsideratë dhe t'iu jap peshën që u takon të gjithë faktorëve që lidhen me një akt të caktuar administrativ. DSHAM duhet të vendosë një balancim të drejtë mes interesave publike dhe interesave private në mënyrë që të evitohen ndërhyrjet e panevojshme në të drejtat dhe interesat e personave fizikë dhe juridikë. Përfundimi i rastit në Gjykatë nuk përbën mjet efektiv juridik duke pasur parasyshë zgjatjen e proceseve gjyqësore përtej afateve të arsyeshme, e që paraqet cenim të të drejtave të përcaktuara me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës.*
- *Të sigurojë që në të gjitha rastet kur vendoset për shtetësi DSHAM-KASH gjatë procedurës vendimmarrëse të respektojë Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.*

Në përputhje me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr.05/L-019, Ju lutem të na informoni lidhur me veprimet që do t'i ndërmarrë MBP e Kosovës lidhur me këtë çështje, si përgjigje në rekomandimet e dhëna më sipër. Gjithashtu, Ju lutem që përgjigjet lidhur me këtë çështje t'i dërgoni brenda afatit të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se më 25 dhjetor 2015.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Prishtinë, më 16 dhjetor 2015

Isa Musafa, Kryeministër

Qeveria e Republikës së Kosovës

Ndërtesa e Qeverisë

## **Rekomandim**

### **lidhur me**

Strategjitë për mbrojtjen e drejtave dhe lirive të njeriut të hartuara nga  
Zyra për Qeverisje të Mirë / ZKM

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme, si dhe bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Mbrojtja, avancimi dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut janë obligim shtetëror dhe ato duhet t’iu përmbahen marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Republika e Kosovës i ka përfshirë në nenin 22 të Kushtetutës<sup>66</sup> marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare më të rëndësishme për të

---

<sup>66</sup> “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*

(2) *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*

(3) *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*

(4) *Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*

(5) *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;*

(6) *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*

drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat njëkohësisht janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.

Këto instrumente ndërkombëtare kanë rëndësi të posaçme në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për shkak se ato zbatohen drejtpërdrejt edhe në raste kur ka mangësi apo zbrazëti të shprehura në legjislacionin e brendshëm të Kosovës.

Roli kushtetues i Avokatit të Popullit është të *“mbikëqyrë dhe mbrojtë të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”*.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Avokatin e Popullit kanë përcaktuar mandatin e Avokatit të Popullit për të pranuar dhe për të hetuar ankesa nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga autoritetet publike në Kosovë.

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t’i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, por edhe mund t’i këshillojë dhe t’i rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Prandaj, Avokati i Popullit, duke u bazuar në kompetencat kushtetuese dhe përgjegjësitë ligjore, ka vërejtur se ZQM me “Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2015” ka paraparë nxjerrjen e strategjive dhe planeve të veprimit për strategjitë aktuale për të krijuar politika më efikase, të qëndrueshme dhe të bashkërenduara në fushën e të drejtave dhe të lirive të njeriut, ku ZQM është përgjegjëse e aktiviteteve. Në këtë drejtim, deri në fund të vitit 2015 pritet hartimi i disa dokumenteve të tjera strategjike për periudhën 2016-2020, e që janë:

---

(7) *Konventa për të Drejtat e Fëmijës;*

(8) *Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.* “

- *Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës;*
- *Plani Strategjik për të Drejtat e Fëmijëve;*
- *Plani Strategjik për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet; dhe*
- *Plani i Veprimit për integrimin e komuniteteve RAE.*

Aktualisht janë në zbatim e sipër gjashtë (6) strategji, tri prej të cilave përfundojnë sivjet, si:

- *Strategjia për integrimin e komuniteteve RAE në Republikën e Kosovës (2009-2015);*
- *Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në Republikën e Kosovës (2009-2015); dhe*
- *Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2013-2015).*

Ndërkaq, tri dokumente të tjera janë në zbatim e sipër, si:

- *Programi Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave dhe personat e shurdhër në Republikën e Kosovës (2013-2016);*
- *Strategjia Qeveritare dhe Plani i Veprimit për bashkëpunim me shoqërinë civile (2013-2017); dhe*
- *Strategjia Nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës (2013-2023).*

Nga të paraqiturat më lart shihet se Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht ZQM e ZKM-së është e angazhuar në politikat për avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, duke hartuar dokumente strategjike të fushave të caktuara, gjë që është për t'u vlerësuar, por shtrohet çështja e koordinimit të mirëfilltë të strategjive, duke pasur parasysh faktin se kemi disa dokumente strategjike dhe se njëherësh ato kanë mekanizma të veçantë, që merren me koordinimin e zbatimit të



këtyre dokumenteve dhe të monitorimit të zbatimit të tyre. Duke u bazuar në gjetjet e lartshënuara, Avokati i Popullit vëren se ZQM ka hartuar disa dokumente strategjike për të drejtat e njeriut, prandaj duke u nisur nga fakti se të drejtat e njeriut janë unike dhe të patjetërsueshme **rekomandojmë** që në nivel qendror të kemi një strategji për të drejtat dhe liritë e njeriut, e cila do të përfshinte të gjitha strategjitë e fushave të të drejtave të njeriut.

Nga takimi i zëvendësit të Avokatit të Popullit me koordinatoren e ZQM-së jemi informuar se për çdo dokument strategjik ekziston mekanizmi përkatës institucional që koordinon procesin e zbatimit të tij, si dhe monitoron zbatimin e dokumentit dhe raporton për këtë. Këta mekanizma janë në nivel politik (Komiteti ndërministror për integrimin e komuniteteve RAE; Komiteti ndërministror për të drejtat e fëmijëve; Këshilli nacional për personat me aftësi të kufizuar; Këshilli për bashkëpunim me shoqërinë civile) dhe në nivel teknik (grupet punuese teknike).

Andaj, Avokati i Popullit thekson se një dokument strategjik unik për të drejtat e njeriut, do t'i shërbejë Qeverisë së Republikës së Kosovës si orientues për të krijuar politika më efikase, të qëndrueshme dhe të bashkërenduara në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe se një dokument i tillë do të ishte shumë më praktik e më i lehtë për monitorim nga organizatat vendore e ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndërkaq procesi i zbatimit do të mund të monitorohej nga një mekanizëm i vetëm qeveritar.

Nga praktika e deritanishme, Avokati i Popullit, vëren se mekanizmat e nivelit politik të emëruar nga Qeveria janë organe përgjegjëse për të monitoruar progresin dhe vështirësitë e implementimit të strategjisë dhe planit të veprimit për të drejtat e njeriut dhe për t'i raportuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, në baza vjetore, për zbatimin e përgjithshëm të strategjisë për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Nga të gjeturat e theksuara më lart, vërehet se raportimet për zbatimin e strategjive i janë paraqitur Qeverisë së Republikës së Kosovës nga

mekanizmat e themeluar nga Qeveria, pra faktikisht kemi një gjendje ku hartimi i dokumenteve strategjike për të drejtat e njeriut dhe raportimi për zbatimin e tyre janë në të njëjtin institucion - në Qeveri. Prandaj, gjithashtu rekomandojmë që Ju i nderuar z. Kryeministër, në kuadër të raportimeve tuaja para Kuvendit të Republikës së Kosovës të përfshini edhe raportimin për të drejtat e njeriut në baza vjetore, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të Republikës së Kosovës (dhe jo vetëm kur kërkohet nga ky Komision) për zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit.

Së këndejmi, Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjitha informatat dhe dëshmitë e theksuara si më sipër, me qëllim të ngritjes të performancës dhe të efikasitetit të institucioneve publike në fushën e mbrojtjes, të promovimit dhe të avancimit të të drejtave të njeriut, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “[...]Jep rekomandime dhe propozon masa, atëherë kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”, si dhe me nenin 18. paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “Avokati i Popullit mund t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës”, me shpresë që bashkërisht do të ndihmojë në avancimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, e konsideron të arsyeshme të jep këto

***Rekomandime:***

- ***Qeveria e Republikës së Kosovës, mundësisht të hartojë një dokument të vetëm strategjik për fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, ku do të përfshiheshin të gjitha strategjitë e veçanta për të drejtat e njeriut.***
- ***Me Komisionin për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të***

***Republikës së Kosovës dhe ZQM-në të diskutohen gjetjet e zbatimit të strategjive për të drejtat e njeriut.***

Në pajtim me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019 dhe nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ju lutemi që të na informoni për veprimet që do të ndërmerren si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Gjithashtu, shprehim gatishmërinë tonë në qoftë se ju e shini të nevojshme të ofrojmë sqarime shtesë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë ta dërgoni brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditë.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit